

# LIGJ PËR UJËRAT

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
 Закон за водите

**Teksti në  
gjuhën Angleze**  
 Law on Waters

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Lënda e rregullimit

(1) Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësore, duke i përfshirë edhe rrjedhat e përhershme ose rrjedhat në të cilat herëpashershëm rrjedh uji, liqenet, akumulimet dhe burimet, ujërat nëntokësore (në tekstin e mëtejshëm: ujërat), truallin buzë bregut dhe vendbanimet ujore dhe menaxhimin e tyre, duke e përfshirë edhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, si dhe mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave; objektet dhe shërbimet e ekonomive ujore; vendosjen organizative dhe financimin e menaxhimit me ujërat, si dhe kushtet, mënyrën dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohen ose të lëshohen ujërat.

(2) Për rregullimin e çështjeve lidhur me: qasjen te informatat që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me menaxhimin me ujërat, vlerësimin e ndikimit nga strategjitë e caktuara, plan-programet mbi mjedisin jetësor, vlerësimin e ndikimeve nga projektet e caktuara mbi mjedisin jetësor, pengimin dhe kontrollin e avarive me praninë e materieve të rrezikshme, përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në mjedisin jetësor dhe lejet e integruara ekologjike për punën e instalimeve që ndikojnë në mjedisin jetësor, zbatohen dispozitat e Ligjit për mjedisin jetësor, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj, zbatohet Ligji për procedurën e përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

### Neni 2

#### Qëllimet e Ligjit

Qëllimet e këtij ligji janë që të sigurohet:

- qasja te sasi të mjaftueshme të ujit cilësor, në pajtim me parimet për menaxhimin e qëndrueshëm me ujërat: për pije dhe për prodhimin e ushqimit, për nevojat e bujqësisë, industrisë, nevojat hidroenergjetike, për nevojat e parqeve dhe sipërfaqeve të tjera publike, turizmit, lundrimit dhe për nevojat e tjera;
- mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i përhershëm i resurseve ujore në dispozicion, përmirësimi i gjendjes së truallit buzë bregut, ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji, mbrojtja dhe përparimi i mjedisit ujor përmes shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të ujërave, si dhe zvogëlimin progresiv të lëshimeve të dëmshme dhe eliminimit gradual të lëshimeve të materieve dhe substancave të dëmshme në ujëra;
- zbutja e pasojave nga veprimi i dëmshëm i ujërave dhe nga mungesa e

ujit;

- mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës, i ekosistemeve ujore dhe i llojlojshmërisë biologjike dhe mbrojtja e shëndetit të njerëzve.

### Neni 3

#### Zbatimi i ligjit

(1) Menaxhimi me ujërat është veprimtari me interes publik, që kryhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Zbatimi i masave të parapara me këtë ligj, nuk guxon që drejtpërdrejt ose tërthorazi të shkaktojë rritjen e ndotjes së ambienteve dhe rajoneve të mjedisit jetësor ose zvogëlimin e cilësisë ekzistuese të ujit.

(3) Të gjitha masat, standardet dhe qëllimet e mjedisit jetësor, zbatohen si kërkesa minimale, që duhet të plotësohen gjatë menaxhimit me ujërat.

(4) Nëse me këtë ligj ose me ligj tjetër, janë përcaktuar masat, standardet dhe qëllimet e mjedisit jetësor, gjatë menaxhimit me ujërat zbatohen masat dhe standardet më rigorozë, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe arritjes së qëllimeve të mjedisit jetësor.

### Neni 4

#### Definicione

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijon:

1. **Ujëra** janë ujërat sipërfaqësore, duke i përfshirë edhe rrjedhat e përhershme ose rrjedhat në të cilat herëpashershëm rrjedh uji, liqenet, akumulimet, burimet dhe ujërat nëntokësore;
2. **Ujëra sipërfaqësore** janë të gjitha ujërat rrjedhëse dhe jorrjedhëse, në sipërfaqen e tokës;
3. **Ujëra nëntokësore** janë ujërat që gjenden nën sipërfaqen e tokës, në zonën e mbushjes dhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me sipërfaqen e ujit ose me nënshtresat;
4. **Ujëra të brendshme** është uji jorrjedhës ose rrjedhës në sipërfaqen e tokës, si dhe uji nëntokësor nga ana që shkon në tokë, nga vija themelore nga e cila matet gjerësia e ujërave territoriale;
5. **Lum** është trupi i brendshëm ujqor që rrjedh përherë ose herëpashershëm në sipërfaqen e tokës, por që mundet në një pjesë të rrjedhës së vet të rrjedhë edhe nën tokë;
6. **Liqen** është trupi ujqor i brendshëm i palëvizshëm;
7. **Trup ujqor artificial** është trupi ujqor sipërfaqësor, i krijuar me veprimin e njeriut;
8. **Trup ujqor i ndryshuar me forcë** është trupi ujqor sipërfaqësor, karakteri i të cilit është ndryshuar me forcë, si rezultat i modifikimeve fizike të shkaktuara nga veprimi i njeriut, në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
9. **Trup ujqor sipërfaqësor** është elementi i veçantë dhe i rëndësishëm i ujit sipërfaqësor, si liqen, pellg, lum ose kanal, akumulim, rrjedhë uji ose pjesë e rrjedhës së ujit, lumit ose kanalit;
10. **Trup ujqor nëntokësor** është vëllimi i caktuar i ujit nëntokësor, në kuadër të shtresës ujëmbajtëse ose shtresave ujëmbajtëse;
11. E drejta për ujë është e drejtë e personave juridike dhe fizike që të

shfrytëzojnë ujëra dhe/ose të lëshojnë ujëra, e drejtë e shfrytëzimit të ujërave nga trupa ujqorë dhe e drejtë e lëshimit në trupa ujqorë, të fituara me kusht, mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj;

12. **Shtresë ujëmbajtëse** janë shtresa ose shtresat në sipërfaqësore të shkëmbinjve ose formacioneve të tjera gjeologjike, me porozitet dhe lëshim të mjaftueshëm të ujit, që mundësojnë nxjerrjen e sasive të rëndësishme të ujërave nëntokësore;

13. **Rrjedhë lumi** është sipërfaqja nga trualli prej të cilit të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen përmes një vargu përrenjsh, lumenjsh dhe/ose liqenesh, në det në një grykë lumi, estuar ose deltë;

14. **Nënrrjedhë lumi** është sipërfaqja nga trualli prej të cilit të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen përmes një vargu përrenjsh, lumenjsh dhe/ose liqenesh, në një pikë konkrete të një rrjedhe uji, më shpesh liqen ose rrjedhë lumi;

15. **Rajon i rrjedhës** së lumit është rajoni që përbëhet nga një apo më tepër rrjedha fqinje lumenjsh, duke i përfshirë edhe ujërat plotësuese nëntokësore dhe buzë brigjeve;

16. **Gjendje e ujit sipërfaqësor** është të shprehurit e përgjithshëm e gjendjes së trupit ujqor sipërfaqësor, e përcaktuar varësisht nga ajo nëse është në gjendje më të keqe ekologjike ose kimike;

17. **Gjendje e ujit nëntokësor** është shprehje e përgjithshme për gjendjen e trupit ujqor nëntokësor, e përcaktuar varësisht nga ajo nëse është në gjendje më të keqe sasiore ose kimike;

18. **Gjendje ekologjike** është shprehje për kualitetin e strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujqore, të lidhur me ujërat sipërfaqësore dhe të klasifikuara, në pajtim me metodologjinë e vlerësimit nga neni 71 i këtij ligji;

19. **Qëllime të mjedisit jetësor** janë qëllimet e përcaktuara në nenin 72 të këtij ligji;

20. **Potencial i mirë ekologjik** është gjendja e trupit ujqor të ndryshuar me forcë ose e trupit ujqor artificial, të klasifikuar në pajtim me metodologjinë për vlerësim nga neni 71 i këtij ligji;

21. **Gjendje e mirë kimike e ujit sipërfaqësor** është gjendja kimike që i plotëson qëllimet ekologjike për ujërat sipërfaqësore, të përcaktuara me dispozitat nga neni 90 i këtij ligji, përkatësisht gjendja kimike e arritur në një trup ujqor, ku koncentrimet e materieve dhe substancave ndotëse, nuk i tejkalojnë standardet për kualitetin e mjedisit jetësor;

22. **Gjendje e mirë kimike e ujit nëntokësor** është gjendja kimike që i plotëson kushtet për trupin nëntokësor ujqor, të përcaktuara me dispozitat nga neni 92 i këtij ligji;

23. **Gjendje sasiore** është shprehja për shkallën e ndikimit në trupin nëntokësor ujqor, përmes nxjerrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ujit;

24. **Gjendje e mirë sasiore** është gjendja e përcaktuar me dispozitat nga neni 92 i këtij ligji;

25. **Standard për cilësinë e mjedisit jetësor** është koncentrimi i materies ose substancës konkrete ndotëse, ose i një grupi materiesh dhe substancash ndotëse në ujë, fundërrin ose në florën dhe faunën e përgjithshme, i cili nuk duhet të tejkalohet që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi jetësor;

26. **Materie dhe substanca të dëmshme** janë materiet dhe substancat ose një grup materiesh dhe substancash që janë toksike, rezistuese dhe të nënshtruara në bioakumulim, dhe materie dhe substanca të tjera ose një

grup materiesh dhe substancash që shkaktojnë nivel ekuivalent të rrezikut;

**27. Materie dhe substanca të rrezikshme** janë materiet dhe substancat që shkaktojnë ndryshime në përbërjen ose karakteristikat fizike, kimike, biologjike dhe bakteriologjike, si dhe në karakteristikat radiologjike të ujërave, deri në shkallën që mund ta kufizojë ose ta pamundësojë shfrytëzimin e tyre për qëllime të caktuara;

**28. Materie dhe substanca parësore** janë materiet dhe substancat e identifikuar në pajtim me dispozitat nga neni 107 i këtij ligji, duke i përfshirë edhe materiet dhe substancat parësore të dëmshme, për të cilat duhet të ndërmerren masa në pajtim me nenin 109 të këtij ligji;

**29. Materie ndotëse** është secila materie që shkakton ndotje dhe është e përcaktuar me dispozitat nga neni 107 i këtij ligji;

**30. Lëshim i drejtpërdrejtë në ujin nëntokësor** është futja e drejtpërdrejtë e materieve dhe substancave ndotëse në ujin nëntokësor, pa filtrim nëpër tokë ose nëpër nënshtresa.

**31. Ndotje e ujit** është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e materieve dhe substancave ose nxehtësisë në ujë nga ana e ndotësit, që mund ta rrezikojnë shëndetin e njerëzve ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore, që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore;

**32. Ndotës** është personi juridik ose fizik, i cili me veprimin e vet e kryen ndotjen e ujit;

**33. Shërbime të ekonomisë ujore** janë të gjitha shërbimet me të cilat sigurohet: përfshirja, nxjerrja, akumulimi, trajtimi dhe distribuimi i ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore; ose grumbullimi dhe pastrimi i ujërave të zeza, që sillen te ujërat sipërfaqësore;

**34. Vlerë e kufizuar për lëshim** është masa e shprehur në aspekt të parametrave të caktuara specifike, koncentrimi dhe/ose niveli i lëshimit, që nuk guxojnë të tejkalohen gjatë një apo më tepër periudhash kohore, e të cilat mund të jenë të përcaktuara për grupe, familje ose kategori materiesh dhe substancash të caktuara, dhe të cilat rëndom zbatohen në pikën në të cilën lëshimet dalin nga instalimi, me ç'rast gjatë përcaktimit të tyre nuk përfillet shpërbërja. Lidhur me lëshimet e tërthorta në ujë, efektet nga njëri stacion për pastrimin e ujërave të zeza, mund të merren parasysh gjatë përcaktimit të vlerave kufizuese për lëshim, për instalimet lëndore, me kusht që të jetë i garantuar niveli përkatës i mbrojtjes së mjedisit jetësor si tërësi, dhe me kusht që kjo të mos çojë në ngritjen e nivelit të ndotjes së mjedisit jetësor;

**35. Kontrolle të lëshimit** janë kontrollet që kërkojnë kufizimin specifik të lëshimit, si vlerë kufizuese për lëshimin, ose përcaktim tjetër i kufijve ose i kushteve për efektet, natyrën ose i cilësive të tjera të një lëshimi, ose i kushteve të punës që ndikojnë në lëshimet;

**36. Ujë i ëmbël** është uji që paraqitet në mënyrë të natyrshme dhe që ka koncentrim të ulët të kripërave, dhe është i pranueshëm si i preferueshëm për shfrytëzim dhe trajtim, me qëllim që të fitohet uji i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut;

**37. Ujë për banjë** është pjesa e çdo uji sipërfaqësor rrjedhës ose jorrrjedhës, në të cilin lejohet larja nga ana e organit kompetent, ose në të cilin larja nuk ndalohet dhe tradicionalisht e praktikojnë një numër i madh pushuesish. Si ujë për banjë sipas këtij ligji, nuk konsiderohen ujërat në pishina dhe në pishina me ujë burimi, ujërat në banja që shfrytëzohen për qëllime terapeutike dhe ujërat e rrethuara artificialisht, të ndara nga ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore;

**38. Sezon për banjë** është periudha në të cilën pritet numër i madh pushuesish;

39. **Ujëra të zeza urbane** janë ujërat e zeza nga amvisëritë ose përzierja nga ujërat e zeza nga amvisëritë dhe ujërat e zeza industriale dhe/ose uji nga të reshurat;
40. **Ujëra të zeza nga amvisëritë** janë ujërat e zeza nga vendbanimet me ndërtesa dhe nga kapacitetet shërbyese, me prejardhje kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe nga aktivitetet shtëpiake;
41. **Ujëra të zeza industriale** janë të gjitha ujërat e zeza që dalin nga hapësirat që shfrytëzohen për kryerjen e veprimtarisë tregtare ose industriale, përveç ujërave të zeza nga amvisëritë dhe ujit nga të reshurat;
42. **Banor-ekuivalent (në tekstin e mëtejshëm: b.k.)** është ngarkesë organike bioshpërbërëse e ujërave të zeza, që ka kërkesë pesëditore biokimike të oksigjenit (KBO5) prej 60 gr oksigjeni në ditë;
43. **Eutrofikim** është pasurimi i ujit me përbërës ushqyes, veçanërisht me komponime azotike ose fosforike, që shkakton zhvillim të shtuar të algëve dhe të llojeve më të larta bimore, që krijon prishje të padëshirueshme të baraspeshës së organizmave të pranishëm në ujë dhe të kualitetit të ujit në fjalë;
44. **Ujëra ndërshtetërore** janë ujërat që paraqesin kufi shtetëror, ose e ndajnë kufirin shtetëror;
45. **Hidrosistem** është tërësia hidroteknike ose organizative teknike, që përbëhet nga objekte ose stabilimente të ekonomisë ujore, me të cilat rregullohet regjimi i ujërave, sigurohet dhe silltet uji, si dhe objektet për kullimin e ujërave të zeza, objektet mbrojtëse për kullimin e ujërave të tepërta, sipërfaqësore dhe nëntokësore;
46. **Sistem për ujitje dhe kullim (Sistem hidromeliorativ)** është tërësia hidroteknike ose organizative teknike, që përbëhet nga objekte dhe stabilimente të ekonomisë ujore, për sigurimin dhe sjelljen e ujit për ujitje të truallit bujqësor dhe tjetër (sistemi për ujitje), dhe objekte dhe stabilimente për pranimin e tepicës së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe të tjera dhe dërgimin i tyre te marrësi (sistemi për kullim);
47. **Pikë burime të ndotjes** është vend i qëndrueshëm ose stabiliment i palëvizshëm, nga i cili lëshohen materie dhe substanca ndotëse, përkatësisht burim i veçantë i përcaktuar (gyp, kanal, anije, minierë dhe ngjashëm);
48. **Burime të shtrira të ndotjes** janë aktivitete të shpërndara në masë të gjerë, ku nuk mund të identifikohet burimi i veçantë i përcaktuar (plehurat, plehurat organike, pesticidet, materiet dhe substancat biocide dhe ngjashëm);
49. **Veprim i dëmshëm** është veprimi që ndikon dëmshëm në ujë, trupin ujqor, vendbanimet ujore ose në resurset e tjera ujore, përkatësisht veprimi që mund të shkaktojë lëndime të kafshëve, bimëve ose të njerëzve që e konsumojnë ujin, ose jetojnë në ujë apo afër ujit, trupit ujqor, vendbanimeve ujore ose resurseve të tjera ujore;
50. **Truall buzë bregut** është brezi prej 50 metrash truall, i larguar nga kufiri nëpër të cilën ka rrjedha ujore të përhershme apo stinore, lumenj, liqej ose burime;
51. **Menaxhim me ujërat** janë masat dhe aktivitetet për arritjen e qëllimeve të këtij ligji, përkatësisht për shfrytëzimin racional dhe efikas të ujërave, zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave;
52. **Vendbanim ujqor** është sipërfaqja që ka pasqyrë ujore, duke i përfshirë edhe moçalet, kënetat dhe sipërfaqet e tjera të cekëta ujore;
53. **Ujë nëntokësor në disponim** është shkalla afatgjate mesatare

vjetore e mbushjes së përgjithshme të trupit ujor nëntokësor, e zvogëluar për shkallën vjetore afatgjate të rrjedhjes, që është e nevojshme për arritjen e qëllimeve ekologjike për kualitetin e ujërave shoqëruese sipërfaqësore, që të evitohet përkeqësimi i konsiderueshëm i gjendjes ekologjike të atyre ujërave dhe të evitohet çdo dëmtim i konsiderueshëm i ekosistemeve shoqëruese tokësore;

54. **Qasje e kombinuar** është kontrolli i lëshimeve në ujërat sipërfaqësore, në pajtim me qasjen nga neni 91 i këtij ligji;

55. **Dezinfektim i ujit për pije** është aplikimi i mjeteve fizike dhe kimike, me veprimin e të cilave sigurohet që uji për pije të mos përmbajë materie dhe substanca bakteriologjike dhe biologjike, që janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve, nëse janë të pranishme mbi kufijtë e lejuar;

56. **Sistem i vendit për furnizim me ujë** është: gypi, pajisja dhe aparatet e instaluar ndërmjet musllukëve, që rëndom shfrytëzohen për konsumin e ujit, nga ana e njeriut dhe rrjeti i ujësjellësit;

57. **Gjendje e mirë ekologjike** është gjendja e trupit ujor sipërfaqësor, i klasifikuar në pajtim me metodologjinë për vlerësim, nga neni 71 i këtij ligji;

58. **Gjendje e mirë e ujit nëntokësor** është gjendja që e arrin një trup ujor nëntokësor, kur edhe gjendja sasiore edhe kimike janë së paku "të mira";

59. **Gjendje e mirë e ujit sipërfaqësor** është gjendja që e arrin një trup ujor sipërfaqësor, kur edhe gjendja sasiore edhe kimike, janë së paku "të mira";

60. **Ndotje** është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e materieve dhe substancave ose e nxehtësisë në ajër, ujë ose tokë, nga ana e ndotësit, që mund të jetë e dëmshme për shëndetin e njeriut ose për cilësinë e ekosistemeve ujore apo tokësore, që drejtpërdrejt varen nga ekosistemet ujore, e me çka dëmtohet prona materiale ose prishet gjendja e të mirave natyrore;

61. **Ujë i dedikuar për konsum nga ana e njeriut** përkatësisht ujë për pije, është:

- çdo ujë në gjendje origjinale ose pas trajtimit, i dedikuar për pije, gatim, përgatitjen e ushqimit ose për nevoja të tjera shtëpiake, pa dallim se prej nga vjen ose nëse furnizohet nga rrjeti i ujësjellësit, nga cisterna, nga shishet ose në enë;

- uji që shfrytëzohet për prodhimin e ushqimit, përpunimin, konservimin ose shitjen e prodhimeve apo materieve dhe substancave për konsumim nga ana e njeriut, përveç nëse organi kompetent konfirmon se cilësia e ujit nuk mund të ndikojë në sigurinë e prodhimit të gatshëm ushqimor;

62. **Furnizim publik i popullatës** me ujë është furnizimi me ujë për pije i më shumë se pesë amvisërive, përkatësisht më shumë se 20 qytetarëve, furnizimi nga objektet personale të ndërmarrjeve dhe personave të tjerë juridikë që prodhojnë dhe/ose kryejnë qarkullim me ushqim dhe pije dhe furnizim të objekteve publike (institucioneve arsimore-edukative, institucioneve shëndetësore, personave juridikë nga sfera e veprimtarisë turistike hoteliere, komunikacionit etj.);

63. **Pasurim natyror** është procesi me të cilin pa intervenimin e njeriut, materie dhe substanca të caktuara transportohen nga trualli në ujë, dhe nuk e rrezikon shëndetin e njeriut;

64. **Organ kompetent** për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e menaxhimit me ujërat dhe rrjedhës së lumit, është organi që kryen punë profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, i themeluar me Ligjin për mjedisin jetësor;

65. **Person fizik** është tregtari individual, kryerësi i veprimtarisë dhe

qytetari;

66. **Marrës** është trupi uJOR, trualli buzë bregut dhe vendbanimi uJOR, që i pranojnë ujërat e lëshuara në pajtim me nenin 79 të këtij ligji, si dhe sistemet e kanalizimit dhe sistemet për kullim, në të cilat lëshohen ujërat, nëse të njëjtat nuk janë të përfshira në sistemin e përbashkët për shkarkim dhe trajtim me ujërat e zeza.

## Neni 5

Parimet për menaxhim të qëndrueshëm me ujërat Në pajtim me qëllimet për mbrojtjen afatgjate dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm, menaxhimi me ujërat, truallin buzë bregut dhe vendbanimet ujore, bazohet në:

1. **Konceptin ekologjik social dhe ekonomik** – Ujërat janë pjesë e proceseve natyrore dhe duhet të mbrohen si vendbanime të florës dhe faunës. Me menaxhimin me ujërat sigurohet realizimi i interesit publik, i përcaktuar me këtë ligj dhe ligj tjetër, në mënyrën me të cilën do të sigurohet menaxhimi i qëndrueshëm me ujërat.

2. **Parimin e kujdesisë** – Nëse ekziston rreziku se aktiviteti i caktuar mund të shkaktojë veprim të dëmshëm në ujërat, ose veprim të dëmshëm nga ujërat, por për atë nuk ka dëshmi shkencore, ndërmerren masa të bazuara në vlerësimin përkatës të rrezikut, të domosdoshme që të sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së ujërave dhe nga ujërat, para se të bëhet e kapshme dëshmia shkencore, se veprimi i dëmshëm mund të ndodhë.

3. **Parimin e parandalimit** – Masat dhe aktivitetet e domosdoshme për mbrojtjen e ujërave dhe për mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave, truallit buzë bregut dhe vendbanimeve ujore, duhet të merren në fazën e hershme, duke e penguar që të paraqitet rreziku, ose të vijë te çfarëdo pasojash të dëmshme për ujërat, truallin buzë bregut dhe vendbanimet ujore.

4. **Parimin e minimizimit të përdorimit të resurseve** – Gjatë kryerjes së aktiviteteve që do të mund të kenë ndikim në ujërat dhe jetën dhe shëndetin e njerëzve, secili është i obliguar që të silllet me kujdes dhe në mënyrë të arsyeshme t'i shfrytëzojë ujërat, ta pengojë ndotjen e ujërave, dhe të anashkalojë efekte dhe rreziqe të tjera negative, për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin jetësor.

5. **Parimin e integritetit** – Gjatë menaxhimit me ujërat, doemos duhet të kihet parasysh lidhja e ndërsjellë e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore, raporti i tyre me truallin buzë bregut, vendbanimet ujore, ekosistemet e varura nga uji dhe me ambiente të tjera të mjedisit jetësor, pajtimi i institucioneve dhe konsumatorëve të involvuar drejtpërdrejt dhe lidhja me sektorët e tjerë, bashkëpunimi për çështjet e ujërave ndërkombëtare, si dhe integrimi i masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e ujërave në të gjitha dokumentet zhvillimore, strategjike, të plan-programeve, që i miratojnë organet e Republikës së Maqedonisë dhe njësitë e vetadministrimit lokal.

6. **Parimin "ndotësi pagan"** – Ndotësi i ujërave dhe truallit buzë bregut, i kompenson shpenzimet për kthimin në gjendjen e përparshme të ujërave dhe truallit buzë bregut.

7. **Parimin "kompensimi i shpenzimeve"** – Shfrytëzuesi i ujit i kompenson të gjitha shpenzimet që janë bërë me ofrimin e shërbimit të ekonomisë ujore, në të cilat përfshihen edhe shpenzimet e resursit uJOR që e shfrytëzon dhe shpenzimet për mjedisin jetësor, në pajtim me parimin "ndotësi pagan".

8. **Parimin e pengimit të ndotjes në vendin e ndodhjes së ndotjes** – Lëshimi i materieve dhe substancave ndotëse, pengohet në vendin e ndodhjes së tyre.

9. **Parimin e perspektivës kohore** – Afatet kohore në planet dhe në vendimet për menaxhim me ujërat, duhet të përkojnë me perspektivën kohore të efekteve të pritura.

10. **Parimin e pjesëmarrjes së opinionit dhe qasjes te informatat** – Opinioni duhet të ketë qasje të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen e ujërave dhe menaxhimin me ujërat, e veçanërisht te informatat që janë të nevojshme për pjesëmarrjen e tij, në procedurën për miratimin e vendimeve që kanë të bëjnë me menaxhimin me ujërat.

11. **Parimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara** – Organet kompetente janë të obliguara që të sigurojnë, se në procedurën për miratimin e dispozitave, dokumenteve strategjike, të plan-programeve dhe vendimeve që kanë të bëjnë me menaxhimin me ujërat, do të merren parasysh interesat e palëve të interesuara.

12. **Parimin e universalitetit të shërbimeve të ekonomisë ujore** – Universaliteti i shërbimeve të ekonomisë ujore, sigurohet përmes: mosdiskriminimit, qëndrueshmërisë së shërbimit, kualitetit dhe efikasitetit, transparencës, çmimit të pranueshëm ekonomik dhe mbulimit të tërësishëm në sferën e kryerjes së shërbimeve.

## Neni 6

### Regjimi juridik i ujërave

(1) Ujërat si të mira me interes të përgjithshëm, janë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, dhe gëzojnë mbrojtjen e veçantë në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Ujërat nuk janë lëndë e së drejtës së pronësisë të personave fizikë dhe juridikë, pa dallim nga regjimi juridik i truallit në të cilin gjenden.

(3) Akumulimi, përfshirja, nxjerrja, shfrytëzimi, ndryshimi i drejtimit, dërgimi dhe lëshimi, si dhe veprimet e tjera ndaj ujërave, kryhen në kushte, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Ndalohet çfarëdo lëshimi i ujërave të zeza, materieve dhe substancave në ujëra, përveç në kushte, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

## Neni 7

### Menaxhimi me ujërat nëpër rajonet e rrjedhave të lumenjve

(1) Menaxhimi me ujërat kryhet nëpër rajonet e rrjedhave të lumenjve, në njësitë hidrografike të ndara me ujëndarëse të rrjedhave të lumenjve, duke e pasur parasysh lidhjen e ndërsjellë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, me ç'rast kufijtë administrativ territorial në rajonin e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, nuk do të paraqesin pengesë për menaxhimin e integruar me rajonet e rrjedhave të lumenjve.

(2) Territorin e Republikës së Maqedonisë e përbëjnë katër rajone të rrjedhave të lumenjve, dhe atë rajonet e rrjedhave të lumenjve Vardari, Drini i Zi, Strumica dhe Morava Jugore.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton kufijtë e rajoneve të rrjedhave të lumenjve, me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 8



## Kompetenca

(1) Menaxhimi me ujërat, truallin buzë bregut dhe vendbanimet ujore është në kompetencë të organeve të administratës shtetërore, me përjashtim të atyre punëve që sipas këtij ligji, janë në kompetencë të organeve të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(2) Menaxhimi me ujërat është në kompetencë të organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përveç nëse nuk është e rregulluar ndryshe me këtë ligj.

(3) Menaxhimin me rrjedhat e lumenjve e kryen organi i administratës shtetërore, kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përmes njësive të veta organizative, të formuara veç e veç për secilin rajon të rrjedhës së lumit nga neni 7 i këtij ligji.

(4) Organet të cilat sipas këtij ligji ose ligjit tjetër, janë kompetente për aktivitete të caktuara nga sfera e mjedisit jetësor, janë të obliguara që në çdo kohë pavarësisht ose në pajtim dhe/ose bashkëpunim me organin tjetër kompetent, t'i ndërmarrin masat e nevojshme për realizimin e qëllimeve të ligjit nga neni 2 i këtij ligji.

## Neni 9

### Menaxhimi me ujërat nëpër rajonet ndërkombëtare të rrjedhave të lumenjve

Për vendosjen dhe menaxhimin me rajonet e rrjedhave ndërkombëtare të lumenjve me shtetet përkatëse fqinje, për rajonet e rrjedhave të lumenjve në territorin e Republikës së Maqedonisë, që janë pjesë nga rajoni i rrjedhës ndërkombëtare të lumit, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të jashtme, ndërmarrin aktivitete për vendosjen dhe menaxhimin e rajoneve të rrjedhave ndërkombëtare të lumenjve.

## Neni 10

### Rrjedhat ndërkombëtare të lumenjve

(1) Menaxhimi me rrjedhat ndërkombëtare të lumenjve dhe ujërat ndërkombëtare, kryhet në pajtim me këtë ligj dhe në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

(2) Për realizimin e qëllimeve të këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, ndërmerr aktivitete për koordinimin e planeve për menaxhimin me rajone të rrjedhës ndërkombëtare të lumit dhe programeve të masave, me organet kompetente të shteteve fqinje, që i takojnë rajonit të rrjedhës ndërkombëtare të lumit.

## Neni 11

### Ndikimet negative nga shtetet fqinje

(1) Në rastet e ndikimit negativ ose kërcënimit nga ndikimi negativ në ujëra ose nga ujërat nga ndonjë shtet fqinj, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që menjëherë të ngrisë procedurë për informimin e shtetit fqinj, për situatën e re të krijua dhe për pasojat.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që t'i identifikojë pasojat nga ndikimet e

dëmshme në ujëra dhe nga ujërat, dhe të ngritë procedurë për negociata dhe për harmonizim me organet kompetente të shtetit fqinj, për definimin dhe zbatimin e masave të nevojshme që duhet të merren në burimin e ndikimit të dëmshëm, për mbrojtjen e ujërave në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## II. SHFRYTËZIMI I UJËRAVE

### II. 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR SHFRYTËZIMIN E UJËRAVE

#### Neni 12

##### Regjimi i ujërave

(1) Regjimi i ujërave është shuma e parametrave që e definojnë gjendjen sasiore dhe cilësore të ujërave, në vendin e caktuar dhe në kohë të caktuar, siç janë: niveli i ujit, rrjedha, drejtimi i rrjedhës, shpejtësia e ujit, shpjerja e lymit, veçoritë fizike, kimike dhe radioaktive, përbërja hidrobiologjike e ujërave dhe parametrat e tjerë.

(2) Ndalohet kryerja e punëve që shkaktojnë ndryshime në regjimin e ujërave, përkatësisht ndryshim të parametrave nga paragrafi (1) i këtij neni, në kundërshtim me dispozitat nga ky ligj.

(3) Mirëmbajtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave, kryhet në pajtim me planet për menaxhim më rrjedhat e lumenjve.

#### Neni 13

##### Shfrytëzimi i ujërave

(1) Shfrytëzimi i ujërave i përfshin aktivitetet e akumulimit, përfshirjes, nxjerrjes, ndryshimit të kahes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për:

- 1) konsumim nga ana e njeriut, ujitje, për nevoja industriale, teknologjike, ekonomike dhe për dedikime të tjera;
- 2) për prodhimin e energjisë elektrike dhe për dedikime të tjera motorike;
- 3) për kultivimin e peshqve;
- 4) për lundrim;
- 5) për sport, rekreacion, banjë dhe
- 6) akumulim, përfshirje, nxjerrje, shfrytëzim, ndryshimin e drejtimit dhe për dedikime të tjera.

(2) Shfrytëzimi i ujërave i përfshin edhe aktivitetet e dërgimit dhe lëshimit, si dhe veprimet e tjera ndaj ujërave.

#### Neni 14

##### Obligimet gjatë shfrytëzimit të ujërave

(1) Secili mund ta shfrytëzojë ujin në vëllim, në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj, si dhe në pajtim me aktet e miratuara në bazë të këtij ligji.

(2) Uji shfrytëzohet në mënyrë racionale dhe ekonomike, në mënyrë të baraspeshuar dhe të drejtë, në pajtim me parimet për menaxhimin e qëndrueshëm me ujin, me ç'rast duhet të mbahet llogari për mbajtjen dhe përmirësimin e regjimit të ujërave.

(3) Secili shfrytëzues i ujërave sipërfaqësore ode nëntokësore, është i obliguar që gjatë lëshimit të ujërave të shfrytëzuara, të mos shkaktojë veprime të dëmshme në ujëra dhe në ambientet dhe sferat e tjera të

mjedisit jetësor.

## Neni 15

### Përparësitë për shfrytëzimin e ujërave

Nëse ka më tepër kërkesa për shfrytëzimin e ujërave nga trupi i njëjtë ujqor, për të cilin nuk është dhënë leja për shfrytëzimin e ujqit, leja për shfrytëzimin e ujqit lëshohet në pajtim me përparësitë, si vijon:

- 1) për furnizimin me ujë të popullatës, përmes sistemit publik për furnizim me ujë, për institucionet shëndetësore dhe për personat juridikë nga sfera e veterinarisë, për nevojat e mbrojtjes, për industrinë e prodhimit dhe përpunimit të ushqimit dhe për pije për kafshët;
- 2) për ujqitjen e truallit bujqësor;
- 3) për furnizimin me ujë për industrinë dhe për nevoja ekonomike;
- 4) për nevoja hidroenergjetike dhe për nevoja të tjera motorike;
- 5) për nevojat e parqeve dhe të sipërfaqeve të tjera publike;
- 6) për mbushjen e ujqit nëpër shishe për nevoja komerciale dhe
- 7) për nevoja të tjera.

## Neni 16

### Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave

(1) Ujqërat janë në shfrytëzim të përgjithshëm, nëse:

- 1) ujqërat shfrytëzohen për nevoja personale dhe nevoja të amvisërisë;
- 2) nuk nevojiten objekte dhe stabilimente të veçanta, për shfrytëzimin e ujërave;
- 3) me shfrytëzimin e ujërave, nuk prishet e drejta për shfrytëzimin e barabartë të ujërave, nga ana e personave të tjerë dhe
- 4) shfrytëzimi i ujërave nuk është i kufizuar me dispozita të tjera.

(2) Për shfrytëzimin e përgjithshëm të ujërave, nuk nevojitet leje për shfrytëzimin e ujërave.

(3) Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave, e përfshin veçanërisht shfrytëzimin e ujërave për pije, banjë dhe për nevoja të tjera sanitare në amvisëri, për sport dhe rekreacion dhe për lundrim me mjete lundruese të pamotorizuara, ose për plotësimin e nevojave të tjera personale, nëse me atë nuk kërkohet ndërtimi i objekteve dhe stabilimenteve të veçanta, për të cilat parashihet leje për shfrytëzimin e ujërave. Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave e përfshin edhe shfrytëzimin e ujqit për fikjen e zjarreve dhe për marrjen e masave të domosdoshme sanitare dhe masave të tjera, në rast të gjendjes së jashtëzakonshme ose fatkeqësisë elementare ose aktiviteteve të tjera me interes publik.

(4) Me përmëshje të nevojave tjera personale nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk nënkuptohet shfrytëzimi i ujërave në procesin teknologjik gjatë kryerjes së veprimtarive tregtare, si edhe shfrytëzimi i ujërave për ujqitje, përveç në rastet e caktuara me nenin 17 paragrafi (3) të këtij ligji.

(5) Për shfrytëzimin e përgjithshëm nga paragrafi (1), (2), dhe (3) të këtij neni, nuk paguhet kompensim për shfrytëzimin e ujërave.

## II. 2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR SHFRYTËZIMIN E UJËRAVE

### Neni 17

#### Autorizimi për pronarin e truallit ose për bartësin e së drejtës tjetër reale

(1) Pronari ose bartësi i së drejtës tjetër reale të truallit, mundet pa leje

për shfrytëzimin e ujërave, lirisht t'i shfrytëzojë ujërat atmosferike që grumbullohen në truallin e tij, ose truallin mbi të cilin ka të drejtë reale në kufijtë e nevojave personale të amvisërisë, duke mbajtur llogari për regjimin e ujërave dhe për të drejtat e atilla të personave të tjerë.

(2) Pronari ose bartësi i të drejtës tjetër reale në tokën në të cilën gjendet ujë, mund të nxjerrë dhe të shfrytëzojë ujëra nëntokësore nga trupat ujore nëntokësore për nevoja personale dhe për nevojat e ekonomisë familjare, pa detyrim që të posedojë leje për shfrytëzim të ujit, nëse sasia e ujit të nxjerrë nëntokësor nuk tejkalon 10 m<sup>3</sup> në ditë, e me këtë nuk shkaktohen pasoja negative për të njëjtin, ose për trupin ujor nëntokësor fqinj.

(3) Pronari ose bartësi i të drejtës tjetër reale në tokë bujqësore mund të nxjerrë dhe të shfrytëzojë ujë nga trupat ujorë nëntokësorë për ujitje të tokës bujqësore, pa obligim që të posedojë leje për shfrytëzim të ujit në kushtet në vijim:

- toka të mos jetë e përfshirë me hidrosistem ose sistem për ujitje,
- sasi të nevojshme të ujit për ujitje të mos tejkalojnë më shumë se 1l/sekondë dhe
- para mihjes së pusit të sigurojë mendim pozitiv nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e menaxhimit me ujëra.

## Neni 18

### Nxjerrja e herëpashershme e ujërave për kullimin e truallit

(1) Pa leje për shfrytëzimin e ujit, kryerësit e veprimtarisë tregtare si dhe personat e tjerë, mund t'i nxjerrin ose t'ua ndryshojnë rrjedhën ujërave, vetëm për shkak të:

- 1) kullimit të truallit, si për mbrojtjen e truallit nga erozioni, ose nga vërshimet dhe/ose
- 2) pengimit të dëmeve dhe ndërprerjeve të herëpashershme gjatë operacioneve në miniera, gurore, ndërtimin e ndërtesave dhe punëve të tjera inxhinierike dhe infrastrukturore.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, kryerësit e veprimtarisë dhe personat e tjerë, janë të obliguar që menjëherë pas fillimit të nxjerrjes ose ndryshimit të rrjedhës së ujit, ta njoftojnë organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që menjëherë pas pranimit të njoftimit, të kryejë inspektim të gjendjes dhe të urdhërojë marrjen e masave përkatëse, e varësisht nga sasia e ujit, ta urdhërojë kryerësin e veprimtarisë përkatësisht personin tjetër, të marrë leje për shfrytëzimin e ujit.

## Neni 19

### Shfrytëzimi i ujërave për lundrim

(1) Ujërat sipërfaqësore mund të shfrytëzohen për lundrim, në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat për lundrimin e brendshëm.

(2) Për shkak të mbrojtjes së florës dhe faunës, ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji, si dhe për shkak të ruajtjes dhe kultivimit të llojeve bimore dhe shtazore, lundrimi me objekte dhe instalime lundruese që lëvizin me motorë me djegie të brendshme ndalohet, në zonat e mbrojtura dhe rajonet e përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

(3) Ndalimin nga paragrafi (2) të këtij neni dhe regjimin e aktiviteteve në

zonat dhe rajonet e mbrojtura, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministrin që udhëheq me organ të administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e transportit dhe lidhjeve.

## Neni 20

### Kufizimi i shfrytëzimit të ujërave

(1) Për sigurimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave në dispozicion, dhe ruajtjen dhe përmirësimin e baraspeshës natyrore të ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve që varen nga ujërat, shfrytëzimi i ujërave mund të kufizohet:

1) në rast të dukurive natyrore që shkaktojnë ose paraqesin kërcënim për zvogëlimin e përkohshëm të sasisë së ujërave, dhe përkeqësimit e cilësisë, kështu që nuk ka mundësi që të plotësohen nevojat e të gjithë shfrytëzuesve të ujërave në atë rajon;

2) nëse konfirmohet se për shkak të vëllimit ekzistues të shfrytëzimit të ujit, janë përkeqësuar cilësitë e tij, ose ka rrezik për përkeqësim dhe/ose

3) në rast të avarive, dëmtimeve të objekteve të infrastrukturës dhe raste të tjera, në masë të domosdoshme që të përmirësohet dëmi i shkaktuar.

(2) Ndalimin nga paragrafi (1) të këtij neni, e përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministrin që udhëheq me organ të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë ujore.

(3) Kufizimi i përkohshëm i shfrytëzimit të ujërave nga paragrafi (1) i këtij neni, pika 1 dhe 2, nuk është bazë për kërkesë për kompensimin e dëmit.

(4) Personi që e ka shkaktuar dëmin ose avarinë nga paragrafi (1) pika 3 e këtij neni, është i obliguar që t'ua kompensojë dëmin shfrytëzuesve të ujit.

## Neni 21

### Ruajtja e ujërave nëntokësore

(1) Për sigurimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave nëntokësore në dispozicion, dhe ruajtjen dhe përmirësimin e baraspeshës natyrore të ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve që varen nga ujërat, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mundet ta kufizojë shfrytëzimin e ujërave nëntokësore, nëse konfirmohet se rezervat e ujërave nëntokësore nga të cilat shfrytëzohet uji për nevojat e furnizimit publik janë nxjerrë, ashtu që nuk ekziston mundësia për shfrytëzimin e tyre të mëtejshëm ose ekziston rreziku nga nxjerrja e tërësishme e tyre.

(2) Ujërat nëntokësore të volitshme për furnizimin publik me ujë, ruhen dhe përdoren parësisht për furnizim publik me ujë. Me përjashtim, ujërat nëntokësore mund të shfrytëzohen për dedikime të tjera, në kushte, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj, nëse kjo është në pajtim me Planet për menaxhim me rrjedhat e lumenjve.

## Neni 22

### Obligimet dhe kufizimet gjatë shfrytëzimit të ujërave nëntokësore

(1) Personi juridik ose fizik i cili gjatë kryerjes së hulumtimeve gjeologjike ose gjatë eksplotimit të lëndëve të para minerale, gërmimit të tuneleve

dhe aktiviteteteve të tjera të gërmimit ose shpimit të truallit, ndeshet në ujëra nëntokësore (burime të ujit, ujëra të rrjedhshëm dhe të parrjedhshëm), është i obliguar që menjëherë ta kryejë mbrojtjen e ujit nëntokësor, më së voni në afat prej 24 orësh nga zbulimi, dhe për atë ta njoftojë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, t'i mundësojë marrjen e të dhënave dhe kryerjen e analizave të nevojshme, për përcaktimin e shtresave, sasisë dhe cilësive të ujit, si dhe t'i ndër marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e ujërave nëntokësore, të përcaktuara nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Nëse ujërat nëntokësore janë të nevojshme për furnizimin publik me ujë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e menaxhimit me ujëra, mund të propozojë shpronësimin e truallit në të cilin gjenden ato, sipas dispozitave për shpronësim.

(4) Në rastin nga paragrafi (3) i këtij neni, bartësi i të drejtave për hulumtime gjeologjike ose eksploatimin e lëndëve të para minerale, i cili për shkak të shfrytëzimit të ujërave nëntokësore për furnizim publik me ujë, ka pushuar me hulumtime gjeologjike ose me eksploatimin e lëndëve të para minerale, ka të drejtë kompensimi të fitimit të humbur në pajtim me dispozitatat për kompensimin e dëmit.

## II. 3. E DREJTA PËR UJË

### Neni 23

#### E drejta për ujë

(1) Për realizimin e interesit publik gjatë shfrytëzimit të ujërave, si dhe për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të personave juridikë dhe fizikë që të shfrytëzojnë ose lëshojnë ujëra, të drejtës së shfrytëzimit të ujërave nga trupat ujorë dhe të drejtës së lëshimit në trupat ujorë, u ndahet e drejta për ujë personave juridikë dhe fizikë (në tekstin e mëtejshëm: e drejta për ujë), në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Ndarja dhe realizimi i së drejtës për ujë, nuk guxon të shpie në pasoja negative për ujërat.

(3) E drejta për ujë realizohet në kushte, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

(4) E drejta për ujë fitohet edhe për shfrytëzimin e ujërave për kryerjen e veprimtarisë, përmes koncesionit ose për kryerjen e punëve për partneritet publik privat.

(5) Koncesioni përkatësisht partneriteti publik privat nga paragrafi (4) i këtij neni, nuk mund të ndahet pa fitimin paraprakisht të së drejtës për ujë, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me këtë ligj.

(6) Kushtet, mënyra dhe procedura për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujërave, rregullohen me këtë ligj dhe Ligjin për koncesione dhe partneritet publik privat.

### Neni 24

#### Bartësi i së drejtës për ujë

Bartës i së drejtës për ujë mund të jetë secili person i vendit ose i huaj, juridik ose fizik, duke i përfshirë edhe organet e pushtetit shtetëror edhe komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, në kushte

dhe në mënyrë të përcaktuara me këtë ligj.

## Neni 25

### Përmbajtja e së drejtës për ujë

(1) Bartësi i së drejtës për ujë, ka të drejtë që pa pengesa dhe plotësisht ta shfrytëzojë ujin dhe të disponojë me ujin, për të cilin e ka fituar të drejtën për ujë, nëse ajo nuk është në kundërshtim me këtë ligj.

(2) E drejta për ujë krijon të drejta dhe obligime dhe duhet të shërbejë për të mirën e bartësit të tij dhe të bashkësisë.

(3) Secili është i obliguar që të përmbahet nga cenimet e të drejtës për ujë të personit tjetër.

(4) Bartësi, të drejtën për ujë e realizon në pajtim me dedikimin dhe në mënyrën e përcaktuar në leje ose në koncesion, në pajtim me këtë ligj.

(5) Me fitimin e të drejtës për ujë, bartësi i të drejtës për ujë nuk e fiton të drejtën e pronësisë ose të drejtën tjetër reale, për truallin ku gjendet uji.

(6) Me fitimin e të drejtës për ujë, bartësi i të drejtës për ujë, nuk e fiton të drejtën e pronësisë ose të drejtën tjetër reale, për objektet dhe stabilimentet për shfrytëzimin e ujit.

## Neni 26

### Fitimi i së drejtës për ujë

(1) Personi juridik ose fizik e fiton të drejtën për ujë, në bazë të lejes për shfrytëzimin e ujit dhe lejes për lëshimin në ujë.

(2) Kushtet, mënyra dhe procedura për lëshimin e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni, rregullohen me këtë ligj.

(3) E drejta për ujë nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të fitohet edhe me trashëgimi.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 27

### Fitimi i së drejtës për ujë me trashëgimi

(1) Nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj, e drejta për ujë mund të bartet te trashëguesi juridik i bartësit të së drejtës për ujë, me kërkesën e tij.

(2) Kërkesën për bartjen e së drejtës për ujë, trashëguesi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni, e dorëzon te organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor. Kërkesës për bartjen e së drejtës për ujë, i bashkëngjitet edhe vendimi gjyqësor, me të cilin përcaktohet statusi i trashëguesit juridik.

(3) Pas pranimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në afat jo më të gjatë se dy muaj pas pranimit të kërkesës, miraton aktvendimi me të cilin ndryshohen të dhënat në librin për ujin, në aspekt të bartësit të së drejtës për ujë, ose aktvendim për refuzimin e kërkesës.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me aktvendime kryen ndryshimin e të

dhënave në librin për ujin, nëse konfirmon se trashëguesi juridik pa ndryshimin e kushteve në leje, vazhdon:

- 1) t'i shfrytëzojë ujërat që janë lëndë e lejes, ose
- 2) me ndërtimin, mirëmbajtjen, eksploatimin, ndryshimin, zgjerimin ose rehabilitimin e objekteve të ekonomisë ujore dhe të objekteve të tjera.

(5) Në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, trashëguesi juridik mundet ta shfrytëzojë lejen ekzistuese.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, trashëguesi juridik ka të drejtë për ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, e drejta për ujë mund t'i bartet trashëguesit juridik me vendim gjyqësor.

## Neni 28

### Veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat nevojitet leja

(1) Leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, nevojitet për kryerjen e aktiviteteve, që ndikojnë ose mund të ndikojnë në regjimin e ujërave dhe/ose në morfologjinë e trupit ujqor, veçanërisht në rastet e:

1) vëllimit, nxjerrjes, ndryshimit të rrjedhës, akumulimit dhe shfrytëzimit të ujit, nga trupi ujqor sipërfaqësor, për:

- furnizim me ujë, i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut,
- ujitjen e tokës bujqësore,
- nevoja industriale, teknologjike dhe ekonomike,
- mbushjen e ujit nëpër shishe për nevoja komerciale,
- prodhimin e energjisë elektrike dhe për nevoja të tjera motorike,
- kultivimin e peshqve, shpezëve ujore etj.,
- turizëm, sport, rekreacion, banjë dhe dedikime të tjera të ngjashme,
- kullimin e truallit,
- larjen dhe separacionin e rërës, zhavorrit dhe gurit,
- mirëmbajtjen e rrjedhave ujore, me përdorimin e materieve dhe substancave kimike dhe
- aktivitete të tjera, për të cilat organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, do të vlerësojë se ndikojnë në regjimin e ujërave dhe /ose në morfologjinë e trupit ujqor;

2) nxjerrjes, ndryshimit të rrjedhës, akumulimit dhe shfrytëzimit të ujit, nga trupi nëntokësor ujqor, për:

- furnizim me ujë, i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut,
- ujitjen e tokës bujqësore,
- nevoja industriale, teknologjike dhe ekonomike,
- mbushjen e ujit nëpër shishe për nevoja komerciale,
- absorbimin e energjisë termike nga ujërat gjeotermike,
- hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave dhe
- aktivitete të tjera, për të cilat organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, do të vlerësojë se ndikojnë në regjimin e ujërave dhe/ose në morfologjinë e trupit ujqor;

3) lëshimin e ujërave dhe lëshimin dhe hedhjen e materieve dhe substancave në ujërat sipërfaqësore.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në bazë të propozimit të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, më afërsisht i rregullon aktivitetet nga paragrafi (1) pika 1 alineja 13 dhe pika 2 alineja 7, për të cilat nevojitet leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji.

(3) Për shkak të zbatimit të planeve për menaxhim me rrjedhën e lumit, leja lëshohet në pajtim me Planin për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(4) Për objektet dhe për instalimet për të cilat është e nevojshme leja nga



neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, e për të cilat me Ligjin për mjedisin jetësor është e përcaktuar se merret leja A - ekologjike e integruar, përkatësisht leja B - ekologjike e integruar për instalime në rajon të mbrojtur, leja merret në procedurë të përcaktuar me atë ligj.

(5) Leja A - ekologjike e integruar, përkatësisht leja B - ekologjike e integruar për instalime në rajonin e mbrojtur, nga paragrafi (4) i këtij neni, e zëvendëson lejen nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji.

(6) Për objektet dhe për instalimet për të cilat është e nevojshme leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, ndërsa për të cilat me Ligjin për mjedisin jetësor është e përcaktuar se është e nevojshme leja B - ekologjike e integruar, me përjashtim të lejes B - ekologjike të integruar për instalime në rajon të mbrojtur, leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, merret në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(7) Për projektet për të cilat me Ligjin për mjedisin jetësor është e përcaktuar se kryhet vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedisin jetësor, duke i përfshirë edhe projektet për të cilat nevoja për vlerësim të ndikimit kryhet me shqyrtimin e çdo rasti të veçantë, vlerësimi kryhet në pajtim me atë ligj.

## **Neni 29**

### **Shfrytëzimi i ujit nga pusët**

(1) Pronari ose bartësi i të drejtës tjetër reale në tokë bujqësore mund të nxjerrë dhe të shfrytëzojë ujë nga trupat ujqorë nëntokësorë për ujitje të tokës bujqësore, pa obligim që të posedojë leje për shfrytëzim të ujit në kushtet në vijim:

- toka të mos jetë e përfshirë me hidrosistem ose sistem për ujitje,
- sasi të nevojshme të ujit për ujitje të mos tejkalojnë më shumë se 1l/sekondë dhe
- para mihjes së pusit të sigurojë mendim pozitiv nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e menaxhimit me ujëra.

(2) Pusi i rëndomtë nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të hapet në largësi prej së paku 5 metrash, nga objekti ndërtimor dhe nga parcela ndërtimore e fqinj, ndërsa kuota në fund të pusit, nuk guxon që të jetë më e ulët, nga kuota e fundit të pusit fqinj.

## **Neni 30**

### **Kërkesa për lëshimin e lejes**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e lëshon lejen nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, me kërkesë të personit juridik ose fizik (në tekstin e mëtejshëm: kërkuksi).

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton përmbajtjen dhe formën e formularit të kërkesës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që i bashkëngjitet kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 31**

### **Lëshimi i kushteve të ekonomisë ujore dhe kushteve të tjera, për projektimin dhe për sigurimin e informatave të tjera**

(1) Para paraqitjes së kërkesës për lëshimin e lejes nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji, personi juridik dhe fizik është i obliguar që të kërkojë nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga

sfera e mjedisit jetësor:

1) kushtet e ekonomisë ujore për projektim dhe  
2) kushtet për mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve që varen nga uji, për përpilimin e dokumentacionit teknik.

(2) Kushtet e ekonomisë ujore për projektim dhe për mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet të jenë në pajtim me Bazën e ekonomisë ujore dhe Planin për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(3) Përveç kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik dhe fizik ka të drejtë që të kërkojë edhe listën e lejeve që janë lëshuar në pajtim me këtë ligj, në rajonin ku planifikohet vendi i objektit.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e menaxhimit me ujëra, është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, personit juridik dhe fizik t'ia dorëzojë me shkrim, kushtet nga paragrafi (1) dhe informatat nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nuk është në gjendje që t'i përgjigjet kërkesës për dorëzimin e kushteve dhe informatave në afatin e caktuar në paragrafin (4) të këtij neni, për pamundësinë dhe për shkaqet e mosdorëzimit, si dhe për afatin plotësues në të cilin do ta kryeja atë, me shkrim e njofton personin juridik dhe fizik. Afati plotësues nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, arkëton kompensim për sigurimin e informatave nga paragrafi (1) dhe paragrafi (3) të këtij neni, me ç'rast lartësia e kompensimit nuk duhet t'i tejkalojë shpenzimet reale për sigurimin, përgatitjen dhe dërgimin e tyre.

(7) Qasja te regjistrat, evidencat ekzistuese ose baza e të dhënave, si dhe kontrolli i informatave në vendin ku ruhen ose mbahen, është pa pagesë.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton lartësinë e kompensimit nga paragrafi (6) i këtij neni.

(9) Në bazë të kushteve të lëshuara të ekonomisë ujore për projektim dhe kushteve për mbrojtjen e ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji, personi juridik ose fizik e përgatit detyrën e projektit për objektin për të cilin kërkohet leja.

## Neni 32

### Procedura për konsultime

(1) Para se të fillojë me përgatitjen e kërkesës për leje, personi juridik dhe fizik ka të drejtë që të paraqesë kërkesë me shkrim, për fillimin e procedurës së konsultimeve, me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, lidhur me përmbajtjen dhe vëllimin e dokumentacionit, që dorëzohet me kërkesën nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që ta fillojë procedurën për konsultime me personin juridik dhe fizik, më së voni në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Për konsultimet e kryera organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe personi juridik përkatësisht fizik, e nënshkruajnë procesverbalin.

## Neni 33

### Procedimi me kërkesën për lëshimin e lejes

(1) Në afatin që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e obligon kërkuesin që ta plotësojë kërkesën dhe i përcakton të dhënat me të cilat, në pajtim me nenin 30 paragrafi (2) i këtij ligji duhet të plotësohet kërkesa, dhe varësisht nga lloji i mangësive dhe qasja e të dhënave, e përcakton afatin për plotësimin e kërkesës, që nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë.

(2) Nëse kërkuesi nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me aktvendim e hedh poshtë kërkesën.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, kërkuesi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, mundet të paraqesë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që pa prolongim, nga një ekzemplar të kërkesës, ta dorëzojë te:

1) organi i administratës shtetërore, kompetent për veprimtaritë që do të kryhen me objektin dhe/ose me stabilimentin, (në tekstin e mëtejshëm: organet e tjera kompetente të administratës shtetërore) dhe

2) kryetari i komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, në rajonin e të cilave do të ndërtohet objekti dhe/ose stabilimenti.

## Neni 34

### Ndryshimi dhe plotësimi i përmbajtjes dhe i vëllimit të kërkesës për lëshimin e lejes

(1) Pas dorëzimit të kërkesës për lëshimin e lejes, kërkuesi mundet në mënyrë plotësuese të paraqesë kërkesë për ndryshimin dhe/ose plotësimin e përmbajtjes dhe vëllimit të kërkesës nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Kërkesës për ndryshim dhe plotësim nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkuesi është i obliguar që t'ia bashkëngjisë dokumentet e nevojshme, që kërkohen në pajtim me nenin 30 paragrafin (2) të këtij ligji, nëse me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, bëhet ndryshimi i atyre të dhënave.

(3) Për kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e përmbajtjes dhe vëllimit të kërkesës për lëshimin e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, procedon në pajtim me nenin 33 të këtij ligji.

## Neni 35

### Publikimi i shpalljes dhe pjesëmarrja e opinionit, në procedurën e lëshimit të lejes

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji, është i obliguar që ta publikojë kërkesën në së paku një gazetë ditore të kapshme në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në faqen e vet të internetit.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve

nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që t'i sigurojë opinionit qasje të lirë te informatat e nevojshme për formimin e mendimeve dhe të qëndrimeve, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(3) Opinioni mundet t'i shprehë mendimet dhe vërejtjet e veta lidhur me kërkesën, në afat prej 15 ditësh nga publikimi.

(4) Përmbajtjen e shpalljes nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Shpallja nga paragrafi (1) i këtij neni, është në llogari të kërkuarit të lejës.

## **Neni 36**

### **Të drejtat dhe obligimet e organeve të komunave dhe të qytetit të Shkupit lidhur me kërkesën**

(1) Kryetari i komunave dhe kryetari i komunës së Shkupit, është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës, në pajtim me nenin 33 paragrafi (4) i këtij ligji, t'i dorëzojë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mendim me shkrim lidhur me të dhënat e përmbajtura në kërkesë.

(2) Nëse kryetari i komunave dhe kryetari i komunës së Shkupit, nuk e dorëzon mendimin me shkrim në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, konsiderohet se është pajtuar me kërkesën.

## **Neni 37**

### **Procedimi me kërkesën në rastin e ujërave ndërshtetërore**

Kur organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në bazë të përmbajtjes së kërkesës, vlerëson se kryerja e veprimtarive në objekte ose në instalime për të cilat kërkohet leje, mund të shkaktojë pasoja negative në regjimin e ujërave dhe/ose në morfologjinë e trupit ujor, ai është i obliguar që të ngritë procedurë për dorëzimin e kërkesës te organi përkatës kompetent i shtetit tjetër dhe t'i mundësojë që të prononcohet për kërkesën, në mënyrë dhe në kushte të parapara me ligj, e në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë, me të cilën është marrë ai obligim.

## **Neni 38**

### **Dorëzimi i qëndrimeve dhe mendimeve pas kërkesës**

(1) Organet e shënuara në nenin 33 paragrafi (4) pika 1 e këtij ligji, si dhe opinioni nga neni 35 i këtij ligji, munden në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës, t'i dorëzojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre me shkrim, lidhur me kërkesën nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Gjatë përgatitjes së lejës nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nuk do t'i marrë parasysh mendimet e dorëzuara pas kalimit të afatit dhe mënyrës të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Gjatë përgatitjes së lejës nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i arsyeton shkaqet për të cilat janë hedhur poshtë mendimet dhe qëndrimet e marra nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Nëse organet e shënuara në nenin 33 paragrafi (4) pika 1 e këtij neni,

nuk dorëzojnë mendim me shkrim në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, konsiderohet se nuk kanë vërejtje për kërkesën,

## Neni 39

### Hedhja poshtë e kërkesës për lëshimin e lejes

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me aktvendim e refuzon kërkesën nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji, nëse konfirmon se lëshimi i lejes nuk është në pajtim me Planin për menaxhim me rrjedhën e lumit, rrezikohet interesi publik, ose cenohen dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkuesi mundet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, të paraqesë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

## Neni 40

### Lëshimi i lejes

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që ta lëshojë lejen në afat jo më të gjatë se tre muaj, nga dita e pranimi të kërkesës nga neni 30 paragrafi (1) i këtij ligji, përkatësisht nga pranimi i të dhënave për plotësimin e kërkesës, në pajtim me nenin 34 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin lëshohet leja nga paragrafi (1) i këtij neni, kërkuesi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të lejes, mundet të paraqesë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(3) Nëse organi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk lëshon leje nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, përkatësisht nuk merr aktvendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e lejes nga neni 26 paragrafi (1) në afat nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejt në afat prej tre ditësh pune, pas skadimit të afatit të parashtrorë kërkesë në sekretarinë e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor, që të marrë aktvendim me të cilin jepet pëlqimi për lëshimin e lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrorë në sekretari në selinë e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Me kërkesën nga paragrafi (3) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon kopje të kërkesës nga neni 30 paragrafi (1) të këtij ligji për lëshimin e lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, është i detyruar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimi të kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni në sekretari të marrë aktvendim me të cilin kërkesa për lëshimin e lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji pranohet ose refuzohet.

(7) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk merr aktvendimin nga paragrafi 6 i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(8) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditësh nga pranimi i njoftimit nga paragrafi (7) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer, e informon parashtruesin e kërkesës për gjendjen e vërtetuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(9) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin merr aktvendim me të cilin e obligon ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët në sferën mjedisit jetësor, që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta miratojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(10) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afat nga paragrafi (9) i këtij neni, inspektori do të parashtrtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin funksionari i cili udhëheq me organin do të vendosë për kërkesën e parashtruar me ç'rast në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(11) Nëse ministri nuk vendos edhe në afat plotësues nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve pune do të parashtrtojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (7) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë që të parashtrtojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretari në selinë e Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(13) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimi, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (12) i këtij neni, dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës në pajtim me paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, dhe/ose nuk parashtron fletëparaqitje në pajtim me nenet (10) dhe (11) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin, dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me Ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(14) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrtojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Në rast nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta realizojë menjëherë mbikëqyrjen.

(16) Në rastet nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve pune e informon

parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(17) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (13) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve pune.

(18) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit nuk vendos në afat nga paragrafi (10) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(19) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

(20) Akti nënligjor nga paragrafi (4) i këtij neni do të miratohet në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit të këtij ligji.

(21) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (4) i këtij neni i njëjti menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orëve shpallet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët e mjedisit jetësor.

## Neni 41

### Fillimi i veprimit juridik të lejes

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që ta kryejë kontrollin e objekteve dhe stabilimenteve, dhe nëse kushtet nga leja janë plotësuar, bartësit të lejes i lëshon vërtetim për kontrollin e kryer të objekteve dhe stabilimenteve.

(2) Kontrollin e objekteve dhe stabilimenteve nga paragrafi (1) i këtij neni, e kryen Komisioni i formuar nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i përbërë nga pesë anëtarë dhe atë, prej një anëtarë nga Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor, dy anëtarëve nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e menaxhimit me rrjedhën e lumit dhe dy anëtarëve nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, fillon të prodhojë veprim juridik, nga momenti kur bartësi i lejes, do të dorëzojë vërtetim për kontrollin e kryer, te organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Nga momenti i lëshimit të lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, deri në momentin e fillimit të veprimit juridik të lejes në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mundet në bazë të kërkesës së personit juridik ose fizik, të lëshojë leje për shfrytëzimin e përkohshëm të ujit nga trupi i njëjtë ujor, për të cilin ka të bëjë leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji.

(5) Anëtarët e komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni, zgjidhen me mandat prej dy vitesh, me të drejtën e zgjedhjes sërish, më së tepërmi edhe për një mandat.

(6) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, për punën e vet nxjerr rregullore.

(7) Punët profesionale administrative të komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni, i kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor.

## Neni 42

## Bartja e të drejtave dhe obligimeve nga leja

(1) Bartësi i lejes mundet personit të tretë, t'ia bartë me ose pa kompensim, tërësisht ose pjesërisht, të gjitha të drejtat dhe obligimet ose të drejtat dhe obligimet e veçanta, që dalin prej lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, nëse me atë nuk ndryshohet përmbajtja e lejes, nuk çrregullohet realizimi i interesit publik, i përcaktuar me ligj dhe kushtet për kryerjen e veprimtarisë.

(2) Për bartjen e të drejtave dhe obligimeve të lejes nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i lejes është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e bartjes, të kërkojë pajtim nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Nëse në bazë të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, konfirmon se me bartjen e lejes janë plotësuar kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton aktvendim për ndryshimin e të dhënave për bartësin e lejes, dhe ndryshimin e kryer e regjistron në librin për ujin.

(4) Nëse në bazë të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, konfirmon se me bartjen e lejes nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, miraton aktvendim me të cilin e pezullon lejen, dhe me të cilin e obligon personin tjetër juridik ose fizik që të marrë leje të re, ndërsa ndërprerjen e lejes e regjistron në librin për ujin.

(5) Bartësi i lejes është i obliguar që ta njoftojë organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse e autorizon personin e tretë që në emër të tij, t'i kryejë veprimtaritë dhe aktivitetet për të cilat lëshohet leja, në afat prej tri ditësh nga dita e lëshimit të autorizimit.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e regjistron në librin për ujin personin që e kryen veprimtarinë, në emër dhe për llogari të bartësit të lejes..

### Neni 43

#### Mbrojtja e të drejtave të bartësit të lejes

(1) Secili përmbahet nga ndërmarrja e veprimeve ose aktiviteteve, me të cilat cenohet ose kufizohet e drejta që për bartësen rezulton prej lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që t'i sigurojë bartësit të lejes pa pengesa ta realizojë të drejtën që rezulton nga leja në masën e përcaktuar me leje, dhe të përmbahet nga marrja e veprimeve dhe aktiviteteve për pengimin ose kufizimin e asaj të drejte, nëse ato veprime dhe aktivitete nuk ndërmerren për mbrojtjen dhe sigurimin e interesit publik të përcaktuar me ligj, ose për shkak të forcës madhore dhe rrethanave të tjera objektive.

(3) Nëse veprimet dhe aktivitetet me të cilat pengohet ose kufizohet e drejta, ndërmerren për mbrojtjen ose sigurimin e interesit publik të përcaktuar me ligj, bartësi i lejes ka të drejtë:

- 1) ta shfrytëzojë ujin nga trupi tjetër ujor, në sasi dhe cilësi përkatëse me atë të përcaktuar në leje, ose nëse ajo nuk është e mundur,
- 2) kompensimi të dëmit që e ka pësuar për shkak të kufizimit.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, bartësi i lejes nuk ka të drejtë kompensimi të dëmit për fitimin e humbur.

(5) Në rast kur kufizimi i së drejtës së bartësit të lejes që rezulton nga



leja, nuk kryhet për shkak të mbrojtjes ose sigurimit të interesit publik, ose për shkak të forcës madhore dhe rrethanave të tjera objektive, bartësi i lejes ka të drejtë kompensimi të dëmit që e ka pësuar për shkak të kufizimit të së drejtës, në mënyrë përkatëse me të përcaktuarën në leje.

(6) Kompensimi i dëmit nga paragrafi (2) i këtij neni, realizohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme për kompensimin e dëmit.

(7) Leja nuk krijon të drejta dhe obligime për personat e tretë dhe për pronën e tyre.

## Neni 44

### Administrimi i përkohshëm i dhunshëm

(1) Në rastin kur leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, lëshohet për kryerjen e veprimtarisë me interes publik, ndërsa bartësi nuk e kryen veprimtarinë në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje, përkatësisht kryen cenimin e rëndësishëm dhe në vazhdimësi të kushteve për kryerjen e veprimtarisë me interes publik të përcaktuar në leje, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, miraton aktvendim për vënien e lejes nën administrim të përkohshëm të dhunshëm (sekuestër).

(2) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni, veçanërisht përmban:

- 1) shkaqet për të cilat vihet leja nën administrimin e dhunshëm të përkohshëm;
- 2) personin që e kryen administrimin e dhunshëm të përkohshëm;
- 3) afatin në të cilin kryhet administrimi i dhunshëm i përkohshëm;
- 4) kushtet e administrimit të dhunshëm të përkohshëm;
- 5) të drejtat dhe obligimet e bartësit të lejes, pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Administrimin e dhunshëm të përkohshëm nga paragrafi (1) i këtij neni, e kryen personi juridik i autorizuar nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Personi nga paragrafi (3) i këtij neni, ka përgjegjësi për aktet dhe veprimet e ndërmarra gjatë kohëzgjatjes së administrimit të dhunshëm të përkohshëm.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i lejes në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij ligji, ka të drejtë ankese te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

(6) Pas kalimit të afatit të përcaktuar me paragrafin (2) pika 3 e këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, miraton aktvendim me të cilin e pezullon aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, ose e heq lejen.

(7) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i regjistron në librin për ujin aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe aktvendimin nga paragrafi (6) i këtij neni.

(8) Personi juridik nga paragrafi (3) i këtij neni, që të jetë i autorizuar duhet t'i plotësojë kushtet përkatëse kadrovike dhe hapësinore, si dhe të ketë së paku pesë vite përvojë, në kryerjen e punëve nga veprimtaria përkatëse, për të cilën autorizohet ta kryejë administrimin e dhunshëm.

(9) Lidhur me kuadrin personi juridik nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të ketë të punësuar së paku pesë persona me arsimim sipëror, nga sfera e shkencave natyrore dhe teknike, me përvojë pune prej së paku pesë vite.

(10) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, më afërsisht i

përcakton kushtet që duhet t'i plotësojë personi juridik nga paragrafi (3) i këtij neni.

## Neni 45

### Ndryshimi dhe plotësimi i lejes

(1) Leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, mund të ndryshohet ose të plotësohet, me detyrë zyrtare ose me kërkesën e bartësit të lejes nëse ndryshohet:

- 1) sasia dhe/ose cilësia e ujit që shfrytëzohet, ose
- 2) sasia dhe/ose cilësia e trupit ujqor nga i cili shfrytëzohet uji, ose
- 3) procesi teknologjik i punës.

(2) Kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin e lejes, në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, i bashkëngjitet dokumentacioni teknik që veçanërisht i përmban: shkaqet dhe të dhënat për ndryshimet e ndodhura në sasinë, cilësinë, vendin dhe mënyrën e shfrytëzimit të ujërave, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i regjistron ndryshimet dhe plotësimet e lejes në librin për ujin.

(4) Kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, me detyrë zyrtare mund ta paraqesë organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, si dhe organi tjetër që ka kompetenca që lidhen me sasinë dhe/ose cilësinë e ujit që shfrytëzohet, duke i përfshirë edhe subjektet që në bazë të autorizimit publik kryejnë aktivitete të lidhura me cilësinë dhe/ose sasinë e ujit që shfrytëzohet.

## Neni 46

### Kohëzgjatja e lejes

(1) Leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, lëshohet për kohë të caktuar varësisht nga lloji i objektit për furnizimin me ujë, por jo më të gjatë se 10 vite.

(2) Me përjashtim, leja nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, lëshohet për kohë më të gjatë se ajo e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, nëse e njëjta merret me procedurën për ndarjen e koncesionit, për veprimtaritë që realizohen me shfrytëzimin e ujërave, dhe atë për kohëzgjatjen e koncesionit.

(3) Kohëzgjatja e lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, fillon në momentin e fillimit të veprimit juridik të lejes, që përcaktohet në pajtim me nenin 41 të këtij ligji.

(4) Kërkesë për vazhdimin e kohëzgjatjes së lejes, bartësi i lejes është i obliguar që të paraqesë më së voni gjashtë muaj para kalimit të vlefshmërisë së lejes nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, në pajtim me procedurën e përcaktuar në nenin 34 të këtij ligji.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me kërkesën e bartësi të lejes, mundet nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ta vazhdojë afatin e përcaktuar të lejes në të cilin duhet të përfundojnë punët dhe aktivitetet për ndërtimin, mirëmbajtjen, eksploatimin, ndryshimin, zgjerimin, rehabilitimin dhe pushimin e punës së ndërtimit të objekteve të ekonomisë ujore dhe objekteve të tjera.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve

nga sfera e mjedisit jetësor, e regjistron vazhdimin e lejes në librin për ujin.

## Neni 47

### Ndërprerja e lejes

(1) Leja nga neni 26, paragrafi (1) i këtij ligji, ndërpritet nëse:

- 1) kalon afati i vlefshmërisë së lejes;
- 2) shfrytëzuesi ka hequr dorë nga të drejtat e përcaktuara në leje;
- 3) nuk fillohet me ndërtim, rikonstruktim ose mbindërtim të objekteve dhe stabilimenteve nga leja, në afat prej së paku dy vitesh nga dita e lëshimit të lejes;
- 4) nuk përfundohen punët dhe aktivitetet për ndërtimin, mirëmbajtjen, eksploatimin, ndryshimin, zgjerimin, rehabilitimin ose mbylljen e objekteve të ndërtuara të ekonomisë ujore dhe objekteve të tjera, në afatin e përcaktuar në leje;
- 5) uji pa shkaqe të arsyeshme nuk shfrytëzohet dhe/ose lëshohet në vazhdimësi në periudhën prej dy vitesh, gjatë kohëzgjatjes së lejes;
- 6) nëse nuk plotësohet kushti nga neni 42 paragrafi (4) i këtij ligji;
- 7) leja e lëshuar nuk është në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet e planeve për menaxhim me rrjedhat e lumenjve;
- 8) nëse ndodh vdekja e personit fizik pa trashëgimtarë ose
- 9) likuidimi i bartësit të lejes.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e regjistron ndërprerjen e lejes në librin për ujin.

## Neni 48

### Rastet në të cilat nuk nevojitet leja për shfrytëzim

Për shfrytëzimin e përgjithshëm të ujërave nga neni 16 paragrafi (1) i këtij ligji, si dhe në rastet e tjera të përcaktuara me këtë ligj, nuk nevojitet leja për shfrytëzimin e ujërave.

## Neni 49

### Kufizimi i së drejtës për ujin

(1) E drejta për ujin që rezulton dhe realizohet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me lejen nga neni 26 paragrafi (1) i këtij ligji, përkohësisht kufizohet nëse me realizimin e saj:

- 1) rrezikohet shëndeti i njerëzve;
- 2) rrezikohet baraspesha natyrore e ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji;
- 3) kufizohet shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave;
- 4) ndikon dëmshëm në rajonet e mbrojtura, të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e natyrës.

(2) Kufizimi i përkohshëm i të drejtës për ujin, kryhet edhe për shkak të nevojave të mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, bartësi i lejes ka të drejtë kompensimi për dëmin, në pajtim me dispozitat e përgjithshme për kompensimin e dëmit.

(4) Për kufizimet nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni, me aktvendim vendos organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor. Kufizime nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të kërkojë edhe organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë.

(5) Me aktvendimin nga paragrafi (4) i këtij neni, organi i administratës

shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përcakton edhe masa të përmirësimit dhe masa të tjera që duhet t'i ndërmarrë bartësi i lejes.

(6) Kufizimi nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) i këtij neni, nuk mund të zgjasë më shumë se nevoja për realizimin e masave të përmirësimit dhe masave të tjera.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni, bartësi i lejes në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesë kërkesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e prolongon zbatimin e vendimit.

(8) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e regjistron kufizimin e të drejtës për ujë në librin për ujin.

## Neni 50

### Ndryshimi i lejes për shfrytëzimin e ujërave për shkak të ndryshimit të përparësisë

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mundet në rastin e mungesës së ujit për pije, në lejen për shfrytëzimin e ujërave për nevojat nga neni 15 pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij ligji, ta bëjë ndryshimin e dedikimit, nëse është e domosdoshme që ato ujëra të shfrytëzohen për nevojat nga neni 15 pika 1 e këtij ligji.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, shfrytëzuesi i mëparshëm ka të drejtë kompensimi të dëmit për humbjen e fitimit dhe kompensimi të mjeteve të depozituara në objektet dhe stabilimentet e ekonomisë ujore dhe të tjera, në pajtim me dispozitat e përgjithshme për kompensimin e dëmit.

(3) Për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë së trupave të caktuar ujore, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mund ta përcaktojë mënyrën e shfrytëzimit të ujit, ta miratojë shpërndarjen e tërë ujit apo në pjese të ujit ndërmjet kërkuësve të lejes, ose të drejtën tjetër për shfrytëzimin e ujërave, nëse kërkesa për lëshimin e lejes për shfrytëzimin e ujërave është me interes publik.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e regjistron ndryshimin e lejes nga paragrafi (1) i këtij neni, në librin për ujin.

## Neni 51

### Heqja e lejes

(1) Leja nga neni 26, paragrafi (1) i këtij ligji, hiqet nëse:

- 1) uji shfrytëzohet përkatësisht lëshohet, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në leje;
- 2) bartësi nuk e ka paguar kompensimin dhe
- 3) bartësi të lejes me vendim të plotfuqishëm, i është kumtuar sanksioni kundërvajtës, ndalim për kryerjen e veprimtarisë, lidhur me shfrytëzimin e ujërave ose lëshimin e ujërave.

(2) Për heqjen e lejes në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, miraton aktvendim.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që për fillimin e procedurës për heqjen e lejes ta njoftojë bartësin e lejes, dhe në aktvendimin nga

paragrafi (2) i këtij neni, t'i japë afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, në të cilin e urdhëron për evitim të shkakut nga paragrafi (1) pika 1 dhe 2 të këtij neni, për fillimin e procedurës.

(4) Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, bartësi i lejes nuk i eviton shkaqet ose vazhdon me aktivitetet nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, miraton aktvendim për heqjen e lejes.

(5) Veprimi juridik nga heqja e lejes, vlen nga dita e përcaktuar në aktvendimin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, bartësi i lejes në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Ankesa nga paragrafi (6) i këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

(8) Personi juridik ose fizik të cilit i është heqë leja, nuk ka të drejtë kompensimi për dëmin.

(9) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e regjistron heqjen e lejes në librin për ujin.

## **Neni 52**

### **Kushti i veçantë për heqjen e lejes**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, ose me propozimin e organit tjetër të administratës shtetërore, mund të vendosë që t'ia heqë lejen bartësit, nëse me heqjen sigurohet ose realizohet interesi më i lartë publik nga ai për realizimin e të cilit është lëshuar leja.

(2) Interes më i madh publik nga paragrafi (1) i këtij neni, është realizimi i të drejtës për shfrytëzimin e ujit për më shumë shfrytëzues, në kuadër të përparësisë së njëjtë të përcaktuar me nenin 15 të këtij ligji.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik përkatësisht fizik të cilit i është hequr leja, ka të drejtë kompensimi për dëmin, në pajtim me dispozitat e përgjithshme për kompensimin e demit.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e menaxhimit me ujërat, e regjistron heqjen e lejes për sigurimin e interesit më të lartë publik, në librin për ujin.

## **II. 4. KONCESIONI PËR SHFRYTËZIMIN E UJËRAVE**

### **Neni 53**

#### **Veprimtaritë për të cilat ndahet koncesioni për shfrytëzimin e ujërave**

(1) Veprimtaritë afariste të cilat realizohen me shfrytëzimin e ujit nga trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, mund të kryhen përmes ndarjes së koncesionit dhe partneritetit privat publik (në tekstin e mëtejshëm: koncesioni), në kohë të caktuar personit vendor dhe të huaj, juridik dhe fizik.

(2) Koncesioni nga paragrafi (1) i këtij neni, ndahet për:

- 1) prodhimin e energjisë elektrike në centralet hidroelektrike;
- 2) mbushjen e ujit në shishe, për nevojat komerciale;
- 3) komunikacionin e liqeneve dhe
- 4) ofrimin e shërbimeve turistike, sportive dhe shërbimeve të tjera rekreative me ndërtimin e objekteve të përhershme.

## **Neni 54**

### **Procedura për ndarjen e koncesionit**

(1) Në emër të Republikës së Maqedonisë, koncesionin nga neni 53 paragrafi (1) i këtij ligji, e jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Për fillimin e procedurës për ndarjen e koncesionit, vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e arsyetuar të dorëzuar nga ana e ministrit, që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, të përpiluar në pajtim me Bazën e ekonomisë ujore të Republikës së Maqedonisë dhe planet për menaxhim me rrjedhat e lumenjve.

(3) Propozimin e arsyetuar nga paragrafi (2) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e dorëzon pas pajtimit paraprakisht me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, e për të cilin pozitivisht janë prononcuar organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ekonomisë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme dhe Enti republikan për mbrojtjen e monumenteve të kulturës.

(4) Vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni, botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(5) Lidhur me procedurën për ndarjen e koncesionit si dhe çështjet e tjera lidhur me koncesionin, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga Ligji për koncesione dhe partneritet privat publik.

## **Neni 55**

### **Ndarja e koncesionit nëpërmjet konkursit publik dhe përjashtime**

Koncesioni ndahet nëpërmjet thirrjes publike të organizuar dhe realizuar në pajtim me dispozita e Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik.

## **Neni 55-a**

### **Ndarja e koncesioni për ujë me kërkesë**

(1) Koncesioni për shfrytëzim të ujit mund të ndahet me kërkesë të cilën e parashtrajnë ndërmarrjet publike, institucionet publike, shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë dhe shoqëritë mbi të cilat shteti ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nëpërmjet pronësisë mbi to, përkatësisht nëse posedon pjesë më të madhe të kapitalit të shoqërisë, ka shumicë votash të aksionarëve/ bashkëpronarëve dhe nëse emëron më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit drejtues ose mbikëqyrës, përkatësisht organet drejtuese të shoqërisë, personat tjerë juridike të cilët kryejnë autorizime publike në pjesën e kryerjes së autorizimeve publike me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, pa zbatimin e procedurës për ndarjen e koncesioni nëpërmjet thirrjes

publike.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni, përpilon dhe dorëzon propozim të arsyetuar te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujit.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni ndaj kërkesës për marrjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujit duhet të dorëzojnë:

- arsyetim dhe të dhëna themelore për parashtruesin e kërkesës,
- periudhë të propozuar në të cilën do të ndahet koncesioni,
- hapësirë në të cilën propozohet të kryhet veprimtaria e koncesionit e shënuar në hartë topografike në përmasë 1:25000, me pozicionim të koordinatës në pikën e përfshirjes dhe lëshimit dhe
- elaborat gjeodezik për dedikime të veçanta me indikacione kadastrale të përpiluar nga tregtarë individë gjeodetë të autorizuar dhe shoqëri tregtare për punë gjeodezike që i plotësojnë kushtet nga Ligji për kadastër të patundshmërive.

## Neni 56

### Raporti ndërmjet koncesionit dhe lejes për shfrytëzimin e ujit

(1) Kur koncesioni ndahet në pajtim me dispozitën e nenit 55 të këtij ligji, në thirrjen publike për dorëzimin e ofertave për ndarjen e koncesionit, detyrimisht shënohet se kusht i obligueshëm për lidhjen e marrëveshjes për koncesion, është marrja e lejes për shfrytëzimin e ujit në pajtim me dispozitat e këtij ligji, ndërsa në dokumentacionin e tenderit përveç elementeve të përcaktuara në pajtim me Ligjin për koncesione të partneritetit privat publik, shënohen edhe kushtet që do të përmbahen në lejen për shfrytëzimin e ujit, si dhe kushtet që janë të domosdoshme të plotësohen ose hulumtohen për mbrojtjen dhe përparimin e ambienteve dhe sferave të mjedisit jetësor.

(2) Kur koncesioni ndahet në pajtim me dispozitën e nenit 55-a të këtij ligji, në vendimin për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujit detyrimisht shënohet se kusht i detyrueshëm për lidhje të marrëveshjes së koncesionit është marrja e lejes për shfrytëzim të ujit në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Leja për shfrytëzimin e ujit, e fituar në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk do të prodhojë veprim juridik, nëse nuk lidhet marrëveshje për koncesion.

(4) Me marrjen e koncesionit nëpërmjet thirrjes publike, ofertuesi i zgjedhur më i volitshëm pajiset me leje për shfrytëzimin e ujit në pajtim me këtë ligj.

## Neni 57

### Kohëzgjatja e koncesionit

(1) Kohëzgjatja e koncesionit përcaktohet me marrëveshjen e koncesionit, me ç'rast periudha më e gjatë është:

- 1) për prodhimin e energjisë elektrike në centralet hidroelektrike;
  - me fuqi mbi 10 MNJ deri në 70 vite,
  - me fuqi prej 2 deri në 10 MNJ deri në 50 vite dhe
  - me fuqi deri në 2 MNJ deri në 30 vite,
- 2) për mbushjen e shisheve me ujë për nevoja komerciale, pa dallim nëse bëhet fjalë për përfshirjen e ujit nga trupi uhor sipërfaqësor ose nëntokësor, deri në 20 vite,
- 3) për komunikacionin e liqeneve deri në 10 vite dhe
- 4) ofrimin e shërbimeve turistike, sportive dhe shërbimeve të tjera rekreative me ndërtimin e objekteve të përhershme, deri në 20 vite.

(2) Kohëzgjatja e lejes për shfrytëzimin e ujit, nuk guxon të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e marrëveshjes së koncesionit, e përcaktuar në pajtim me këtë ligj.

(3) Si fillim i koncesionit konsiderohet dita e lidhjes së koncesionit.

## Neni 58

### Kompensimi i koncesionit

(1) Përveç kompensimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit në bazë të lejes për shfrytëzimin e ujit dhe kompensimeve të tjera të përcaktuara me këtë ligj, koncesionari paguan kompensim për koncesionin, varësisht nga lloji i veprimtarisë tregtare. Lartësia e kompensimit për secilën veprimtari, përcaktohet në marrëveshjen e koncesionit.

(2) Kompensimi për koncesionin për shfrytëzimin e ujit, përbëhet nga dy pjesë si vijon:

- kompensimi i njehershëm që paguhet me ndarjen e koncesionit,
- kompensimi vjetor që paguhet për çdo vit, gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes për koncesion.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, kompensimin për koncesion për shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga elektranat me fuqi të instaluar mbi 10 MW përbëhet vetëm nga kompensimi vjetor i cili paguhet për çdo vjet nga kohëzgjatja e marrëveshjes së koncesionit.

(4) Lartësia e kompensimit vjetor për shfrytëzimin e ujit varësisht nga lloji i veprimtarisë tregtare përcaktohet në bazë të këtyre kriterëve:

- për prodhimin e energjisë elektrike-si përqindje nga çmimi mesatar i realizuar i energjisë së prodhuar elektrike,
- për mbushje të ujit në shishe-si përqindje nga çmimi i shitjes për litër prodhim të prodhuar,
- për shërbime turistike-si përqindje nga çmimi shitës mesatar i tokës ndërtimore në rajoni e qytetit ose komunës në të cilën është ndarë koncesioni, sipas sipërfaqes për shfrytëzimin dhe vitit të shfrytëzimit dhe
- për komunikacion liqenor-si përqindje nga të hyrat e realizuara nga kryerja e veprimtarisë.

(5) Lartësia e kompensimit të njëfishtë për koncesion për shfrytëzimin e ujit përcaktohet si përqindje ose shumë e shumëfishtë nga shuma e llogaritur ose e vlerësuar vjetore e kompensimit vjetor.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punën nga sfera e mjedisit jetësor, më afërsisht e përcakton mënyrën e përcaktimit të lartësisë së kompensimit të njëfishtë dhe vjetor, në pajtim me kriteret nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji.

(7) Mjetet e kompensimit të koncesionit për shfrytëzim të ujit për prodhim të energjisë elektrike paguhen në llogari të veçantë në kuadër të llogarisë së trezorit. Të hyrat nga këto mjete ndahen në përpjesëtim 50% të hyra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe 50% në buxhetin e komunave dhe komunave në qytetin e Shkupit, varësisht në rajonin e së cilës kryhet veprimtaria koncesionare.

(8) Mjetet nga paragrafi (7) i këtij neni që ndahen ndërmjet komunave të rajonit të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit, ndahen në përpjesëtim 50% të hyra për komunën e rajonit të qytetit të Shkupit dhe 50% për qytetin e Shkupit.

(9) Obligacionet nga denacionalizimi mund të shfrytëzohen për pagesë të pjesës së kompensimit të koncesionit për shfrytëzimin e resurseve ujore për prodhim të energjisë elektrike që janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë në lartësi 50% nga shuma e përgjithshme,



ndërsa 50% të tjera që janë të hyra të buxhetit të komunave dhe komunave në qytetin e Shkupit, paguhen në llogari të veçantë në kuadër të llogarisë së trezorit.

## **Neni 59**

### **Bartja e koncesionit**

Marrëveshja për koncesion mund të bartet në pajtim me dispozitat e Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik dhe nëse paraprakisht barten të drejtat dhe obligimet për shfrytëzimin e ujit, të përcaktuara në lejen për shfrytëzim të ujit.

## **Neni 60**

### **Ndërprerja e koncesionit**

Koncesioni shfuqizohet:

- 1) nëse i hiqet leja për shfrytëzim të ujit dhe
- 2) në rastet e parapara me dispozitat e Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik.

(2) Me ndërprerjen e koncesionit, ndërpritet edhe leja për shfrytëzimin e ujit.

## **III. PLANIFIKIMI**

## **Neni 61**

### **Dokumentet themelore të planit**

Dokumentet themelore për planifikimin dhe zhvillimin e menaxhimit me ujëra në Republikën e Maqedonisë, janë:

- 1) Strategjia nacionale për ujërat;
- 2) Baza e ekonomisë ujore e Republikës së Maqedonisë dhe
- 3) Planet për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve.

## **Neni 62**

### **Strategjia nacionale për ujërat**

(1) Me Strategjinë nacionale për ujërat, përcaktohet politika afatgjate me të cilën veçanërisht sigurohet:

- 1) zhvillimi i qëndrueshëm i ujërave, përmes plotësimit të nevojave të të gjithë shfrytëzuesve, me ujë cilësor në sasi të mjaftueshme;
- 2) shfrytëzimi racional dhe ekonomik i ujërave;
- 3) mbrojtja e ujërave nga ndotja dhe kontrolli i ndotjes;
- 4) mbrojtja dhe përmirësimi i truallit buzë bregut dhe vendbanimeve ujore dhe
- 5) mbrojtja dhe zbutja e pasojave nga veprimi i dëmshëm i ujërave dhe mungesa e ujit.

(2) Strategjia nacionale për ujërat, miratohet për periudhën prej 30 vitesh.

(3) Strategjinë nacionale për ujërat, me propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e pylltarisë, organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ekonomisë, organin e administratës

shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes, dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e vetadministrimit lokal, është kompetent për përpilimin e Strategjisë nacionale për ujërat dhe e dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për shqyrtim dhe dorëzimin në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(5) Përcaktimet e Strategjisë nacionale për ujërat, obligativisht duhet të kihën parasysh gjatë përpilimit të dokumenteve të tjera strategjike, me të cilat përcaktohen politika dhe qëllimet e zhvillimit të ekonomisë në Republikën e Maqedonisë, shfrytëzimi i resurseve natyrore, mbrojtja shëndetësore, zhvillimi lokal dhe rajonal dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

(6) E drejta për qasje në informatat e përmbajtura në Strategjinë nacionale për ujërat, e të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, realizohet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara në Ligjin për mjedisin jetësor.

(7) Pjesëmarrja e opinionit në procedurën për miratimin e Strategjisë nacionale për ujërat, kryhet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 63

### Baza e ekonomisë ujore e Republikës së Maqedonisë

(1) Për planifikimin dhe zbatimin e integruar të programeve dhe masave për zhvillimin e ujërave, në pajtim me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm nacional dhe harmonizimin e zhvillimit ekonomik, përparimin social dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe realizimin e Strategjisë nacionale për ujërat, miratohet Baza e ekonomisë ujore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Baza e ekonomisë ujore).

(2) Baza e ekonomisë ujore, miratohet për territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Bazën e ekonomisë ujore, me propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

(4) Baza e ekonomisë ujore, miratohet për periudhën prej 20 vitesh.

(5) Baza e ekonomisë ujore, veçanërisht i përmban:

- 1) gjendjen e ekzistuese të ujërave;
- 2) nevojat e tanishme dhe të ardhshme për ujërat;
- 3) bilancin e ujërave;
- 4) zgjidhjet teknike dhe ekonomike për shfrytëzimin racional të ujërave, për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe për mbrojtjen nga ndikimi i dëmshëm në ujërat, në bazë të principeve për zhvillimin e qëndrueshëm;
- 5) planin kohor për realizimin e zgjidhjeve teknike dhe ekonomike, nga pika 4 e këtij paragrafi dhe
- 6) qëllimet afatgjate për mjedisin jetësor dhe programin e masave për realizimin e tyre.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është kompetent për përpilimin e Bazës së ekonomisë ujore, dhe e dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për shqyrtim dhe dorëzim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(7) Përmbajtja më e afërt, mënyra dhe procedura e përpilimit, revidimit dhe përditësimit të Bazës së ekonomisë ujore, përcaktohet me metodologjinë e përcaktuar nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit

jetësor.

(8) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e siguron harmonizimin ndërmjet Bazës së ekonomisë ujore të Republikës së Maqedonisë dhe Planit hapësinor të Republikës së Maqedonisë.

(9) Gjatë përpilimit të dokumenteve afatgjate të planeve, me të cilat rregullohet zhvillimi i degëve të veçanta ekonomike në Republikën e Maqedonisë, si dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore, obligativisht kryhet harmonizimi i tyre me Bazën e ekonomisë ujore.

(10) E drejta për qasje në informatat e përmbajtura në Bazën e ekonomisë ujore, e të cilat kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, realizohet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor.

(11) Konsultimi i opinionit për miratimin e Bazës së ekonomisë ujore, si dhe miratimi i Bazës së ekonomisë ujore, zbatohet në bazë të Ligjit për mjedisin jetësor.

## **Neni 64**

### **Përpilimi, revidimi dhe përditësimi i Bazës së ekonomisë ujore të Republikës së Maqedonisë dhe informimi dhe konsultimi me opinionin**

(1) Baza e ekonomisë ujore, përpilohet në dy faza si vijon:

- 1) projekti dhe
- 2) propozimi.

(2) Për sigurimin e pjesëmarrjes së opinionit profesional, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton vendim për vënien e Projektit të Bazës së ekonomisë ujore në shqyrtim profesional, që publikohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(3) Shqyrtimin profesional e organizon organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në afat prej 60 ditësh nga dita e publikimit të vendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, me ç'rast është i obliguar të sigurojë kushte që opinionin profesional në mënyrë përkatëse të ketë qasje në Projektin e Bazës së ekonomisë ujore, dhe t'i tregojë mendimet dhe qëndrimet e veta.

(4) Në bazë të mendimeve dhe qëndrimeve të marra nga shqyrtimi profesional për Projektin e Bazës së ekonomisë ujore, përpilohet Propozimi i Bazës së ekonomisë ujore, të cilin me propozimin e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e dorëzon Propozimin e Bazës së ekonomisë ujore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, për miratimin e tij.

(6) Pjesëmarrja e opinionit profesional në përpilimin e Bazës së ekonomisë ujore, nuk e ndryshon procedurën për pjesëmarrjen e opinionit gjatë miratimit të dokumenteve të planit, të përcaktuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **Neni 65**

### **Ndryshimi dhe plotësimi i Bazës së ekonomisë ujore të Republikës së Maqedonisë**

(1) Baza e ekonomisë ujore e Republikës së Maqedonisë revidohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet, së paku në çdo 10 vite, ndërsa sipas nevojës edhe më herët.

(2) Ndryshimet dhe plotësimet e Bazës së ekonomisë ujore, i kryen

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(3) Në ndryshimet dhe plotësimet e Bazës së ekonomisë ujore, në mënyrë përkatëse zbatohet neni 64 i këtij ligji.

## Neni 66

### Planet për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve

(1) Për secilën rrjedhë të lumit të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, përpilohet Plani për menaxhimin me rrjedhën e lumit për periudhën prej gjashtë vitesh.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i miraton planet për menaxhim me rrjedhat e lumit, me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Planet për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve, përpilohen në pajtim me Bazën e ekonomisë ujore të Republikës së Maqedonisë.

(4) Plani për menaxhimin me rrjedhën e lumit, veçanërisht i përmban elementet si vijojnë:

- 1) përshkrimin e karakteristikave të rrjedhës së lumit;
- 2) pasqyrën e shtypjeve dhe ndikimeve të konsiderueshme në gjendjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut;
- 3) informatat dhe pasqyrat hartografike të zonave të mbrojtura të regjistruara;
- 4) informatat dhe pasqyrat hartografike për aktivitetet e monitorimit të gjendjes së ujërave dhe programet e monitorimit;
- 5) listën e qëllimeve të mjedisit jetësor për secilin trup uhor në rrjedhën e lumit, në pajtim me nenin 72, nenin 90, nenin 92, nenin 93 dhe nenin 94 të këtij ligji, duke i përfshirë edhe informatat për lëshimet e bëra në pajtim me këtë ligj; shënimin e ujërave sipërfaqësore artificiale dhe të ndryshuara me forcë. Informatat i përmbajnë masat e planifikuara dhe të ndërmarra, për përmirësimin e cilësisë së ujërave dhe arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor;
- 6) analizën ekonomike për shfrytëzimin e ujërave, duke e përfshirë edhe raportin për zbatimin e parimit shfrytëzuesi paguan;
- 7) Programin e masave për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor, në pajtim me nenin 73 të këtij ligji;
- 8) plan-programet më detajore për menaxhim me ujërat e rrjedhave të lumenjve dhe nënrrjedhat;
- 9) Programin për mbrojtje nga veprimi i dëmshëm i ujërave nga neni 124 i këtij ligji, si dhe masat themelore për mbrojtje nga vërshimet;
- 10) përshkrimin e aktiviteteve dhe rezultateve nga pjesëmarrja e opinionit gjatë përpilimit të planit;
- 11) listën e organeve dhe institucioneve, kompetente për ujërat në rrjedhën e lumit;
- 12) mënyrën në të cilën informatat dhe dokumentet lidhur me përpilimin dhe implementimin e planit, janë të kapshme për opinionin;
- 13) realizimin e obligimeve të ndërmarra me marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë dhe
- 14) punë të tjera të përcaktuara nga ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është përgjegjës për përpilimin e planeve për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve, nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjatë përpilimit të Planeve për menaxhim me rrjedhën e lumit, merren parasysh mendimet e Këshillit për menaxhim me rajonin e rrjedhës së

lumit dhe të Këshillave për menaxhim me pjesët nga rajoni i rrjedhës së lumit.

(7) Planet për menaxhim me rrjedhën e lumit, zbatohen përmes lëshimit të lejeve dhe përmes instrumenteve të tjera, të përcaktuara me këtë ligj.

(8) Organet dhe institucionet që kanë të drejta dhe obligime lidhur me menaxhimin me ujërat në rrjedhën e lumit, janë të obliguara që të punojnë në pajtim me planet për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve.

(9) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, më afërsisht e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e përpilimit të planeve për menaxhim me rrjedhat e lumenjve.

(10) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, më afërsisht e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së informatave dhe pasqyrave hartografike për aktivitetet e monitorimit të ujërave, të plan-programeve më detajore për menaxhim me ujërat dhe rrjedhat dhe nënrrjedhat e lumenjve, dhe përshkrimin e aktiviteteve dhe rezultateve nga pjesëmarrja e opinionit gjatë përgatitjes së Planit nga paragrafi (4) i këtij neni.

## Neni 67

### **Përpilimi, revidimi dhe përditësimi i planeve për menaxhim me rrjedhat e lumenjve dhe informimi dhe konsultimi me opinionin**

(1) Plani për menaxhim me rrjedhën e lumit, përpilohet në dy faza si vijon:

- 1) projektplanit dhe
- 2) propozim-planit.

(2) Për sigurimin e pjesëmarrjes së opinionit në përpilimin e planit, do të publikohet dhe do të paraqitet për shikim publik Projektplanit, e veçanërisht të dhënat si vijojnë:

- 1) orari kohor dhe programi i punës për përpilimin e Projektplanit, duke e përfshirë edhe deklaratën (listën) për masat konsultuese që duhet të ndërmerren, së paku tre vite para fillimit të periudhës që është lëndë e planit;
- 2) pasqyrën e çështjeve të rëndësishme nga sfera e menaxhimit me ujërat, të identifikuar në nivelin e rrjedhës së lumit, së paku dy vite para fillimit të periudhës që është lëndë e planit dhe
- 3) Projektplanin - ekzemplarë të planit për menaxhim me rrjedhën e lumit, së paku një vit para fillimit të periudhës që është lëndë e planit.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, miraton vendim për paraqitjen e Projektplanit në shikim publik. Vendimi publikohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Shikimi publik nga paragrafi (2) i këtij neni, zgjat së paku gjashtë muaj nga dita e publikimit të vendimit, për paraqitjen e Projektplanit në shikim publik.

(5) Shikimin publik e organizon organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me ç'rast është i obliguar që të sigurojë kushte dhe mënyrën që opinionin të mund t'i tregojë qëndrimet dhe mendimet e veta.

(6) Për kohëzgjatjen e shikimit publik, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që të organizojë debat profesional për Projektplanin.

(7) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve

nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që të përpilojë procesverbal nga shikimi publik dhe shqyrtimi profesional, dhe atij t'ia bashkëngjisë shënimet e stenogramit nga shqyrtimi.

(8) Me kërkesën e opinionit të preokupuar, sigurohet edhe shikimi në dokumentet burimore dhe në informatat që janë shfrytëzuar gjatë përpilimit të Projektplanit.

(9) Në bazë të mendimeve dhe qëndrimeve të marra nga shikimi publik dhe shqyrtimi profesional për Projektplanin, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përpilon Propozim-planin për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(10) Organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e dorëzon Propozim-planin për menaxhim me rrjedhën e lumit, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

## **Neni 68**

### **Ndryshime dhe plotësime të planit për menaxhim me rrjedhën e lumit**

(1) Plani për menaxhim me rrjedhje të lumit rishikohet, ndryshohet dhe plotësohet së paku në çdo gjashtë vite, ndërsa sipas nevojës edhe më herët.

(2) Ndryshimet dhe plotësimet e planit për menaxhim me rrjedhën e lumit i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Në ndryshimet dhe plotësimet e planit për menaxhim me rrjedhën e lumit, në mënyrë përkatëse zbatohet neni 67 i këtij ligji.

## **Neni 69**

### **Sigurimi i realizimit të objekteve dhe masave të planifikuara**

Për shkak të sigurimit të realizimit të objekteve të planifikuara dhe masave me interes publik për: furnizimin me ujë, akumulimin e ujërave, pastrimin e ujërave të zeza, prodhimin e energjisë, ujitjen dhe kullimin, mbrojtjen nga vërshimet dhe rregullimin e ujërave sipërfaqësorë, në planin për menaxhim me rrjedhjet e lumit përcaktohen sferat në të cilën ndalohet ndërtimi ose aktivitet tjetër i cili mundet ta pengojë realizimin e objekteve të planifikuara dhe masave me interes publik.

## **Neni 70**

### **Rajoni ndërkombëtar i rrjedhjes së lumit**

(1) Nëse rajoni ndërkombëtar i rrjedhjeve të lumit ndodhet në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe pjesërisht në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe pjesërisht në territorin e shtetit tjetër ose shteteve, organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar të bashkëpunojë me organet kompetente të shteteve relevante për shkak të përpilimit të planit të vetëm për menaxhim me rrjedhjet ndërkombëtare të lumit.

(2) Nëse me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë është i përcaktuar rajoni ndërkombëtar i rrjedhjeve të lumit, organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor siguron menaxhim me pjesën nga rajoni ndërkombëtar i rrjedhjeve të lumit që gjendet në territorin e Republikës së

Maqedonisë në pajtim me Ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

(3) Në rast kur plani për menaxhim me rajonin të rrjedhjeve ndërkombëtare të lumit nuk është i hartuar, plani për menaxhim me rrjedhën e lumit hartohet, në pajtim me këtë ligj, për atë pjesë të rrjedhjeve ndërkombëtare të lumit i cili gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë.

## **Neni 71**

### **Vlerësimi i rrjedhjeve të lumeve**

(1) Për çdo rajon i rrjedhjeve të lumit i përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, së paku në çdo gjashtë muaj kryen:

- 1) analiza të karakteristikave të veta;
- 2) kontroll të shtypjeve të rëndësishme dhe ndikimeve të aktiviteteve njerëzore mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe
- 3) analizë ekonomike të shfrytëzimit të ujit duke marrë parasysh zbatimin e parimit shfrytëzuesi paguan.

(2) Rezultatet nga vlerësimi i kryer nga paragrafi (1) i këtij neni janë pjesë përbërëse e planit për menaxhim me rrjedhjen e lumit.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit e përcakton metodologjinë për vlerësimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 72**

### **Qëllimet për mjedisin jetësor**

(1) Për shkak të menaxhimit me rajonet e rrjedhjeve të lumenjve të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, për çdo trup uhor në rajonin e rrjedhjes detyrimisht:

- 1) përcaktohen qëllimet për mjedisin jetësor në pajtim me kriteret e përcaktuara në nenet 90, 92, 93 dhe 94 të këtij ligji dhe
- 2) miraton Program të masave për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor për shkak të arritjes së atyre qëllimeve.

(2) Gjatë përcaktimit të qëllimeve për mjedisin jetësor dhe miratimit të programit të masave, merren parasysh vlerësimet e kryera në pajtim me nenin 71 të këtij ligji.

(3) Gjatë përcaktimit të qëllimeve për mjedisin jetësor dhe miratimit të programit të masave, mbahet llogari veçanërisht për:

- 1) tipin e qëllimit për mjedisin jetësor në varshmëri nga karakteristikat e trupit uhor si dhe përjashtimet;
- 2) kohën, kriterin, metodat dhe procedurën gjatë vërtetimit të qëllimeve për mjedisin jetësor;
- 3) afatin në të cilin doemos duhet të arrihen qëllimet për mjedisin jetësor dhe
- 4) llojin dhe afatin në të cilin doemos duhet të ndërmerren masat përcaktuara në Programin e masave për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor, si dhe mënyrën dhe procedurën për përpilimin e Programit.

## **Neni 73**

### **Programi i masave për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor**

(1) Për shkak të arritjes së qëllimeve për mjedis jetësor të përcaktuara me planet për menaxhim me rrjedhjet e lumit në pajtim me këtë ligj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me

organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për çdo rajon të rrjedhjes së lumit në territorin e Republikës së Maqedonisë, të përcaktuar me nenin 7 të këtij ligji, miraton Program të masave për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor (në tekstin e mëtutjeshëm: Program i masave).

(2) Pjesë përbërëse e Programit të masave është programi financiar për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parapara. Gjatë përpilimit të planit financiar merret parasysh analiza ekonomike nga neni 66 paragrafi (4) pika 6 e këtij ligji.

(3) Programi i masave i përmban masat themelore nga neni 74 i këtij ligji, ndërsa sipas nevojës dhe masat plotësuese të cilat doemos duhet të ndërmerren në rrjedhën përkatëse të lumit për shkak të arritjes së qëllimeve të përcaktuara të mjedisit jetësor.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është përgjegjës për përpilimin e Programit të masave.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për së afërmi e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së Programit të masave, në të cilën janë përfshirë ndaras masat për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke përfshirë edhe rajonet e mbrojtura, përmbajtjen më të afërt të masave themelore dhe plotësuese të përcaktuara në pajtim me nenin 74 të këtij ligji dhe kushtet për zbatimin e tyre, si dhe masat të cilat doemos duhen të ndërmerren nëse qëllimet e mjedisit jetësor për trupin konkret ujon nuk janë arritur.

(6) Programi i masave, azhurnohet së paku në çdo gjashtë vjet, ndërsa masat e reja ose të ndryshuara bëhen operative me vendosjen e tyre.

## Neni 74

### Masat themelore dhe masat plotësuese për zbatimin e Programit të masave

(1) Masat themelore për zbatimin e Programit të masave, për të gjitha masat të cilat në pajtim me këtë apo ligj tjetër janë të përcaktuar si instrument të veçantë, si dhe masa të tjera ekzistuese ose të ardhshme të drejtuara ndaj realizimit të qëllimeve të përcaktuara me planet për menaxhim me rrjedhjet e lumit, ndërsa veçanërisht:

1) masat për arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor dhe masat për pengimin e përkeqësimit të gjendjes së ujërave të përcaktuara me këtë ligj;

2) masat e mbrojtjes, përmirësimit dhe kthimit në gjendje të mëparshme e të gjithë trupave ujorë, masa kundër ndotjes së ujërave me ndotës të caktuar ose grupor të cilat paraqesin rrezik të konsiderueshëm për mjedisin ujon, rrezikun ndaj ujërave për pije dhe ujërave për banjë, duke përfshirë dhe lejet, kontrollat dhe sistemet për evidentim dhe masat për burime pikë-pikë dhe difuze të ndotjes;

3) masa dhe ndalesa lidhur me mbrojtjen e ujërave nëntokësor, duke përfshirë edhe kushtet për zbatimin tyre;

4) masa për zvogëlimin e derdhjeve të materieve dhe substancave të rrezikshme në ujëra;

5) masa të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe për mbrojtjen e natyrës;

6) masa të përcaktuara me dispozitat për lundrim të brendshëm;

7) masa të përcaktuara me dispozitat për peshkim;

8) masa të përcaktuara me dispozitat për siguri të ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut, duke përfshirë edhe masat për zvogëlimin e nivelit të spastrimit të nevojshëm gjatë prodhimit të ujit për pije;

9) masa për mirëmbajtjen e gjendjes kuantitative të ujërave;

10) masa për mbrojtje nga veprimi i dëmshëm i ujërave;



- 11) masa të cilat ndërmerren në rast të fatkeqësive dhe fuqisë madhore;
- 12) masa për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitrata nga prodhimet bujqësore
- 13) masa për trajtim të ujërave të zeza urbane;
- 14) masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor veçanërisht të tokës gjatë shfrytëzimit të llumit të fituar me spastrimin e ujërave të zeza për nevojat e bujqësisë;
- 15) masa për kontroll të shfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, duke përfshirë edhe masat për zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- 16) masa për kontroll të vëllimit të ndërtimit të objekteve të ekonomisë së ujërave;
- 17) masa për përcaktimin e kompensimeve për shpenzimet për përdorimin e ujit;
- 18) masa për nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të ujërave;
- 19) masat e përcaktuara me dispozitat për vlerësim të ndikimeve nga projekte të caktuara mbi mjedisin jetësor;
- 20) masat e përcaktuara me dispozitat për pengimin e integruar dhe kontroll të ndotjes;
- 21) masat e përcaktuara me dispozitat për pengim dhe kontroll të prishjeve në praninë të substancave të rrezikshme;
- 22) masat të përcaktuara me dispozitat për prodhime për mbrojtjen e bimëve;
- 23) masa për mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjes dhe menaxhimit racional me komponentë të caktuar të llojllojshmërisë biologjike dhe rajonale, si dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe racional të pasurisë natyrore, si dhe
- 24) masa të tjera që janë të përcaktuara me ligj, ndërsa të cilat janë relevante për zbatimin e të njëjtëve, ndërsa kontribuojnë ndaj arritjes së qëllimeve të këtij ligji.

(2) Nëse qëllimet e mjedisit jetësor për trup konkret uxor nuk janë arritur me ndërmarrjen e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor cakton masa plotësuese të cilat doemos duhen të ndërmerren, ndërsa veçanërisht: ndërmarrjen e masave ligjore, administrative-ekonomike dhe fiskale; lidhjen e marrëveshjeve për mbrojtjen e mjedisit jetësor; vendosjen e kontrolleve të emetimeve; përcaktimin e kodekseve për praktikë të mirë; vendosjen e masave për reparacion të vendbanimeve ujore; vendosjen e masave për kufizimin dhe kontrollim të shfrytëzimit; masa për rregullimin e shpenzimeve, duke përfshirë edhe masa për adaptim të prodhimitarisë bujqësore të kulturave të cilat kërkojnë më pak ujë në rajone të prekura nga thatësira; masa për përdorim racional, efikas dhe përdorim të përsëritshëm, duke përfshirë dhe përdorimin e teknologjive në industri dhe ujitjen për përdorim efikas të ujit dhe për ruajtjen e ujit; zbatimin e ndërhyrjeve ndërtimore dhe projekteve për rehabilitim; masa për mbushje artificiale të shtresave ujëmbajtëse; masa për edukim, kërkim, zhvillim dhe trajnim; dhe masa tjera të domosdoshme.

(3) Nëse me mbikëqyrje ose të dhënat tjera për trupin uxor tregojnë se është e vogël mundësia se do të arrihen qëllimet për mjedis jetësor për trupat uxorë të përcaktuar me këtë ligj, përveç në rast në pajtim me nenin 119 të këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar t'i ndërmarrë aktivitetet, si vijon:

- t'i analizojë shkaqet për mospësuksin e mundshëm,
- t'i analizojë dhe/ose kontrollojë lejet relevante dhe lejet lidhur me trupin uxor,
- t'i kontrollojë dhe nëse është e nevojshme t'i adaptojë programet për mbikëqyrje të trupit uxor dhe
- të vendosë nëse është e nevojshme masa plotësuese me qëllim që të arrihen qëllimet për mjedisin jetësor, duke përfshirë dhe standarde me të larta për kualitet të mjedisit jetësor.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mund të miratojë program të veçantë për një

ose për disa masa nga paragrafi (1) i këtij neni nëse vlerëson se në atë mënyrë do të sigurojë në mënyrë më kompetente zbatimin e masave të dhëna.

## Neni 75

### **Njoftim për zbatimin e planeve për menaxhim me rrjedhën e lumit dhe Programi i masave**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar:

- 1) së paku një herë në tre vjet ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për zbatimin e planeve për menaxhim me rrjedhjet e lumit;
- 2) së paku një herë në vit ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për zbatimin e Programit të masave, për shkaqet për moszbatimin dhe vendosjen e masave plotësuese dhe
- 3) t'i shpallë planet për menaxhim me rrjedhjet e lumit në pajtim me nenin 163 të këtij ligji.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë të paraqesë raport inicial për:

- 1) zbatimin e planeve për menaxhim me rrjedhjet e lumit në afat prej tre vitesh nga sjellja e Planit për menaxhim me rrjedhën e lumit dhe
- 2) zbatimin e Programit të masave në afat prej një viti nga sjellja e Programit të masave.

## Neni 76

### **Vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor nga dokumentet themelore për planifikim dhe zhvillim të menaxhimit me ujëra në Republikën e Maqedonisë**

Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar të sigurojë vlerësim të ndikimit të strategjive, planet dhe programet për planifikim dhe zhvillim të menaxhimit me ujëra në Republikën e Maqedonisë ndaj mjedisit jetësor, veçanërisht ndikimi i dokumenteve të planifikuara themelore të përcaktuara me nenin 61 të këtij ligji, dhe nga programi për mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave të përcaktuara me nenin 124 të këtij ligji, si dhe nga ndryshimet dhe plotësimet e tyre, në procedurë të përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

## IV. MBROJTJA E UJËRAVE

### 1. DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

## Neni 77

### **Ndalim i përgjithshëm**

(1) Çdo veprim ose aktivitet me të cilin ndoten ujërat ose lëshohen ujëra të zeza ose mosndërmarrjen e veprimeve me të cilin mundësohet ndotja e ujërave ose derdhja e ujërave të zeza është e ndaluar.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, veprimet dhe aktivitetet mund të ndërmerren nën kushte dhe mënyrë të përcaktuara me këtë ligj.

## Neni 78

### **Dispozitë e përgjithshme për derdhjet në mjedisin ujqor**

(1) Çdo derdhje në ujërat, truallin buzë bregut dhe vendbanimet ujore kryhet në bazë të lejes në pajtim me kriteret për kualitet të ujit dhe qëllimet e mjedisit jetësor të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitë tjetër.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar të sigurojë se, leja e lëshuar është në pajtim me kriteret ekzistuese për kualitet të ujit dhe qëllimet e mjedisit jetësor, të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitë tjetër.

## **Neni 79**

### **Leje për derdhje**

(1) Personat juridikë dhe fizikë, duke përfshirë edhe organet e administratës shtetërore, komunitat, komunitat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit munden të lëshojnë ujëra të zeza ose të lëshojnë ose hedhin materie dhe substanca në recipientët vetëm pas marrjes paraprake të lejes për derdhje të ujërave (në tekstin mëtutjeshëm: leje për derdhje), në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Për shkak të zbatimit të planeve për menaxhim me rrjedhën e lumit, leja për derdhje jepet në pajtim me Planin për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(3) Për objektet dhe për instalimet për të cilat është e nevojshme leja për derdhje, ndërsa për të cilat me Ligjin për mjedis jetësor është e përcaktuar se pajiset me A - leje ekologjike të integruar, përkatësisht B - leje ekologjike të integruar për instalime në rajonet e mbrojtura, leja pajiset në procedurë të përcaktuar me atë ligj.

(4) A - Leje ekologjike e integruar, përkatësisht B - leje ekologjike e integruar për instalimet në rajonin e mbrojtur nga paragrafi (3) i këtij neni, e zëvendëson lejen për derdhje.

(5) Për objektet dhe për instalimet për të cilat është e nevojshme leja për derdhje, ndërsa për të cilat me Ligjin për mjedis jetësor është e përcaktuar se është e nevojshme B - leje ekologjike e integruar me përjashtim të B - lejes ekologjike të integruar për instalime në rajonin e mbrojtur, leja për derdhje pajiset nën kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(6) Projektet për të cilat me Ligjin për mjedis jetësor është e përcaktuar se kryhet vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor, duke përfshirë edhe projektet për të cilat nevoja për vlerësimin e ndikimit kryhet me shqyrtimin e çdo rasti ndaras, vlerësimi kryhet nën kushte dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(7) Në lejen nga paragrafi (4) i këtij neni përcaktohen vlerat kufitare për emetimet e substancave dhe sasitë e tyre si dhe standardet për mjedisin jetësor që janë përfshirë me këtë ligj dhe dispozitat e sjella në bazë të këtij ligji, duke përfshirë edhe emetimet dhe standardet e përcaktuara me dispozitat nga sfera që e rregullojnë dhënien e lejes së integruar ekologjike, me qëllim arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor të trupit ujqor të përcaktuar me këtë ligj.

## **Neni 80**

### **Kërkesë për dhënien e lejes për derdhje**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e jep lejen për derdhje me kërkesë të personit juridik ose fizik (në tekstin e mëtutjeshëm: kërkuar)

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës, si dhe dokumentacionin

e nevojshëm i cili i bashkëngjitet kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni.

## **Neni 81**

### **Veprim me kërkesën për dhënien e lejes për derdhje**

Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me kërkesën për dhënien e lejes për derdhje, vepron në pajtim me nenet 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 42 të këtij ligji.

## **Neni 82**

### **Dhënia e lejes për derdhje**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësorë është i detyruar që ta japë lejen për derdhje ose të sjellë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për dhënien e lejes për derdhje, në afat jo më të gjatë se tre muaj nga data e pranimit të kërkesës përkatësisht pranimin e të dhënave për plotësimin e kërkesës.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni si dhe kushtet e përcaktuara në lejen nga paragrafi (1) të këtij neni, kërkuesi, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa për dhënien e lejes përkatësisht lejes për derdhje, mundet të paraqes ankesë deri te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, lejet e dhëna për derdhje, bartja e të drejtave dhe detyrimeve nga leja për derdhje, administrata e përkohshme e detyrueshme, ndryshimet dhe plotësimet e lejes, kufizimet e lejes, marrjen dhe ndërprerjen e lejes, i regjistron në librin për ujin.

(4) Nëse organi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e lëshon lejen nga neni 79 paragrafi (1) i këtij ligji, përkatësisht nuk merr vendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e lejes në afatin e përcaktuar me paragrafin (1) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune, të parashtrorë kërkesë në sekretari të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, që të marrë vendim me të cilin jepet leje për lëshim. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrorë në sekretari në selinë e organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (4) të këtij neni e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Me kërkesë nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon kopje të kërkesës sipas nenit 80 paragrafi (1) të këtij ligji për miratimin e aktvendimit me të cilën jepet leja për lëshim.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, është i detyruar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimin të kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni në sekretari, të marrë aktvendim me të cilin kërkesa për dhënien e lejes për lëshim është lejuar ose refuzuar.

(8) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk merr aktvendimin nga paragrafi (7) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve pune.

(9) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditësh nga pranimi i njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni të kryejë

mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tre ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkesës për gjendjen e vërtetuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(10) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin merr aktvendim me të cilin e detyron ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e mjedisit jetësor, që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e parashtruar nga paragrafi (4) i këtij neni, përkatësisht ta miratojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(11) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afat nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori do të parashtrorë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilën ministri do të vendosë për kërkesën e parashtruar me ç'rast në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës.

(12) Nëse ministri nuk ka vendosur dhe në afat plotësues nga paragrafi (11) të këtij neni, inspektori në afat prej tre ditëve pune do të parashtrorë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë të parashtrorë kundërshtim në sekretari të drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrorë në sekretari në selinë e Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(14) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditësh pune, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (13) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës në pajtim me paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni dhe/ose nuk parashtron fletëparaqitje në pajtim me paragrafët (11) dhe (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrorë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në pajtim me Ligjin dhënë afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse inspektori nuk ka vepruar edhe në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrorë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Në rastet nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror administrativ menjëherë e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta realizojë menjëherë mbikëqyrjen.

(17) Në rastet nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror administrativ në afat prej tre ditëve e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(18) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror administrativ nuk ka vepruar

në pajtim me paragrafin (14) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(19) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e turizmit nuk vendos në afat nga paragrafi (11) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(20) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

(21) Akti nënligjor nga paragrafi 5 i këtij neni do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(22) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafit (5) i këtij neni i njëjti menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh shpallet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e mjedisit jetësor.

## Neni 83

### Përmbajtja e lejes për derdhje

(1) Me lejen për derdhje veçanërisht përcaktohen:

- 1) të dhënat për bartësin e lejes;
- 2) listat e objekteve dhe stabilimenteve në pajtim me dokumentacionin e ofruar teknik;
- 3) mënyrat dhe kushtet e ndërtimit, rikonstruksionit dhe rindërtimit të objekteve dhe stabilimenteve;
- 4) regjimi për punë të objekteve dhe stabilimenteve;
- 5) mënyra dhe kushtet për derdhje në ujëra, truallin buzë bregut dhe vendbanimet ujore dhe pasojat nga ndryshimi i regjimit të ujërave, trualli buzë bregut dhe vendbanimet ujore, duke përfshirë edhe vlerat kufitare për emetimet e substancave dhe sasi të tyre si dhe standardet për mjedisin jetësor;
- 6) mënyra dhe procedura e matjes së kuantitetit dhe kualitetit të derdhjeve në ujëra, si dhe mënyra e dërgimit të të dhënave nga matja;
- 7) mënyra dhe procedura për pagimin e kompensimit për derdhje në ujëra;
- 8) mënyra, kushtet dhe shkalla e spastrimit dhe grumbullimit si dhe tretmanit të ujërave të zeza;
- 9) afatet në të cilën doemos duhet të fillojnë dhe të mbarojnë punët dhe aktivitetet për ndërtim, mirëmbajtje, eksploatim, ndryshim, zgjerim, rehabilitim dhe mbyllje të objekteve të ndërtuara dhe të tjera të ekonomisë së ujërave dhe
- 10) kohëzgjatja e lejes.

(2) Në lejen për derdhje përcaktohen edhe autorizimet e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor për:

- 1) përcaktimin e kushteve plotësuese ose ndryshimin e llojit të materieve dhe substancave në ujë ose vlerat kufitare të materieve dhe substancave;
- 2) përcaktimin e masave plotësuese teknike;
- 3) shtrimin e masave plotësuese për vendosjen e baraspeshës të gjendjes së përkeqësuar ekologjike dhe kimike të ujërave sipërfaqësore, të shkaktuar nga derdhja e ujërave në shpenzim të bartësit të lejes;
- 4) ndryshimin e standardevë dhe vlerave kufitare të ujërave të zeza ose materieve të lëshuara dhe substancave të përcaktuara me lejen në varshmëri nga ndryshimi i dispozitave me të cilat janë të vërtetuara ato standarde dhe
- 5) përcaktimin e kërkesave plotësuese në lidhje me monitorimin e ujërave.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, më për së afërmi e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes për derdhje.

## Neni 84

### Ndryshime dhe plotësime të lejes për derdhje

(1) Përveç kushteve të përcaktuara në nenin 45 paragrafi (1) i këtij ligji, leja për derdhje, mund të ndryshohet ose të plotësohet, sipas detyrës zyrtare, ose me kërkesë të bartësit të lejes nëse ndryshohet edhe kualiteti dhe kuantiteti i ujërave që lëshohen.

(2) Ndaj kërkesës për ndryshim dhe plotësim të lejes për derdhje në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i lejes dorëzon dokumentacionin teknik i cili veçanërisht përmban: shkaqe dhe të dhëna për ndryshimet e shkaktuara të sasisë, kualitetit, vendit dhe mënyrës së derdhjeve të ujërave si dhe të dhëna tjera të nevojshme.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i regjistron ndryshimet dhe plotësimet e lejes për derdhje në librin për ujin.

## Neni 85

### Kohëzgjatja e lejes për derdhje

(1) Leja për derdhje, jepet në kohë të caktuar në varshmëri nga lloji i objektit të ekonomisë së ujërave, por jo më gjatë së 10 vjet.

(2) Kohëzgjatja e lejes për derdhje fillon me momentin e fillimit të veprimit juridik të lejes.

(3) Kërkesë për vazhdimin e kohëzgjatjes së lejes bartësi i lejes është i detyruar të dërgojë më së voni gjashtë muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së lejes për derdhje.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me kërkesë të bartësit të lejes për derdhje, mundet, nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, ta vazhdojë afatin e përcaktuar me lejen në të cilën doemos duhet të mbarojnë punët dhe aktivitetet për ndërtim, mirëmbajtje, eksploatim, ndryshim, zgjerim, rehabilitim dhe ndërprerje të punës të objekteve të ndërtuara të ekonomisë së ujërave dhe objekteve tjera.

(5) Për shkak të mbrojtjes së ujërave nëntokësore lejet për derdhje të dhëna në pajtim me nenin 111 të këtij ligji detyrimisht rishqyrtohen së paku në çdo katër vite.

## Neni 86

### Ndërprerja e lejes për derdhje

(1) Leja për derdhje, ndërpritet në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 47 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e regjistron ndërprerjen e lejes në librin për ujin.

## Neni 87

### Kufizime të lejes për derdhje

(1) Derdhja në ujëra përkohësisht kufizohet, nëse me derdhjen:

1) rrezikohet shëndeti i njerëzve;

2) rrezikohet baraspesha natyrore e ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji dhe

3) ndikon dëmshëm mbi rajonet e mbrojtura të përcaktuara me dispozitat

për mbrojtjen e natyrës.

(2) Kufizim i përkohshëm i derdhjeve në ujëra kryhet edhe për shkak të nevojave të mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni bartësi i lejes ka të drejtë në kompensim, në bazë të dispozitave të përgjithshme për kompensim të dëmit.

(4) Për kufizimet nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) nga ky nen me aktvendim vendos organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor. Kufizimet nga paragrafi (1) të këtij neni mund t'i kërkojë edhe organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë.

(5) Me aktvendimin nga paragrafi (4) të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e mjedisit jetësor përcakton masa riparimi dhe tjera të cilat doemos duhet t'i ndërmerr bartësi i lejes.

(6) Kufizimi nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) i këtij neni nuk mund të zgjasë më gjatë nga nevoja për realizimin e masave për riparim ose të tjera.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni, bartësi i lejes për derdhje, në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i aktvendimit, mund të dërgojë ankesë deri te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(8) Ankesa nga paragrafi (7) i këtij neni nuk e prolongon kryerjen e aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni.

(9) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e regjistron kufizimin e së drejtës për ujë në librin për ujën.

## **Neni 88**

### **Marrja e lejes për derdhje**

(1) Leja për derdhje, merret nëse në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 51 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Për marrjen e lejes në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, sjell aktvendim.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i detyruar për fillimin e procedurës për marrjen e lejes ta njoftojë bartësin e lejes për derdhje dhe në aktvendimin nga paragrafi (2) nga ky nen t'i jep afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë, në të cilin i imponon mënjanimin e shkakut nga neni 51 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2 nga ky ligj për fillimin e procedurës.

(4) Nëse edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, bartësi i lejes për derdhje nuk i mënjanon shkaqet ose vazhdon me aktivitetet nga neni 51 paragrafi (1) pika 1 dhe 2 i këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, sjell aktvendim për marrjen e lejes.

(5) Veprimi juridik nga marrja e lejes vlen nga dita e përcaktuar në aktvendimin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, bartësi i lejes për, në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i aktvendimit, mundet të paraqesë ankesë deri te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë



Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(7) Ankesa nga paragrafi (5) i këtij neni nuk e prolongon kryerjen e aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni.

(8) Personi juridik ose fizik të cilit i është hequr leja nuk ka të drejtë në kompensim të dëmit.

(9) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e regjistron marrjen e lejes në librin për ujin.

## Neni 89

### Kusht i veçantë për marrjen e lejes për derdhje

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor ose me propozim të organit tjetër të administratës shtetërore, mund të vendosë që t'ia merr bartësit lejen për derdhje, nëse me marrjen sigurohet ose realizohet interesi publik më i lartë nga ai për shkak të realizimit të së cilës është lëshuar leja.

(2) Interes publik më i lartë nga paragrafi (1) nga ky nen është mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve.

(3) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik përkatësisht fizik të cilit i është marrë leja ka të drejtë në kompensim të dëmit në pajtim me rregullat e përgjithshme për kompensim të dëmit.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e regjistron marrjen e lejes për shkak të sigurimit më të lartë të interesit publik në librin për ujin.

## 2. QËLLIMET E MJEDISIT JETËSOR PËR UJËRAT

### Neni 90

#### Qëllimet e mjedisit jetësor për ujërat sipërfaqësore

(1) Me ujërat sipërfaqësore administrohet në mënyrë e cila siguron:

- 1) shmangien e përkeqësimit të gjendjes së ujërave dhe ndikimeve të cilat shkaktojnë përkeqësim të gjendjes së ekosistemeve të ujërave dhe gjendjen kimike të ujërave;
- 2) arritjen e gjendjes së mirë të trupave të ujit dhe ekosistemet për ujë, si dhe ekosistemet të varura nga uji dhe
- 3) arritjen e gjendjes së mirë kimike dhe potencialit të mirë ekologjik të ujit tek trupat ujor artificial të ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i përcakton karakteristikat dhe kriteret për përcaktimin e gjendjes së mirë të ujërave sipërfaqësore, gjendjes së mirë kimike dhe potencialit ekologjik të mirë të ujit nga paragrafi (1) i këtij neni, duke përfshirë edhe kushtet për përcaktimin e trupave ujor sipërfaqësor artificial të fortë të ndryshuar, si dhe afatin për arritjen e gjendjes së mirë të ujërave sipërfaqësore, duke i marrë parasysh kushtet e veçanta të përcaktuara për zonat e mbrojtura të parapara me dispozitat nga neni 96 deri në nenin 103 të këtij ligji.

(3) Me dispozitën nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohen edhe masat për:

- 1) zvogëlimin e derdhjeve të materieve ndotëse dhe substancave;
- 2) zvogëlim progresiv të derdhjeve si dhe rrjedhjeve të materieve të

caktuara ndotëse si dhe substanca ose grupe materiesh ndotëse që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për ujin si medium i mjedisit jetësor, duke përfshirë edhe ujin për pirje (materie dhe substanca prioritare);

3) ndërprerje dhe zvogëlimin gradual të derdhjeve të materieve dhe substancave ndotëse;

4) rehabilitimin ose zbutjen e pasojave nga çdo lloj ndotje të ujërave, truallit buzë bregut dhe vendbanimeve ujore;

5) kthim në gjendje të natyrshme të trupit ujqor në rast kur ajo është e mundshme dhe nëse për atë nuk është e nevojshme në mënyrë joadekuate shpenzime të larta, përkatësisht nuk shkakton pasoja të konsiderueshme negative ndaj mjedisit jetësor, lundrimin dhe rekreacionin, depozitimn e ujit për furnizim me ujë, ujitje dhe prodhim të energjisë elektrike, rregullimin e rrjedhave të ujit, mbrojtja nga vërshimet dhe aktivitete tjera të rëndësishme lidhur me zhvillimin njerëzor dhe

6) përmirësimin e karakteristikave të trupave ujqor sipërfaqësor artificial dhe fort të ndryshueshëm.

(4) Afati për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor nga paragrafi (2) nga ky nen për ujërat sipërfaqësore të cilat dalin në rajone të mbrojtura të shfaqura në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës doemos të jetë i harmonizuar me afatet për arritjen e standardeve për mjedisin jetësor të cilat dalin nga dispozitat në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

## Neni 91

### Qasje e kombinuar për kontroll të burimeve pikë - pikë dhe difuze të ndotjes

(1) Kontrolli i derdhjeve dhe emetimeve në ujërat sipërfaqësor bazohet mbi qasjen e kombinuar për kontroll të burimeve pikë - pikë dhe difuze të ndotjes, edhe atë përmes;

1) kontrolle të emetimit të themeluara në teknikat më të mira të kapshme;

2) vendosjen e vlerave relevante kufitare për emetime ose

3) praktika më të mira ekologjike në rast të burimeve difuze të ndotjes.

(2) Në rast të qëllimeve më të ashpësuara dhe standardeve për kualitet të ujërave sipërfaqësor nga ata të përcaktuar në pajtim me kriteret nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohet kontrolli më i ashpër i derdhjeve dhe emetimeve.

## Neni 92

### Qëllimet e mjedisit jetësor për ujërat nëntokësore

(1) Me ujërat nëntokësore menaxhohet në mënyrë të cilën:

1) shmangjet përkeqësimi i gjendjes së tyre kuantitative dhe kimike;

2) zvogëlohet trendi i konsiderueshëm dhe afatgjatë zhvillimor i përqendrimit të materialit ndotës në ujërat i cili është si rezultat i aktiviteteve të njeriut;

3) sigurohet baraspesha në mes marrjes dhe mbushjes të serishëm të ujërave nëntokësore dhe

4) arrihet gjendje e mirë kuantitative dhe kimike e ujërave nëntokësore.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton:

1) kriteret dhe karakteristikat e gjendjes së mirë kuantitative dhe kimike të ujërave nëntokësore, si dhe përcaktimin e trendit retroaktiv të gjendjeve nga paragrafi (1) pika 2 e këtij neni.

2) masat e nevojshme për pengimin dhe kufizimin e materieve dhe substancave ndotëse dhe

3) afati për arritjen e gjendjes së mirë të ujërave nëntokësore, duke marrë parasysh kushtet e veçanta të përcaktuara në zonat mbrojtëse të parapara me nenin 96 deri në nenin 103 të këtij ligji.

(3) Afati për arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor nga paragrafi (2) pika 3 nga ky nen për ujërat sipërfaqësore të cilat hyjnë në rajone të mbrojtura të shfaqura në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës doemos të jetë i harmonizuar me afatet për arritjen e standardeve për mjedisin jetësor të cilat dalin nga dispozitat në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

## Neni 93

### Qëllime për kualitetin e ujërave

Për shkak të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të kualitetit të ujërave, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton:

- 1) klasifikimin dhe kategorizimin e ujërave, në pajtim me nenin 94 të këtij ligji;
- 2) afatin për arritjen e qëllimeve të kualitetit të ujërave për çdo kategori të ujërave të përcaktuara në pajtim me nenin 94 të këtij ligji dhe
- 3) standardet minimale për kualitetin e ujërave dhe qëllimet e mjedisit jetësor për të gjithë trupat ujqorë.

## Neni 94

### Klasifikimi i ujërave dhe kategorizimi i trupave ujqorë

(1) Kualiteti dhe përshtatshmëria e ujit për shfrytëzim për dedikime të ndryshme i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë përmes kualifikimit të ujit dhe kategorizimit të trupave ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

(2) Me dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni veçanërisht përcaktohen:

- 1) kushtet e përgjithshme të cilat doemos duhet t'i plotësojë uji, për dedikime të caktuara,
- 2) kushtet konkrete të cilat doemos duhet t'i plotësojë uji në pikëpamje të pranishme të materieve dhe substancave dhe përqendrimeve të tyre;
- 3) kushtet konkrete për gjendjen e trupave ujqorë në pajtim me dispozitat nga neni 72 i këtij ligji;
- 4) kushtet konkrete për klasifikimin e trupave ujqor sipërfaqësor të ujit për pirje në 3 klasa në pajtim me dispozitat nga neni 183 të këtij ligji;
- 5) kushtet konkrete të nevojshme që të përkrahet jeta e peshqve;
- 6) karakteristika tjera konkrete në pajtim me nenin 72 të këtij ligji dhe
- 7) qëllime të kualitetit të ujërave për shkak të zvogëlimit të ndotjes së ujërave në korniza të klasit përkatës.

(3) Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga çdo rrjedhë lumi ndahen dhe kategorizohen në trupa ujqorë të caktuar sipërfaqësorë dhe nëntokësorë sipas kushteve konkrete të një apo më tepër kualifikimeve, si dhe në pajtim me nenin 72 të këtij ligji.

## Neni 95

### Shmangie nga qëllimet e mjedisit jetësor

(1) Me përjashtim, nëse arritja e qëllimeve të mjedisit jetësor për trup ujqor të caktuar të përcaktuar me këtë ligj, është e përcaktueshme ose e paarsyeshme shtrenjtë, për atë trup ujqor mund të vendosen më pak qëllime të rrepta të mjedisit jetësor.

(2) Me përjashtim, shmangia nga qëllimet e mjedisit jetësor të vërtetuar me këtë ligj është e lejuar vetëm nëse shmangia ka të bëjë me:

- ndryshimet e reja të karakteristikave fizike të trupit ujqor sipërfaqësor,

- ndryshime në nivelin e trupave ujorë nëntokësorë ose  
 - ndërmarren e masave të zhvillimit të ruajtur nga njeriu të cilat shkaktojnë përkeqësim të gjendjes nga gjendja e lartë në të mirë të trupit ujor sipërfaqësor.

(3) Shmangia nga qëllimet e mjedisit jetësor nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni nuk guxon në mënyrë të përhershme ta ndalojë ose pamundësojë arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor të përcaktuar me këtë ligj, për trup ujor konkret dhe trupa tjerë ujorë.

(4) Të dhënat për shmangien nga qëllimet e mjedisit jetësor nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, si dhe masat e planifikuara dhe të ndërmarra për përmirësimin e kualitetit të ujërave dhe plotësimit të qëllimeve të mjedisit jetësor të përcaktuar me këtë ligj, janë pjesë përbërëse e planit për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor më për së afërmi i përcakton kushtet për shmangien nga qëllimet e mjedisit jetësor.

## 3. ZONA TË MBROJTURA

### 3.1. Dispozitë e përgjithshme

#### Neni 96

#### Përcaktimi i zonave të mbrojtura

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton:

1) zonat e mbrojtura për trupa ujorë të dedikuara për konsum nga ana e njeriut, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor;

2) zonat e mbrojtura për trupa ujorë të shënuar si ujëra për rekreacion, duke përfshirë edhe ujërat për banjë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor;

3) zonat e mbrojtura të cilat janë të ndjeshme në nitrate, me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë si dhe ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e bujqësisë;

4) zonat e mbrojtura të cilat janë të ndjeshme në nitrate, me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e bujqësisë;

5) sferat e përcaktuara si trashëgimi natyrore të mbrojtur ku mirëmbajtja dhe përmirësimi i gjendjes së ujërave është faktor i rëndësishëm, me propozimin të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe

6) zonat e dedikuara për mbrojtjen e llojeve të shtazëve që rriten që jetojnë ose janë të varura nga uji ndërsa janë ekonomikisht të rëndësishëm, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e pylltarisë.

(2) Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit mund t'i

tregojnë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për nevojën nga përcaktimi i zonës së mbrojtur, në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni. Vendimi për nevojën e përcaktimit të zonës së mbrojtur, në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni e sjell Këshilli i komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

(3) Zonat e mbrojtura shënohen në vetë vendin me ndihmën e shenjave paralajmëruese dhe tabelave informuese. Shënimin e zonave të mbrojtura e siguron organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, cakton masa të nevojshme për mbrojtjen e zonave nga paragrafi (1) të këtij neni duke siguruar arritjen e qëllimeve për mjedisin jetësor.

(5) Zonat e mbrojtura dhe trupat ujorë në korniza të çdo rrjedhe lumi që kërkojnë mbrojtje të veçantë, të përcaktuara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni regjistrohen dhe në mënyrë të përhershme azhurnohen në regjistrin e zonave të mbrojtura që i mban organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Të dhënat dhe pasqyrat hartografike të zonave të mbrojtura nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe të dhënat nga regjistri i zonave të mbrojtura, janë pjesë përbërëse e Planit për menaxhim me rrjedhën përkatëse të lumit.

(7) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, i përcakton kushtet dhe mënyrën për vendosjen e zonave të mbrojtura dhe për pasqyrën hartografike të zonave të mbrojtura të këtij neni.

(8) Formën dhe përmbajtjen e regjistrin nga paragrafi (5) i këtij neni i përcakton:

1) ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për zonat nga paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 4 të këtij neni;

2) ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor si dhe ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, për zonat nga paragrafi (1) pika 3 e këtij neni;

3) ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit për zonat nga paragrafi (1) pika 5 nga ky nen dhe

4) ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, për zonat nga paragrafi (1) pika 6 nga ky nen.

(9) Gjatë përcaktimit të zonave nga paragrafi (1) pika 6 të këtij neni zbatohen masat dhe kushtet e përcaktuara në pajtim me këtë ligj, si dhe masat dhe kushtet e përcaktuara me dispozitat nga sfera e mbrojtjes së natyrës.

### **3.2. Ujë i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut**

#### **Neni 97**

## **Trupa ujqorë nga të cilët merret uji i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Në korniza të çdo rrjedhe lumi përcaktohen trupat ujqorë nga të cilët merret ose mund të merren më tepër se 10m<sup>3</sup> ujë në ditë dedikuar për konsumim nga ana e njeriut, ose të bëhet furnizimi me ujë i më shumë se 20 njerëzve.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë i përcaktojnë trupat ujqorë nga paragrafi (1) i këtij neni dhe i dërgojnë deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për shkak të përcaktimit të zonave të mbrojtura nga neni 96 paragrafi (1) pika 1 e këtij ligji.

(3) Mbi trupat ujqorë, të cilët janë të përcaktuar për marrjen e ujit dedikuar për konsumim nga ana e njeriut në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, ndërsa të cilat sigurojnë më tepër së 100 m<sup>3</sup> në ditë zbatohet mbikëqyrje e detyrueshme në pajtim me nenin 145 të këtij ligji.

### **Neni 98**

#### **Zonat e mbrojtura për trupat ujqorë të dedikuara për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Trupi ujqor i cili shfrytëzohet për furnizimin me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut mbrohet përmes vendosjes dhe mirëmbajtjes së zonës më të ngushtë ose mbikëqyrjes së rreptë sanitare dhe një apo më tepër zona të zgjeruara mbrojtëse.

(2) Zonë e ngushtë mbrojtëse, në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni, është hapësira e drejtpërdrejtë përreth vendit për përfshirjen e ujit të dedikuar për konsumimin nga ana e njeriut, kufiri i së cilës përcaktohet veçanërisht në varshmëri nga mos kursimi dhe rëndësia e trupit ujqor, konfigurimit, llojit dhe përbërjes së truallit dhe afërsisë së vendbanimeve.

(3) Zona mbrojtëse e zgjeruar, në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni, është hapësira më e zgjeruar buzë trupit ujqor të dedikuar për furnizim me ujë për konsumim nga ana e njeriut, në të cilën përpunimi i truallit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të objekteve dhe kryerjen e punëve të tjera munden negativisht të ndikojnë mbi gjendjen kualitative dhe kuantitative të trupit ujqor, ndërsa kufiri i tij përcaktohet veçanërisht nga madhësia dhe rëndësia e trupit ujqor, gjendja hidro-gjeologjike dhe origjina e trupit ujqor.

(4) Pasqyrat hartografike të zonave të mbrojtura janë pjesë përbërëse e kadastrave dhe planeve urbanistike të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e vërteton mënyrën e përcaktimit dhe mirëmbajtjes së zonave mbrojtëse më të ngushta dhe më të gjata dhe mënyrën e përpunimit të truallit, ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve dhe kryerjen e punëve të tjera dhe aktiviteteve në zonat e mbrojtura që munden në mënyrë të pavolitshme të ndikojnë mbi gjendjen kualitative dhe kuantitative të trupit ujqor.

### **Neni 99**

#### **Kufijtë e zonave të mbrojtura për ujërat e dedikuara për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Kufijtë e zonave të mbrojtura për ujërat e dedikuara për konsumim

nga ana e njeriut, masat mbrojtëse dhe kushte të tjera përcaktohen me elaborat i përpiluar në bazë të studimeve dhe rezultateve nga puna kërkimore nga ana e personit të autorizuar profesional juridik.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, më për së afërmi i përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e përpilimit të elaboratit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Personi i autorizuar profesional juridik nga paragrafi 1 i këtij neni, doemos duhet t'i plotësojë kushtet si vijon:

- të ketë të punësuar së paku një person i cili ka të kryer përgatitje të lartë profesionale nga sfera e shkencave natyrore dhe shëndetësore, i cili ka së paku tre vite përvojë pune, dhe
- të posedojë pajisje përkatëse dhe kushte hapësinore për punë.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, më për së afërmi e përcakton llojin e përgatitjes profesionale, pajisjen dhe kushtet hapësinore të cilat domosdo duhen t'i plotësojë personi profesional juridik me qëllim që të jetë i autorizuar për punët nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Autorizimin nga paragrafi (1) i këtij neni e lëshon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe e njëjta botohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

## **Neni 100**

### **Regjim në zonat e mbrojtura për trupat ujorë të dedikuara për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Për shkak të mbrojtjes së trupit ujor, i cili përdoret për furnizimin me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut, nga ndotja ose të llojeve të tjera të shfrytëzimeve të cilat mund të ndikojnë mbi sigurinë e ujit ose sasisë së tij, ndërmerren masa të domosdoshme të cilat nuk do të lejojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi:

- 1) përkeqësimin e kualitetit ekzistues të ujit në masë relevante për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe
- 2) rritjen e nivelit të tretmanit për spastrimin e ujërave që shfrytëzohen për prodhimin e ujit për pirje.

(2) Aktivitetet të cilat do ta rrezikonin gjendjen kualitative dhe kuantitative të trupit ujor të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut janë të ndaluara në zonat mbrojtëse.

(3) Për shkak të kufizimit dhe zbatimit të kontrollit të lëvizjes, personi juridik i cili udhëheq me sistemin për furnizim me ujë e ndërton dhe ndërmerr masa tjera të nevojshme për mbrojtjen dhe sigurimin e truallit në zonën më të ngushtë të mbrojtur.

(4) Trualli në zonën më të ngushtë të mbrojtur e cila është në pronësi të personave fizikë dhe juridikë eksproprijohet, në pajtim me dispozitat për eksproprijim.

(5) Ndërtimin objekteve dhe kryerjen e veprimeve të tjera dhe aktiviteteteve, me përjashtim të objekteve vëllimore, rezervuare, trafo stacione, rrugë të brendshme dhe objekte tjera të nevojshme për furnizim me ujë dhe veprime të nevojshme për funksionimin e atyre aktiviteteteve, të truallit në zonën më të ngushtë mbrojtëse është e ndaluar.

### **3.3. Zona për banjë**

## Neni 101

### Zona për banjë

- (1) Zona për banjë janë sferat në të cilën gjendet uji për banjë.
- (2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve i përcaktojnë trupat ujqorë nga paragrafi (1) i këtij neni dhe i dërgojnë deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për shkak të përcaktimit të zonave të mbrojtura nga neni 96 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji.
- (3) Kryetari i komunave dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar t'i shënojnë zonat për banjë, në të cilat doemos duhet si minimum t'i përfshijë zonat nga paragrafi (1) i këtij neni.
- (4) Kryetari i komunave dhe qyteti i Shkupit është i detyruar të ndërmerr masa për mbrojtjen e zonave për banjë nga ndotja dhe për mbrojtjen nga veprimet dhe aktivitetet të cilat mund të negativisht të ndikojnë mbi kualitetin e ujit për banjë, në pajtim me nenin 104 të këtij ligji.
- (5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, një herë në vit e azhurnon listën e zonave për banjë e përcaktuar në pajtim me nenin 96 nga paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji.
- (6) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe ministri që udhëheq me organ të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, e përcakton mënyrën e shënimit dhe mënyrën e përdorimit të zonave për banjë.

### 3.4. Zona të ndjeshme në nitrate

## Neni 102

### Zona të ndjeshme në nitrate

- (1) Për shkak të sigurimit të ujërave nga ndotja e shkaktuar nga aktivitete bujqësore, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, sjell praktik të mirë bujqësore që doemos duhet të realizohet në bazë vullnetare me qëllim:
- 1) të dhënies së udhëzimeve praktike bujqve dhe personave tjerë të përfshirë në bujqësi, në lidhje me aktivitetet që mund të ndikojnë mbi trupat ujqorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë dhe
  - 2) të promovimit të praktikave përkatëse për zvogëlimin e ndotjes së ujërave.
- (2) Për shkak të ndalimit ose kontrollit të hyrjes së nitrateve në ujërat si rezultat i aktiviteteve bujqësore, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë dhe ministri që udhëheq me organ të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, më për së



afërmi i përcakton kriteret për përcaktimin e zonave të ndjeshme në nitrato të përcaktuara në pajtim me nenin 96 paragrafi (1) pika 3 e këtij ligji në të cilën veçanërisht hyjnë sipërfaqet që ekzistojnë:

- trupat sipërfaqësore ujorë, veçanërisht ata që shfrytëzohen ose janë të dedikuara për marrjen e ujit për pirje dhe janë të klasifikuara në pajtim me nenin 94 të këtij ligji,
- ujëra nëntokësore që përmbajnë më tepër se 50 mg/l nitrato ose për të cilat ekziston mundësia të përmbajnë më tepër se 50 mg/l nitrato në të ardhmen nëse nuk ndërmerren masa mbrojtëse dhe
- ujëra sipërfaqësore që llogariten si eutrofike ose që mund të bëhen eutrofike në të ardhmen nëse nuk ndërmerren masa mbrojtëse.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë dhe ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, në çdo 4 vite, sjell plan operativ për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitrato nga burime bujqësore i përcakton kriteret, ndalesat ose kufizimet në lidhje me përdorimin e truallit dhe kryerjen e aktiviteteve bujqësore në zonat e shënuara, për shkak të implementimit të masave.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, e përcakton përmbajtjen, masat dhe kërkesat për zbatimin e praktikës së mirë bujqësore nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe përmbajtjen, masat e detyrueshme dhe të tjera të planit operativ nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Në programin operativ nga paragrafi (3) i këtij neni veçanërisht do të merren parasysh të dhënat ekzistuese shkencore, veçanërisht lidhur me pjesëmarrjen përkatëse të azotit të cilët e kanë origjinën nga burime bujqësore dhe të tjera, si dhe kushtet në rajonet relevante në të cilën gjenden zonat të ndjeshme në nitrato.

(6) Nëse vërtetohet se masat e ndërmarra për zbatimin e planit operativ nga paragrafi (3) i këtij neni nuk janë të mjaftueshme për zvogëlimin e ndotjes së ujit të shkaktuar nga nitrato nga burimet bujqësore dhe pengimin e ndotjes së mëtejshme, në planin operativ të jenë të vërtetuar masa të tilla ose veprime të përforcuara që llogariten si të domosdoshme për arritjen e qëllimeve në planin operativ. Gjatë vërtetimit të masave ose veprimeve do të mbahet llogari për efikasitetin e tyre dhe për shpenzimin në raport me masat e tjera preventive.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë sjell program për realizimin e planit operativ nga paragrafi (3) i këtij neni.

### **3.5. Zona të ndjeshme në derdhjen e ujërave të zeza urbane**

#### **Neni 103**

#### **Zona të ndjeshme në derdhjet e ujërave të zeza urbane**

(1) Si zonë e ndjeshme në derdhjen e ujërave të zeza urbane, llogaritet trupi ujor i cili plotëson njërin prej kriterëve si vijon:

- 1) ujëra sipërfaqësore që llogariten si eutrofike ose që mund të bëhen eutrofike në të ardhmen nëse nuk ndërmerren masa mbrojtëse;
- 2) sfera të trupave ujorë të dedikuara për shterjen e ujit të dedikuara për konsumim nga ana e njeriut që përmbajnë përqendrim më tepër se 50 mg/l nitrat, ose që mund të arrijë përqendrim në atë masë në të ardhmen dhe

3) trupa ujqorë në të cilën lëshohen ujëra të zeza nga vendbanime më tepër se 2.000 banorë ekuivalent, ku kërkohet më tepër nga pastrimi sekondar (biologjik) i ujërave të zeza urbane.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë e vërteton dhe mirëmban listën e trupave ujqorë të ndjeshëm dhe i vërteton kërkesat në raport me ngarkesat dhe metodës për pastrim të ujërave të zeza urbane që lëshohen në trupat ujqorë në zonat e ndjeshme.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministri që udhëheq me organ të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, më për së afërmi i përcakton kriteret për vërtetimin e zonave të ndjeshme të derdhjeve të ujërave të zeza urbane nga paragrafi (1) i këtij neni të përcaktuar në pajtim me nenin 96 paragrafi (1) pika 4 e këtij ligji.

## 4. MBROJTA E UJËRAVE PËR BANJË

### Neni 104

#### Mbrojta e ujërave për banjë

(1) Kryetari i komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit në rajonin e të cilit ndodhen ujërat për banjë, e rregullojnë mënyrën e shfrytëzimit të ujërave për banjë në pajtim me standardet dhe procedurat e vërtetuara me dispozitat nga ky ligj ose me dispozitë të sjellë në bazë të këtij ligji.

(2) Kryetari i komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit në rajonin e të cilit gjenden ujërat për banjë, e përcaktojnë periudhën e kohëzgjatjes së sezonit për banjë si dhe numrin e pushuesve gjatë ditës në bazë të të cilave mund të llogaritet se sezoni për banjë ka filluar ose ka mbaruar jashtë afatit të përcaktuar të kohëzgjatjes së sezonit për pushim, në bazë të dispozitës së sjellë të paragrafit (6) të këtij ligji.

(3) Në rast të zvogëlimit të kualitetit të ujit për banjë, kryetari i komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit detyrimisht e njofton opinionin për ndryshimin e kualitetit të ujit si dhe për masat të cilat doemos duhet të ndërmerren.

(4) Për shkak të mbrojtjes së ujërave nga ndotja, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mundet në zonat për banjë ta ndalojë ose kufizojë kryerjen e aktiviteteve të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë mbi shëndetin dhe jetën e njerëzve.

(5) Uji për banjë nuk guxon të përmbajë materie dhe substanca të dëmshme dhe të rrezikshme ndaj shëndetit të njerëzve mbi vlerat e përcaktuara për kualitet të ujit për banjë.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton mënyrën dhe masat e menaxhimit me ujërat për banjë, kriteret teknike dhe qëllimet për kualitetin e ujit për banjë të cilat veçanërisht përfshijnë:

- 1) vendosjen dhe mirëmbajtjen e profilit të ujërave për banjë;
- 2) vendosjen e kalendarit për mbikëqyrje, parametrat dhe vlerat kufizuese

të ujërave për banjë dhe zonat për banjë;

3) mbikëqyrje të ujërave për banjë, metoda matëse referente, frekuencën, vendin dhe metodologjinë për marrjen e ekzemplarëve;

4) vlerësimin e kualitetit të ujërave për banjë, kushtet konkrete të cilat doemos duhet t'i plotësoj uji në pikëpamje të pranisë së materieve dhe substancave dhe përqendrimet e tyre, mënyrën e kryerjes së kontrollit dhe njoftimit për kualitetin e ujërave për banjë;

5) klasifikimin e ujërave për banjë;

6) identifikimin dhe vlerësimin e rasteve të ndotjes së ujërave për banjë që mund të ndikojnë ndaj shëndetit të pushuesve;

7) mënyrën dhe procedurën për informim të publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në udhëheqje me ujërat për banjë;

8) ndërmarrjen e aktiviteteve për mbrojtjen e pushuesve nga ndotja;

9) ndërmarrjen e aktiviteteve për zvogëlimin e rrezikut nga ndotja;

10) kriteret për përcaktimin e sezonit për banjë (data, numri i pushuesve, dhe ngjashëm) dhe

11) raste ku mundet përkohësisht të kufizohet dhe ndalohet banja.

(7) Në bazë të vlerësimit të kualitetit të ujërave për banjë, në pajtim me paragrafin (6) të këtij neni klasifikohen si ujëra për banjë me të varfër, të mjaftueshëm, të mirë dhe të shkëlqyeshëm.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në bashkëpunim paraprak me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, si dhe Kryetari i komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit sjell program të masave me qëllim përmirësimin e kualitetit të ujërave për banjë me çka kategorizimi i ujërave për banjë dhe të ngrihet në kategori të mirë dhe të shkëlqyeshme.

## 5. TROJE BUZË BREGUT

### Neni 105

#### Mbrojtja e truallit buzë bregut

(1) Ndërtimi i stabilimenteve dhe objekteve ose cilado punë dhe aktivitete që përfshijnë përpunimin, veprimin, magazinimin, mënjanimin ose transportin e materieve të rrezikshme dhe substancave dhe hedhurinave të forta ose rrjedhëse ndalohet në truallin buzë bregut përveç nëse me këtë ligj ndryshe nuk është e përcaktuar.

(2) Përdorimi i hedhurinave artificiale, mjetet për mbrojtjen e bimëve dhe të prodhimeve biocidale ndalohet në distancë prej 10 metra nga bregu i ujërave sipërfaqësore.

## 6. KONTROLL I EMISIONEVE DHE NDOTJES

### Neni 106

#### Qëllimet

Kontroll të emetimeve dhe të ndotjes është reduktimi i derdhjeve të materieve ndotëse dhe substancave dhe zvogëlimi dhe eliminimi i derdhjeve të materieve dhe substancave prioritare.

### Neni 107

#### Materie dhe substanca të rrezikshme

(1) Në grupin e materieve dhe substancave të rrezikshme bien veçanërisht:

1) nafta e papërpunuar, benzina, lëndë djegëse dizel, lëndë djegëse për

ngrohje dhe cilado lëndë tjetër petrokimie;

2) përbërës organo-halogjen dhe materie dhe substanca të cilat mund të formojnë përbërës të tillë në mjedisin jetësor ujqor, përbërës organo-fosforik, përbërës organo-kallaj, materie dhe substanca të cilat posedojnë kancerogjene, mutagjene ose dukuri teratogjene në ose përmes mjedisit jetësor ujqor, zhivë dhe përbërësit e tij, kadmium dhe përbërësit e tij, vajra minerale dhe hidrokarbonike, cianide, materie të rrezikshme individuale prioritare dhe substanca dhe kategori të materieve dhe substancave të theksuara në listën e përcaktuar në pajtim me këtë ligj, dhe

3) materie tjera të lëngshme dhe me gaz dhe substanca për të cilat ekziston rrezik se janë toksike, dhe të nënshtruar në bio-akumulim;

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë i përcakton:

1) listat e materieve dhe substancave ndotëse dhe materiet dhe substancat prioritare duke përfshirë edhe materiet dhe substancat e rrezikshme prioritare;

2) kushtet teknike dhe të tjera në lidhje me instalimin dhe punën e stabilimenteve nga neni 108 të këtij ligji dhe

3) mënyrën e testimit të objekteve dhe stabilimenteve nga neni 108 i këtij ligji, nga ana e ekspertëve para lëshimit në punë dhe në intervale të rregullta për kohën e punës.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në intervale të rregullta, jo më të gjatë se katër vite e rishikon Listën nga paragrafi (2) pika 1 e këtij neni.

(4) Lista nga paragrafi (2) pika 1 e këtij neni dhe karakteristikat e tyre është pjesë e Regjistrit të materieve dhe substancave ndotëse në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **Neni 108**

### **Objekte dhe stabilimente të cilat punojnë me materie dhe substanca të rrezikshme**

(1) Objektet dhe stabilimentet të cilat në procesin e prodhimitarisë, përpunimit, mbushjes dhe magazinimit, shfrytëzojnë ose zbatojnë materie dhe substanca të rrezikshme që mund të ndikojnë ndaj kualitetit të ujit, duke përfshirë edhe gypa për ujë për transportin e materieve dhe substancave të tilla, ndërtohen, vendosen, punojnë dhe mirëmbahen në mënyrë që përjashton çdo ndotje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ujërave.

(2) Objektet dhe stabilimentet nga paragrafi (1) nga ky ligj doemos duhet të jenë në pajtim me teknikat më të mira të kapshme.

(3) Objektet dhe stabilimentet nga paragrafi (1) nga ky nen nuk mund të ndërtohen ose të fillojnë me punë nëse nuk është e pajisur me leje ekologjike e integruar, mendime ose pajtueshmëri të cilat janë të nevojshme në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(4) Në rast të emetimit që do të mund të hyjë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore ose sistemet e kanalizimit, personi juridik përgjegjës për punën e stabilimentit doemos duhet menjëherë ta informojë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, si dhe t'i ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara për pengimin dhe zvogëlimin e pasojave negative ndaj mjedisit jetësor.

(5) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni kanë të

bëjnë me objektet dhe stabilimentet për magazinimin e hedhurinave të lëngëta, stalle dhe prodhime tjera dytësore të aktiviteve bujqësore.

## Neni 109

### Aktivite kundër ndotjes

(1) Në rast kur në ujërat hyjnë ose ekziston mundësia të hyjnë materie dhe substanca prioritare, helmuese dhe të dëmshme ose materie dhe substanca ndotëse ose hedhurina, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor ndërmerr masa për:

- 1) pengimin e hyrjes së materieve dhe substancave dhe hedhurina të tilla;
- 2) mënjanimin dhe shtrimin e materieve dhe substancave;
- 3) sanimin dhe zbutjen e çdo ndotje mbi ujërat dhe
- 4) aq sa mundet kthimi në gjendje të mëparshme të ujërave dhe florës dhe faunës në ekosistemet të varura nga uji.

(2) Për shkak të zbatimit të masave nga paragrafi (1) i këtij neni, përfaqësuesit të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, kanë të drejtë në qasje të çdo truall përkatësisht patundshmërive në pronësi private.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i ndërmerr masat nga paragrafi (1) i këtij neni në bashkëpunim me personin juridik dhe fizik i cili ka shkaktuar rastet nga paragrafi (1) i këtij neni në pajtim me dispozitat nga ky ligj dhe Ligjit për mjedis jetësor.

## Neni 110

### Derdhje të ujërave të zeza

(1) Derdhje të masës nga hedhurina të lëngëta industriale dhe bujqësore si dhe ujëra të zeza urbane, si dhe vajra të përdorura (në tekstin e mëtutjeshëm: ujëra të zeza) në kanalizim ose në sistem për kullim, në trupa ujq sipërfaqësorë ose nëntokësorë, si dhe në truall buzë bregut dhe vendbanime ujqore, ndalohet përveç në bazë të lejes nga neni 79 nga ky ligj.

(2) Leje për derdhje lëshohet vetëm nëse:

- 1) përqendrimi i materieve dhe substancave të hedhura në ujërat e zeza me zbatimin e teknikave dhe praktikave bashkëkohore përkatësisht zbatimin e teknikave më të mira të kapshme për instalimet me të cilat pajiset me leje-A të integruar ekologjike, mirëmbahet në nivelin më të ulët të mundshëm;
- 2) efluenti nuk përmban materie dhe substanca me prioritet të rrezikshëm të përcaktuara në pajtim me nenin 107 të këtij ligji;
- 3) karakteristikat e efluentit janë në pajtim me dispozitat për vlerat kufitare të emetimeve të materieve dhe substancave të caktuara të rrezikshme dhe qëllimet për kualitetin;
- 4) dhënia e lejes është në pajtim me planin për menaxhim me rrjedhjen e lumit dhe
- 5) dhënia e lejes është në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton materiet dhe substancat e rrezikshme dhe standardet e tyre emetuese që mund të lëshohen në kanalizim ose në sistemin për kullim, në trupa ujq sipërfaqësorë ose nëntokësorë, si dhe në truall buzë bregut dhe vendbanime ujqore.

(4) Standardet emetuese nga paragrafi (3) nga ky nen veçanërisht janë të shprehura në vlera kufizuese të emisioneve si maksimum përqendrime të

materieve dhe substancave të rrezikshme dhe të dëmshme për çdo sektor ndaras, për ujërat e zeza urbane dhe industriale, faktori i zbutjes, mënyrës së përcaktimit të emetimeve, mënyrës së përcaktimit të emetimeve në lejet dhe raportin me lejet ekologjike të integruara, indikatorët dhe standardet për ndotje dhe niveli i rrezikshmërisë/dëmit, si dhe sasia maksimale e substancave dhe materieve të cilat mund të lëshohen, duke përfshirë dhe periudhën kohore në të cilën mund të lëshohen.

(5) Me programin e masave nga neni 74 nga ky ligj mundet të përcaktohen afatet kohore për zvogëlimin ose eliminimin e derdhjeve e të gjithave ose ndaras të materieve dhe substancave të rrezikshme dhe të dëmshme.

(6) Gjatë lëshimit të lejeve për derdhje në ujërat nëntokësore detyrimisht mbahet llogari për dispozitat nga neni 111 i këtij ligji.

## **Neni 111**

### **Dispozita e veçanta për ujërat nëntokësore**

(1) Me qëllim të mbrojtjes së ujërave nëntokësore ndalohet çdo derdhje e drejtpërdrejtë e materieve dhe substancave prioritare dhe materieve dhe substancave ndotëse në ujërat nëntokësor të përcaktuara në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni.

(2) Deponimin ose mënjanimin e ndonjë materie dhe substance prioritare ose kryerja e aktivitetit tjetër me të cilën do të shkactohej derdhje e tërthortë e materieve dhe substancave prioritare ose materieve dhe substancave ndotëse në ujërat nëntokësor, ndalohet përveç në bazë të lejes nga neni 79 të këtij ligji dhe nëse:

- 1) paraprakisht është kryer analizë të kushteve hidrogeologjike të sferës përkatëse,
- 2) janë të parapara dhe zbatohen të gjitha masat e domosdoshme teknike të vigjilencës që të pengohet derdhje e tërthortë e çfarëdo materie dhe substance prioritare dhe materie ndotëse dhe substancë.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni mundet me lejen për derdhje të lejohet derdhje e materieve dhe substancave nga paragrafi (1) i këtij neni nëse:

- 1) me masat e ndërmarrja nga paragrafi (2) të këtij neni vërtetohet se ujërat nëntokësore nuk janë përkatës për përdorim, veçanërisht jo për nevoja të ekonomisë shtëpiake dhe bujqësisë, edhe pse me lejen nga ky paragraf nuk pengohet shfrytëzimi i resurseve tjera nëntokësore edhe pse substancat nuk mund të hyjnë në sisteme tjera akuatike ose negativisht të ndikojnë mbi ekosistem tjetër dhe
- 2) lejohet derdhje për shkak të injektimit në të njëjtin akifer të ujërave që, përdoren për qëllime gjeotermale, ujëra që pompohen nga xeherore dhe gurëthyes ose ujëra që pompohen gjatë punëve ndërtimore.

(4) Me qëllim të mbrojtjes së ujërave nëntokësore bëhet kufizimi i të gjitha derdhjeve të drejtpërdrejta të materieve dhe substancave prioritare dhe materieve dhe substancave ndotëse në ujërat nëntokësore si dhe kryhet analizë e të gjitha deponimeve ose mënjanimëve të ndonjë materie dhe substance prioritare ose kryerja e aktivitetit tjetër me të cilin do të shkactohej derdhje e tërthortë e materieve dhe substancave prioritare ose materie dhe substanca ndotëse në ujërat nëntokësore të përcaktuara me ligj në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni.

(5) Analizat nga paragrafët (2), (3) dhe (4) nga ky nen përfshijnë edhe analizë të aftësive eventuale të spastruara të tokës dhe të shtresave nëntokësore dhe të rrezikut nga ndotja dhe ndryshimi i kualitetit të ujërave nëntokësore për shkak të derdhjeve dhe do të vërtetojnë nëse derdhjet e substancave dhe materieve në ujërat nëntokësor paraqesin zgjidhje të kënaqshme në aspekt të mjedisit jetësor.

(6) Me përjashtim të paragrafëve (2), (3) dhe (4) të këtij neni leja për derdhje mundet të jepet për mbushje artificiale të sërishme të trupit uhor nëntokësor, për shkak të menaxhimit me ujërat nëntokësore vetëm nëse nuk ka rrezik nga ndotja e ujërave nëntokësor.

(7) Dispozitat nga ky nen nuk kanë të bëjnë me derdhjet e ujërave të zeza nga amvisëritë në objekte të izoluar ndërtimi të cilat nuk janë të kyçura në sistemin e ujërave të zeza, ndërsa gjenden jashtë nga sferat e mbrojtura për shkak të shfrytëzimit të ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut; për derdhjet për të cilat është e përcaktuar nga organi kompetent se përmbajtja e substancave dhe materieve janë në sasi dhe përqendrime të cilat janë të vogla dhe nuk ndikojnë negativisht mbi kualitetin e sotëm ose të ardhshëm të ujërave nëntokësor recipient edhe për derdhjen e materieve që përmbajnë substanca radioaktive.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë i përcakton materiet dhe substancat prioritare dhe materiet dhe substancat ndotëse në ujërat nëntokësore që janë të ndaluara për derdhje në pajtim me paragrafin (1) nga ky nen dha materiet dhe substancat prioritare dhe materiet dhe substancat ndotëse në ujërat nëntokësore që janë të kufizuara për derdhje në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

(9) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve për shëndetësinë, më për së afërmi i përcakton kushtet e veçanta për derdhjen e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në ujërat nëntokësor për marrjen e lejeve nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni, masat dhe aktivitetet të cilat janë të përfshira në lejet, ndërsa doemos duhen të ndërmerren që të shmanget hyrja e ndonjë materie ndotëse ose substance në ujërat nëntokësor.

## 7. UJËRAT E ZEZA URBANE

### Neni 112

#### Mënjanimi i ujërave të zeza

Mënjanimi i ujërave të zeza, në kuptimin e këtij ligji nënkupton grumbullimin, kullimin, spastrimin dhe derdhjen e ujërave të zeza nga efluentët vendas dhe industrial, si dhe rrëke uji të grumbulluara nga shirat atmosferike në sferat urbane. Mënjanimi përfshin edhe infiltrim nëntokësor ose ujitjen e truallit me ujëra të zeza si dhe mënjanimi i llumit të marrë me spastrimin e ujërave të zeza.

### Neni 113

#### Detyrime të përgjithshme

(1) Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar t'i grumbullojnë, largojnë dhe spastrojnë ujërat e zeza që dalin ose krijohen në rajonin e tyre, duke përfshirë edhe mënjanimin e llumit.

(2) Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, janë të detyruar të sigurojnë ujërat e zeza urbane që hyjnë në sistemet kolektor, para derdhjeve në mënyrë përkatëse të trajtohen në pajtim me dispozitat nga nenet 114 deri në 118 të këtij ligji, si dhe të sigurojnë se:

1) stabilimentet projektohen, ndërtohen, përdorohen dhe mirëmbahen në mënyrë të cilën sigurojnë punë të suksesshme në kushtet të zakonshme lokale klimatike;

2) ujërat zeza të spastruara dhe llumi i fituar me tretman të ujërave të zeza të shfrytëzohen përsëri, çdoherë kur ajo është përkatëse, në pajtim

me këtë ligj;

3) mënjanimi i ujërave të zeza dhe llumi nuk guxon të shpie deri në ndikime negative mbi mjedisin jetësor.

(3) Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar të:

1) sigurojnë, përmirësojnë dhe zgjerojnë sistemet e kanalizimit dhe t'i pastrojnë dhe mirëmbajnë sistemet për kullim për shkak të kullimit përkatës të ujërave të zeza në rajonin e tyre;

2) kujdesen për zbrazjen e gropave septike, në pajtim me nevojat;

3) lejojnë derdhjen e ujërave të zeza industriale në sistemet e kanalizimit në pajtim me këtë ligj dhe të sigurojnë kushte për kullimin e tyre, grumbullimin dhe spastrimin e tyre dhe

4) sigurojnë mbikëqyrje në pajtim me dispozitat nga Kreu VI i këtij ligji.

## **Neni 114**

### **Kullim, grumbullim dhe spastrim të ujërave të zeza urbane**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe kryetari i komunave, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit kryetari i qytetit të Shkupit janë të detyruar të sigurojnë:

1) ekzistimin e sistemit për grumbullim të ujërave të zeza në çdo vendbanim me më tepër se 2.000 nj.B.;

2) spastrim përkatës i të gjitha ujërave të zeza të cilat lëshohen nga sistemet për grumbullim të ujërave të zeza nga vendbanime me më pak se 2.000 nj.b.

3) spastrim sekondar (biologjik) ose përkatës i ujërave të zeza nga sistemet për grumbullimin e ujërave të zeza nga vendbanimet me më tepër se 2.000 nj,b., dhe

4) ujërat e ndotura të cilat lëshohen në zona të ndjeshme të lëshimit të ujërave të ndotura urbane do t'i nënshtrohen pastrimit rigoroz nga ajo që është përcaktuar në pikën 3 të këtij paragrafi, për aglomeracione më të mëdhenj se 10.000 e.b.

(2) Kur ekzistimi i sistemit për grumbullim dhe kullim të ujërave të zeza nuk është i arsyetueshëm për shkak të shpenzimeve të mëdha ose për shkak se sistemi nuk do të kontribuojë ndaj përmirësimit të mjedisit jetësor, shfrytëzohen sisteme individuale ose sisteme tjera përkatëse me të cilat arrihet niveli i njëjtë i mbrojtjes së mjedisit jetësor.

(3) Për realizimin e dispozitave nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera mjedisit jetësor dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, sjell Program për kullim, grumbullim dhe spastrim të ujërave të zeza urbane.

(4) Propozim-programi për kullim, grumbullim dhe spastrim të ujërave të zeza urbane përpunohet në bazë të propozim-programeve të Këshillit të komunave dhe Këshillit të qytetit të Shkupit. Programi për kullim, grumbullim dhe spastrim të ujërave të zeza urbane për qytetin e Shkupit përpunohet në bazë të propozimit të miratuar nga këshillat e komunave në qytetin e Shkupit.

(5) Ujërat e zeza urbane grumbullohen, kullohen dhe spastrohen përmes sistemeve në pajtim me paragrafi (1) dhe paragrafin (2) të këtij neni, përveç nëse nuk janë të nevojshme metoda të tjera grumbullimi, kullimi dhe spastrimi, të përcaktuar me lejen për derdhjen në ujëra, për shkak të natyrës së rrezikshme të ujërave të zeza industriale.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, më për së



afërmi i përcakton kushtet për grumbullim, kullim dhe spastrim, mënyrën dhe kushtet për projektim, ndërtim dhe eksploatim të sistemeve dhe stacioneve për spastrimin e ujërave të zeza urbane, si dhe standardet teknike, parametrat, standardet e emetimeve dhe normat për kualitet për paratretman, mënjanimin dhe spastrimin e ujërave të zeza, duke marrë parasysh ngarkesën dhe metodën për spastrim të ujërave të zeza urbane që lëshohen në zonat e ndjeshme të ujërave të zeza urbane.

(7) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministri që udhëheq me organ të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, më për së afërmi i përcakton kushtet, mënyrën dhe vlerat kufitare të emisionit për derdhjen e ujërave të zeza pas spastrimit të tyre, mënyrën e përlllogaritjes së tyre, duke marrë parasysh kërkesat e veçanta për mbrojtjen e zonave të mbrojtura.

(8) Dispozitat nga paragrafi (6) dhe (7) të këtij neni rishikohen dhe plotësohen në intervale të rregullta jo më të gjata se katër vite.

## **Neni 115**

### **Derdhje të ujërave të zeza industriale**

(1) Çdo derdhje e ujërave të zeza industriale, kryhet në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me lejen për derdhje përkatësisht leje të integruar ekologjike në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

(2) Çdo derdhje të ujërave të zeza të bio-zbërthyeshme industriale të cilat dalin nga kapacitetet me ngarkesë më të madhe se 4.000 nj. b., ndërsa nuk hyjnë në sistemet për spastrim të ujërave të zeza urbane, kryhet nën kushte dhe mënyrë të përcaktuar me lejen për derdhje përkatësisht lejen e integruar ekologjike në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor, ndërsa detyrimisht për sektorët industrial si vijojnë: përpunimin e qumështit; prodhimin e produkteve të perimeve dhe të pemëve; prodhimin dhe paketimin në shishe të pijeve joalkoolike; përpunimin e patateve; industrisë ushqimore; bodrum të birrave; prodhimin e alkoolit dhe pijeve alkoolike; prodhimin e ushqimit për kafshë nga prodhime bimore; prodhimin e xhelatinës dhe të ngjitësit nga lëkurë e thatë, lëkurë dhe nga eshtrat; fabrika për mjaltë, dhe industrisë për përpunimin e peshqve.

## **Neni 116**

### **Paratretman i ujërave të zeza industriale**

Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve dhe kryetari i komunave në qytetin Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit, janë të detyruar të sigurojnë efluentët nga ujërat e zeza industriale të cilat hyjnë në sistemin për grumbullim dhe pastrim të ujërave të zeza urbane të jenë të nënshtruar në paratretmanin e nevojshëm për shkak të:

- 1) plotësimit të kërkesave nga neni 115 të këtij ligji;
- 2) mbrojtjes së shëndetit të punësuarve në sistemet për kullim, grumbullimit dhe spastrimit të ujërave të zeza;
- 3) pengimit të dëmtimit të sistemeve për kullim, grumbullim dhe spastrim të ujërave të zeza dhe tretmanit të llumit;
- 4) sigurimit se nuk do të jetë e penguar puna e sistemeve për kullim, grumbullimit dhe spastrimit të ujërave të zeza dhe tretmanit të llumit;
- 5) sigurimit se derdhjet nga stacioni për spastrim ose ndonjë sistem tjetër nuk do të ndikojnë negativisht mbi mjedisin jetësor në pajtim me ligjin dhe
- 6) sigurimit se llumi mënjanohet në mënyrë të sigurt për mjedisin jetësor.

## Neni 117

### Shfrytëzim i serishëm i ujërave të zeza urbane

(1) Ujërat e zeza të spastruara urbane shfrytëzohen përsëri nëse ato janë përkatëse, duke mbajtur para së gjithash llogari për zvogëlimin deri në masën më të vogël të mundshme të ndikimeve negative ndaj mjedisit jetësor, ndërsa pas marrjes së lejes paraprake nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, më për së afërmi i përcakton kushtet, mënyrën dhe vlerat maksimale të lejuara dhe përqendrime të parametrave të ujërave të zeza të spastruara për shfrytëzimin e tyre të serishëm.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, më për së afërmi e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe të lejes për shfrytëzim të serishëm të ujërave të zeza të spastruara si dhe mënyra e lëshimit të lejes.

## Neni 118

### Shfrytëzimi i llumit nga spastrimi i ujërave të zeza urbane

(1) Llumi që fitohet prej ujërave të zeza të spastruara urbane, shfrytëzohet përsëri nëse ai është përkatës, duke mbajtur para së gjithash llogari për zvogëlimin deri në masën më të vogël të mundshme të ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor, dhe pas marrjes së lejes paraprake nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, e përcakton: mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e llumit, vlerat maksimale të përqendrimeve të metaleve të rënda në tokë në të cilën përdoret llumi, vlerat e përqendrimeve të metaleve të rënda në llum, vlerat e përqendrimit të metaleve të rënda në llum, në pajtim me dedikimin e tij dhe sasinë maksimale vjetore të metaleve të rënda që mund të futen në truall.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën për dërgimin e të dhënave dhe llojin e informatave për shfrytëzimin e llumit nga tretmani i ujërave të zeza urbane në pajtim me dedikimin, tretmanin, përbërjen dhe vendin e shfrytëzimit të tij.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i mjedisit jetësor në bazë të të dhënave të marra nga paragrafi (3) të këtij neni, mban evidencë për shkallën e shfrytëzimit të llumit nga tretmani i ujërave të zeza urbane në pajtim me dedikimin e saj, si dhe sasinë e prodhimit të llumit, tretmanin dhe përbërjen e llumit dhe vendin e shfrytëzimit të tij.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor së afërmi përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesë dhe të lejes për shfrytëzimin e llumit, si dhe mënyrën e lëshimit të lejes për shfrytëzimin e llumit nga paragrafi (1) të këtij neni.

## 8. SHMANGIE

### Neni 119

#### Forca e madhe dhe pasurimi i natyrshëm

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mund të lejojë shmangie të përkohshme nga dispozitat nga ky kre në rast të dukurive natyrore ose gjendje të forcës madhore të cilat janë ekskluzivisht dhe të cilat nuk ka qenë e mundur të parashihen, si dhe në rastin e rrethanave të cilat janë si rezultat i fatkeqësive dhe ngjarjeve tjera të paparashikuara, veçanërisht në rast të:

- 1) përmbytjeve ekstreme dhe thatësira afatgjate, dhe fatkeqësive tjera natyrore;
- 2) kushteve të jashtëzakonshme meteorologjike ose kushteve gjeografike dhe
- 3) ujërave sipërfaqësore të cilat në mënyrë të natyrshme pasurohen me materie dhe substanca të caktuara që sjell deri në tejkalimin e vlerave kufitare të përcaktuara në pajtim me këtë ligj.

(2) Shmangia e përkohshme nga paragrafi (1) nga ky nen nuk guxon të sjellë deri te rrezikimi i jetës dhe i shëndetit të njerëzve.

(3) Në rast të shmangies së përkohshme nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, është i detyruar:

- 1) t'i përcaktojë kushtet në bazë të cilave shfaqja, gjendja ose ndodhia mund të përcaktohen si ekskluzive dhe/ose e paparashikueshme, duke përfshirë edhe përcaktimin e indikatorëve përkatës në planin për menaxhim me rrjedhën e lumit;
- 2) të sigurojë që shmangia të jetë proporcionale dhe të mos zgjasë më gjatë se koha e nevojshme për kthim në gjendje të mëparshme;
- 3) të sigurojë që ndërmarrjen e të gjitha masave për pengimin e përkeqësimit të mëtutjeshëm të gjendjes, me çka siguron arritjen e qëllimeve të përcaktuara me këtë ligj që kanë të bëjnë me trupat ujorë të tjerë mbi të cilët nuk ndikojnë shfaqjet e ndodhura, gjendjet dhe rrethanat, si dhe masat për kthimin e trupit ujor në gjendje të mëparshme e cila ka ekzistuar para se të veprojnë pasojat e shfaqjes, gjendjes ose ndodhisë, menjëherë pas pushimit të shfaqjes, gjendjes ose ndodhisë e cila është bazë për shmangien;
- 4) t'i sigurojë masat të cilat doemos duhen të zbatohen të kyçen në Programin e masave nga neni 74 të këtij ligji, para së gjithash të kihet kujdes të njëjtët të mos e sjellin në pikëpyetje kthimin e kualitetit të trupit ujor pas ndryshimit të rrethanave dhe
- 5) siguron se përshkrimi i shkurtër për pasojat nga rrethanat dhe për masat të cilat janë të ndërmarra ose doemos duhet të ndërmerren të jetë pjesë përbërëse nga plani i ardhshëm përkatës për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(4) Në rast të shmangies në bazë të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor menjëherë e njofton publikun e interesuar, siguron informacione relevante për masat e ndërmarra dhe jep këshilla për masat që doemos duhet t'i ndërmerren publiku, me qëllim të mbrohet jeta dhe shëndeti i njerëzve dhe qëllimet e mjedisit jetësor të përcaktuara me këtë apo ligj tjetër.

(5) Për shkak të kthimit të trupit ujor në gjendjen e mëparshme e cila ka ekzistuar para se të veprojnë pasojat nga shfaqja, gjendja apo ndodhia, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar pasojat nga rrethanat ekskluzive, ose nga rrethanat e arsyeshme që nuk kanë mundur të parashihen të rishikohen një herë në vit dhe në varshmëri nga kushtet e përcaktuara në paragrafin (3) pikën 1 të këtij neni, t'i ndërmarrë të gjitha masat e mundshme.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, për së afërmi e përcakton mënyrën për përcaktimin e rasteve nga paragrafi (1) i këtij neni si dhe masat nga paragrafi (3) i këtij neni.

## 9. ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME MBROJTJEN E UJËRAVE

### Neni 120

#### Qarkullim minimal i pranueshëm i ujit dhe niveli i ujërave nëntokësore

(1) Qarkullimi minimal i ujit dhe niveli i ujit nëntokësor mirëmbahet në çdo trup uJOR sipërfaqësor përkatësisht trup të ujit nëntokësor, që nuk do të jetë më i vogël nga minimumi i pranueshëm i qarkullimit përkatësisht nivelit të nevojshëm për:

- 1) mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë;
- 2) ruajtjen e bilancit natyror të ujërave dhe ekosistemeve tokësore;
- 3) ruajtjen karakteristikave të rajonit dhe
- 4) përkrahjen e gjendjes kimike, fizike dhe ekologjike të trupave uJORë në pajtim me nenin 94 të këtij ligji.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton metodologjinë për përcaktimin e qarkullimit minimal të pranueshëm të ujërave dhe nivelin e ujërave nëntokësore, nga aspekti i kuantitetit dhe kualitetit, duke marr parasysh:

- 1) qarkullimin sezonal të ujërave sipërfaqësore përkatësisht nivelin e ujërave nëntokësore;
- 2) qëllimet për kualitetin e ujërave të përcaktuara në pajtim me këtë ligj;
- 3) qëllimet e mjedisit jetësor të përcaktuara në pajtim me këtë ligj dhe
- 4) dispozitat për shfrytëzimin e ujërave në pajtim me këtë ligj.

(3) Mbikëqyrja e qarkullimit dhe niveli i ujit që janë në minimum të pranueshëm për trup të caktuar uJORë doemos duhet të përcillet në vende të caktuara matëse në mes punkteve kontrolluese.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton masat matëse në punkte të caktuara kontrolluese për trupin uJOR të caktuar. Metodologjia për mbikëqyrje të qarkullimit dhe/ose nivelit për çdo vend matës përcaktohen me planin për menaxhim me rrjedhën e lumit.

### Neni 121

#### Derdhje të jashtëzakonshme të sasive të ujërave

Nëse sasia e ujit në rrjedhën e ujit zvogëlohet deri në shkallën në të cilën mund të shkaktohet ndotje e rritur të atyre ujërave, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozimin ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mund të urdhërojë derdhje të jashtëzakonshme të sasive të ujit nga akumulimet për shkak të klasifikimit të përqendrimeve të ndotjes.

## V. MBROJTA NGA VEPRIMET E DËMSHME TË UJËRAVE

### 1. Dispozita të përgjithshme

## Neni 122

### Mbrojta nga veprimet e dëmshme të ujërave

(1) Mbrojta nga veprimet e dëmshme të ujërave përfshin aktivitete dhe masa për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet, mbrojtjen nga erozioni dhe rrëketë, mbrojtjen nga ngrirja e trupave uJOR sipërfaqësorë, si dhe mënjanimin e pasojave nga veprimet e tilla të dëmshme të ujit.

(2) Mbrojta nga veprimet e dëmshme të ujërave kryhet nën kushte, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me këtë apo me ligj tjetër.

## Neni 123

### Kompetenca për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave

(1) Për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet dhe për mbrojtjen nga veprimi tjetër i dëmshëm i ujërave në rajonet urbane kompetente janë komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në rajonin e tyre.

(2) Personat juridikë të cilët udhëheqin me ekonominë e ujërave nga neni 191 nga ky ligj janë kompetent për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet dhe për mbrojtjen nga veprim tjetër i dëmshëm i ujërave në rajonin e fushëveprimit të tyre, duke përfshirë edhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtratit dhe kanaleve në rajonin e tyre.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcjell koordinimin e aktiviteteve nga paragrafi (1) i këtij neni që ndërmerren nga organet kompetente të komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e siguron dhe e përcjell koordinimin e aktiviteteve nga paragrafi (2) i këtij neni që ndërmerren nga ekonomitë e ujërave nga neni 191 të këtij ligji.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet dhe për mbrojtjen nga veprimi tjetër i dëmshëm i ujërave për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, me përjashtim me veprimet e dëmshme në rajonet nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) i këtij neni, do të përcaktojë ekonomi të ujërave e cila do të jetë kompetente për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet dhe për mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave.

## Neni 124

### Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave

(1) Për shkak të mbrojtjes nga veprimet e dëmshme të ujërave, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, përpilon Program për mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave në korniza të rrjedhës përkatëse të lumit (në tekstin e mëtutjeshëm: Program), si pjesë përbërëse të planeve për menaxhim me rrjedhën e lumit.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e mjedisit jetësor, pjesët nga Programi nga paragrafi (1) i këtij neni për rajonet e komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, e përpilon në bazë të programeve të këshillit të komunave,

komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, pjesët nga Programi nga paragrafi (1) i këtij neni për rajonet e ekonomisë së ujërave, e përpilon në bazë të programit të Ekonomisë së ujërave Programi i ekonomisë së ujërave rajonet e së cilës shtihen në rajone të urbanizuara të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, Ekonomia e ujërave e sjell në bashkëpunim me komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(4) Me programin nga paragrafi (1) i këtij neni parashihen masa preventive, ndërtimi i objekteve mbrojtëse dhe stabilimenteve dhe realizimin e punëve për mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave (ndërtimin e lymishtave, akumulimeve, rregullimin e lumenjve, rregullimin e rrëkeve, mbrojtjen e truallit nga erozioni, pyllëzimin dhe ngjashëm).

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë e përcakton përmbajtjen e programit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe programet nga paragrafi (2) dhe (3), mënyra dhe procedura e sjelljes së tyre, mënyra dhe procedura e realizimit të bashkëpunimit në mes subjekteve të cilat përpunojnë programet nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni.

## 2. Mbrojta dhe sigurimi nga vërshimet

### Neni 125

#### Masat themelore për mbrojtje nga vërshimet

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e vetadministrimit lokal, ndërsa me bashkëpunim paraprak me organet shtetërore kompetente për mbrojtje dhe shpëtim, përcakton:

- 1) regjistër dhe pasqyrë hartografike të rrafshinave të përmbytura, të vendbanimeve ujore, truallit buzë bregut dhe liqeneve dhe akumulimet, si dhe sistemeve tjera ujore;
- 2) harta të rajoneve me rrezik nga vërshimet në të cilën shënohen rajonet të ekspozuara në rrezik nga vërshimet, shtrirje të valëve vërshuese dhe nivelet më të larta të liqeneve dhe akumulimeve;
- 3) sistemi për prognozë dhe paralajmërim (alarmim) për vërshime;
- 4) masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e rajoneve të theksuara në regjistër dhe të shënuara në pasqyrën hartografike;
- 5) ndihmë teknike dhe këshilla për të gjitha çështjet lidhur me zbatimin e masave preventive dhe rehabilitimit për zbutjen e pasojave në rast të vërshimeve dhe
- 6) masa për gjendje të jashtëzakonshme dhe organizimi i tyre.

(2) Në pasqyrën hartografike nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni veçanërisht shënohen edhe sferat për kontroll të vërshimeve të vendosura afër, ose që e rrethojnë tropin ujor sipërfaqësor ose vendbanimet ujore.

(3) Me masat e përcaktuara në dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohet:

- 1) realizimi i interesit publik në mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i

ujërave;

2) pamundësimi i rregullimit të hapësirës, shfrytëzimit të truallit, kryerjes së punëve ndërtimore dhe aktivitete të tjera që do të mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet dhe dëmet;

3) mbrojtja e jetës, shëndetit dhe pronës së njerëzve;

4) arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor të përcaktuara në pajtim me këtë ligj dhe

5) minimizimin e shpenzimeve për mbrojtjen nga vërshimet.

## Neni 126

### Plane operative për mbrojtje dhe sigurim nga vërshimet

(1) Për shkak të zbatimit të Programit nga neni 124 i këtij ligji, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, këshilli i komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe ekonomia e ujërave nga neni 191 nga ky ligj, sjellin plane operative për mbrojtjen e sigurisë nga vërshimet për rajonet e rrezikuara (në tekstin e mëtutjeshëm: plani operativ).

(2) Nëse rajoni i rrezikuar nga vërshimet shtrihet në dy apo më tepër komuna, komuna në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, plani operativ për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet për rajonet e rrezikuara e sjellin me marrëveshje këshilli i komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, me pajtim paraprak nga organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Këshilli i komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit sjellin plane operative për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet për rajone të rrezikuara me propozim të kryetarit të komunave, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit.

(4) Plani operativ për mbrojtje dhe siguri nga vërshimet veçanërisht përmban: punë dhe masa topografike, hidrologjike, demografike, ekonomike dhe fundamente dhe të dhëna tjera, kufij të rajoneve të rrezikuara që ndërmerren dhe kryhen para rrezikut dhe në kohën e mbrojtjes nga vërshimet dhe organeve kompetente për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet.

(5) Me planin operativ nga paragrafi (1) i këtij neni parashihen masa operative dhe veprime tjera për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre, si dhe organi ose subjekti që menaxhon me mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet.

(6) Në realizimin e planit operativ nga paragrafi (1) i këtij neni, marrin pjesë organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera mjedisit jetësor, kryetari i komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit si dhe ekonomia e ujërave, organet kompetente për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe persona juridikë dhe fizikë nga rajoni i rrezikuar të përcaktuar me Programin nga neni 124 i këtij ligji.

(7) Në personat juridikë dhe fizikë, për objektet e të cilave, stabilimente dhe prona organizohet dhe kryen mbrojtje nga vërshimet, nuk i takon kompensim të dëmit, përveç për dëme të shkaktuara me derdhje të qëllimshëm të ujit në rajonin e ndaluar për shkak të pengimit të dëmeve më të mëdha.

(8) Pajtueshmëri të planeve operative nga paragrafi (1) i këtij neni jep organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, Drejtoria për mbrojtjen dhe shpëtimin dhe Qendra për menaxhim me kriza.

## Neni 127

### Masa plotësuese të planeve operative

Nëse masat e përcaktuara në pajtim me nenin 124 paragrafin (4) të këtij ligji, nuk janë të mjaftueshëm për mënjanimin e rrezikut, në rast të rrezikut të drejtpërdrejt nga veprimi i dëmshëm i ujërave, organet të cilat në pajtim me planin operativ nga neni 126 paragrafi (5) i këtij ligji janë kompetent për mbrojtjen dhe sigurinë nga vërshimet, mund të urdhërojnë edhe ndërmarrjen e masave tjera të domosdoshme.

## **Neni 128**

### **Derdhje të ujit në rajonin e mbrojtur**

(1) Në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, mund të lejohet derdhje të ujit në rajonin e mbrojtur me prerje e lëmishteve ose në mënyrë tjetër me qëllim të pengimit, përkatësisht të zvogëlimit të dëmeve.

(2) Vendi për derdhjen e ujit në rajonin e mbrojtur sjell organi ose subjekti që udhëheq me mbrojtjen nga vërshimet të përcaktuar me planin operativ nga neni 126 paragrafi (5) i këtij ligji.

## **Neni 129**

### **Detyrë për mirëmbajtjen e objekteve të ekonomisë së ujërave**

Ekonomia e ujërave dhe personat tjerë juridik, komunat, qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit të cilat menaxhojnë me penda dhe akumulime dhe me lymishte mbrojtëse, janë të detyruar këto objekte t'i shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë në mënyrë që siguron pranimin e valëve vërshuese, si dhe sigurimin e mbrojtjes së tyre nga fatkeqësitë natyrore.

## **Neni 130**

### **Detyrim për njoftim**

(1) Ekonomia e ujërave dhe personat tjerë juridikë nga neni 129 i këtij ligji, janë të detyruar të kryejnë mbikëqyrje të gjendjes të sasisë së tyre të ujërave të akumuluar në akumulime, si dhe në sasinë e ujërave që hyjnë dhe që lëshohen nga to, dhe për atë e njoftojnë organin e administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e hidrologjisë dhe meteorologjisë.

(2) Në rast të rrezikut nga rrënimi i pendëve, depërtimit të lymishtave mbrojtëse, si dhe lëshimit ose derdhjes së sasive më të mëdha të ujit nga akumulimet që mund të shkaktojnë vërshime, ekonomia e ujërave dhe personat tjerë juridik nga neni 129 i këtij ligji janë të detyruar të sigurojnë njoftim dhe alarmim të popullatës në rajonin e rrezikuar.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, formon trup të përhershëm operativ i cili kryen koordinimin e aktiviteteve gjatë shfaqjes së rasteve nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Njoftimi për gjendjen nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet në bazë të metodologjisë që e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bashkëpunim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e



bujqësisë.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, me propozim të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e hidrologjisë dhe meteorologjisë, para shfaqjes së nivelit kritik të ujit për rajonin e mbrojtur, e njofton Qendrën për menaxhim me kriza që të japë prognozë për kohën e ardhjes dhe lartësisë së valëve vërshuese.

(6) Në kohëzgjatjen e rrezikut nga vërshimet, organi që udhëheq me mbrojtjen nga vërshimet, të përcaktuar në planet operative nga neni 126 paragrafi (3), i njofton organet kompetente për mbrojtjen nga vërshimet të rajoneve buzë ujërave për të gjitha shfaqjet dhe masat që i ndërmerr në rajonin e vet, ndërsa të cilat janë me rëndësi për mbrojtjen e atyre rajoneve, si dhe të bashkëpunoj me ta.

### 3. Rregullimi dhe mirëmbajtja e ujërave sipërfaqësore

#### Neni 131

##### Rregullimi dhe mirëmbajtja e ujërave sipërfaqësore

(1) Për shkak të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së koritave të natyrshme dhe të rregulluara të lumit dhe brigjet e rrjedhjeve të ujit, liqeneve dhe akumulimeve, është ndaluar, përveç me leje ose pajtim të lëshuar në bazë të ligjit:

- 1) të hiqet çakalli, rëra dhe guri nga korita dhe brigjet e trupave ujq sipërfaqësor (rrjedhave të ujit, liqeneve dhe akumulimeve), me çka përkeqësohet regjimi i përhershëm i ujërave, shkaktohen procese të erozionit dhe kufizohet ose pamundësohet shfrytëzimi i ujërave;
- 2) të ndryshohet drejtimi i rrjedhës së ujit;
- 3) të hidhet mbeturina material (industriale, komunale dhe mbeturina tjera), tokë, mbetje ndërtimore, llum dhe të tjera;
- 4) të kryhen punë të tjera me të cilat dëmtohen koritat e lumenjve dhe brigjet e rrjedhjeve të ujërave, liqeneve dhe akumulimeve;
- 5) të prishen drunjtët dhe të shkatërrohet vegjetacioni tjetër në koritat e lumenjve dhe brigjet e rrjedhjeve të ujërave, liqeneve dhe akumulimeve;
- 6) të ndërtohet pendë, lymishtë ose pengës tjetër e ngjashme e cila do të kishte ndikim negativ mbi qarkullimin e rrjedhës së lumit dhe
- 7) të kryhet ndërtim ose ndërhyrje e cila do të kishte ndikim negativ mbi qarkullimin e rrjedhës së lumit.

(2) Gjatë zbatimit të paragrafit (1) të këtij neni, duhet doemos të kihet parasysh se:

- 1) Korita e rrjedhës së ujit e rregulluar, në kuptimin e këtij ligji, është hapësira në mes objekteve buzë bregut (lymishte, skele ose tjetër) në të cilën në mënyrë të përhershme ose përkohësisht rrjedh ujë;
- 2) Korita e rrjedhës së ujit natyrshëm, në kuptimin e këtij ligji, është hapësira në mes kufijve të prekjes së ujit pesëdhjetëvjeçar;
- 3) Brezi buzë bregut të rrjedhjes së ujit jashtë vendeve të banuara, në kuptimin e këtij ligji, është brezi në gjatësi prej 50 metra pas gërshërëve të lymishtës të rrjedhjeve të rregulluara të ujit, përkatësisht pas linjës së prekjes së ujit pesëdhjetëvjeçar tek rrjedhjet e parregulluara të lumit, ndërsa në vendet e banuara gjerësinë e brezit buzë bregut e përcakton këshilli i komunave dhe këshilli i qytetit të Shkupit, me propozim të kryetarit të komunave dhe qyteti i Shkupit, me pajtueshmëri paraprake të organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe
- 4) Brezi buzë bregut të liqenit dhe akumulimet, në kuptimin nga ky ligj, është brezi në gjatësi prej 50 metra nga linja më e lartë e përcaktuar e nivelit të ujit.

#### Neni 132

## Qasje deri te ujërat sipërfaqësore

(1) Qasja deri te brezi buzë bregut të rrjedhës së uji, liqeneve dhe akumulimeve për sport, rekreacion dhe aktivitete të ngjashme është i lirë.

(2) Këshilli i komunave dhe qyteti i Shkupit, me propozim të kryetarit të komunave dhe kryetarit të qytetit të Shkupit, e rregullon qasjen deri te brezi buzë bregut të rrjedhjes së ujërave, liqeneve dhe akumulimeve për sport, rekreacion dhe aktivitete të ngjashme përveç nëse nuk është ndryshe e përcaktuar me këtë apo ligj tjetër.

### Neni 133

#### Sigurimi i qarkullimit të rrjedhjeve të ujërave

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, kryetari i komunave dhe kryetari i qytetit të Shkupit dhe ekonomisë së ujërave janë të detyruar të kryejnë vlerësim, një herë në vit deri në fund të muajit shtator, për atë se rrjedhjet e ujërave në rajon, nën kompetencë të tyre, janë në gjendje të shkaktojnë vërshime të truallit dhe nëse sigurojnë qarkullim të pandërprerë të ujit, si dhe nëse dispozitat për kontroll të vërshimeve respektohen plotësisht.

(2) Nëse rrjedhjet e ujit nuk sigurojnë qarkullim të papenguar, subjektet nga paragrafi (1) nga ky nen ndërmarrin masa për sigurimin e qarkullimit të papenguar, nëse qarkullimi nuk sigurohet.

## 4. Mbrojtje nga erozioni dhe rregullimi i rrëkeve

### Neni 134

#### Erozion

(1) Erozion, në kuptimin e këtij ligji, është shkatërrimi i truallit dhe shpërndarjen e grimcave nën ndikimin e ujit, në vëllim që e degradon shtresën sipërfaqësore të truallit.

(2) Rajoni eroziv, në kuptimin këtij ligji, është rajoni i përfshirë me gjurmë të dukshme nga erozioni dhe ku shtresa sipërfaqësore e truallit është i degraduar.

(3) Rajoni i rrezikuar nga erozioni, në kuptimin e këtij ligji, është trualli në të cilin ende nuk janë të dukshme gjurmët nga erozioni, por ai mund të shfaqet për shkak të shfrytëzimit të parregullt të tij ose truallit buzë dhe kulturat bujqësore dhe pyjore.

### Neni 135

#### Kufijtë e rajonit eroziv

(1) Këshilli i komunave dhe këshilli i qytetit të Shkupit dhe ekonomit të ujërave nga neni 191 nga ky ligj janë të detyruar në territorin nën kompetencë të tyre t'i përcaktojnë kufijtë të rajonit eroziv dhe rajonit të rrezikuar nga erozioni dhe i përcakton masat dhe punët për mbrojtjen e truallit nga erozioni dhe rregullimin e rrëkeve, në bazë të dokumentacionit teknik.

(2) Këshilli i qytetit të Shkupit i përcakton kufijtë e rajoneve nga paragrafi (1) të këtij neni me propozim të këshillit të komunave në Qytetin e Shkupit.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë i përcakton kufijtë e rajonit eroziv dhe rajonit të rrezikuar nga erozioni dhe i

përcakton masat për mbrojtjen rajonit eroziv dhe i përcakton punët për rregullimin e rrëkeve, në bazë të dokumentacionit teknik për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, me përjashtim në rajonet nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni.

## **Neni 136**

### **Masat për mbrojtjen e rajonit eroziv**

Masat për mbrojtjen e rajonit eroziv janë:

- 1) Pyllëzimi, mbjellja e barit dhe brezimit (me kanale konture, ngritje të murit e tjerë);
- 2) Ndalimi i nxjerrjes së dheut, rërës, zhavorrit dhe gurit;
- 3) Ndalimi i shartimit, prerjes dhe gërmimit të drunjve dhe kaçubave dhe
- 4) Ndalimi për kullotjen e kafshëve.

## **Neni 137**

### **Mbrojtja nga erozioni**

(1) Në rajonet kodrinore-malore, prerja e drunjtëve doemos duhet të bëhet në mënyrë me të cilën sigurohet mbrojtja e erozionit.

(2) Me pellgjet e akumulimeve dhe në sistemet hidromeliorative, me pyet që janë ngritur si objekte mbrojtëse kundër erozionit, si dhe me vegjetacionin mbrojtës në brezat bregore të rrjedhave të ujit në pyje menaxhohet në pajtim me ligjin.

(3) Prerja e pyjeve dhe vegjetacionit bregor nga paragrafi (2) të këtij neni bëhet sipas mendimit paraprak të ekonomisë së ujërave në suazat e rajonit të veprimit së saj.

## **Neni 138**

### **Krijimi i erozionit dhe kompensimi i dëmit**

Personat juridik dhe fizik, të cilët me veprimin e tyre, me përpunimin jo të drejtë të sipërfaqeve ose me veprim tjetër shkaktojnë erozion me çka u bëjnë dëme edhe objekteve tjera, janë të detyruar që në llogari të tyre të ndërmarrin masa mbrojtëse për pengimin e erozionit, si dhe masa për mënjanimin e pasojave të dëmshme për pengimin e erozionit, si dhe masa për pengimin e pasojave të dëmshme, dhe t'i kompensojnë dëmet e shkaktuara.

## **Neni 139**

### **Rrëketë**

Rrëketë, në kuptim të këtij ligji, janë rrjedhat me lëshim të pjerrët, me ujëra të shpejtë dhe befases, që bartin dhe shtresojnë pjesë të rrëmbyera dhe të nxjerra të tokës, rërës, zhavorrit dhe materiale tjera nga vendet më të larta drejt pjesëve më të ulëta, ndërsa ujërat me lymishte lëshohen pa kontroll në fusha ose derdhen në recipientë natyror ose artificial.

## **Neni 140**

### **Shtrati i rrëkesë**

(1) Gjerësia e shtratit të rrëkesë, në kuptim të këtij ligji, është sipërfaqja nëpër të cilat rrjedhin ujërat më të larta të rrëkesë.

(2) Gjatësia e shtratit të rrëkesë, në kuptim të këtij ligji, është sipërfaqja nga grumbullimi i rrjedhës së rrëkesë deri në vendin e shtrirjes,

respektivisht derdhjes në recipient.

(3) Bregu i shtratit të rrëkesë te vendet e shembjes dhe vendet rrëshqitëse, në kuptim të këtij ligji është sipërfaqja nga pika më e ulët e shtratit të rrëkesë deri te skaji i lartë i vendit të shembjes, respektivisht rrafshit të vendit rrëshqitës.

(4) Brezi bregdetar i shtratit të rrëkesë, në kuptim të këtij ligji, është gjerësia e brezit më së shumti deri 100 metër horizontalisht majtas dhe djathtas nga skajet e lartë të vendeve të shembjes, respektivisht rrafshit të vendit rrëshqitës.

## **Neni 141**

### **Rregullimi i rrëkeve**

(1) Drejtpërdrejtë me rregullimin e rrëkesë bëhet edhe rregullimi i sipërfaqeve erozive në pellg.

(2) Me dokumentacionin teknik për rregullimin e rrëkesë përcaktohen brigjet dhe brezi bregdetar i shtratit të rrëkesë nga vendgrumbullimi deri te vendi i shtrirjes, respektivisht derdhjes në recipient.

(3) Me objektet mbrojtëse të sipërfaqeve të brigjeve dhe të vendit të shtrirjes respektivisht derdhjes në recipient menaxhon personi juridik i cili e rregullon rrëkenë ose që menaxhon me ato objekte.

(4) Komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit janë të detyruar t'i ndërmarrin masat për rregullimin e rrëkeve që gjinden në rajonin e tyre, përveç për rajonet e personit juridik nga paragrafi (3) të këtij neni.

## **5. Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave me nxjerrjen e rërës, gurit dhe zhavorrit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujqorë sipërfaqësorë**

## **Neni 142**

### **Mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave me nxjerrjen e rërës, gurit dhe zhavorrit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujqorë sipërfaqësorë**

(1) Për shkak mbrojtjes dhe përmirësimit të regjimit të ujërave nga shtrati dhe brigjet e trupave ujqor sipërfaqësor (rrjedhave të ujit, liqenet dhe nga akumulimet) nxirret rëra, zhavorri dhe guri.

(2) Për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e rrjedhave ujqore, liqeneve dhe akumulacioneve, për përmirësim të regjimit të ujërave janë kompetente ekonomitë ujqore të rajonit të veprimit të tyre, ndërsa njësitë e vetadministrimit lokal janë kompetente në rajonet ku nuk janë themeluar ekonomi ujqore dhe në mjediset urbane.

(3) Nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujqor sipërfaqësor bëhet në bazë të lejes nga neni që e lëshon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Me lejen nga paragrafi (3) i këtij neni, përcaktohet lokacioni, sasia, mënyra, koha, sendet dhe mjetet për nxjerrje, ngarkim dhe transport të rërës, zhavorrit dhe gurit.

(5) Leja nga paragrafi (3) i këtij neni, evidentohet në librin për ujëra nga

neni 160 i këtij ligji.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes nga paragrafi (3) i këtij neni.

## **Neni 142-a**

### **Dokumentacioni i nevojshëm për lëshimin e lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit**

(1) Leja për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e rrjedhave ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit teknik, i cili veçanërisht përmban: analizë hidrologjike dhe hidraulike për ujërat e mëdha dhe të vogla dhe për ujërat nëntokësore, trasenë, nivelin, profilin hidraulik të shtratit të rrjedhës ujore ose pjesës së saj që paraqet një tërësi rregullative, sasinë e prurjes dhe të dhëna tjera të cilat janë të rëndësishme për regjimin e ujërave dhe për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës.

(2) Leja për nxjerrje të rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e liqeneve dhe akumulacioneve lëshohet në bazë të dokumentacionit teknik, i cili veçanërisht përmban: regjim të oscilacioneve të nivelit të ujit, sasinë e prurjes, ndikimin e stabilitetit të bregliqenit dhe të dhëna tjera të cilat janë të rëndësishme për regjimin e ujërave dhe për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës.

## **Neni 142-b**

### **Procedura për lëshimin e lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit për përmirësimin e regjimit të ujërave**

(1) Procedura për lëshimin e lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e trupave ujore sipërfaqësore fillon me kërkesë me shkrim nga subjektet nga neni 142 paragrafi (2) i këtij ligji, dorëzuar në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Organi nga paragrafi (1) i këtij neni, e ka për detyrë që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për lëshimin e lejes pranohet ose refuzohet.

(3) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për lëshimin e lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit, miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, subjektet nga neni 142 paragrafi (2) i këtij ligji dhe personat tjerë me interes juridik në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesin ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

(5) Nëse organi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk miraton aktvendim me të cilin kërkesa për lëshimin e lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e trupave ujore sipërfaqësore pranohet ose refuzohet, në afatin e paraparë në paragrafin (2) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tre ditësh pune të paraqet kërkesë në sekretarinë e ministrit i cili udhëheq me organin kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, që të miratojë aktvendim me të cilin lëshohet leja për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e trupave ujore sipërfaqësore. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa paraqitet në sekretarinë në selinë e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(7) Me kërkesën nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës paraqet edhe kopje të kërkesës për lëshimin e lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit për përmirësimin e regjimit të ujërave.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni në sekretari, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për lëshimin e lejes pranohet ose refuzohet.

(9) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk e miraton aktvendimin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(10) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditësh pune nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tre ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(11) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor që në afat prej dhjetë ditësh të vendos për kërkesën e parashtruar nga paragrafi (5) i këtij neni, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(12) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori do të parashtrtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin ministri do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Nëse ministri nuk vendos as në afatin plotësues nga paragrafi (12) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(14) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (10) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh pune ka të drejtë të paraqesë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(15) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditësh pune ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (14) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës në pajtim me paragrafët (10) dhe (11) të këtij neni dhe/ose nuk paraqet kallëzim në pajtim me paragrafët (12) dhe (13) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtrtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për

inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Nëse inspektori nuk vepron as në afatin plotësues nga paragrafi (15) i këtij neni, Inspektorati Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(17) Në rastet nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(18) Në rastet nga paragrafi (17) i këtij neni, Inspektorati Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditësh pune e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(19) Nëse drejtori i Administratës Shtetërore Administrative nuk vepron në pajtim me paragrafin (15) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(20) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afatin nga paragrafi (11) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrejë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(21) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(22) Akti nënligjor nga paragrafi (6) i këtij neni miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(23) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (5) i këtij neni, ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 142-v**

### **Obligimet e bartësit të lejes**

(1) Ekonomitë ujore dhe njësitë e vetadministrimit lokal të cilëve u është lëshuar leja për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati dhe brigjet e trupave ujore sipërfaqësore e kanë për obligim të mbajnë ditar në të cilin veçanërisht evidentohet sasia e nxjerrë e rërës, zhavorrit dhe gurit në bazë ditore, lokacioni prej ku nxirret ai material dhe koha e nxjerrjes së materialit.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 142-g**

### **Veprimi me materialin e nxjerrë**

(1) Ekonomitë ujore dhe njësitë e vetadministrimit lokal të cilëve u është lëshuar leja për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit, janë të detyruara që t'u përmbahen kushteve në leje.

(2) Nëse me lejen është përcaktuar që një pjesë e materialit të mënjanohet nga shtrati dhe brigjet, bartësi i lejes mund që atë ta lëshojë

në qarkullim me fletëshoqërime të lëshuara dhe të verifikuara nga organi i administratës kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Fletëshoqërimet nga paragrafi (2) i këtij neni, i lëshohen bartësit të lejes, në sasi të përcaktuara me lejen, dhe çdo person i cili kryen transport të rërës, zhavorrit dhe gurit është i detyruar që të ketë fletëshoqërim.

(4) Për fletëshoqërimet e lëshuara dhe të verifikuara nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e menaxhimit me ujera mban evidencë në regjistrin e fletëshoqërimeve të lëshuara dhe të verifikuara.

(5) Formën dhe përmbajtjen e fletëshoqërimeve dhe formën dhe përmbajtjen e regjistrit të fletëshoqërimeve të lëshuara dhe të verifikuara i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e menaxhimit me ujera.

## **6. Njoftimi**

### **Neni 143**

#### **Obligimi për njoftim**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, këshilli i komunave në Qytetin e Shkupit dhe Ekonomia e ujërave janë të detyruar të përgatitin, të sjellin dhe të publikojnë raporte për aktivitetet e realizuara në vitin e kaluar dhe aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm në lidhje me mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave (mbrojtja dhe siguria nga vërshimet, rregullimi dhe mirëmbajtja e rrjedhave të ujit natyror dhe të rregulluar dhe ujërave tjerë sipërfaqësor, mbrojtja nga erozioni dhe rrëketë, mbrojtja nga ngrirja e trupave uhor sipërfaqësor dhe mbrojtja dhe përmirësimi i regjimit të ujërave me nxjerrjen e rërës, gurit dhe zhavorrit), si dhe masat që ato i konsiderojnë si të duhura për shkak të pengimit dhe amortizimit të pasojave nga veprimi i dëmshëm i ujërave në tokën e rajonit të tyre.

(2) Raportet e komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit nga paragrafi (1) të këtij neni i përgatitin dhe i botojnë Kryetari i Komunave, Kryetari i Komunave të Qytetit të Shkupit dhe Kryetari i Qytetit të Shkupit.

(3) Raportet nga paragrafi (1) të këtij neni dorëzohen për lejim në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor deri më 31 mars të vitit vijues.

(4) Raportet nga paragrafi (1) të këtij neni janë në qasje të popullatës sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

(5) Të dhënat nga planet, programet dhe masat e përcaktuara në këtë kapitull janë pjesë e planeve për menaxhim me pellgjet e lumenjve.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, menjëherë e informon popullatën e prekur në rast të rrezikut dhe siguron informata adekuate për masat e marra dhe këshillon çfarë masa të ndërmerren me qëllim që të mbrohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, dhe qëllimet e mjedisit jetësor të përcaktuar me këtë ligj ose me dispozitë tjetër.

## **VI. MONITORIMI I UJËRAVE**

### **Neni 144**



## Monitorimi i ujërave

(1) Monitorimi i gjendjes së kuantitetit dhe kualitetit i të gjithë trupave ujqor në Republikën e Maqedonisë dhe ujërave të dedikuar për shfrytëzim, bëhet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Qëllimi i monitorimit të gjendjes së kuantitetit dhe kualitetit i të gjitha trupave ujqor në Republikën e Maqedonisë dhe ujërave të dedikuar për shfrytëzim është që të vihet dhe të mirëmbahet baza e përgjithshme e të dhënave të duhura për menaxhimin dhe kontrollin e gjendjes me ujërat në suazat e rajonit të pellgjeve lumore.

(3) Informatat e siguruara nëpërmjet monitorimit të gjendjes së kuantitetit dhe kualitetit të të gjithë trupave ujqor në Republikën e Maqedonisë dhe të ujërave të dedikuar për shfrytëzim, janë në qasje të popullatës dhe organeve, organizatave dhe institucioneve kompetente, veçanërisht për shkak të zbatimit dhe vlerësimit të realizimit të masave për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të të gjithë trupave ujqor.

### Neni 145

#### Rrjeti shtetëror hidrologjik për monitorimin e trupave ujqor

(1) Për shkak të monitorimit të trupave ujqor sipërfaqësor dhe nëntokësor instalohet rrjeti shtetëror hidrologjik për monitorim (në tekstin e mëtejme: rrjeti shtetëror).

(2) Rrjeti shtetëror hidrologjik është pjesë e rrjeteve shtetërore për monitorimin e medimeve dhe sferave të mjedisit jetësor të përcaktuar me Ligjin për mjedis jetësor.

(3) Për trupat ujqor që nuk janë përfshirë me vendet matëse të rrjetit shtetëror, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit mund të instalojnë rrjete lokale në vende matëse për monitorimin e trupave ujqor (në tekstin e mëtejme: rrjeti lokal).

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton kriteret për zgjedhjen e vendeve matëse për rrjetin shtetëror dhe lokal për monitorimin e trupave ujqor.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurën për instalimin dhe punën e të gjitha rrjeteve për monitorimin e gjendjes së trupave ujqor.

(6) Për kryerjen e monitorimit nga paragrafi (1) të këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor sjell Programin për monitorimin e ujërave.

(7) Për kryerjen e monitorimit nga paragrafi (3) të këtij neni, këshilli i komunave, dhe këshilli i Qytetit të Shkupit, sjell Program për monitorimin e ujërave.

(8) Në programin për monitorim nga paragrafi (6) të këtij neni detyrimisht futet pjesa e veçantë për kryerjen e monitorimit të sigurisë së ujit për konsumim nga ana e njeriut me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë.

(9) Programi nga paragrafi (6) dhe paragrafi (7) të këtij neni është pjesë përbërëse e planeve për menaxhim me pellgun lumor.

## Neni 146

### Kompetenca për monitorimin e trupave ujq dhe të ujërave të dedikuar për shfrytëzim

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është përgjegjësi për monitorimin e plotë të trupave ujq të përfshirë me rrjetin shtetëror. Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është përgjegjësi edhe për realizimin, punën, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit shtetëror.

(2) Kryetari i komunave dhe Kryetari i Qytetit të Shkupit e bëjnë dhe janë përgjegjësi për monitorimin e trupave ujq të përfshirë me rrjetin lokal dhe janë përgjegjësi për realizimin, punën, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal për monitorimin e gjendjes.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është kompetent për monitorimin e lëshimit të ujërave të zeza.

(4) Monitorimin e ujërave të dedikuar për konsumimin nga ana e njeriut e bëjnë organet kompetente për mbrojtjen shëndetësore në pajtim me dispozitat për sigurinë e ushqimit.

(5) Monitorimin e ujërave në zonat për banjë e bëjnë Kryetari i komunave dhe Kryetari i Qytetit të Shkupit në territorin e të cilit gjendet zona për banjë. Në rast kur zona për banjë gjendet në rajonin e dy ose më shumë komunave monitorimin e gjendjes së ujërave e bëjnë kryetarët në bashkëpunim dhe koordinim midis tyre, në përpjesëtim me madhësinë e zonës për banjë e cila hyn në rajonin e secilës komunë.

(6) Llojet e caktuara të punëve profesionale për monitorimin e trupave ujq të përfshirë me rrjetin shtetëror dhe lokal, si dhe të atyre të përfshira për monitorimin e ujërave të dedikuar për shfrytëzim, mund ta bëjnë organizatat dhe institutet e akredituara shkencore dhe profesionale dhe personat tjerë juridik që kanë pajisje adekuate, aparate, instrumente dhe kushte lokale për kryerjen e punëve, dhe së paku një person me arsim sipëror nga sfera e mbrojtjes shëndetësore.

(7) Kushtet e përafërta që duhet t'i plotësojnë personat e akredituar nga paragrafi (6) të këtij neni, në lidhje me, kuadrin profesional, pajisjen, stabilimentet, instrumentet dhe kushtet e lokaleve për kryerjen e punëve, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë.

## Neni 147

### Monitorimi i kuantitetit dhe kualitetit të trupave ujq

(1) Monitorimi i ujërave sipërfaqësor përfshin:

- 1) vëllimin, nivelin, ose rrjedhën në shkallë relevante për gjendjen ekologjike dhe kimike dhe potencialin ekologjik dhe
- 2) gjendjen ekologjike dhe kimike dhe potencialin ekologjik.

(2) Monitorimi i ujërave nëntokësor e përfshin gjendjen kimike dhe kuantitative dhe regjimin termik.

(3) Monitorimi i zonave të mbrojtura i përfshin edhe kërkesat plotësuese për përcaktimin e gjendjes së zonës së mbrojtur.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton metodologjinë dhe i përcakton parametrat për matjen dhe monitorimin e

kualitetit dhe kuantitetit të të gjitha trupave ujqor, përveç për trupat ujqor të definuar në nenet 148 dhe 149 të këtij ligji.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë e përcakton metodologjinë dhe i përcakton metodat referente matëse dhe parametrat për matje dhe monitorim të kualitetit dhe kuantitetit të trupave ujqor të shpallura si zona të ndjeshëm në lidhje me ujërat e zeza urbane të lëshuara.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë e përcakton metodologjinë dhe i përcakton metodat referente matëse dhe parametrat për matjen dhe monitorimin e kualitetit dhe kuantitetit të trupave ujqor në zonat e ndjeshëm të nitrateve.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton metodologjinë dhe i përcakton metodat referente matëse dhe parametrat për matjen dhe monitorimin e kualitetit dhe kuantitetit të të gjitha trupave ujqor në rajonet e mbrojtura si trashëgimi natyrore.

(8) Me dispozitat nga paragrafët (4), (5), (6) dhe (7) të këtij neni përcaktohen edhe kërkesat e veçanta për monitorim në rast të vërshimeve dhe gjendjes së jashtëzakonshme, forcës madhore dhe fatkeqësive, si dhe afati kohor për revizionin e programeve për monitorim.

(9) Informatat përfundimtare nga programet për monitorim dhe nga aktivitetet për monitorim janë pjesë përbërëse e planit për menaxhim me pellgun lumor.

## **Neni 148**

### **Monitorimi i ujqit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Monitorimi dhe analiza e ujqit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut bëhet në mënyrë me të cilën sigurohet ujqit i siguar në pajtim me nenin 183 të këtij ligji dhe të dispozitave nga sfera e sigurisë së ushqimit.

(2) Kampionët për analizën e sigurisë së ujqit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut merren në atë mënyrë që siguron reprezentativitetin e kualitetit të ujqit që konsumohet gjatë vitit.

(3) Në rast kur në procesin e përpunimit dhe distribuimit të ujqit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut duhet të bëhet dezinfektimi i ujqit, efikasiteti i dezinfektimit duhet të kontrollohet në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me nenin 186 të këtij ligji dhe dispozitave nga sfera e sigurisë së ushqimit.

(4) Personat juridik dhe fizik të cilët për nevojat e furnizimit publik me ujqë ose për nevoja komerciale thithin ose shfrytëzojnë ujqë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut janë të detyruar që ta përcjellin kualitetin dhe sasinë e shfrytëzimit ose të ujërave të thithur, t'i ruajnë të dhënat për matjet dhe analizat e kryera t'i dorëzojnë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, si dhe organit kompetent për sigurinë e ushqimit dhe organit kompetent për mbrojtjen shëndetësore.

(5) Obligimi nga paragrafi (4) i këtij neni nuk ka të bëjë për personat fizik

të cilët për nevoja personale ose për nevojat e amvisërisë së familjes së tij, thithin ose shfrytëzojnë më pak se 10 m<sup>3</sup> në dit, ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë e përcakton metodologjinë, kushtet më të afërme për objektet, pajisjen dhe kuadrin profesional, mënyrën dhe procedurën për monitorim e sigurisë së ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut në pajtim me këtë ligj dhe me dispozitat për sigurinë e ushqimit.

(7) Sipas nevojës, për rastet e caktuara në të cilat ekziston shkak i arsyetuar për dyshim se disa materie dhe substanca të caktuara ose mikroorganizma për të cilat nuk ekzistojnë vlerat e parametrave në pajtim me nenin 183 të këtij ligji, e të cilat janë prezent në ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut në sasi ose vlera që paraqesin rrezik potencial për shëndetin e njeriut, bëhet ndjekja e tyre plotësuese.

(8) Personi juridik që udhëheq me sistemin e furnizimit të ujit është i detyruar të instalojë dhe t'i mbajë në gjendje të rregullt instrumentet për matjen dhe analizën e kualitetit të:

- 1) ujit të papërpunuar në gjendjen e tij burimore;
- 2) ujit të pastër pas dezinfektimit dhe
- 3) ujit në vendet e furnizimit prej ku shfrytëzohet për konsumim nga ana e njeriut;

(9) Në rast të dyshimit për autenticitetin e të dhënave të dorëzuara, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe organet e mbrojtjes shëndetësore dhe organi kompetent për sigurinë e ushqimit nga paragrafi (4) të këtij neni si dhe kryetari i komunës, të komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit mund të kërkojnë superanalizë. Superanalizën e bën laborator i akredituar. Nëse konstatohet se të dhënat e dorëzuara nuk janë autentike, shpenzimet për superanalizën janë në barë të personave juridik dhe fizik nga paragrafi (4) të këtij neni.

(10) Personat juridik dhe fizik nga paragrafi (4) i këtij neni mund të bëjnë monitorim intern të ujërave nëpërmjet shërbimeve personale të akredituara ose nëpërmjet organizatave të akredituara shkencore ose profesionale ose personat tjerë juridik që i plotësojnë kushtet për kryerjen e monitorimit të ujërave në pajtim me nenin 146 paragrafi (6) dhe (7) të këtij ligji.

(11) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë është i detyruar të botojë rezultatet për gjendjen e ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut çdo tre vjet.

(12) Monitorimin dhe analizat e ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut dhe ujërave për banjë dhe rekreacion, në procedurë administrative me kërkesë të organit inspektues, e bëjnë organet kompetent për mbrojtje shëndetësore. Nëse konstatohet se të dhënat e dorëzuara nuk janë autentike, shpenzimet për analizat e bëra, bien në barë të personave juridik dhe fizik të paragrafit (4) të këtij neni.

## **Neni 149**

### **Monitorimi i ujit në zonat për banjë**

(1) Kryetari i komunave, i komunave të qytetit të Shkupit, dhe i Qytetit të Shkupit në territorin e të cilit gjendet zona për banjë janë të detyruar që ta përcjellin kualitetin e ujit për banjë dhe të dhënat për atë t'ia dorëzojnë organit të administratës shtetërore kompetent për mbrojtje shëndetësore, inspektoratit shtetëror sanitar dhe shëndetësor dhe organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë e përcakton metodologjinë dhe i përcakton metodat referente, kushtet, mënyrat dhe procedurën e monitorimit si dhe parametrat për kualitetin e ujit për banjë.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton mënyrën dhe procedurën për informimin e popullatës për rezultatet e monitorimit të kualitetit të ujit për banjë.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë është i detyruar që çdo vit të bëjë identifikimin e ujit për banjë, më së voni para datës 24 mars gjatë vitit vijues, në bazë të monitorimit të ujit për banjë që bëhet në pajtim me dispozitat e sjella në bazë të nenit 104 paragrafi (6) i këtij ligji.

## Neni 150

### Monitorimi i lëshimit të ujërave të zeza

(1) Personat juridik dhe fizik që lëshojnë ujëra të zeza, janë të detyruar që të instalojnë instrumente për matjen e sasive të lëshuara të ujërave dhe analizën e kualitetit të tyre dhe t'i mbajnë instrumentet në gjendje të rregullt, të mbajnë shkresa për matjet e bëra dhe këto të dhëna t'ia dorëzojnë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Personat juridik dhe fizik që lëshojnë ujëra të zeza, që përmbajnë materie dhe substanca të rrezikshme në pajtim me nenin 108 të këtij ligji, janë të detyruar që të instalojnë instrumente për matjen e sasive të lëshuara të ujërave dhe analizën e kualitetit të tyre dhe t'i mbajnë instrumentet në gjendje të duhur, të mbajnë shkresa për matjet e bëra dhe këto të dhëna t'ia dorëzojnë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton metodologjinë, metodat referente matëse, mënyrën dhe parametrat e monitorimit të ujërave të zeza, duke përfshirë edhe llumin nga pastrimi i ujërave të zeza urbane.

(4) Personat juridik dhe fizik nga paragrafi (1) i këtij neni mund t'i ndjekin ujërat e zeza nëpërmjet shërbimeve të veta të akredituara ose nëpërmjet organizatave të akredituara shkencore, profesionale ose personave tjerë juridik.

(5) Kushtet më të afërta që duhet t'i plotësojnë personat juridik dhe fizik, respektivisht organizatat dhe institucionet e akredituara shkencore dhe profesionale nga paragrafi (4) i këtij neni në lidhje me kuadrin profesional, pajisjen, aparatet, instrumentet dhe kushtet e lokaleve për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) të këtij neni, i përcakton ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Në rast të dyshimit për autenticitetin e të dhënave të dorëzuara, subjektet e interesuar nga paragrafi (1) të këtij neni mund të kërkojnë superanalizë. Superanalizën e bën personi i akredituar, që ka pajisje adekuate, aparate, instrumente dhe kushte të lokaleve dhe kuadër adekuat profesional për kryerjen e analizës. Nëse me superanalizën konstatohet se personat nga paragrafi (1) të këtij neni lëshojnë materie dhe substanca të dëmshme dhe të rrezikshme mbi kufijtë e lejuar, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor bën studime kontrolluese së paku dy herë gjatë muajit në

Ilogari të personave që lëshojnë ujëra të zeza në recipientin.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor së afërmi i përcakton kushtet për kryerjen e superanalizës nga paragrafi (6) të këtij neni.

(8) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor çdo 2 vjet i shpall raportet për gjendjen me lëshimin e ujërave të zeza.

(9) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar të përcjellë dhe të zbatojë studime relevante shkencore dhe studime tjera me qëllim që të kontrollohet se lëshimi i ujërave të zeza ose derdhja e llumit, duke përfshirë edhe atëherë kur lëshimi dhe/ose derdhja është e rregulluar me leje, nuk do të ndikojë negativisht mbi mjedisin jetësor.

## **Neni 151**

### **Monitorimi i ujit për ujitje**

(1) Pronarët ose shfrytëzuesit e hidrosistemeve ose sistemeve për ujitje janë të detyruar t'i matin sasinë e përfshira ose të thithura të ujit dhe ta përcjellin kualitetin e tyre në vendet e thithjes ose përfshirjes. Të dhënat për sasinë dhe kualitetin e ujit i dorëzohen administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë i përcakton kushtet më të afërta teknike, mënyrën dhe procedurën për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) të këtij neni.

## **Neni 152**

### **Monitorimi i ujit të ujitjes së tokës**

(1) Pronarët ose shfrytëzuesit e sistemeve hidromeliorative për shterjen e tokës janë të detyruar në vendet e lëshimit të ujit të shterjes në recipient, ta matin sasinë e ujit të lëshuar dhe ta përcjellin kualitetin e tij. Të dhënat për sasinë dhe kualitetin e ujit i dorëzohen organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë i përcakton kushtet më të afërta teknike, mënyrën dhe procedurën për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 153**

### **Monitorimi i ujit që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike**

(1) Shfrytëzuesit e sistemit për prodhimin e energjisë elektrike janë të detyruar ta matin sasinë e ujit që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike në vendet përfshirëse. Të dhënat për sasinë e matura i dorëzohen organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton

kushtet e përafërta teknike, mënyrën dhe procedurën e kryerjes së punëve nga paragrafi (1) të këtij neni.

## **Neni 154**

### **Monitorimi i ujit për dedikime tjera**

(1) Personat juridik dhe fizik që thithin ose që përfshijnë më shumë se 10 m<sup>3</sup> ujë për dedikime tjera të ndryshme nga ato të theksuara në nenet 148, 151, 152, 153 të këtij ligji janë të detyruar t'i matin sasitë e thithura ose të përfshira të ujit dhe kualitetit të tij. Të dhënat e këtyre matjeve i dorëzohen organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton kushtet e përafërta teknike, mënyrën dhe procedurën e kryerjes së punëve nga paragrafi (1) të këtij neni.

## **Neni 155**

### **Monitorimi i ujërave në rajonet e mbrojtura me dispozitat për mbrojtjen e natyrës**

(1) Personat juridik dhe fizik që në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e natyrës janë kompetent për menaxhim me rajonet e mbrojtura, janë të detyruar që të bëjnë monitorimin e ujërave në ato rajone dhe t'i dorëzojnë rezultatet në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton kushtet teknike, mënyrën dhe procedurën për monitorimin e ujërave në rajonet e mbrojtura.

## **Neni 156**

### **Dorëzimi i informatave**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i grumbullon, përpunon dhe i ruan të gjitha informatat e fituara nga monitorimi i trupave ujqor.

(2) Organi i administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes shëndetësore i grumbullon, përpunon dhe i ruan të gjitha të dhënat dhe informatat e marra nga monitorimi sipas neneve 148 dhe 149 të këtij ligji dhe ia dorëzon organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe organit kompetent për sigurinë e ushqimit.

(3) Kryetari i komunave, i komunave të qytetit të Shkupit, dhe i Qytetit të Shkupit i dorëzojnë të dhënat e marra nga rrjeti lokal për monitorim, si dhe të dhënat e marra nga monitorimi i ujit për banjë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Grumbullimi, përpunimi, ruajtja dhe dorëzimi i informatave të marra nga monitorimi bëhet pa kompensim.

(5) Të gjitha informatat e marra dhe të përpunuara në pajtim me obligimet dhe kompetencat me këtë ligj dhe me ligj tjetër, janë në qasje pa kompensim për të gjitha organet kompetente.

(6) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton

kushtet e përafërta teknike dhe mënyrën e dorëzimit të informatave të monitorimit të trupave ujqorë nga paragrafi (1) të këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit me të cilin dorëzohen të dhënat.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë i përcakton kushtet më të afërta dhe mënyrën e dorëzimit të informatave të monitorimit të ujërave nga neni 148 dhe neni 149 të këtij ligji, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit me të cilin dorëzohen informatat.

(8) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e ekonomisë i përcakton mënyrën e dorëzimit të informatave nga monitorimi i ujërave nga neni 151, 152, 153 dhe neni 154 të këtij ligji, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit me të cilin dorëzohen informatat.

(9) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton mënyrën e bartjes së informatave të monitorimit nga neni 150 të këtij ligji, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit me të cilin dorëzohen të dhënat.

(10) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton mënyrën e bartjes së të dhënave të monitorimit nga neni 155 të këtij ligji, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit me të cilin dorëzohen të dhënat.

(11) Qasja e popullatës te të dhënat dhe informatat në lidhje me monitorimin e ujërave bëhet në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(12) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe organi për mbrojtje shëndetësore për shkak mundësimin të qasjes së popullatës te të dhënat dhe informatat në lidhje me monitorimin e ujërave i botojnë të dhënat dhe rezultatet e marra nga monitorimi i trupave ujqorë dhe ujërave të dedikuara për shfrytëzim, në raporte periodike dhe/ose vjetore në pajtim me dispozitën nga neni 162 të këtij ligji.

## **Neni 157**

### **Baza e të dhënave për menaxhim me ujërat**

(1) Të dhënat dhe informatat e marra nga matja që janë grumbulluar, përpunuar dhe verifikuar paraqesin bazë oficiale të të dhënave për menaxhim me resurset e ujërave, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e menaxhimit dhe mbrojtjen e ujërave.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i dorëzon të dhënat adekuate në të gjitha organet kompetente me kërkesë të tyre, pa kompensim.

## **Neni 158**

### **Monitorimi në gjendje të jashtëzakonshme**

(1) Organet, personat juridik dhe fizik kompetent për kryerjen e monitorimit të ujërave në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në rast të keqësimit ose kërcënimit nga keqësimi i ujit ose trupit ujqor që e ndjekin, menjëherë e informojnë organin e administratës shtetërore kompetent për



kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor për shkak të marrjes së masave të domosdoshme.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë i përcakton masat që duhet të ndërmerren në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, kushtet dhe mënyrat për realizimin e tyre.

## **Neni 159**

### **Obligimet nga marrëveshjet ndërkombëtare**

Për shkak të realizimit të obligimeve të ndërmarra me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë janë kompetent për prezantimin e të dhënave të marra nga monitorimi i ujërave në suazat e kompetencave të tyre.

## **VII. SISTEMI I INFORMIMIT**

### **Neni 160**

#### **Libri i ujërave**

(1) Me qëllim që të vendoset baza e të dhënave dhe të informohen të gjitha palët për shfrytëzimin e ujërave instalohet dhe mbahet libri i ujërave.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e instalon dhe e mban librin e ujërave të paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton formën dhe përmbajtjen e librit të ujit dhe mënyrën e instalimit dhe mbajtjes së sajë.

(4) Libri i ujit është regjistër i azhurnuar plotësisht dhe vazhdimisht i:

- 1) lejeve për shfrytëzimin e ujërave;
- 2) lejeve për lëshimin e ujërave;
- 3) lejeve për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtrati i brigjeve të trupave sipërfaqësor të ujërave;
- 4) zonave të mbrojtura;
- 5) zonave të vërshuara;
- 6) të drejtave dhe obligimeve të vjetra;
- 7) pëlqimeve të ekonomive të ujërave;
- 8) kërkesave për dhënien e lejeve;
- 9) drejtorive të dhunshme të përkohshme dhe
- 10) të dhënave tjera me vlerë për vendimet administrative në lidhje me ujërat.

(5) Shikimi në përmbajtjen e librit të ujit është i lirë për popullatën pa kompensim, me përjashtim të të dhënave me karakter besueshmërie. Secili ka të drejtë të kërkojë kopje nga të dhënat të përfshira në librin e ujit.

(6) Të dhënat e përfshira në librin e ujit ruhen së paku pesë vjet pas skadimit të vlefshmërisë së dokumenteve, ndërsa më pas arkivohen në pajtim me ligjin.

### **Neni 161**

## Kadastra e ndotësve të ujit

(1) Për përcaktimin e shkallës së ndotjes së ujërave të zeza industriale, atmosferike dhe urbane, ujërat e plehërishtave, si dhe ndikimi i tyre i dëmshëm mbi kualitetin e ujërave në recipient dhe për shkak të përcaktimit të burimeve tjera të ndotjes së ujërave në rajonin e pellgut, vendoset dhe mbahet kadastra e ndotësve të ujërave si pjesë e Kadastrës së ndotësve të përcaktuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor (në tekstin e mëtejme: Kadastra).

(2) Kadastrën nga paragrafi (1) të këtij neni e themelon, e përgatit dhe e mban organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Mënyrën dhe procedurën për regjistrimin e të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Për shkak të përgatitjes dhe mbajtjes së Kadastrës nga paragrafi (1) të këtij neni, personat juridik dhe fizik janë të detyruar që të dhënat nga paragrafi (3) të këtij neni, si dhe të dhënat tjera të duhura, t'ia dorëzojnë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(5) Të dhënat nga Kadastra janë në qasje ndaj popullatës në vëllim, formë dhe mënyrë të përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

### Neni 162

#### Informimi i popullatës

(1) Për shkak të informimit të popullatës, organet kompetente të administratës shtetërore përgatisin raporte periodike për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, duke përfshirë edhe të dhënat e marra nga monitorimi i ujërave.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar të ngrit procedurë për dorëzimin e raporteve shtetit tjetër për çështjet që kanë të bëjnë me ujërat ndërkombëtare, në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton përmbajtjen e raporteve, mënyrën dhe procedurën për informim nga paragrafi (1) të këtij neni.

## VIII. OBJEKTET DHE SHËRBIMET E EKONOMIVE TË UJËRAVE

### 1. Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 163

#### Objektet dhe stabilimentet e ekonomive të ujërave

Objektet dhe stabilimentet e ekonomive të ujërave në kuptim të këtij ligji, janë objektet e dedikuara për:

1) përcaktimin e regjimit të ujërave edhe atë: digave me lokalet e tyre akumuluese, baseneve retnzionive dhe inundacionive, shtretërit e rregulluara të lumit, ledheve mbrojtëse, rrëkeve të rregulluar dhe sipërfaqeve erozive, kanaleve rrethore, stacioneve thithëse e tjerë (në tekstin e mëtejme: objektet mbrojtëse);

- 2) sigurimin, përfshirjen, sjelljen dhe përgatitjen e ujit për furnizim me ujë të banorëve, nevojave industriale dhe nevojave tjera ekonomike dhe komunale (në tekstin e mëtejshëm: objektet ujëfurnizues);
- 3) sigurimin, përfshirjen dhe sjelljen e ujit për ujitje të tokës bujqësore-ujitjen dhe për pranimin dhe dërgimin e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor të tepërta-kullim (në tekstin e mëtejshëm: sistemet e ujitjes dhe sistemet për kullim);
- 4) përfshirjen, sjelljen dhe shfrytëzimin e ujit për prodhimin e energjisë elektrike dhe për lëvizjen e ndonjë llojit tjetër të aparateve (në tekstin e mëtejshëm: objektet hidroenergjetike);
- 5) përfshirjen, sjelljen dhe pastrimin e ujërave të zeza ndotëse dhe dërgimin e tyre në recipien dhe për pengimin e lëshimit të përnjëhershëm, lëshimit ekscesik të materieve dhe substancave të rrezikshme dhe të dëmshme (në tekstin e mëtejshëm: objektet për mbrojtjen e ujërave) dhe
- 6) plotësimin e dedikimeve të veçanta për mbrojtjen, nevojat e veçanta ekologjike e tjerë (në tekstin e mëtejshëm: objektet e veçanta).

## Neni 164

### Veprimtaritë dhe shërbimet me interes publik

(1) Veprimtaritë e caktuara që kanë të bëjnë me ndërtimin, punën, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të ekonomisë së ujërave dhe aparateve për shkak të menaxhimit me ujërat, si dhe dhënien e shërbimeve të ekonomisë së ujërave, konsiderohen si veprimtari dhe shërbime me interes publik dhe bëhen në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Veprimtaritë dhe shërbimet e ekonomisë së ujërave me interes publik në kuptim të këtij ligji janë ndërtimi, eksploatimi dhe mirëmbajtja e objekteve dhe aparateve të ekonomisë së ujërave që sigurojnë shërbimet e ekonomisë së ujërave për:

- 1) furnizimin publik me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut dhe për nevoja teknologjike;
- 2) prodhimin e energjisë elektrike në pajtim me ligjin;
- 3) ujitjen dhe kullimin e tokës;
- 4) mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujore;
- 5) grumbullimi dhe dërgimin, trajtimin dhe lëshimin e ujërave të zeza;
- 6) mbrojtjen nga veprimi i dëmshëm i ujërave;
- 7) eksploatimin e ujërave nëntokësor;
- 8) nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit për përmirësimin e regjimit të ujërave dhe
- 9) sigurimin e rezervave të ujit me të cilat sigurohet regjim unik i ujërave në pellg ose në pjesë të pellgut.

(3) Veprimtaritë dhe shërbimet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni do të bëhen nga personat juridik të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose me vendim të këshillit të komunave, të komunave të qytetit të Shkupit respektivisht këshillit të qytetit të Shkupit në pajtim me kompetencat e tyre të përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

(4) Veprimtaritë dhe kushtet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni mund t'i bëjnë edhe personat tjerë juridik, në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

## Neni 165

### Standardet teknike për realizimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e aparateve dhe objekteve të ekonomive të ujërave

(1) Për shkak të mbrojtjes së interesit publik, mjedisit jetësor dhe jetës dhe shëndetit të njerëzve, realizimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e

aparateve dhe objekteve të ekonomisë së ujërave bëhet në pajtim me standardet dhe teknikat bashkëkohore të pranuar, të adoptuara për zhvillimin shkencor-teknik në atë mënyrë që nuk do të shkaktojë ndikim negativ në regjimin e ujërave dhe ndaj shfrytëzuesve.

(2) Personi juridik ose fizik i cili përfshin ujë nga trupi ujqor për shkak të sigurimit të ujit për furnizimin publik të ujit, industrisë, ujitjen ose çfarëdo dedikimi, është e domosdoshme që të instalojë dhe të mbajë në gjendje të rregullt, instrumentet matëse në vendin e përfshirjes, t'i matë sasinë dhe kualitetin e ujit të përfshirë dhe t'i ruajë të dhënat e matjes.

(3) Personi juridik ose fizik i cili lëshon ujë të shfrytëzuar ose ujëra të zeza në trupin ujqor ose në ekosisteme ujore është e domosdoshme që të instalojë dhe të mbajë në gjendje të rregullt, instrumentet matëse në vendin e përfshirjes, t'i matë sasinë dhe kualitetin e ujit të përfshirë dhe t'i ruajë të dhënat e këtyre parametrave.

(4) Personi juridik ose fizik i cili i bën matjet nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni është e detyruar që të dhënat nga matjet t'ia dorëzojë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me këtë ligj.

## Neni 166

### **Obligimet për mirëmbajtjen dhe përdorimin e objekteve dhe stabilimenteve të ekonomisë së ujërave**

(1) Objektet dhe stabilimentet e ekonomisë së ujërave menaxhohen dhe mirëmbahen në mënyrë të përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve.

(2) Nëse objekti ose stabilimenti i ekonomisë së ujërave, menaxhimi ose kryerja e veprimtarisë së ujërave, sjell pasoja negative ndaj ujërave, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor të përcaktuar në bashkëpunim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve, mund të urdhërojë marrjen e aktiviteteve paraprake për pengimin e efekteve negative.

(3) Personi juridik dhe fizik i cili udhëheq me objektet dhe stabilimentet e ekonomisë së ujërave është i detyruar, në rast të rrezikut ndaj objekteve dhe stabilimenteve të ekonomisë së ujërave, për atë ta informojë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe t'i ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet e domosdoshme për zvogëlimin ose mënjanimin e rrezikut.

## Neni 167

### **Mbrojtja e objekteve të ekonomisë së ujërave**

Për shkak të mbrojtjes dhe pengimit të dëmtimeve të objekteve dhe stabilimenteve të ekonomisë së ujërave, ndalohet:

1) që të bëhen ndërtime ose të bëhen punë me të cilat rrezikohet stabiliteti i ledheve mbrojtëse, të gërmohet dheu, të mbillen drunj dhe kaçuba, të ngulen kunj ose të vihen gardhe, nëse nuk janë pjesë përbërëse të sistemit për mbrojtje nga vërshimet;

- 2) që të gropohen dhe të shpohen puse në diametër më pak se 20 metra nga fundi i ledheve mbrojtëse;
- 3) që të gropohet hendeqe dhe kanale paralele në gjatësinë e ledhit më afër se 10 metra nga brendia dhe 10 metra nga ana e jashtme e fundit të ledhit;
- 4) që në brezin e ledhit mbrojtës dhe në objekte dhe stabilimente tjera mbrojtëse të ekonomisë së ujërave të prehen drunj, shelgje dhe kaçuba që janë pjesë përbërëse e mbrojtjes, punëve dhe masave mbrojtëse, nëse ajo nuk është përcaktuar me planin për ruajtjen e objekteve dhe stabilimenteve mbrojtëse;
- 5) që të lëshohet kafsha për kullotje dhe kalim nëpër ose përgjatë objekteve të ekonomisë së ujërave, nëse ajo nuk është paraparë me planin për mirëmbajtjen e objekteve dhe stabilimenteve të ekonomisë së ujërave;
- 6) që të zhvillohet komunikacioni përgjatë ose nëpër objekte dhe stabilimente të ekonomisë së ujërave, përveç në vend të caktuara për atë (barrierë natyrore);
- 7) që të hidhen hedhurina, dheu dhe sende tjera me të cilat mbulohen kanale;
- 8) që të lëshohen ujërat e zeza në objektet e hidrosistemeve dhe sistemeve për ujitje dhe sistemeve për shterje;
- 9) që të realizohen punë të cilat do të mundet t'i ndryshojnë kushtet për matjen e ujit të profileve hidrometrike te stacionet hidrologjike;
- 10) që të realizohen punë që do të mund ta rrezikojnë stabilitetin e digës, ledheve mbrojtëse dhe objekteve dhe stabilimenteve tjera të ekonomisë së ujërave ose shfrytëzimin e tyre dedikues, si dhe të ndërrohen kushtet natyrore në rrethin e akumulacionit për çka do të mund të vijë deri te rrëshqitja e terrenit, paraqitjes së erozionit ose krijimit të pjerrësive ose rrëkeve;
- 11) që të ndërtohen ledhe kryq e tërthortë, të vihet gardh, objekte tjera dhe bimë në shtratin e rrjedhave ë ujit që e keqësojnë regjimin e rrjedhës së ujërave;
- 12) që të nxirret rërë, zhavorr, gurë e tjerë nga objektet mbrojtëse të ekonomisë së ujërave, nëse ajo nuk është e përcaktuar me planin për mirëmbajtjen e tyre dhe
- 13) që të bëhen edhe punë tjera me të cilat dëmtohen objektet dhe stabilimentet e ekonomisë së ujërave.

## **Neni 168**

### **Obligimi për harmonizim me planet për menaxhim me pellgjet e lumenjve**

Përpunimi i dokumentacionit investues-technik, ndërtimi dhe përdorimi i objekteve dhe stabilimenteve për menaxhim me ujërat, objektet dhe stabilimentet e elektroekonomisë, ato komunale, industrisë e tjerë që ndikojnë mbi kuantitetin dhe kualitetin e ujërave, si dhe shfrytëzimin e ujërave dhe lëshimin e ujërave të përdorura dhe veprime tjera mbi ujërat, bëhen në pajtim me planet për menaxhim me pellgjet lumore.

## **Neni 169**

### **Kufizimi i shërbimit**

(1) Nëse në territorin e caktuar sasia e ujit zvogëlohet në masë që nuk mund t'i përmbushë nevojat e të gjithë shfrytëzuesve, personi juridik i cili menaxhon me objektet dhe stabilimentet e ekonomisë së ujërave, mund që shfrytëzuesve të veçantë përkohësisht tua kufizojë ose ndalojë shfrytëzimin e ujërave, në pajtim me prioritetet e caktuara me nenin 15 të këtij ligji.

(2) Në rast të mungesës së ujit ose të tepicës së ujit për shkak të veprimit të forcës madhore ose për shkak të punëve të domosdoshme dhe rikonstruimit të objekteve dhe stabilimenteve, personi juridik i cili

menaxhon me objektet dhe stabilimentet e ekonomisë së ujërave mund përkohësisht ta kufizojë furnizimin me ujë dhe pranimin e ujit, nëse ekzistojnë arsye që e kanë shkaktuar atë.

(3) Personi juridik për rastet nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni është i detyrueshëm që menjëherë t'i informojë shfrytëzuesit e shërbimit të ekonomisë së ujërave.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, shfrytëzuesit e shërbimit të ekonomisë së ujërave nuk kanë të drejtë në kompensimin e dëmit.

## **Neni 170**

### **E drejta e përjashtimit të shfrytëzuesit**

Dhënësi i shërbimeve të ekonomisë së ujërave mund ta përjashtojë nga rrjeti shfrytëzuesin e shërbimit nëse:

- 1) ajo është e nevojshme për kryerjen e punëve të domosdoshme dhe
- 2) shfrytëzuesi i shërbimit i cili është i informuar se duhet t'i paguajë shpenzimet dhe ka një afat të arsyeshëm për atë, ai atë nuk e ka bërë në afatin e caktuar.

## **Neni 171**

### **Evidenca**

(1) Personat juridik që menaxhojnë me objektet dhe stabilimentet e ekonomive të ujërave janë të detyruar të vendosin dhe të mbajnë evidencë për ato objekte dhe stabilimente.

(2) Personat juridik që menaxhojnë me hidrosistemet, sistemet për ujitje dhe sistemet për shterje janë të detyruar të vendosin dhe të mbajnë evidencë të sipërfaqeve të përfshira me hidrosistemet, sistemet për ujitje dhe sistemet për shterje, në pajtim me dokumentacionin investuesteknik sipas të cili janë ndërtuar sistemet.

(3) Personat juridik nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni janë të detyruar që të dhënat nga evidenca t'ia dorëzojnë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni, si dhe mënyrën e dorëzimit të evidencës.

## **Neni 172**

### **Obligimi për mënjanimin e ujërave të shfrytëzuara**

Bartësi i të drejtës së ujit i cili përfshin ujin, është i detyruar që t'i mënjanojë të gjitha ujërat e shfrytëzuara që dalin nga përfshirja e ujërave në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## **Neni 173**

### **Dispozitat për tokën**

(1) Toka nën ujë dhe toka bregore në pronësi të Republikës së Maqedonisë që shfrytëzohet ose përfshihet për nevojat e ekonomisë së ujërave, përcaktohet në lejen në pajtim me këtë ligj.

(2) Pronari ose bartësi i të drejtave tjera reale mbi tokën fqinjësore të tokës nga paragrafi (1) të këtij neni është i detyruar që të lejojë qasje në objektet e ekonomisë së ujërave dhe shfrytëzimin e tokës për të gjitha aktivitetet për nevojat e ndërtimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së objekteve të ekonomisë së ujërave.

(3) Me përjashtim, nëse toka që shfrytëzohet ose përfshihet për nevojat e objekteve të ekonomisë së ujërave, është në pronë të personit juridik ose fizik, ndërsa është në interes të veçantë për ndërtimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të ekonomisë së ujërave, toka mund të eksproprijohet në pajtim me ligjin.

## **Neni 174**

### **Pëlqimi i ekonomisë së ujërave**

(1) Pëlqimi i ekonomisë së ujërave jepet për shkak të: ndërtimit të objekteve të reja, rikonstruimit ose për zgjerimin e objekteve ekzistuese, që gjenden në ose pranë ujërave sipërfaqësor, objekte që kalojnë nëpër ose nën ujërat sipërfaqësor ose objekte që janë vendosur në afërsi të ujërave sipërfaqësor ose tokë buzë bregut, e që mund të ndikojnë ndaj regjimit të ujërave.

(2) Pëlqimi i ekonomisë së ujërave jepet edhe për shkak të ndërtimit të objekteve të reja të ekonomisë së ujërave, rikonstruimit ose të zgjerimit të objekteve ekzistuese nga neni 163 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji, me përjashtim të digave.

(3) Me pëlqimin e ekonomisë së ujërave përcaktohen kushtet e ekonomisë së ujërave që detyrimisht duhet të realizohen gjatë ndërtimit.

(4) Pa pëlqim të ekonomisë së ujërave nuk guxon të jepet leje për ndërtimin e objekteve dhe stabilimenteve nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni.

(5) Pëlqimi i ekonomisë së ujërave nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni nuk paraqet bazë juridike për shfrytëzimin e ujit.

## **Neni 175**

### **Harmonizimi me planet për menaxhim me pellgjet lumore dhe dokumentet tjera**

Në procedurën për dhënien e pëlqimit të ekonomisë së ujërave, vlerësohet harmonizimi i dokumentacionit për ndërtim, rikonstruim ose zgjerim të objekteve dhe stabilimenteve me dispozitat e këtij ligji, me bazën e ekonomisë së ujërave, respektivisht me planin për menaxhim me pellgun lumor dhe me dokumente tjera të sjella në pajtim me këtë ligj ose me ligj tjetër.

## **Neni 176**

### **Kërkesa dhe dokumentacioni i duhur për dhënien e pëlqimit të ekonomisë së ujërave**

(1) Pëlqimin e ekonomisë së ujërave me kërkesë me shkrim të investitorit e jep organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Së bashku me pëlqimin e ekonomisë së ujërave nga paragrafi (1) të këtij neni, përveç të dhënave për investitorin veçanërisht i bashkëngjiten edhe:

- 1) aktvendimi për kushtet e lokacionit në pajtim me ligjin dhe
- 2) Projekti bazë i përpiluar nga enti profesional ose personi tjetër juridik ose fizik i regjistruar për kryerjen e atyre llojeve të punës.

(3) Projekti bazë nga paragrafi (2) pika 2 i këtij neni, veçanërisht përmban: lokacionin e objektit, bazat hidrologjike, llogaritë hidraulike, dedikimin e objektit dhe ndikimin e tij mbi regjimin e ujërave.

(4) Dokumentacionin teknik të projektit bazë nga paragrafi (2) pika 2 të këtij neni detyrimisht duhet të jetë i reviduar nga enti profesional ose nga personi tjetër juridik ose fizik i regjistruar për kryerjen e atij llojit të punës.

(5) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor vlerëson se dokumentacioni i dorëzuar nga paragrafi (2) i këtij neni nuk është në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozita tjera për përpilimin e atij lloji të dokumentacionit, e ndërpret procedurën dhe përcakton afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se 15 ditë, në të cilin investitori është i detyruar ta dorëzojë dokumentacionin e duhur ose veç dokumentacionit të dorëzuar ta harmonizojë me kërkesat e përcaktuara..

(6) Nëse investitori nuk vepron në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, sjell aktvendim me të cilin e refuzon kërkesën për dhënien e pëlqimit të ekonomisë së ujërave.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafi (6) nga ky nen investuesi në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit mund që të paraqesë ankesë në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 177**

### **Lejet ekologjike integruese dhe vlerësimi i ndikimit ndaj mjedisit jetësor**

(1) Për objektet dhe instalimet nga neni 174 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij ligji për të cilat në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor është përcaktuar se detyrimisht sigurohet leje integruese ekologjike, nuk mund të ndërtohen respektivisht të fillojnë me punë nëse nuk është siguruar leje, sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Për objektet dhe instalimet nga neni 174 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij ligji për të cilat në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor është përcaktuar realizimi i procedurës për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor, nuk mund të ndërtohen nëse nuk është siguruar mendimi pozitiv për studimin, për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor, në kushte dhe në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **Neni 178**

### **Dhënia e pëlqimit të ekonomisë së ujërave**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i detyruar që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, të merr aktvendim me të cilin kërkesa për pëlqim të ekonomisë së ujërave pranohet ose refuzohet.

(2) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e pëlqimit të ekonomisë së ujërave, merr aktvendim për refuzimin e kërkesës.

(3) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) nga ky nen, investuesi dhe personat tjerë me interes juridik në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit për pëlqim të ekonomisë së ujërave, mund të paraqesë



ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Nëse organi nga paragrafit (1) i këtij neni nuk merr vendim me të cilën kërkesa për pëlqim të ekonomisë së ujërave pranohet ose refuzohet, në afatin e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditësh pune të parashtojë kërkesë në sekretari të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, të marrë aktvendim me të cilin lëshohet aktvendim për pëlqim të ekonomisë së ujërave. Nëse ministri nuk ka sekretari kërkesa parashtrohet në sekretari në selinë e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(6) Me kërkesën nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon kopje të kërkesës nga neni 176 paragrafi (1) të këtij ligji për miratimin e aktvendimit me të cilën lëshohet pëlqimi i ekonomisë së ujërave.

(7) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, është i detyruar që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e parashtrimt të kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni të sekretaria, të marrë aktvendim me të cilin kërkesa për dhënien e lejes për lëshim është lejuar ose refuzuar.

(8) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk merr aktvendim nga paragrafi (7) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve pune.

(9) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i detyruar që në afat prej dhjetë ditësh nga pranimi i njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e kërkesës për gjendjen e vërtetuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(10) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin merr aktvendim me të cilin e detyron ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e mjedisit jetësor, që në afat prej dhjetë ditëve të vendosë për kërkesën e parashtruar nga paragrafi (4) i këtij neni, përkatësisht ta miratojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(11) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afat nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin ministri do të vendosë për kërkesën e parashtruar me ç'rast në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse ministri nuk ka vendosur edhe në afat plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve pune do të parashtojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Nëse inspektori nuk vepron pas njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë që të parashtojë kundërshtim në sekretari të drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretari në selinë e Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(14) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror administrativ është i detyruar që në afat prej tri ditësh pune, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (13) i këtij neni dhe nëse vërteton se inspektori nuk ka vepruar pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës në pajtim me paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni dhe/ose nuk parashtron fletëparaqitje në pajtim me paragrafët (11) dhe (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e mjedisit jetësor, nëse është zbatuar procedura në pajtim me Ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Në rast nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë e më së voni në afat prej një dite pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta realizojë menjëherë mbikëqyrjen.

(17) Në rastet nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(18) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (14) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtojë fletëparaqitje te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(19) Nëse ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor nuk vendos në afat nga paragrafi (11) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(20) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

(21) Akti nënligjor nga paragrafi (5) i këtij neni do të miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të këtij ligji.

(22) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (5) i këtij neni i njëjti menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh shpallet në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e mjedisit jetësor.

## **Neni 179**

### **Pushimi i pëlqimit të ekonomisë së ujërave**

Pëlqimi i ekonomisë së ujërave pushon të vlejë me pushimin e vlefshmërisë së lejes për ndërtim në pajtim me Ligjin për ndërtim.

## **Neni 180**

### **Anulimi i pëlqimit të ekonomisë së ujërave**

(1) Nëse organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor konstaton se gjatë kryerjes së ndërtimit, rikonstruimit ose zgjerimit të objekteve dhe stabilimenteve nga neni 174 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij ligji, investitori nuk i respekton kushtet e përfshira në pëlqimin e ekonomisë së ujërave, merr aktvendim për ndërprerjen e punëve dhe i cakton afat investuesit për përshtatjen e kushteve të përfshira në pëlqim.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) nga ky nen, investuesi, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesë ankesë në Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë. Ankesa nuk e shtyn zbatimin e aktvendimit.

(3) Nëse investitori plotësisht ose pjesërisht nuk vepron në pajtim me aktvendimin nga paragrafi (1) të këtij neni organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, mund plotësisht ose pjesërisht ta anulojë pëlqimin e ekonomisë së ujërave.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, në bazë të kërkesës paraprake me shkrim nga investuesi, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mund që t'i ndryshojë kushtet e përfshira në pëlqimin e ekonomisë së ujërave, nëse ajo është në kundërshtim me interesin publik të menaxhimit të ujërave.

## **2. Furnizimi me ujë**

### **Neni 181**

#### **Ujërat e dedikuar për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Ujërat që në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në bazë të Ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë dhe me planet për menaxhim me pellgjet e lumenjve, janë përcaktuar fillimisht që të shfrytëzohen për: furnizimin me ujë të qytetarëve, për institucionet shëndetësore dhe personat juridik nga sfera e ekonomisë së ujërave, për nevojat e mbrojtjes, për industrinë, për prodhimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore dhe për dhënien ujë kafshëve për të cilët duhet ujë kualitativ për pirje, nuk lejohet që të shfrytëzohen për qëllime dhe mënyrë tjetër në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Ujërat natyrorë sipërfaqësorë, burimet dhe ujërat nëntokësor me kuantitet dhe kualitet adekuat për konsumim nga ana e njeriut, duhet fillimisht të shfrytëzohen për furnizim publik dhe prodhimin e ushqimit të banorëve lokal, të rajonit të komunës, komunave të qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

### **Neni 182**

#### **Përjashtimet**

(1) Dispozitat nga neni 183 deri 190 të këtij ligji, nuk do të zbatohen për:

- 1) ujërat natyrorë mineral dhe ujërat natyror burimor të përcaktuar nga organet kompetente në pajtim me Ligjin për sigurinë e ushqimit dhe dispozitat me të cilat përcaktohet kualiteti i ujit natyror mineral;
- 2) ujërat që në pajtim me dispozitat për prodhimet medicinale janë përcaktuar si produkte medicinale dhe
- 3) furnizimin me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut që bëhet nga burime individuale për furnizim prej të cilëve sigurohen më pak se 10 m<sup>3</sup> në ditë ose përmbush nevoja për më pak se 20 persona, në kushte që i njëjti të mos jetë i dedikuar për nevojat personale dhe nevojat e amvisërisë dhe të mos jetë lëndë e shitjes, dedikimit komercial ose furnizimit publik të ujit.

(2) Në rastin e pikës 3 të paragrafit (1) të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë është i detyruar që t'i informojë banorët e prekur për përjashtimet, dhe për të gjitha veprimet që mund të ndërmerren me qëllim që të mbrohet shëndeti njerëzor prej efekteve negative që dalin nga çfarëdo ndotje të ujit si dhe menjëherë t'u jep këshilla adekuate banorëve.

## **Neni 183**

### **Standardet dhe vlerat për kualitet**

(1) Uji i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut, gjithmonë doemos duhet të jetë i sigurt dhe i pastër në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e sjella në bazë të këtij ligji ose të ligjit tjetër.

(2) Për shkak të arritjes së qëllimeve nga paragrafi (1) të këtij neni, uji i dedikuar për konsumim nga ana e njeriut doemos duhet:

- 1) të mos përmbajë mikroorganizma ose parazite, materie dhe substanca që në numër ose në koncetrime të caktuara mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve dhe
- 2) t'i plotësojë vlerat dhe standardet minimale dhe parametrat për kualitetin, e ujit në lidhje me:
  - parametrat mikrobiologjike,
  - parametrat fiziko-kimike,
  - parametrat radiologjik dhe
  - indikatorët biologjik (fito dhe zooplanton) për furnizim me ujë prej ujërave sipërfaqësor dhe ujëra nëntokësor dhe nga puset.

(3) Ndalohet çdo furnizim me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni, ose që paraqet rrezik ndaj shëndetit të njeriut.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, me propozim të Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari i përcakton vlerat, standardet dhe parametrat minimale, për kualitetin e ujit nga paragrafi (2) pika 2 e këtij neni, si dhe masat që janë të domosdoshme për arritjen e qëllimit nga paragrafi (1) të këtij neni.

## **Neni 184**

### **Vendet matëse**

Vlerat e parametrave të përcaktuara në pajtim me nenin 183 paragrafi (2) të këtij ligji kanë të bëjnë me:

- 1) ujin që sillet nga rrjeti u ujësjellësit, në suazat e lokaleve ose organizimi i vendit në të cilin del, nga rubinetet që zakonisht shfrytëzohen për konsumim nga ana e njeriut;
- 2) ujin që sillet nga cisterna, në vendin ku del nga cisterna;
- 3) ujin që mbushet në shishe ose në enë të dedikuar për shitje, në vendin ku uji mbushet në shishe ose në enë dhe
- 4) ujin që shfrytëzohet për prodhimin e ushqimit, në vendin ku uji shfrytëzohet.

## **Neni 185**

### **Kompetencat**

(1) Kryetari i komunave, kryetari i komunave të qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit janë të detyruar të sigurojnë:

- 1) arritjen e qëllimeve të nenit 183 të këtij ligji;
- 2) zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë për pije në sasi të mjaftueshme dhe sipas kërkesave për të gjithë shfrytëzuesit dhe
- 3) ndërmarrjen e masave të duhura të përcaktuara me dispozitat e neneve

të kësaj pjese, përveç nëse me këtë ligj më ndryshe nuk është përcaktuar.

(2) Për shkak të kryerjes së punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, me propozim të kryetarit të komunave, të komunave të qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, mund të themelojnë ndërmarrje publike për kryerjen e veprimtarisë edhe për punën dhe mirëmbajtjen e sistemeve për furnizim me ujë dhe furnizim me ujë të pijshëm.

(3) Dy ose më shumë komuna dhe Qyteti i Shkupit për shkak të kryerjes së punëve nga paragrafi (1) të këtij neni, me propozim të kryetarit të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit mund të themelojnë ndërmarrje publike të përbashkët.

(4) Kryerjen e punëve nga paragrafi (1) të këtij neni me propozim të kryetarit të komunave, kryetarit të komunave të qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, mund ta bëjnë personat juridik në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

(5) Shfrytëzuesi është i detyruar që ta shfrytëzojë dhe ta mirëmbajë sistemin vendor të furnizimit me ujë, në mënyrë që nuk do të sjell zvogëlimin e kualitetit të ujit për pije dhe do të mundësohet që uji në sasi të mjaftueshme, si dhe në mënyrë që humbja e ujit të sillet në minimum.

## **Neni 186**

### **Dezinfektimi dhe pastrimi i ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut**

(1) Për shkak të arritjes së standardeve dhe vlerave kualitative nga neni 183 të këtij ligji, personat juridik që bëjnë furnizim me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut janë të detyruar që të bëjnë dezinfektimin e ujit.

(2) Çdo ndryshim i kualitetit i shkaktuar nga nus-produktet të dezinfektimit doemos duhet të jetë në nivelin më të ulët pa ndikuar paraprakisht mbi efikasitetin e dezinfektimit dhe të mos ketë pasoja ndaj shëndetit të njeriut.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetit e përcakton pajisjen dhe kuadrin profesional të personave juridik dhe fizik nga paragrafi (1) të këtij neni, intensitetin dhe metodologjinë për kryerjen e dezinfektimit të ujit.

## **Neni 187**

### **Shmangia nga vlerat dhe standardet për kualitetin dhe masat për sanim**

(1) Në rast të shmangies nga vlerat dhe standardet për kualitetin e përcaktuar në pajtim me nenin 183 të këtij ligji, personat juridik që bëjnë furnizim publik me ujë dhe organet kompetente për mbrojtje shëndetësore i hulumtojnë dhe i identifikojnë shkaqet që e kanë shkaktuar shmangien.

(2) Kryetari i komunave, të komunave të qytetit të Shkupit, dhe Qytetit të Shkupit, në bashkëpunim me personin juridik që bën furnizim publik me ujë janë të detyruar në rast të shmangieve nga paragrafi (1) të këtij neni, që menjëherë dhe pa shtyrje t'i ndërmarrin masat e duhura për sanim, si dhe të caktojnë kufizime dhe ndalesa të shfrytëzimit të ujit sipas nevojës, me qëllim që sërish të sigurohet uji i sigurt, si dhe ta informojnë organin kompetent për sigurinë e ushqimit.

(3) Prioritetet në realizimin e masave të duhura nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohen varësisht nga shkalla e tejkalimit të vlerave dhe standardeve për kualitet, si dhe varësisht nga rreziku ndaj shëndetit të njerëzve.

(4) Masat nga paragrafi (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni janë adekuate dhe të kufizuara në aspektin kohor me nevojën e zbatimit të tyre, duke pasur parasysh:

- 1) rreziqet ndaj shëndetit të njeriut që do të kishin qenë me ndërprerjen e furnizimit të ujit dhe
- 2) numrin dhe nevojat e shfrytëzuesve të fundit të secilit sistem furnizues me ujë veç e veç.

(5) Në rastet kur masat për sanim kanë ndikim ndaj banorëve, kryetari i komunave, të komunave të qytetit të Shkupit, i Qytetit të Shkupit, janë të detyruar që menjëherë t'i informojnë qytetarët e prekur për masat e ndërmarra dhe për masat që do të ndërmerren si dhe për kohëzgjatjen e tyre, dhe të jep këshilla dhe rekomandime adekuate për aktivitetet që duhet të ndërmerren me qëllim që të mbrohet shëndeti i tyre.

(6) Kryetari i komunave, të komunave të qytetit të Shkupit, i Qytetit të Shkupit janë të detyruar, në rastet kur masat nga paragrafi (2) të këtij neni zgjasin më shumë se 14 ditë, menjëherë duhet ta informojnë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë për kufizimin, shkaqet e kufizimit, masat e ndërmarra dhe kohëzgjatjen e tyre të paraparë.

(7) Në rast kur shmangiet nga vlerat dhe standardet për kualitet janë si rezultat i sistemit vendor të furnizimit me ujë ose të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së tij, masat nga paragrafi (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni i ndërmerr pronari i sistemit vendor të furnizimit me ujë nën mbikëqyrjen dhe udhëzimin e organit kompetent.

(8) Paragrafi (7) i këtij neni nuk zbatohet në rast kur furnizohen me ujë lokalet publike, respektivisht entet parashkollore, shkollore dhe shëndetësore, restorantet dhe objektet për prodhimin e produkteve shëndetësore. Në këtë rast masat nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni merren në bashkëpunim me pronarin e lokaleve respektivisht objekteve.

(9) Shpenzimet për hulumtimin dhe identifikimin e shkaqeve si dhe shpenzimet për marrjen e masave nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni në rastet nga paragrafi (7) dhe paragrafi (8) janë në barrë të pronarit të sistemit vendor për furnizim me ujë respektivisht pronarit të lokaleve ose objekteve.

(10) Masat nga paragrafi (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni janë:

- 1) masat për zvogëlimin ose mënjanimin e rrezikut nga mosharmonizimi me vlerat e parametrave ose për mënjanimin e rrezikut të mosharmonizimit;
- 2) masat tjera veçanërisht metodat adekuate për trajtim që të ndryshojë natyra ose cilësia e ujit para se të lëshohet, në atë mënyrë me të cilën mënjanohet rreziku që uji të mos jetë në pajtim me vlerat e parametrave pas lëshimit dhe
- 3) informimi në mënyrë adekuate dhe në kohë i shpenzuesve të prekur për të gjitha masat e mundshme plotësuese për sanim që duhet të ndërmerren.

## Neni 188

### Kufizimi për shkak të mungesës së ujit

(1) Në rastin kur për shkak të mungesës së ujit nuk mund të përmbushen nevoja e të gjithë shfrytëzuesve, personi juridik i cili bën furnizimin publik me ujë, mund që shfrytëzuesve të veçantë përkohësisht t'ua kufizojë shfrytëzimin, vetëm pas njoftimit paraprak të shfrytëzuesve dhe Kryetarit të komunave, të komunave të qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit për kufizimin dhe kohëzgjatjen e saj të paraparë, ndërrimin e furnizimit, dhe masat që do të merren, në afat prej 24 orëve para se të fillojë kufizimi.

(2) Nëse me kufizimin përfshihen nevojat e banorëve nga uji i dedikuar

për konsumim nga ana e njeriut, personi juridik i cili bën furnizim publik me ujë është i detyruar të vendos dhe t'i njoftojë banorët e prekur për furnizim plotësues me ujë adekuat.

(3) Kufizimi nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të jetë adekuat me numrin dhe nevojat e shfrytëzuesve të fundit të secilit sistem për furnizim publik me ujë veç e veç dhe të mos zgjasë më gjatë se sa është e duhur.

(4) Kryetari i komunave, të komunave të qytetit të Shkupit, dhe Qytetit të Shkupit janë të detyruar, në rastet kur kufizimet nga paragrafi (1) të këtij neni zgjasin më shumë se 14 ditë, menjëherë duhet ta informojnë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë për kufizimin, shkaqet e kufizimit, masat e ndërmarra dhe kohëzgjatjen e saj të paraparë.

## **Neni 189**

### **Keqpërdorimi dhe shfrytëzimi jo adekuat i ujërave**

(1) Secili është i detyruar që ta shfrytëzojë ujin me kujdes dhe në mënyrë racionale vetëm për dedikimin për të cilin është paraparë.

(2) Shfrytëzuesi i ujit është i detyrueshëm që t'i paguajë shpenzimet e bëra, nëse me qëllim ose nga pakujdesi, shkakton dëmtime ose mosfunksionimin e sistemit për të cilin duhet të bëhet riparimi ose me atë shkakton ndotje ose shfrytëzim jo adekuat të ujit.

(3) Materiet, substancat ose materialet në instalimet e reja për përgatitje dhe distribuimin e ujit për pije, nuk guxojnë të jenë prezent në koncentrim më të larta nga ato të nevojshme për dedikimin e tyre ose në koncentrim me të cilat do të shkaktonte zvogëlimin e mbrojtjes së shëndetit në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.

(4) Personi juridik i cili bën furnizimin publik me ujë është i detyruar që humbjet e sistemit të furnizimit të ujit t'i zbret në minimum, si dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për atë.

## **Neni 190**

### **Informimi i popullatës**

(1) Të gjitha informatat dhe të dhënat për kualitetin e ujit për pije janë në qasje për popullatën në pajtim me ligjin.

(2) Për shkak të informimit të popullatës, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë çdo tre vjet përgatit dhe jep raport për ujin e dedikuar për konsumim nga ana e njeriut për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Raporti nga paragrafi (2) i këtij neni veçanërisht përmban informata për realizimin e obligimeve të këtij kapitulli, masat e ndërmarra, për vlerat dhe standardet e përcaktuara, për kualitetin, për shmangiet nga vlerat dhe standardet, për kualitetin e përcaktuar, programet për monitorim dhe rezultatet e monitorimit për sigurinë e ujit të dedikuar, për konsumim nga ana e njeriut, si dhe të dhënat për të gjitha personat juridik dhe fizik që bëjnë furnizimin me ujë të më shumë se 5.000 banorëve ose furnizojnë më shumë se 1.000 metër kub ujë në ditë.

(4) Raporti për informim nga paragrafi (3) i këtij neni ka të bëjë për tre vitet kalendarike dhe jepet në afat prej një viti kalendarik prej fundit të periudhës së kaluar dhe fillimit të vitit të ardhshëm.

## **3. Ujitja dhe kullimi**

### **Neni 191**

## **Ekonomitë e ujërave**

(1) Përfshirja dhe shfrytëzimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor për nevojat e ujitjes si dhe kullimit bëhet me hidrosisteme, ose sistemeve për ujitje dhe kullim.

(2) Për shkak të shfrytëzimit, eksploatimit dhe mirëmbajtjes së hidrosistemeve ose sistemeve për ujitje dhe kullim themelohen ekonomi të ujërave në pajtim me ligjin.

(3) Për punët lidhur me aktivitetet dhe veprimtaritë e ekonomisë së ujërave, të këtij neni, është kompetent organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në sferën e bujqësisë.

### **Neni 192**

#### **Bashkësitë e ujërave**

(1) Për shkak të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, ndërtimit, rikonstruimit dhe zgjerimit të ndërtimit të sistemeve të vogla për ujitje dhe/ose ujitjes dhe rrjetit segmentues dhe shpërndarës të sistemit për ujitje dhe/ose kullimit (infrastruktura për ujitje dhe/ose kullim) pronarët dhe shfrytëzuesit e tokës bujqësore dhe tokës tjetër mund të themelojnë bashkësi ujore, në pajtim me ligjin.

(2) Për punët lidhur me aktivitetet dhe veprimtaritë e bashkësive ujore të këtij neni kompetent është organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në sferën e bujqësisë.

### **Neni 193**

#### **Ndalesa për ujitje dhe dhënie ujë kafshëve**

(1) Për shkak të mbrojtjes së njerëzve dhe kafshëve, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e drejtorisë shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë, dhe ministrin i cili udhëheq me organin e drejtorisë shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë e ndalon shfrytëzimin ose përdorimin e ujërave për ujitje dhe për dhënien ujë kafshëve, në rast të keqësimit të kualitetit të ujit në masë që e bën ujin të papërdorshëm për atë dedikim.

(2) Ndalesa nga paragrafi (1) i këtij neni zgjat deri sa të jetë kualiteti i ujit në kategorinë që nuk është i përshtatshëm për ujitje dhe dhënie ujë kafshëve.

## **4. Digat dhe akumulimet**

### **Neni 194**

#### **Digat**

(1) Diga, në kuptim të këtij ligji, është objekti hidroteknik me të cilin mbahet uji me qëllim që të krijohet akumulim i përhershëm ose i përkohshëm i ujit ose materieve tjera në gjendje të lëngët, lartësia minimale e të cilit është 5 metra duke matur midis këmbëzës në ujë dhe kurorës, ose e cila në hapësirë deri te kurora e pakalueshme mund të akumulojë më shumë se 100.000m<sup>3</sup> ujë.

(2) Diga e madhe është objekti hidroteknik, në pajtim me paragrafin (1) i këtij neni, lartësia e të cilës është më e vogël se 15 metra. Në grupin e digave të mëdha bien edhe digat, lartësia e të cilave është më së paku 10 m, dhe plotësojnë së paku një nga kushtet si vijon:

1) gjatësia e kurorës së digës të jetë më e madhe se 500 m;



- 2) vëllimi i akumulimit të jetë më i madh se 1.000.000 m<sup>3</sup> dhe
- 3) rrjedha maksimale e kalimit të jetë më e madhe se 2.000 m<sup>3</sup>/s.

(3) Secila digë nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni është digë me rëndësi të veçantë për Republikën e Maqedonisë.

(4) Diga e vogël, duke përfshirë edhe mikroakumulimet, është objekt hidroteknik, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni që nuk bie në grupin e digave të mëdha sipas paragrafit (2) të këtij neni.

## **Neni 195**

### **Dispozitat teknike**

(1) Për shkak të ofrimit të sigurisë konstruktive, ekonomike dhe funksionale, digat dhe objektet shoqëruese projektohen, ndërtohen, eksploatohen (përdoren dhe mirëmbahen) dhe menaxhohen në mënyrë të përcaktuar në dokumentacionin teknik për diga të vogla dhe të mëdha të përpiluar në pajtim me ligjin, dispozitën me të cilën rregullohen masat e duhura për mbikëqyrje teknike të digave dhe objekteve dhe akumulimeve shoqëruese të cilën e sjell ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes, mund t'i përcaktojë digat e vogla nga neni 194 paragrafi (3) të këtij ligji si diga me rëndësi të veçantë dhe t'i klasifikojë si diga të mëdha, me propozim të Komisionit për diga nga neni 197 të këtij ligji.

(3) Për digat ekzistuese të mëdha dhe ato të planifikuara, bëhet studim dhe analizë detale në bazë të standardeve bashkëkohore për stabilitetin statik, rrezikun nga ujërat e mëdha dhe tërmetet, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton zonat mbrojtëse në vendet rreth digës respektivisht akumulimin me propozim të shfrytëzuesit të digës me sipërfaqen akumuluese.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë mund që për digat ekzistuese ose digat që janë gjatë ndërtimit të propozojë masa sanimi ose masa për kthimin në gjendjen e mëparshme, të domosdoshme për arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor në pajtim me nenin 90 të këtij ligji.

## **Neni 196**

### **Digat me rëndësi të veçanta**

(1) Digat që gjenden mbi vendbanime, auto rrugë ose objekte tjera ekonomike ose të mira tjera me interes të përgjithshme janë në kontroll të veçantë dhe jenë të rëndësishme për mbrojtjen.

(2) Digat nga paragrafi (1) të këtij neni i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve

nga sfera e mbrojtjes në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e transportit dhe lidhjeve.

## **Neni 197**

### **Komisioni për diga**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera mjedisit jetësor formon Komision për diga për çështjet që kanë të bëjnë me projektimin, realizimit dhe menaxhimin e digave dhe akumulimeve.

(2) Komisioni për diga përbëhet prej shtatë anëtarëve nga radhët e punëtorëve shkencorë dhe profesional të dalluar nga sfera e hidroteknikës dhe digave.

(3) Komisioni për diga sjell Rregullore pune për punën e vet.

(4) Anëtarëve të Komisionit për diga ju takon kompensim për punën e tyre në komision.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton lartësinë e kompensimit nga paragrafi (4) të këtij neni varësisht nga vëllimi dhe kompleksiviteti i punëve që i bëjnë.

(6) Mjetet për kompensim dhe shpenzimet e punës së Komisionit për diga sigurohen nga buxheti i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(7) Punët profesionale dhe administrative-teknike të duhura për punën e Komisionit për diga i bën organi i administratës shtetërore kompetente për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 198**

### **Monitorimi i digave**

(1) Personat juridik që menaxhojnë me digat që janë caktuar si diga të rëndësisë së veçantë janë të detyruar të vendosin dhe të organizojnë mbikëqyrje teknike të digave dhe të objekteve shoqëruese dhe akumulimeve, në bazë të projektit për mbikëqyrje teknike (oskultimit) të digës, objekteve shoqëruese dhe akumulimeve, në pajtim me nenin 195 paragrafi 1 të këtij ligji.

(2) Personi juridik i cili menaxhon me digat e rëndësisë së veçantë, objektet shoqëruese dhe akumulimet, në bazë të të dhënave të mbikëqyrjes teknike në pajtim me projektin për mbikëqyrje teknike, është e domosdoshme që së paku një herë në vit të përpilojë elaborat të veçantë për analizën dhe vlerësimin e stabilitetit dhe funksionalitetin e digave me objektet shoqëruese dhe akumulimeve dhe për stabilitetin e terrenit përreth digave, objekteve shoqëruese dhe akumulimeve.

(3) Elaboratet nga paragrafi (2) të këtij neni i dorëzohen organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor më së voni katër muaj pas skadimit të vitit për të cilin kanë të bëjnë, që i lejon në bazë të mendimit paraprak me shkrim nga Komisioni për diga.

(4) Nëse gjatë mbikëqyrjes teknike ose gjatë përpunimit të elaboratit nga paragrafi (2) i këtij neni, zbulohen dhe konstatohen mangësi me të cilat mund të rrezikohet stabiliteti i digës me objektet shoqëruese, personi juridik i cili menaxhon me digën është i detyruar që për atë menjëherë ta

informojë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor si dhe organin kompetent për mbrojtje dhe shpëtim.

## **Neni 199**

### **Alarmi në rast të rrezikut**

(1) Personi juridik i cili menaxhon me digat e rëndësisë së veçantë është i detyruar:

1) që të përpilojë elaborat për analizën e pasojave të propagacioneve të valës vërshuese gjatë rrëzimit eventual ose derdhjes së digës, së cilës detyrimisht duhet t'i bëhet kontrolli dhe vlerësimi (revizioni);

2) që të vendosë dhe t'i mbajë në gjendje të rregullt të gjitha pajisjet për lajmërim dhe alarmim;

3) që të organizojë dhe të sigurojë lajmërimin dhe alarmimin në rast të rrezikut që mund të paraqitet për shkak të rrënimit ose derdhjes së digës dhe

4) që sistemi për lajmërimin, paralajmërimin dhe alarmimin e digës ta lidhë me sistemin për lajmërimin dhe alarmimin e Republikës së Maqedonisë, të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit rajonet e të cilave janë të rrezikuara në rast të rrënimit ose derdhjes së digës.

(2) Personi juridik i cili menaxhon me digat të rëndësisë së veçantë është i detyruar që të dorëzojë kampion nga elaborati nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor dhe Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, së paku 30 ditë para mbushjes së parë të akumulimit.

## **Neni 200**

### **Menaxhimi me digat që nuk janë të rëndësisë së veçantë**

(1) Personat juridik të cilët menaxhojnë me digat që nuk janë përcaktuar si diga të rëndësisë së veçantë janë të detyruar të krijojnë dhe të organizojnë vëzhgim minimal teknik të digave me objektet shoqëruese dhe akumulimeve.

(2) Mënyrën e mbikëqyrjes nga paragrafi (1) të këtij neni duhet të përcaktohet dokumentacioni teknik për ndërtimin e digës në pajtim me dispozitat nga neni 195 të këtij ligji.

## **5. Gropimi i puseve**

### **Neni 201**

#### **Gropimi i pusit**

(1) Gropimi (shpimi) i pusit ose të shpuarit për shkak të thithjes së ujit nga trupi uhor nëntokësor në pajtim me nenin 29 të këtij ligji bëhet vetëm pas njoftimit paraprak të dorëzuar në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, si dhe në organin e komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton mënyrën e lajmërimin, të dhënat që duhet t'i përmbajë lajmërimi, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit për lajmërim nga paragrafi (1) të këtij neni.

## **Neni 202**

## Obligimet e grupuesit të pusit

(1) Grupuesi i pusit është i detyruar që:

- 1) ta bëjë testimin e kapacitetit të pusit të grupuar në pajtim me dispozitën;
- 2) të grumbullojë kampionë të ujit dhe të organizojë testimin e kualitetit të ujit nga kampionët e grumbulluar në laboratorin e akredituar, në pajtim me dispozitat dhe
- 3) të ruajë dhe të sigurojë, të dhëna nga testimi, informatat gjeologjike dhe kampionët, të caktuara nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Në afat prej një muaji nga mbarimi i ndërtimit të pusit, grupuesi i pusit përgatit dhe dorëzon në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, raport në formë dhe në mënyrë të përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

### Neni 203

#### Ndikimi në mes tyre, mbrojtja dhe monitorimi i puseve

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor e përcakton nivelin deri ku mund të thithet uji nëntokësor nga pusi me qëllim:

- 1) që të minimizohet rreziku nga zvogëlimi i nivelit të ujit, që do të kishte mundur ta zvogëlojë kapacitetin e puseve fqinjë;
- 2) që të mbahet baraspesha midis mbushjes dhe thithjes së akuiferit, dhe
- 3) që të mënjanohej efektet negative ndaj ekosistemeve të ujit dhe mjedisit të ujit.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor përcakton zonën mbrojtëse përreth pusit për ujë nëntokësor që shfrytëzohet për qëllime tjera të ndryshme nga ajo për konsumim nga ana e njeriut me qëllim që të mbrohet uji nëntokësor nga ndotja.

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mund të urdhërojë studimin dhe monitorimin për shkak grumbullimit të të dhënave dhe informatave tjera për disponimin e ujërave nëntokësore shkallët e ruajtjes së thithjes së ujërave, shpërndarjet në hapësirë të puseve, testet për thithje, hartografimi gjeologjik dhe punët tjera të domosdoshme për shfrytëzimin e drejtë të ujërave nëntokësor.

## IX. GJENDJA E JASHTËZAKONSHME DHE SHMANGIET

### Neni 204

#### Gjendja e jashtëzakonshme dhe shmangiet

(1) Aty ku monitorimi ose të dhënat tjera tregojnë se dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me masat ose me ndryshimet në kualitetin e ujërave, nuk janë në pajtim ose nuk mund të arrihen, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shëndetësisë, menjëherë dhe pa shtyrje doemos duhet:

- 1) që t'i studiojë dhe identifikojë shkaqet për shmangien;
- 2) që në rast të rrezikut ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut, ta informojë popullatën e prekur për atë, dhe t'i sigurojë popullatës të gjitha informatat

relevante për mënyrën në të cilën mund të zbuten pasojat, si dhe rekomandimet ose masat tjera të vëmendjes;

3) që të ndërmerr masa për zvogëlimin dhe mënjanimin e rrezikut dhe shkakun e shmangieve;

4) që të ndërmerr masa preventive adekuate dhe masa për kthim në gjendje paraprake, për shkak të kontrollit të gjendjes dhe informimit të popullatës dhe

5) që të iniciojë aktivitete për kthimin në gjendje të mëparshme të kualitetit të mjedisit jetësor;

(2) Përveç masave dhe aktiviteteve nga paragrafi (1) të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, do të sigurojë:

1) studimin adekuat dhe revizionin e lejeve relevante dhe pëlqimeve

2) revizionin dhe adoptimin e programeve për monitorim dhe

3) masat adekuate për pengimin e keqësimit të mëtejshëm të gjendjes, duke përfshirë nëse është e nevojshme edhe kriteret më rigorozë për kualitetin e mjedisit jetësor.

(3) Kur shkaqet për shmangien janë si rezultat i forcës madhore veçanërisht vërshimeve ekstreme ose thatësirave të vazhdueshme, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, mund të përcaktojë se kriteret më rigorozë për kualitetin nuk do të zbatohen.

(4) Kur nga gjendja e jashtëzakonshme dhe shmangiet, preken interesat e ndonjë shtetit fqinj, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, ngrit procedurë për dorëzimin e të gjitha informatave relevante në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni në shtetin e prekur fqinj.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të Qendrës për menaxhim me kriza, në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, i përcakton masat, aktivitetet, mënyrën e mbikëqyrjes dhe mënyrën e paralajmërimit të më hershëm, planet në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe mënyrën e informimit të popullatës dhe shtetit fqinje.

## X. BAZA MATERIALE DHE FINANCIMI I MENAXHIMIT DHE ZHVILLIMIT TË UJËRAVE

### Neni 205

#### Dispozita e përgjithshme

(1) Në pajtim me parimin shfrytëzuesi paguan, nëpërmjet të çmimit të ujit do të mundësohet që shfrytëzuesit e ujit ta shfrytëzojnë ujin në mënyrë efikase për shkak kontributit të realizimit të qëllimeve të mjedisit jetësor në mënyrë që shfrytëzuesit e ndryshëm të ujit do të paguajnë kompensim adekuat.

(2) Realizimi i qëllimeve nga paragrafi (1) i këtij neni themelohet në bazë të analizës ekonomike nga neni 71 të këtij ligji, duke pasur parasysh efektet sociale, ekonomike dhe efektet ndaj mjedisit jetësor, nga vendosja e serishme e gjendjes, si dhe kushtet gjeografike dhe klimatike të rajonit.

(3) Raporti për planifikim dhe realizimi i aktiviteteve për shkak të zbatimit të këtij neni janë pjesë e planit për menaxhim me pellgun lumor.

(4) Nëse është e duhur arritja e qëllimeve të përcaktuara me këtë ligj, mund me akt të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë respektivisht me akt të Këshillit të komunave, këshillit të komunave të qytetit të Shkupit dhe këshillit të Qytetit të Shkupit të financohet marrja e masave të veçanta dhe plotësuese preventive, në suazat e kompetencave të përcaktuara me ligj.

## Neni 206

### Burimet e mjeteve financiare

Mjete financiare për menaxhim dhe zhvillim të ujërave sigurohen nga:

- 1) kompensimi për shfrytëzimin e ujit;
- 2) kompensimi për lëshimin e ujërave;
- 3) kompensimi për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit;
- 4) qiraja nga toka në pronë të shtetit të dhënë me qira, e që në kadastrën e patundshmërive është shënuar "nën ujëra";
- 5) Buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- 6) buxheti i komunave, komunave të qytetit të Shkupit, Qytetit të Shkupit dhe
- 7) burime tjera financiare në pajtim me ligjin.

## Neni 207

### Kompensimi për shfrytëzimin dhe lëshimin e ujërave dhe nxjerrjes së rërës, zhavorrit dhe gurit

(1) Obliguesit për pagimin e kompensimit për shfrytëzimin e ujit janë personat juridik dhe fizik të cilët në bazë të lejes për shfrytëzimin e ujërave të dhënë në pajtim me këtë ligj:

1) zënë, thithin, dërgojnë, akumulojnë, depozitojnë ose në mënyrë tjetër shfrytëzojnë ujë nga trupat uJOR sipërfaqësor natyrorë dhe artificialë për shkak:

- të furnizimit me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut nëpërmjet sistemit publik për furnizim me ujë, për prodhimtari dhe përpunimin e ushqimit, për nevojat e mbrojtjes dhe për dhënien ujë kafshëve,
- ujitjes së tokës bujqësore,
- nevojave të industrisë dhe teknologjisë (ekonomisë),
- prodhimit të energjisë elektrike dhe nevojave tjera për punë,
- ambalazhim të ujit për nevojat komerciale,
- shfrytëzimit të energjisë së ngrohjes nga ujërat gjeotermik,
- ruajtjes së peshqve dhe zogjve të ujit,
- ujitjes së tokës,
- ruajtjes së rrjedhave të ujit me përdorimin e materieve dhe substancave kimike,
- larjes dhe separimit të rërës, zhavorrit dhe gurit dhe
- aktivitete tjera për të cilat organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor do të vlerësojë se ndikojnë ndaj regjimit të ujërave dhe/ose morfologjisë së trupit uJOR dhe

2) zënë, thithin, dërgojnë, akumulojnë, depozitojnë ose në mënyrë tjetër shfrytëzojnë ujë nga trupi uJOR nëntokësor për shkak:

- të furnizimit me ujë të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut nëpërmjet sistemit publik për furnizim me ujë, për prodhimtari dhe përpunimin e ushqimit, për nevojat e mbrojtjes dhe për dhënien ujë kafshëve,
- ujitjes së tokës bujqësore,
- nevojave të industrisë dhe teknologjisë (ekonomisë),
- ambalazhim të ujit për nevojat komerciale,
- absorbimit të energjisë së ngrohtë nga ujërat gjeotermik,
- studimit hidrologjik dhe grumbullimit të të dhënave dhe
- aktiviteteve tjera për të cilat organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor do të vlerësojë se ndikojnë ndaj regjimit të ujërave dhe/ose morfologjisë së trupit uJOR.

(2) Obliguesit për pagesën e kompensimit për lëshimin e ujit janë personat fizik dhe juridik të cilët në bazë të:

- 1) lejes për lëshimin e ujërave të zeza të dhënë në pajtim me këtë ligj lëshojnë ujëra të zeza në ujëra sipërfaqësor dhe/ose në trupa uJOR dhe
- 2) lejes për lëshimin ose hedhjen lëshojnë ose hedhin, në pajtim me këtë ligj, materie dhe substanca në ujëra sipërfaqësor dhe/ose nëntokësor, në

trupa uJOR.

(3) Obliguesit për pagesë të kompensimit për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit janë personat juridik dhe fizik që në bazë të lejes në pajtim me këtë ligj nxjerrin rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati dhe brigjet e trupave uJOR sipërfaqësor dhe nga sipërfaqe tjera që në kadastër janë regjistruar "nën ujëra".

## Neni 208

### Rastet në të cilat nuk paguhet kompensimi

(1) Kompensimi për shfrytëzimin e ujit nuk paguhet në rastet kur uji shfrytëzohet për:

- 1) pastrimin dhe mbushjen artificiale të ujërave nëntokësor dhe
- 2) mbrojtjen e natyrës dhe rajonit.

(2) Kompensimi për nxjerrje, rërë, zhavorr dhe gurë nuk paguhet nëse rëra e nxjerrë, zhavorri dhe guri përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve mbrojtëse të ekonomisë së ujërave dhe objekteve nga sfera e mbrojtjes.

## Neni 209

### Obligimi për pagimin e kompensimit

(1) Obligimi për pagimin e kompensimit për obliguesit nga neni 207 paragrafi (1) dhe (3) të këtij ligji fillon ditën kur leja fillon të prodhojë veprim juridik në pajtim me dispozitat nga neni 41 paragrafi (3) dhe (4) të këtij ligji.

(2) Obligimi për pagimin e kompensimit për obliguesit nga neni 207 paragrafi (2) i këtij ligji, fillon ditën kur leja për lëshim fillon të prodhojë veprim juridik në pajtim me dispozitat nga neni 82 paragrafi (1) i këtij ligji.

(3) Bartësi i lejes nga neni 207 paragrafi (1) i këtij ligji, që siguron kushte për furnizim me ujë personave të tretë, mjetet për pagimin e kompensimit për shfrytëzimin e ujit i siguron nëpërmjet pagesës së shërbimit nga shfrytëzuesit e fundit të ujit.

(4) Bartësi i lejes nga neni 207 paragrafi (2) i këtij ligji, që siguron kushte për dërgimin dhe pastrimin e ujit personave të tretë, mjetet për pagimin e kompensimit i siguron nëpërmjet pagesës së shërbimit nga shfrytëzuesit e shërbimit.

(5) Obligimet nga marrëveshja për furnizim me ujë dhe/ose marrëveshja për sigurim të shërbimeve për dërgimin dhe pastrimin e ujit midis bartësit të lejes nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni dhe shfrytëzuesve të fundit si dhe marrëdhëniet midis tyre nuk prodhojnë obligime juridike për dhënësin e lejes në drejtim të kushteve, afateve, dhe mënyrës së pagesës dhe lartësisë së kompensimit për shfrytëzimin e ujit të përcaktuar në leje.

## Neni 210

### Kompensimi i përgjithshëm

(1) Kompensimi i përgjithshëm për shfrytëzuesit e fundit të ujit e përbëjnë çmimin e shërbimit për shfrytëzim të nenit 211 paragrafi (1) të këtij ligji dhe kompensimi për shfrytëzimin e ujit nga neni 207 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Kompensimi i përgjithshëm për shfrytëzuesit për dërgimin dhe pastrimin e ujit e përbëjnë çmimin e shërbimit për dërgimin dhe pastrimin e ujit të nenit 211 paragrafi (2) të këtij ligji dhe kompensimi për lëshimin në ujërave nga neni 207 paragrafi (2) të këtij ligji.

## Neni 211

### Çmimi i shërbimit

(1) Çmimin e shërbimit për shfrytëzuesit e fundit të ujit e përbëjnë shpenzimet e shërbimit për furnizim, shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shpenzimet për resursin, në pajtim me parimin shfrytëzuesi paguan.

(2) Çmimin e shërbimit për shfrytëzuesit e fundit të ujit e për dërgimin dhe pastrimin e ujit e përbëjnë shpenzimet e shërbimit për dërgim dhe pastrim të ujit, shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga lëshimi në ujëra dhe shpenzimet për recipientin, në pajtim me parimin ndotësi paguan.

(3) Çmimi i shërbimit nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të këtij neni i përfshin të gjitha shpenzimet eksploatuese, shpenzimet për mirëmbajtje, shpenzimet për zëvendësimin e pjesëve amortizuese dhe dëmtimeve tjera, investimet kapitale, kamata për pagesën e investimeve kapitale dhe huaja, garancitë dhe shpenzimet tjera.

## Neni 212

### Dedikimi i mjeteve të kompensimit

(1) Mjetet e kompensimeve nga neni 207 i këtij ligji shfrytëzohen për menaxhimin dhe zhvillimin e resurseve të ujit dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e organeve të administratës shtetërore, organeve dhe organizatave që në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër që kanë kompetenca adekuate në menaxhimin e ujërave, respektivisht kryerjen e aktiviteteve të veçanta në lidhje me ujërat.

(2) Mjetet e kompensimit që paguhen në pajtim me nenin 207 paragrafi (1) pika 1 alinetë, 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, dhe 10 dhe pika 2 alinetë 1,2 dhe 3 të këtij ligji, shfrytëzohen për:

- 1) ndërtimin e objekteve të reja dhe mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese publike të furnizimit me ujë;
- 2) ndërtimin e objekteve të reja dhe mirëmbajtjen dhe zhvillimin e hidrosistemeve dhe sistemeve hidromelorative;
- 3) mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e liqeneve artificiale;
- 4) mirëmbajtjen e rrjedhave të ujit, ndërtimin, mirëmbajtjen e objekteve për rregullimin e rrjedhave të ujit dhe mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave (erozionit dhe rrëkeve) jashtë vendbanimeve dhe
- 5) përgatitjen e planeve për mbrojtje nga vërshimet dhe ngrirja, planeve për mbrojtje nga erozioni dhe rrëketë si dhe për përgatitjen e planeve adekuate për mbrojtje nga veprimet tjera të dëmshme të ujërave jashtë vendbanimeve.

(3) Mjetet e kompensimit që paguhet në pajtim me nenin 207 paragrafi (1) nga pika 1 alinetë, 5,9 dhe 11 dhe pika 2 alinetë 4,5,6 dhe 7 të këtij ligji, shfrytëzohen për:

- 1) kontrollin e gjendjes dhe grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave për rezervat e ujit dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë racionale dhe
- 2) studime hidrologjike dhe studimeve tjera.

(4) Mjetet e kompensimit që paguhet në pajtim me neni 207 paragrafi (2) i këtij ligji shfrytëzohen për:

- 1) përgatitjen dhe organizimin e zbatimit të programit të masave për mbrojtjen e ujërave nga ndotja;
- 2) monitorimin dhe përcaktimin e gjendjes me kuantitetin dhe kualitetin e ujërave dhe monitorimin e sigurisë së ujit për konsumim nga ana e njeriut dhe
- 3) vendosjen dhe mirëmbajtjen e zonave mbrojtëse të këtij ligji dhe ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja.



(5) Mjetet e kompensimit që paguhen në pajtim me neni 207 paragrafi (3) të këtij ligji shfrytëzohen për mirëmbajtjen dhe rindërtimin e rrjedhave të ujit, mirëmbajtjen e objekteve për rregullimin e rrjedhave të ujit dhe mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave (erozionit dhe rrëkeve).

(6) Nga mjetet e përgjithshme nga kompensimet e nenit 207 të këtij ligji 5% shfrytëzohen për:

1) realizimin e zgjidhjeve teknike dhe ekonomike për shfrytëzimin racional të ujërave, për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe për mbrojtjen nga ndikimi i dëmshëm i ujërave që mbeten në Bazën e ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë dhe planet për menaxhim me rrjedhat e lumenjve;

2) përpunimin e Strategjisë nacionale për ujëra, Bazën e ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë dhe planet për menaxhim me rrjedhat e lumenjve;

3) mbulimin e shpenzimeve për punë të Këshillit nacional për ujëra, Këshillit për menaxhim me rrjedhat e lumenjve, këshillit për menaxhim me një pjesë nga rrjedha e lumenjve, si dhe komisionet dhe trupat tjerë të themeluara me këtë ligj;

4) përpunimin e studimeve dhe punëve shkencore-hulumtuese në sferën e menaxhimit me ujëra;

5) vendosjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit shtetëror për monitorimin e ujërave;

6) pjesëmarrjen në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të ekonomisë së ujërave;

7) promovimin e teknikave dhe metodave për kursimin e ujit;

8) pjesëmarrjen në realizimin e obligimeve nga marrëveshjet ndërshtetërore dhe konventave në lëmin e ujërave dhe mbrojtjes së ujërave dhe ekosistemet e ujërave;

9) kualifikimin e kuadrove nga lëmi i menaxhimit me ujërat;

10) dedikime të tjera me qëllim të implementimit të Strategjisë nacionale për ujëra, Bazës së ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë dhe planeve për menaxhim për rrjedhat e lumenjve.

(7) Mjetet nga paragrafi (6) të këtij neni shfrytëzohen sipas Programit për menaxhim me ujërat nga neni 218 i këtij ligj.

## Neni 213

### Përcaktimi i lartësisë së kompensimit për shfrytëzimin e ujit

(1) Lartësia e kompozimit për shfrytëzimin e ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut, për nevojat e mbrojtjes, dhe për dhënien ujë kafshëve është 2% nga çmim i përcaktuar për metër kub ujë nga dhënësi i shërbimit për furnizim me ujë;

(2) Obligues për pagim të kompensimit nga paragrafi (1) të këtij neni është secili person juridik ose fizik i cili shfrytëzon ujë nga sistemi për furnizim me ujë.

(3) Kompensimin nga paragrafi (1) i këtij neni e llogarit personi juridik i cili menaxhon me sistemin e furnizimit me ujë, dhe e paguan gjatë pagimit të çmimit për shërbimin e bërë për furnizim me ujë dhe e tregon ndaras në llogarinë për shërbimin e bërë.

(4) Personi juridik nga paragrafi (3) i këtij neni është i detyruar që një herë në muaj ta arkëtojë kompensimin për pagesë nga paragrafi (1) të këtij neni në llogari të veçantë arkëtimin në llogari të trezorit.

(5) Lartësia e kompozimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit për ujitje është 2% nga çmimi i përcaktuar për metër kub ujë dhënësit të shërbimit për furnizim me ujë.

(6) Obligues për pagimin dhe llogaritjen e kompensimit nga paragrafi (5) të këtij neni është secili person juridik ose fizik i cili shfrytëzon ujë nga

hidrosistemi dhe/ose sistemi për ujitje.

(7) Kompensimin nga paragrafi (5) të këtij neni e llogarit personi juridik i cili menaxhon me hidrosistemin ose sistemin për ujitje, dhe e paguan gjatë pagimit të çmimit për shërbimin e bërë për furnizim me ujë dhe e tregon ndaras në llogarinë për shërbimin e bërë.

(8) Personi juridik nga paragrafi (7) i këtij neni është i detyruar që një herë në muaj që ta arkëtojë kompensimin për pagesë nga paragrafi (5) të këtij neni në llogari të veçantë arkëtimin në llogari të trezorit.

(9) Lartësia e kompozimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit për shterje të tokës është 1% nga çmimi i përcaktuar për tokë hektar që shteret nga çmimi i dhënësit të shërbimit.

(10) Obligues për pagimin dhe llogaritjen e kompensimit nga paragrafi (9) të këtij neni është secili person juridik ose fizik toka e të cilit shteret me sistem për ujitje.

(11) Kompensimin nga paragrafi (9) të këtij neni e llogarit personi juridik i cili menaxhon me sistemin e shterjes dhe e paguan gjatë pagimit të çmimit për shërbimin e bërë për shterje dhe e tregon ndaras në llogarinë për shërbimin e bërë.

(12) Personi juridik nga paragrafi (11) i këtij neni është i detyruar që një herë në muaj ta arkëtojë kompensimin për pagesë nga paragrafi (9) të këtij neni në llogarinë e veçantë arkëtimi në llogari të trezorit.

(13) Lartësia e kompensimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit gjatë prodhimit të energjisë elektrike është:

- 1% nga çmimi i prodhimit të një kilovati orë në prag të elektranës te centralet hidroelektrike dhe
- 0,5% nga çmimi i prodhimit të një kilovat orë në pragun e elektranës te centralet termoelektrike.

(14) Obligues për pagim dhe llogaritje të kompensimit nga paragrafi (13) të këtij neni është personi juridik i cili prodhon energji elektrike.

(15) Obliguesi nga paragrafi (14) i këtij neni është i detyruar që një herë në muaj ta arkëtojë kompensimin për pagesë nga paragrafi (13) të këtij neni në llogarinë e veçantë arkëtimi në llogari të trezorit.

(16) Lartësia e kompensimit që paguhet gjatë ambalazhimit të ujit për nevoja komerciale është 0,5% nga çmimi i përcaktuar shitës i produktit.

(17) Obligues për pagim dhe llogaritje të kompensimit nga paragrafi (16) të këtij neni është personi juridik i cili mbush dhe ambalazhon ujë për nevoja komerciale.

(18) Obliguesi nga paragrafi (17) i këtij neni është i detyruar që ta arkëtojë kompensimin nga paragrafi (16) të këtij neni më së voni 30 ditë nga dita e faturimit të ujit gjatë lëshimit në qarkullim dhe e tregon ndaras në faturën ndërsa e arkëton në llogari të veçantë arkëtimi në llogari të trezorit një herë në muaj.

(19) Lartësia e kompensimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit për energjinë e ngrohjes nga ujërat gjeotermik, është shtatë denarë për metër kub ujë të shfrytëzuar.

(20) Obligues për pagim dhe llogaritje të kompensimit nga paragrafi (19) i këtij neni është personi juridik ose fizik bartës i lejes për shfrytëzimin e ujërave gjeotermik.

(21) Obliguesi nga paragrafi (20) i këtij neni është i detyruar që ta arkëtojë kompensimin nga paragrafi (19) të këtij neni më së voni 30 ditë nga dita e shfrytëzimit të ujit gjeotermik, ndërsa e arkëton në llogari të veçantë arkëtimi në llogari të trezorit një herë në muaj.

(22) Me përjashtim nga paragrafi (21) të këtij neni kompensimin nga paragrafi (19) të këtij neni obliguesi nga paragrafi (20) i këtij neni e paguan në lartësi prej 30% nga lartësia e përcaktuar nga paragrafi (19) i këtij neni nëse ka sistem me të cilin sigurohet kthimi i ujit gjeotermik të shfrytëzuar në trupin ujqor prej ku thithet.

(23) Lartësia e kompensimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit për ruajtjen e peshqve, në basene peshqish dhe në kafaze dhe zogj uji, është 3% për kilogram nga çmimi shitës i peshkut, respektivisht zogut gjatë lëshimit në qarkullim.

(24) Obligues për pagimin e llogarisë së kompensimit nga paragrafi (23) të këtij neni është personi juridik ose fizik i cili menaxhon me peshq dhe/ose kafaz dhe/ose ruajtjen e zogjve të ujit, dhe e tregon kompensimin ndaras në faturë ose llogari për shitjen e peshkut, respektivisht zogut gjatë lëshimit në qarkullim.

(25) Obliguesi nga paragrafi (24) i këtij neni është i detyruar që ta arkëtojë kompensimin nga paragrafi (23) të këtij neni më së voni 30 ditë nga dita e faturimit respektivisht dhënies së llogarisë, ndërsa e arkëton në llogari të veçantë arkëtimin në suazat e llogarisë së trezorit një herë në muaj.

(26) Lartësia e kompensimit që paguhet për shfrytëzim të ujit për larje dhe separacion të rërës, zhavorrit dhe gurit është 2% nga çmimi për një metër në kub të materialit të separuar.

(27) Detyrues për pagese dhe përlllogaritje të kompensimit nga paragrafi (26) i këtij neni është personi juridik dhe fizik i cili kryen veprimtari larje dhe separacion të rërës, zhavorrit dhe gurit dhe e paraqet kompensimin veçmas në faturë ose llogarinë për shitjen e materialit.

(28) Detyrësi nga paragrafi (27) i këtij neni, e ka për detyrë që ta paguajë kompensimin nga paragrafi (26) i këtij neni më së voni 30 ditë nga dita e faturimit, përkatësisht lëshimit të llogarisë, ndërsa e paguan në llogari të veçantë pagesore në kuadër të llogarisë së thesarit, njëherë në muaj.

(29) Lartësia e kompensimit që paguhet për shfrytëzimin e ujit për prodhimin dhe përpunimin e ushqimit dhe pijeve, nevojave industriale dhe teknologjike është 2% nga çmimi i përcaktuar i ujit në sistemin e furnizimit publik me ujë.

(30) Kompensimin nga paragrafi (26) i këtij neni e paguan dhe e llogarit personi juridik ose fizik i objektit i cili menaxhon me objekte që shfrytëzojnë ujë për prodhimtarinë dhe përpunimin e ushqimit dhe pijeve, nevojave të industrisë dhe teknologjisë, në bazë të metër kub ujë të harxhuar, përveç në rastet kur shfrytëzon ujë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(31) Obliguesi nga paragrafi (27) i këtij neni e llogarit kompensimin nga paragrafi (26) të këtij neni dhe e arkëton në llogari të veçantë arkëtimi në llogari të trezorit, një herë në muaj.

(32) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e bujqësisë mund ta anulojë përkohësisht pagesën e kompensimeve nga paragrafi (1), (5), (9), (13), (16), (19), (23), dhe (26) ose të caktojë zmadhimin e përkohshëm, jo më shumë se 20% ose zvogëlimin e lartësisë, jo më pak se 20 % nga lartësia e kompensimeve të caktuara në paragrafin (1), (5), (9), (13), (16), (19), (23) dhe (26) të këtij neni.

(33) Në rastet nga paragrafi (29) të këtij neni Qeveria e Republikës së Maqedonisë veçmas do të kihet parasysh:

- 1) dedikimi dhe rastet në të cilat shfrytëzohet uji;
- 2) kualiteti i ujit;

- 3) dallimi në drejtim të asaj se a shfrytëzohen ujërat sipërfaqësor ose nëntokësor dhe trupat e ndryshëm ujor;
- 4) situatat klimatike dhe meteorologjike gjatë shfrytëzimit të ujit dhe
- 5) kushtet dhe nevojave teknike për shfrytëzimin e ujit.

## Neni 214

### **Lartësia dhe mënyra e pagesës së kompensimit për shkarkim në ujëra**

(1) Lartësia e kompensimit për shkarkim në ujëra me ç'rast bëhet shkarkimi i ujërave të zeza dhe shkarkimi e hedhja e materieve dhe substancave të mbetura në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë përcaktohet si:

- 1) vlerë themelore dhe
- 2) vlerë variabël.

(2) Vlera themelore e lartësisë së kompensimit nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni, është 1% nga çmimi i përcaktuar i shërbimit nga dhënësi i shërbimit për grumbullimin dhe pastrimin e ujërave të zeza.

(3) Vlera variabël e lartësisë së kompensimit nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni, përcaktohet me lejen në bazë të "njësisë së dëmit".

(4) Një njësi e dëmit i përgjigjet ndotjes së një banori ekuivalent dhe është 0,4% nga paga mesatare në Republikën e Maqedonisë.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili e drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor e përcakton mënyrën e përlllogaritjes së njësisë së dëmit në përputhje me sasinë e ujit të shkarkuar dhe llojit e sasisë së materieve dhe substancave të mbetura që shkarkohen në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë dhe mënyrën e pagimit të kompensimit nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Gjatë përcaktimit të lartësisë së kompensimit dhënësi i lejes, veçanërisht duhet ta ketë para sysh:

- 1) vlerësimin e dëmit të substancave të shprehur përmes njësive ndotëse;
- 2) nëse pagesa bëhet në bazë të sasisë së ujërave të zeza të shkarkuara ose materieve dhe substancave të mbetura të shkarkuara dhe të hedhura ose në bazë kuturu dhe
- 3) kërkesat specifike nga aspekti i monitorimit;

(7) Obligues për pagimin e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni, është personi juridik ose fizik i cili nuk ka instalime për shkarkimin dhe pastrimin ujërave të zeza dhe/ose lëshon ujëra të zeza të papastruara dhe materie ose substanca të mbetura në recipientë në përputhje me lejen për shkarkimin e ujërave.

(8) Kompensimin nga paragrafi (2) i këtij neni, e përlllogarit personi juridik i cili menaxhon me sistemin e shkarkimit dhe pastrimit të ujërave të zeza, në bazë të sasisë së ujit të lëshuar në sistem, dhe e arkëton gjatë arkëtimit të tarifës për shërbimin e kryer dhe e regjistron ndaras në faturën për shërbim të kryer.

(9) Personi juridik nga paragrafi (8) i këtij neni, e ka për detyrë një herë në muaj kompensimin e arkëtuar nga paragrafi (1) i këtij neni, ta paguajë në llogari të veçantë pagesore në kuadër të llogarisë së thesarit.

(10) Kompensimin nga paragrafi (3) i këtij neni, e përlllogarit dhe paguan personi juridik ose fizik i cili shkarkon ujëra të zeza të papastruara dhe materie ose substanca të mbetura në recipientë, në përputhje me lejen për shkarkimin e ujërave.

(11) Personi juridik nga paragrafi (10) i këtij neni, kompensimin nga paragrafi (3) i këtij nen, e ka për detyrë një herë në muaj ta paguajë në

Ilogari të veçantë pagesore në kuadër të llogarisë së thesarit, në përputhje me sasinë e ujërave të zeza të shkarkuara që përcaktohet me aparate matëse dhe me llojin e sasinë e materieve dhe substancave të mbetura të shkarkuara në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

(12) Me përjashtim nga paragrafi (6) i këtij neni, nëse bartësi i lejes i përmbush kushtet e cekura në lejen që kanë të bëjnë me cilësinë e ujërave të shkarkuar, bartësi i lejes lirohet nga pagesa e vlerës variabël të kompensimit nga paragrafi (3) i këtij neni.

## Neni 215

### Lartësia dhe mënyra e pagimit të kompensimit për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit

(1) Lartësia e kompensimit për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit prej brigjeve të shtretërve të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe sipërfaqeve të tjera të cilat në kadastrën për patundshmëri janë regjistruar "nën ujë" është 7% nga çmimi i një metër kubi rërë, zhavorr dhe gur.

(2) Obligues për pagimin dhe përlllogaritjen e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni, bartësi i lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit prej shtretërve dhe brigjeve të trupave ujorë sipërfaqësorë.

(3) Obliguesi nga paragrafi (2) i këtij neni, e ka për detyrë që kompensimin nga paragrafi (1) i këtij neni, ta regjistrojë ndaras në faturën ose llogarinë për shitjen e rërës, zhavorrit dhe gurit gjatë lëshimit në qarkullim, ndërkaq e paguan në llogari të veçantë pagesore të llogarisë së thesarit, një herë në muaj.

(4) Të hyrat nga kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni, ndahen në proporcion 50% të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe 50% të buxhetit të komunave dhe komunave në Qytetin e Shkupit në rajonin e së cilës nxirret materiali.

(5) Mjetet nga paragrafi (4) i këtij neni që ndahen ndërmjet komunave nga rajoni i qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, ndahen në proporcion 50% për komunën nga rajoni i qytetit të Shkupit dhe 50% për qytetin e Shkupit.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për bujqësi, përkohësisht mund ta shfuqizojë pagesën e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni, ose të caktojë rritje të përkohshme, jo më të lartë se 20% apo ulje jo më pak se 20% nga lartësia e kompensimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni.

(7) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë sidomos do t'i ketë parasysh:

- rrezikshmërinë dhe kualitetin e trupit ujor;
- ndërhyrjet e nevojshme në trupin ujor;
- kushtet klimatike të trupit ujor, dhe
- sasinë e eksploatimit të rërës, zhavorrit dhe gurit nga trupi ujor.

## Neni 216

### Kontributi për ujëra

*I fshirë* 2

## Neni 217

### Obligues për pagimin e kontributit për ujëra

*I fshirë***Neni 218****Realizimi i mjeteve nga kompensimet**

(1) Mjetet e kompensimit nga neni 207 i këtij ligji, shfrytëzohen në bazë të Programit për menaxhim me ujëra të cilin me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor, dhe të konfirmuar me pëlqimin e ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e shëndetësisë, ministrit që drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e bujqësisë dhe ministrit që drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e transportit dhe lidhjeve e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(2) Realizimin e drejtpërdrejtë të mjeteve nga Programi për menaxhim me ujëra kryejnë organet e administratës shtetërore të përcaktuara në Programin.

(3) Ministri i cili drejton me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor, në bazë të raporteve të organeve nga paragrafi (1) i këtij neni, çdo vjet në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë paraqet raport për realizimin e mjeteve nga kompensimet e përcaktuara në Programin për menaxhim me ujëra.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e financave, e përcakton metodologjinë e përlllogaritjes të kompensimit të përgjithshëm dhe çmimin e shërbimit nga nenet 210 dhe 211 të këtij ligji.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Programin për menaxhim me ujëra nga paragrafi (2) i këtij neni, për vitin e ardhshëm e miraton më së voni 30 ditë nga dita e shpalljes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin rrjedhës në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" i cili është përcaktuar si program buxhetor për menaxhim me ujëra në buxhetet e secilit organ të administratës shtetërore, në lartësi të pjesës që financohet, për të cilën është përcaktuar si kompetent për realizim në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni.

(6) Me Programin për menaxhim me ujëra nga paragrafi (1) i këtij neni, financohet dhe/ose bashkëfinancohet realizimi i projekteve, programeve, aktiviteteve shumëvjeçare dhe/ose masat që janë të përmbajtura në dokumentet programore dhe në planet e miratuara në përputhje me këtë ligj, si dhe financohet ose bashkëfinancohet hartimi i dokumenteve programore dhe planet e përcaktuara me këtë ligj.

(7) Me programin për menaxhim me ujëra nga paragrafi (1) i këtij neni, financohet dhe/ose bashkëfinancohet realizimi i projekteve, programeve, aktiviteteve dhe/ose masat e dedikuara për komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit përmes buxheteve të organeve të administratës shtetërore, në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni.

**XI. ORGANIZIMI I MENAXHIMIT ME UJËRAT****1. Këshilli Nacional i Ujërave****Neni 219****Themelimi, përbërja dhe mandati**

(1) Për shkak të shqyrtimit të çështjeve të menaxhimit me ujërat, harmonizimit dhe bashkërenditjes të nevojave edhe interesave të ndryshme si dhe për shkak të propozimit të masave të ndryshme për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin permanent të regjimit të ujërave në territorin e Republikës së Maqedonisë, themelohet Këshilli Nacional i Ujërave si trup konsulent.

(2) Këshilli Nacional i Ujërave përbëhet nga 9 anëtarë, përfshirë edhe kryetarin, të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(3) Anëtarët e Këshillit Nacional të Ujërave zgjidhen si vijon:

- 1) një anëtar me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor;
- 2) një anëtar me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e shëndetësisë;
- 3) një anëtar me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e transportit dhe lidhjeve;
- 4) një anëtar me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e ekonomisë;
- 5) një anëtar me propozim të ministrit i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e bujqësisë;
- 6) një anëtar me propozim të kryetarit të BNjVL;
- 7) një anëtar me propozim të kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë;
- 8) një përfaqësues nga organizata joqeveritare e cila vepron në drejtim të mbrojtjes së ujërave me propozim të organizatave joqeveritare të cilat kanë punuar në këtë sferë në tri vitet e fundit dhe
- 9) një përfaqësues nga Këshilli për menaxhimin e rajonit të rrjedhës së lumit, në mënyrë alternative prej çdo Këshilli nga një mandat.

(4) Anëtarët e Këshillit Nacional të Ujërave zgjidhen nga radhët e personave të shquar shkencorë dhe profesionistë nga fusha e menaxhimit me ujërat dhe nga fusha simotra dhe nga shoqatat e shfrytëzuesve të ujërave.

(5) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Nacional të Ujërave zgjidhen për një periudhë kohore prej tre vitesh pa të drejtë për rizgjedhje, përpos për përfaqësuesin nga paragrafi (3) pika 8 të këtij neni të cilit mandati i zgjat një vit.

## Neni 220

### Funksione

(1) Këshilli Nacional i Ujërave shqyrton dhe jep mendime:

- 1) për propozim ligjet dhe për rregullat e tjera me të cilat rregullohen çështjet nga fusha e menaxhimit me ujërat;
- 2) për zbatimin e ligjeve dhe për rregullat e tjera me të cilat rregullohen çështjet nga fusha e menaxhimit me ujërat;
- 3) për Draft Strategjinë Nationale për Menaxhimin me Ujëra;
- 4) për Draftin e Bazës së Ekonomisë Ujore të Republikës së Maqedonisë;
- 5) për Draftin e planeve për menaxhimin me rrjedhën e lumit;
- 6) për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Bazës së Ekonomisë Ujore të Republikës së Maqedonisë dhe të planeve për menaxhimin me rrjedhën e lumit;
- 7) për plane të tjera, masa dhe programe të përcaktuara në përputhje me këtë ligj dhe
- 8) për çështje të tjera në përputhje me Rregulloren e punës.

(2) Në lidhje me çështjet që i shqyrton, Këshilli Nacional i Ujërave jep mendim, i përcakton qëndrimet dhe propozimet dhe propozon miratimin e

rregullave dhe ndërmarrjen e masave.

## Neni 221

### **Rregullorja, kompensimi dhe kryerja e punëve administrative-teknike**

- (1) Këshilli Nacional i Ujërave miraton Rregullore për punën e vet.
- (2) Anëtarëve të Këshillit Nacional të Ujërave u takon kompensim për punën e tyre në Këshill.
- (3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili e drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor e përcakton lartësinë e kompensimit nga paragrafi (2) i këtij neni, varësisht nga vëllimi dhe ndërlikueshmëria e punëve që i kryejnë.
- (4) Mjetet e kompensimit dhe shpenzimet e punës të Këshillit Nacional të Ujërave, sigurohen nga buxheti i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor.
- (5) Punët profesionale dhe administrative-teknike të nevojshme për punën e Këshillit Nacional të Ujërave i kryen organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor.

## **2. Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga fusha e mjedisit jetësor**

### Neni 222

- (1) Punët profesionale dhe ndërmarrja e masave dhe aktiviteteteve të rëndësishme për menaxhimin me ujërat, të përcaktuara me këtë ligj, në zonën e çdo rrjedhe të lumit të përcaktuar me nenin 7 dhe nenin 8 të këtij ligji, i kryen Drejtoria e Mjedisit Jetësor e themeluar në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor.
- (2) Drejtoria e Mjedisit Jetësor në menaxhimin me rrjedhat e lumenjve, sidomos i kryen punët si vijojnë:
  - 1) mbledh të dhëna dhe i kryen analizat e nevojshme me qëllim të përcaktimit të shtratit, sasisë dhe cilësisë së ujërave dhe urdhëron të ndërmerren masa përkatëse për mbrojtjen e ujërave nëntokësore të zbuluar gjatë kryerjes të kërkimeve gjeologjike apo eksplotimit të lëndëve të para minerale, hapjes së tuneleve dhe gjatë aktiviteteteve të tjera përmes gërmimit ose shpimit të tokës;
  - 2) përpilon vlerësim themelor të karakteristikave të çdo rrjedhe të lumit;
  - 3) siguron menaxhim me pjesën e zonës të rrjedhës së lumit ndërkombëtar që gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, në përputhje me ligjet, me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare nga Republika e Maqedonisë;
  - 4) punë profesionale në lëshimin e lejeve nga neni 26 i këtij ligji, dhe me pëlqimin e ekonomisë ujore nga neni 174 i këtij ligji;
  - 5) e mban dhe drejton librin ujqor;
  - 6) drejton dhe mban regjistër të zonave të mbrojtura;
  - 7) bashkërendit aktivitetete dhe merr pjesë në hartimin e Strategjisë Nacionale për Ujëra;
  - 8) bashkërendit aktivitetete dhe merr pjesë në hartimin e Bazës së Ekonomisë Ujore të Republikës së Maqedonisë;
  - 9) harton Plane për menaxhim me rrjedhat e lumenjve;
  - 10) harton Program të masave;
  - 11) i zbaton planet për menaxhimin me rrjedhën e lumit;
  - 12) e zbaton Programin e masave;
  - 13) mbledh, përpunon dhe i ruan të dhënat nga monitorimi i ujërave;
  - 14) siguron menaxhim me pjesën e zonës të rrjedhës së lumit



ndërkombëtar që gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, në përputhje me ligjet, me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare nga Republika e Maqedonisë;

15) i mbledh, ruan dhe përpunon të dhënat nga evidenca e objekteve dhe impianteve të ekonomive ujore;

16) vendos, harton dhe mban kadastra të ndotësve për rrjedhën e lumit përkatës;

17) kujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave në rrjedhën e lumit përkatës;

18) propozon eksproprijimin e tokës në të cilën gjenden ujëra nëntokësorë të nevojshëm për furnizimin publik me ujë;

19) kryen veprimtari kërkimore-shkencore në sferën e ujërave;

20) bën promovimin e teknikave dhe metodologjive për ruajtjen e ujit dhe

21) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër.

### **3. Këshilli për menaxhim me zonën e rrjedhës së lumit**

#### **Neni 223**

(1) Për shkak të hartimit dhe ndjekjes së zbatimit të Planit për menaxhim me rrjedhën e lumit, si dhe për shkak të dhënies së mendimeve dhe propozimeve rreth prioriteteve të menaxhimit me ujërat, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili e drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor, për çdo zonë të rrjedhës së lumit, formon Këshill për menaxhim me zonën e rrjedhës së lumit (në tekstin në vijim: Këshilli).

(2) Anëtarë të Këshillit janë përfaqësues të emëruar nga: organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e bujqësisë, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e shëndetësisë, organi i administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga fusha e transportit dhe lidhjeve, komunat dhe Qyteti i Shkupit, shoqata e konsumatorëve, ekonomitë ujore, përfaqësues të bashkësive ujore, dhënësit e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe shkarkimin e trajtimin e ujërave të zeza dhe shfrytëzues të tjerë të ujit, industria, organizatat joqeveritare, këshilli për menaxhim me pjesë të zonës të rrjedhës së lumit dhe palë të tjera të interesuara.

(3) Numri i anëtarëve të Këshillit përcaktohet varësisht nga madhësia e zonës të rrjedhës së lumit, si dhe nga vëllimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me ujërat që gjenden në zonën e rrjedhës së lumit.

(4) Për zonën e rrjedhës së lumit e cila shtrihet në sipërfaqe më të madhe ose aktivitetet e të cilës janë më të mëdha dhe/ose janë shpërndarë në mënyrë që të mund të grupohen, ministri i cili e drejton organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor mund të formojë Këshill për menaxhim me pjesë të zonës të rrjedhës së lumit në mënyrë të përcaktuar në paragrafin (2) dhe paragrafin (6) të këtij neni.

(5) Këshilli vendos me 2/3 e shumicës së votave.

(6) Përbërjen dhe mënyrën e pjesëmarrjes, si dhe mënyrën e emërimit të përfaqësuesve nga paragrafi (2) i këtij neni, në Këshill dhe në Këshillin për menaxhim me pjesë të zonës të rrjedhës së lumit, si dhe mënyrën e punës, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili drejton me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor.

(7) Përfaqësuesin e komunave dhe të Qytetit të Shkupit e emëron kryetari i komunave dhe i Qytetit të Shkupit.

(8) Anëtarëve të Këshillit dhe Këshillit për menaxhim me pjesë të zonës të rrjedhës së lumit u takon kompensim për punën e tyre në këshill.

(9) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili e drejton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor e përcakton lartësinë e kompensimit nga paragrafi (8) i këtij neni, si dhe mënyrën e përlogaritjes. Shpenzimet e punës dhe kompensimi i punës në Këshill dhe në Këshillin për menaxhim me pjesë të zonës të rrjedhës së lumit paguhen nga buxheti i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor.

(10) Punët profesionale dhe administrative-teknike të nevojshme për punën e Këshillit dhe Këshillit për menaxhim me pjesë të zonës të rrjedhës së lumit i kryen organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor.

## XII. MBIKËQYRJA

### 1. Mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjit

#### Neni 224

#### Kompetencë për kryerjen e mbikëqyrjes mbi zbatimin e ligjit

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor, përveç mbi:

- dispozitat nga kreu IV.3.2, IV.3.3, IV.4 dhe VIII.2 të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji të cilave mbikëqyrjen mbi zbatimin e bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e shëndetësisë dhe
- dispozitat nga kreu IV.3.4 dhe kreu VIII.3, të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji të cilave mbikëqyrjen mbi zbatimin e bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e bujqësisë.

#### 1.2. Mënyra dhe procedura e kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunave, mbi komunat e Qytetit të Shkupit dhe mbi Qytetin e Shkupit

#### Neni 225

Në realizimin e mbikëqyrjes mbi zbatimin e këtij ligji, organet kompetente nga neni 224 i këtij ligji, bëjnë mbikëqyrje mbi punën e organeve të komunave, mbi komunat e Qytetit të Shkupit dhe mbi Qytetin e Shkupit, në realizimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj.

#### Neni 226

Mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunave, mbi komunat e Qytetit të Shkupit dhe mbi Qytetin e Shkupit, themelohet mbi parimin e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë dhe pavarësisë në realizimin e kompetencave të tyre.

#### Neni 227

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit, dhe të Qytetit të Shkupit, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor i kryen punët si vijojnë:

- 1) vlerëson nëse komunat dhe Qyteti i Shkupit gjatë lëshimit të B-Lejes së integruar ekologjike kanë konstatuar nëse për veprimtaritë dhe aktivitetet e instalimit është lëshuar leja e nevojshme në përputhje me nenin 26 dhe nenin 28 të këtij ligji;
- 2) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit, dhe Qyteti i

Shkupit kanë marrë leje për shkarkimin e ujërave në përputhje me nenin 79 të këtij ligji;

3) vlerëson nëse komunat dhe Qyteti i Shkupit gjatë lëshimit të B-Lejes së integruar ekologjike kanë konstatuar nëse për veprimtaritë dhe aktivitetet e instalimit është lëshuar leja e nevojshme për shkarkimin e ujërave në përputhje me nenin 79 të këtij ligji;

4) vlerëson nëse vendimi për përcaktimin e zonës së mbrojtur është marrë në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara në përputhje me nenin 96 paragrafin (2) të këtij ligji;

5) vlerëson nëse në planet urbanistike të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit në mënyrë hartografike janë dhënë zonat e mbrojtura (neni 98 paragrafi (4));

6) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit i grumbullojnë, shkarkojnë dhe i pastrojnë ujërat e zeza që dalin ose krijohen në rajonin e tyre, përfshirë këtu edhe largimin e llumit (neni 113);

7) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit, dhe Qyteti i Shkupit kanë miratuar Program për shkarkimin, grumbullimin dhe pastrimin e ujërave të zeza urbane (neni 114);

8) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit kanë siguruar që shkarkuesit e ujërave të zeza industrial të cilat derdhen në sistemin e grumbullimit dhe pastrimit të ujërave të zeza urbane t'i nënshtrohen trajtimit të nevojshëm paraprak (neni 116);

9) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit i kanë ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtje dhe siguri nga vërshimet dhe për mbrojtje nga ndonjë ndikim tjetër i dëmshëm nga ujërat në rajonet urbane (neni 123);

10) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit kanë miratuar Program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave në kuadër të rrjedhës së lumit përkatës për zonat e veta të rrjedhës së lumit (neni 124);

11) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit i kanë miratuar dhe a thua i zbatojnë planet operative për mbrojtje dhe siguri prej vërshimeve për zonat e rrezikuara (neni 126);

12) vlerëson nëse komunat dhe Qyteti i Shkupit e kanë përcaktuar rripin e bregut (neni 113);

13) vlerëson nëse komunat dhe Qyteti i Shkupit e kanë rregulluar rripin e bregut (neni 132);

14) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit kanë bërë vlerësim, çdo vit deri në fund të muajit shtator, për atë se a thua rrjedhat e ujërave në zonën që është nën kompetencë të tyre janë në gjendje që të shkarkojnë vërshime mbi tokën dhe a thua ujti i sigurojnë rrjedhë papengesa (neni 133);

15) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit i kanë caktuar kufijtë e zonës erozive dhe zonës së rrezikuar nga erozioni dhe a thua i kanë përcaktuar masat dhe punët për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rregullimin e rrëkeve, në bazë të dokumentacionit teknik (neni 135);

16) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, i ndërmarrin masat për mbrojtjen e zonave erozive (neni 137);

17) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, i ndërmarrin masat për mbrojtje nga rrëketë (neni 141);

18) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit kanë hartuar, dërguar dhe publikuar raport për aktivitetet e realizuara në vitin paraprak dhe për masat e parapara për vitin e ardhshëm në lidhje me mbrojtjen nga ndikimi i dëmshëm i ujërave (neni 143);

19) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, kanë miratuar Program për monitorimin e ujërave (neni 145);

20) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, i dërgojnë të dhënat nga monitorimi (neni 156);

21) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, i ndërmarrin masat e përcaktuara në përputhje me nenin 185, të këtij ligji;

22) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit

- të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit mjetet që i kanë marrë nga Programi për menaxhim me ujërat për realizimin e aktiviteteve në rajonin e tyre i shpenzojnë me dedikim (neni 215);
- 23) e ndjek ligjshmërinë e punës të organeve të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, dhe ndërmerr masa e aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, në përputhje me këtë ligj;
- 24) vlerëson nëse organet e komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, sigurojnë që kompetencat e tyre të realizohen në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj;
- 25) ua bën me dije organeve të komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe me rregull tjetër dhe u propozon masa përkatëse për tejkalimin e gjendjes së këtyllë;
- 26) i vë në pah mangësitë e caktuara materiale dhe procedurale gjatë punës së organeve të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, të cilat do të mund ta pamundësonin kryerjen e punëve me interes publik me rëndësi lokale, në përputhje me këtë ligj;
- 27) jep rekomandime për zbatim konsekuent të kompetencave të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, sipas kërkesës së tyre të përcaktuara me këtë ligj;
- 28) e ndjek miratimin në kohë të rregullave, të cilat komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit i miratojnë në përputhje me këtë ligj;
- 29) paraqet iniciativa dhe propozime pranë komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe pranë Qytetit të Shkupit, në qoftë se konstaton se ky ligj nuk zbatohet;
- 30) paraqet iniciativa dhe propozime pranë komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe pranë Qytetit të Shkupit, në qoftë se konstaton se ky ligj nuk zbatohet si pasojë e konfliktit të kompetencave ndërmjet organeve të komunave, organeve të komunave të Qytetit të Shkupit përkatësisht organeve të Qytetit të Shkupit;
- 31) e ndjek ligjshmërinë e aktvendimeve të cilat kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, i marrin gjatë zgjidhjes të drejtave të veçanta, obligimeve dhe interesave të personave juridikë dhe fizikë, në përputhje me këtë ligj;
- 32) jep mendim dhe ndihmë profesionale në lidhje me propozim rregullat e komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, sipas kërkesës së tyre;
- 33) e ndjek realizimin transparent të punës së organeve të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, veçanërisht në aspekt të njoftimit të rregullt, me kohë, të drejtë dhe të tërësishëm të qytetarëve, në përputhje me këtë ligj;
- 34) e ndjek realizimin e mbikëqyrjes paraprake të rregullave të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit;
- 35) me kohë i njofton organet e komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, për gjendjet e konstatuar gjatë punës së tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe
- 36) përcakton punë të cilat nuk janë ndërmarrë apo realizuar në përputhje me këtë ligj, për të cilat komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit e kanë pasur obligim t'i ndërmarrin.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunave, të komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e shëndetësisë i kryen punët si vijojnë:

- 1) vlerëson nëse komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit i kanë caktuar dhe veprojnë me zonat e mbrojtura në përputhje me rregullin e miratuar në bazë të nenit 98 paragrafi (5) i këtij ligji;
- 2) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, i kanë përcaktuar zonat për banjë në mënyrë të paraparë në përputhje me nenin 101 paragrafin (3) dhe (6) të këtij ligji;
- 3) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit

të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit i kanë ndërmarrë masat për mbrojtje të zonave ku mund të lahet nga ndotja dhe për mbrojtje nga ndikimet dhe aktivitetet të cilat në mënyrë negative mund të ndikojnë mbi cilësinë e ujit për banjë (neni 101, paragrafi (4));

4) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit e kanë rregulluar mënyrën e shfrytëzimit të ujërave ku mund të lahet dhe e kanë caktuar kohëzgjatjen e periudhës së sezonit për banjë (neni 104);

5) vlerëson nëse kryetarët e komunave dhe kryetari i Qytetit të Shkupit bëjnë monitorim mbi ujërat e përfshirë me rrjetin lokal të monitorimit dhe monitorim mbi ujërat në zonat për banjë që gjenden në rajonet e tyre (neni 146);

6) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit e ndjekin cilësinë e ujit për banjë dhe a thua i paraqesin të dhënat (neni 149);

7) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit i paraqesin të dhënat nga monitorimi në lidhje me cilësinë e ujit për pije dhe ujërave për banjë (neni 156);

8) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit në rast të mosrespektimit të vlerave dhe standardeve për cilësi i kanë ndërmarrë masat e sanimit dhe kanë përcaktuar kufizim ose ndalim për shfrytëzimin e ujit dhe a thua i kanë njoftuar organet kompetente (neni 187);

9) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit i kanë ndërmarrë masat e nevojshme në rast të kufizimeve për shkak të mungesës së ujit (neni 188) dhe

10) vlerëson nëse kryetarët e komunave, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit, i kanë ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim që të reduktohen në minimum humbjet në sistemin e ujësjellësit të personit juridik i cili e bën furnizimin me ujë në rajonin e tyre (neni 189);

(3) Për masat dhe aktivitetet e ndërmarrura nga paragrafi (1) alinetë 23, 28, 30 dhe 34 të këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e vetadministrimit lokal.

(4) Gjatë kryerjes së punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e mjedisit jetësor e ka për detyrë që kryetarëve të komunave, kryetarëve të komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit t'ua dërgojë sugjerimet dhe t'u caktojë afat brenda të cilit duhet t'i shmangin mangësitë e konstatuara gjatë realizimit të kompetencave të tyre.

(5) Gjatë kryerjes së punëve nga paragrafi (2) i këtij neni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e shëndetësisë e ka për detyrë që kryetarëve të komunave, kryetarëve të komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit t'ua dërgojë sugjerimet dhe t'u caktojë afat brenda të cilit duhet t'i shmangin mangësitë e konstatuara gjatë realizimit të kompetencave të tyre.

## Neni 228

(1) Në qoftë se krahas sugjerimeve dhe masave e aktiviteteve të ndërmarrura, organet e komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, nuk e sigurojnë kryerjen e punëve të cilat sipas këtij ligji janë përcaktuar në kompetencë të tyre dhe për kryerjen e të cilave përgjegjësi mbajnë komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, sipas ligjit u hiqet kompetenca përkatëse, kurse kryerjen e këtyre punëve e ndërmerr organi kompetent nga neni 227 i këtij ligji, nga fusha përkatëse, por më së shumti deri në një vit nga dita e ndërmarrjes së tyre.

(2) Organi kompetent nga neni 227 i këtij ligji, punët në kompetencë të komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, nga paragrafi (1) i këtij neni, i kryen në emër dhe në llogari të komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.

(3) Për ndërmarrjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent nga neni 227 i këtij ligji, e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e vetadministrimit lokal dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e financave.

## **2. Mbikëqyrje inspektimi**

### **Neni 229**

#### **Kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit**

(1) Mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji bën Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor përmes inspektorëve të ekonomive ujore dhe inspektorëve të mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, në pjesën e kontrollit të cilësisë së ujit për banjë dhe ujit të dedikuar për konsum nga ana e njeriut, bën Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, përmes inspektorëve shtetërorë sanitarë dhe shëndetësorë dhe Drejtoria e ushqimit përmes inspektorëve shtetërorë të ushqimit.

(3) Mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, në pjesën e kontrollit të zonave të ndjeshme ndaj nitrateve dhe ujitjes e kullimit, bën Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë, përmes inspektorëve shtetërorë të bujqësisë.

(4) Për punët në kompetencë të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave të Qytetit të Shkupit, të përcaktuara me këtë ligj, mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji, bëjnë inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunës, inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të Qytetit të Shkupit dhe inspektorët e autorizuar të mjedisit jetësor të komunave të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: inspektorë të autorizuar).

#### **2.1. Inspektorët e ekonomive ujore**

### **Neni 230**

#### **Fushëveprimi i inspektorëve të ekonomive ujore**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit nga fushëveprimi i vet, inspektori i ekonomisë ujore ka të drejtë:

- 1) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave realizohet në përputhje me këtë ligj (neni 16);
- 2) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse pronari ose titullari i një të drejte tjetër reale mbi truallin, vepron në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;
- 3) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse kullimi i truallit zbatohet në përputhje me nenin 18 të këtij ligji;
- 4) nëse personi juridik dhe fizik i cili bën kërkime gjeologjike apo eksploatimin e lëndëve të para minerale, ka vepruar në përputhje me neni 22 të këtij ligji;
- 5) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse shfrytëzimi i ujit nga bunari zbatohet në përputhje me nenin 29 të këtij ligji;
- 6) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse me truallin rreth bregut veprohet në përputhje me nenin 105 të këtij ligji;
- 7) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë që

- menaxhojnë me ekonomitë ujore i ndërmarrin masat dhe aktivitetet e nevojshme për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave (neni 123);
- 8) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë që menaxhojnë me ekonomitë ujore kanë hartuar program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave (neni 124);
- 9) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse janë ndërmarrë masat për mbrojtje dhe siguri nga vërshimet (neni 126);
- 10) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë të cilët menaxhojnë me digat dhe me akumulimet e me penda mbrojtëse i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë në përputhje me nenin 129 të këtij ligji;
- 11) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse personat juridikë të cilët menaxhojnë me digat dhe me akumulimet e me penda mbrojtëse bëjnë monitorim dhe njoftojnë në përputhje me nenin 130 të këtij ligji;
- 12) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse qasja deri tek ujërat sipërfaqësor sigurohet në përputhje me nenin 132 të këtij ligji;
- 13) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse sigurohet rrjedhja e rrjedhave të ujit në përputhje me nenin 133 të këtij ligji;
- 14) bën kontroll nëse zbatohen masat dhe punët për mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rregullimin e rrëkeve, në bazë të dokumentacionit teknik nga neni 135, paragrafi (1) të këtij ligji;
- 15) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse janë ndërmarrë masa për mbrojtjen e zonave erozive (neni 136);
- 16) të konstatojë nëse personat juridikë dhe fizikë të cilët shkaktojnë erozion i kanë ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin e erozionit si dhe masat e shmangies së pasojave të dëmshme dhe nëse për këtë në mënyrë përkatëse i kanë kompensuar dëmet e bëra (neni 138);
- 17) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse ndërmerren masa për rregullimin e rrëkeve (neni 141);
- 18) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse veprohet në përputhje me nenin 142 të këtij ligji;
- 19) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse objektet e ekonomive ujore dhe impiantet veprojnë në përputhje me lejet për shfrytëzimin e ujit dhe shkarkimin në ujëra (neni 163);
- 20) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse e kanë siguruar pëlqimin nga ekonomia ujore (neni 174);
- 21) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse objektet e ekonomive ujore dhe impiantet e masin sasinë dhe cilësinë e ujërave të përfshirë dhe ujërave që i shkarkojnë dhe nëse i ruajnë të dhënat (neni 165);
- 22) të bëjë kontroll dhe inspektim mbi të gjitha objektet e ekonomive ujore dhe impiantet dhe ndaj çështjeve të tjera që mund të krijojnë ndryshime kualitative dhe kuantitative në regjimin e ujërave dhe të konstatojë nëse veprohet në përputhje me nenin 16 të këtij ligji;
- 23) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse respektohen ndalimet nga neni 167 i këtij ligji;
- 24) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse evidenca mbahet në përputhje me nenin 171 të këtij ligji;
- 25) me qëllim të inspektimit në realizimin e kushteve të përmbajtura në pëlqimet e dhëna nga ekonomitë ujore, të bëjë kontroll gjatë ndërtimit të objekteve të reja të ekonomive ujore dhe impianteve ose gjatë rikonstruksionit ose ndërtimit të anekseve të objekteve ekzistuese të ekonomive ujore apo impianteve që gjenden në apo pranë ujërave sipërfaqësorë, objekteve që kalojnë mbi ose nën ujërat sipërfaqësorë apo objekteve që janë vendosur në afërsi të ujërave sipërfaqësorë ose në afërsi të vendeve buzë bregut dhe të cilat mund të ndikojnë mbi regjimin e ujërave;
- 26) me qëllim të inspektimit në realizimin e kushteve të përmbajtura në pëlqimet e dhëna të ekonomive ujore, të bëjë kontroll mbi mënyrën e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve dhe impianteve;
- 27) me qëllim të inspektimit në realizimin e kushteve të përmbajtura në pëlqimet e dhëna të ekonomive ujore, bën kontroll gjatë ndërtimit të objekteve të reja ose gjatë rikonstruksionit apo aneksit të objekteve mbrojtëse ekzistuese me përjashtim të digave, si dhe mënyrën e mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të këtyre objekteve dhe impianteve;
- 28) me qëllim të inspektimit në realizimin e kushteve të përmbajtura në pëlqimet e dhëna, bën kontroll gjatë ndërtimit të objekteve të reja të

ekonomive ujore dhe impianteve ose gjatë rikonstruksionit apo aneksit të objekteve ekzistuese të ekonomive ujore ose impianteve, si dhe mënyrën e mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të këtyre objekteve dhe impianteve;

29) të bëjë kontroll dhe inspektim nëse është siguruar libri uJOR, evidenca e objekteve të ekonomive ujore dhe impianteve, programi nga mbrojtja e ndikimit të dëmshëm të ujërave, planet operative për mbrojtje dhe siguri nga vërshimet, vlerësime, kontratat, programet e librat e tjerë dhe dokumentacioni i personave juridikë që kryejnë veprimtari të ekonomisë ujore;

30) të bëjë kontroll mbi zbatimin e planit operativ për mbrojtje dhe siguri prej vërshimeve dhe kontroll e inspektim mbi zbatimin e masave nga programi për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave, zbatimin e masave mbrojtëse për mbrojtje nga erozioni dhe masave për mbrojtjen e zonave erozive, zonave të rrezikuara nga erozioni, rregullimi i rrëkeve;

31) të bëjë kontroll dhe inspektim mbi mënyrën e realizimit, menaxhimit, mirëmbajtjes në gjendje të mirë dhe mbi mbrojtjen e objekteve të ekonomive ujore;

32) të bëjë kontroll dhe inspektim mbi respektimin e prioriteteve si dhe kontroll e inspektim mbi shpërdorimin dhe shfrytëzimin joadekuat të ujërave;

33) të bëjë kontroll dhe inspektim mbi eksploatimin e ujërave mineralë;

34) të bëjë kontroll dhe inspektim mbi punën e digave dhe akumulimeve në lidhje me shfrytëzimin e ujërave dhe zbatimin e dispozitave teknike (neni 195);

35) të bëjë inspektim mbi miratimin e detyrës sipas projektit, dokumentacionin për mbikëqyrje teknike dhe mbi punët e masat e tjera të përcaktuara të digave dhe akumulimeve (neni 197);

36) bën inspektim mbi ndërtimin e digave të këtij ligji, nga aspekti i regjimit të ujërave, mirëmbajtjes e mbikëqyrjes dhe bën kontroll mbi regjimin e mbushjes dhe zbrazjes të akumulimeve, si dhe monitorimin mbi digat dhe akumulimet (neni 198);

37) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse hapja e puseve dhe shfrytëzimi i ujit nga to bëhet në përputhje me dispozitat e Kreut VIII, pika 5 të këtij ligj;

38) aksesit aty ku është e domosdoshme, në çdo kohë dhe me legjitimitet paraprak, në pronat me pronësi shoqërore dhe private, lokacionet dhe mjetet transportuese, në përputhje me ligj dhe

39) ndërmerr edhe punë e masa të tjera me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit inspektori i ekonomisë ujore me aktvendim:

1) do të urdhërojë shmangien e mangësive që do t'i konstatojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe do të caktojë afat për shmangien e tyre;

2) do të urdhërojë ndërmarrje të masave me qëllim të mbrojtjes nga ndikimi i dëmshëm mbi ujërat dhe nga ujërat, mbrojtje nga erozioni dhe rrëketë;

3) do të urdhërojë ndërprerje të ndërtimit të objekteve dhe impianteve për të cilat nevojitet pëlqimi i ekonomisë ujore ose leje, nëse objekte të këtillë ndërtohen pa pëlqimin e ekonomisë ujore ose pa leje apo objekti ndërtohet në kundërshtim me kushtet e pëlqimit të dhënë nga ekonomia ujore ose me lejen;

4) do ta ndalojë shfrytëzimin dhe shkarkimin e ujërave, nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit, hapjen e puseve dhe aktiviteteve veprimtari të tjera të cilat ndikojnë mbi regjimin e ujërave apo mbi morfologjinë e trupit uJORë nëse veprimtaritë dhe aktivitetet kryhen pa leje apo në kundërshtim me të njëjtën;

5) t'i ndërpresë përkohësisht ose në mënyrë të përhershme të gjitha veprimet që janë në kundërshtim me këtë ligj, apo me ndonjë akt të përgjithshëm dhe të urdhërojë kthim në gjendjen e mëparshme;

6) t'i njoftojë organet kompetente të ekonomive ujore dhe organet e tjera të administratës për parregullsitë e konstatuara dhe të kërkojë intervenim nga të njëjtat;

7) do ta ndalojë vazhdimin e aktiviteteve dhe veprimtarive që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe aty ku ka nevojë shmangien e



të njëjtave, të urdhërojë që të bëhen matje që do të bien mbi kurrizin e përgjegjësit të aktivitetit ose veprimtarisë dhe përkohësisht të sekuestrojë sende me të cilat kryhet aktiviteti ose veprimtaria dhe

8) do të urdhërojë ndërmarrje të masave dhe aktiviteteve me qëllim të evitimit të mangësive të konstatuara.

(3) Gjatë kryerjes së punëve nga fushëveprimi i vet, inspektori i ekonomisë ujore ka të drejtë të ndërmarrë aktivitete të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor;

(4) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektorati shtetëror mund të kërkojë prani të personave nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në mjedisin jetësor.

(5) Me kërkesë të inspektorit të ekonomisë ujore, personi i autorizuar zyrtar i organit të administratës shtetërore kompetent për punët e brendshme e ka për detyrë të marrë pjesë në realizimin e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **Neni 231**

### **Kualifikimi i nevojshëm për inspektor të ekonomisë ujore dhe karta e identitetit zyrtar**

(1) Punët e inspektorit të ekonomisë ujore i kryen inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë i cili është:

- shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është i moshës madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është kumtuar aktgjykim i plotfuqishëm gjyqësor për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka fituar së paku 300 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/1 nga sfera e lartpërmendur, që dëshkohet me certifikatë,
- ka pesë vjet përvojë pune në sferën e mjedisit jetësor,
- i plotëson kushtet tjera të përcaktuara në aktin e sistematizimit të vendeve të punës,
- posedon certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë, përkatësisht një prej këtyre në vijim:
  - 1) Certiport IC3 GS4 Key Applications – të dhënë;
  - 2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell – të dhënë ose
  - 3) ECDL: Core – të dhënë,
- ka marrë mendim pozitiv për përshtatshmëri për vendin e punës nëpërmjet dhënies së testit psikologjik dhe testit për integritet, në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe
- ka licencë për inspektor nga sfera e kompetencës së shërbimit inspektues.

(2) Cilësia zyrtare e inspektorit të ekonomisë ujore dëshkohet përmes kartës së identitetit formën e të cilës, përmbajtjen dhe formularin i përcakton ministri i cili drejton organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit, inspektori i ekonomisë ujore e ka për detyrë ta tregojë kartën e identitetit zyrtar nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Kartën e identitetit nga paragrafi (2) inspektorëve të ekonomive ujore ua lëshon dhe heq ministri i cili drejton me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e mjedisit jetësor në përputhje me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **2.2. Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor**

### **Neni 232**

## Fushëveprimi i inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit nga fushëveprimi i vet, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor ka të drejtë:

- 1) të konstatojë nëse shfrytëzohen motorë me djegie të brendshme në zona dhe rajone të mbrojtura të përcaktuara me këtë ligj ose a kryhen edhe aktivitete të tjera (neni 19);
- 2) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse për veprimtaritë dhe aktivitetet është siguruar leja e nevojshme në përputhje me nenin 26 dhe nenin 28 të këtij ligji;
- 3) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse veprohet në përputhje me kufizimin e të drejtës ujore (nenin 49);
- 4) të bëjë kontroll nëse uji shfrytëzohet sipas prioriteteve të dhëna në nenin 15 dhe nenin 50 të këtij ligji;
- 5) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse uji shfrytëzohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen e lëshuar për shfrytëzimin e ujërave (neni 51);
- 6) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse koncesioneri ka marrë leje për shfrytëzimin e ujit (neni 56);
- 7) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse me veprimin apo aktivitetin veprohet në kundërshtim me ndalimin e përgjithshëm nga neni 77 i këtij ligji;
- 8) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse personi juridik ose fizik posedon leje për shkarkim (neni 79);
- 9) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse ujërat shkarkohen në mënyrë dhe kushte të parapara në përputhje me lejen për shkarkim (neni 83);
- 10) bën kontroll dhe inspektim nëse janë shënuar zonat e mbrojtura dhe regjimi në zonat e mbrojtura, përveç në zonat me ujë të dedikuar për konsum nga njeriu dhe ujërat për banjë (neni 96);
- 11) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse objektet dhe impiantet që punojnë me materie dhe substanca të rrezikshme, veprojnë në përputhje me nenin 108 të këtij ligji;
- 12) të bëjë kontroll dhe inspektim mbi një pjesë dhe të konstatojë nëse ekzistojnë gjendje që kanë të bëjnë me materie dhe substanca të rrezikshme prioritare, materie ose substanca helmuese e të dëmshme ose ndotëse apo me mbeturina në përputhje me nenin 109 të këtij ligji;
- 13) të bëjë kontroll mbi cilësinë e ujërave të zeza që shkarkohen;
- 14) të bëjë kontroll dhe inspektim nëse i posedojnë lejet e nevojshme për shkarkimin e ujërave të zeza;
- 15) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse shkarkohen efluentë prej mbeturinave të lëngshme industriale dhe bujqësore dhe ujërat e zeza urbanë në kanalizim ose në sistem për kullim, në trupa ujorë sipërfaqësorë ose nëntokësorë, si dhe në toka buzë brigjeve dhe në habitate ujore në bazë të lejes (neni 110);
- 16) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse zbatohet para-trajtim i ujërave të zeza industriale (nenin 116);
- 17) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse shfrytëzimi i sërishëm i ujërave të zeza urbanë zbatohet në përputhje me neni 117 të këtij ligji;
- 18) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse shfrytëzimi i llumit zbatohet në përputhje me neni 118 të këtij ligji;
- 19) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse sigurohet minimumi i rrjedhës së pranueshme të ujit dhe i nivelit të ujit nëntokësor (neni 120);
- 20) të bëjë kontroll dhe të konstatojë nëse veprohet në përputhje me nenin 131 të këtij ligji;
- 21) të bëjë kontroll mbi zbatimin e monitorimit të ujërave dhe dhënies së informatave (Kreu VI);
- 22) të bëjë kontroll dhe inspektim nëse dërgohen të dhëna për mbajtjen e kadastrës të ndotësve (neni 161);
- 23) të bëjë kontroll mbi mosrespektimin e standardeve të cilësisë së ujërave;
- 24) të bëjë kontroll dhe inspektim nëse është siguruar minimumi i pranueshëm i rrjedhës së ujit dhe minimumi i nivelit të pranueshëm të ujërave, dhe
- 25) të kryejë punë të tjera për zbatimin e këtij ligji.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor me aktvendim:

- 1) do të përcaktojë masa me qëllim që të shmangen shkaqet e shfaqjes së ndotjes së ujërave;
- 2) do të urdhërojë që të shmangen pasojat e dëmshme që janë shfaqur me ndotjen dhe kthimin e ujërave në gjendjen e mëparshme;
- 3) do të përcaktojë masa preventive dhe masa për shmangien e ndotjes dhe kthimin në gjendje të kënaqshme;
- 4) do ta kufizojë punën e objekteve, impianteve dhe instalimeve, për shkak të veprimeve të dëmshme me të cilat bëhet ndotja ose degradimi i ujërave, mjedisit jetësor dhe i jetës dhe shëndetit të njerëzve, pa marrë parasysh atë se a janë siguruar kushtet për punën e tyre dhe nëse janë siguruar leje, licenca dhe pëlqime të përcaktuara me ligj, në kohëzgjatje prej më së shumti 90 ditësh, brenda këtij afati duhet të shmangen shkaqet e gjendjes së krijuar;
- 5) do ta ndalojë punën e objekteve, impianteve dhe instalimeve, për shkak të veprimeve të dëmshme me të cilat bëhet ndotja ose degradimi i ujërave, mjedisit jetësor dhe i jetës dhe shëndetit të njerëzve, pa marrë parasysh atë se a janë siguruar kushtet për punën e tyre dhe nëse janë siguruar leje, licenca dhe pëlqime të përcaktuara me ligj, në kohëzgjatje prej më së shumti 90 ditësh, brenda të cilit afat duhet të shmangen shkaqet e gjendjes së krijuar;
- 6) do ta ngarkojë personin juridik ose fizik i cili nuk ka dorëzuar kërkesë për të fituar leje për shfrytëzimin e ujit dhe për shkarkim në ujë, këtë ta bëjë brenda afatit prej më së shumti 90 ditësh;
- 7) do ta kufizojë ose ndalojë punën e personit juridik apo fizik i cili nuk ka dorëzuar kërkesë për të fituar leje për shfrytëzimin e ujit dhe për shkarkimin në ujë, më së shumti deri më 90 ditë;
- 8) do ta obligojë personin juridik ose fizik të ndërmarrë masa për përmbushjen e kushteve të parapara me lejet;
- 9) do ta kufizojë apo ndalojë punën e personit juridik ose fizik i cili nuk i përmbush kushtet e parapara me lejet, deri në përmbushjen e kushteve, e më së shumti deri më 90 ditë dhe brenda këtij afati duhet të shmangen shkaqet e gjendjes së krijuar;
- 10) do ta kufizojë apo ndalojë punën e personit juridik ose fizik i cili nuk i përmbush kushtet e parapara me lejet, deri në përmbushjen e kushteve;
- 11) do ta obligojë personin juridik apo fizik t'i dërgoj dhe/ose në mënyrë permanente t'i dërgojë informata nga monitorimi dhe informata të tjera në lidhje me mjedisin jetësor në afat prej më së shumti 30 ditësh;
- 12) do t'i obligojë personat juridikë dhe fizikë të zbatojnë monitorim mbi cilësinë dhe kuantitetin e ujërave në mënyrë të paraparë konform këtij ligj;
- 13) do t'i obligojë personat juridikë dhe fizikë të zbatojnë monitorim brenda periudhës prej më së shumti 90 ditësh, në rast të shfaqjes së ndotjes në rrethin e objektit të personit juridik dhe fizik në të cilin realizohet aktiviteti për të cilin supozohet se e shkakton ndotjen;
- 14) do ta kufizojë apo ndalojë punën e personit juridik dhe fizik i cili nuk e zbaton monitorimin në mënyrë të përcaktuar me ligj, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh dhe brenda këtij afati duhet të shmangen shkaqet e gjendjes së krijuar;
- 15) do t'i obligojë personat juridikë dhe fizikë që t'i dërgojnë të dhënat e nevojshme nga monitorimi edhe për Regjistrin e Kadastrën brenda afatit prej më së shumti 30 ditësh nga dita e konstatimit të mangësisë;
- 16) do ta kufizojë apo ndalojë punën e personit juridik dhe fizik i cili nuk posedon leje, në kohëzgjatje prej 90 ditësh dhe brenda këtij afati duhet të shmangen shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 17) do ta kufizojë apo ndalojë punën e personit juridik ose fizik i cili lëshon emisione në ujëra më të mëdha nga ato të përcaktuara me ligj ose me rregull të miratuara në bazë të ligjit dhe/ose emisione të përcaktuara me leje, më së shumti deri më 90 ditë dhe brenda këtij afati duhet të shmangen shkaqet e gjendjes së krijuar;
- 18) me qëllim të mbrojtjes të shëndetit të njerëzve, do ta kufizojë apo ndalojë punën e personit juridik ose fizik i cili lëshon emisione në ujëra, ose do ta kufizojë lëshimin e emisioneve të tyre, në rastin kur janë shkelë standardet e kualitetit të mjedisit jetësor, brenda periudhës kohore derisa

kualiteti i mjedisit jetësor të kthehet në kuadrin e standardeve të përcaktuara për kualitet.

19) përkohësisht do ta marrë rërën, zhavorrin dhe gurin i cili është hequr nga shtrati dhe brigjet e trupave sipërfaqësore ujore pa leje nga neni 26 i këtij ligji deri në mënjanimin e mangësive, përkatësisht deri në miratimin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës kompetente ose organit kundërvajtës.

(3) Gjatë kryerjes së punëve nga fushëveprimi i vet, inspektori ka të drejtë të ndërmarrë aktivitete të përcaktuara me Ligjin e mjedisit jetësor.

(4) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori shtetëror mund të kërkojë prani të personit nga Drejtoria e mjedisit jetësor.

(5) Me kërkesë të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor, personi i autorizuar i organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e punëve të brendshme e ka për detyrë të marrë pjesë në realizimin e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Për sendet e marra nga paragrafi (2) pika 19 e këtij neni, Inspektorati Shtetëror për mjedis jetësor lëshon vërtetim për marrje të përkohshme të rërës, zhavorrit dhe gurit.

(7) Marrjen e sendeve dhe veprimin e të njëjtat bëhet në pajtim me Ligjin për menaxhim me pronën e konfiskuar, dobinë pronësore dhe sendet e marra në procedurën penale dhe kundërvajtëse.

## **2.3. Inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor i komunave, i komunave të Qytetit të Shkupit dhe i Qytetit të Shkupit**

### **Neni 233**

#### **Fushëveprimi i inspektorit të autorizuar për ambientin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit**

(1) Inspektori i autorizuar për ambientin jetësor të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: inspektori i autorizuar) mbi rajonin e komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, ka të drejtë të bëjë:

1) kontroll mbi derdhjen e ujërave të zeza ose hedhjen e materieve dhe të substancave, si edhe të vajrave të përdorura në kanalizimin dhe të konstatojë nëse bëhet në përputhje me ligjin (neni 79);

2) kontroll dhe bën mbikëqyrje mbi mbrojtjen e zonave për banjë nga ndotja dhe mbi aktivitetet të cilat mund të ndikojnë në mënyrë negative mbi përshtatshmërinë e ujit për banjë (neni 101);

3) kontroll mbi sistemet e kanalizimit, mbi sistemet e kullimit dhe të gropave septike në rajonin e komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, të cilat derdhen në sistemet e kanalizimit (neni 113, paragrafi (3));

4) mbikëqyrje mbi grumbullimin, përçimin, pastrimin dhe derdhjen e ujërave të zeza nga ujërat e zeza vendore, ujërat e grumbulluara të rrëmbyeshme nga të reshurat atmosferike në rajonet e urbanizuara (neni 116);

5) mbikëqyrje mbi grumbullimin, përçimin, pastrimin dhe derdhjen e ujërave të zeza nga derdhësit e ujërave të zeza industriale, të cilët posedojnë leje ekologjike të integruar B ose në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor, janë në kompetencë të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit;

6) kontroll dhe të konstatojë nëse zbatohet plani operativ për mbrojtjen dhe siguri nga vërshimet në rajonin e komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, në përputhje me nenin 126

të këtij ligji;

- 7) kontroll dhe të konstatojë nëse ndërmerren masat për rregullimin e rrëkeve (neni 141);
- 8) kontroll dhe të konstatojë nëse ndërmerren masa për mbrojtje nga erozioni në përputhje me nenin 137, paragrafi (1) të këtij ligji;
- 9) kontroll dhe të konstatojë nëse ndërmerren masa për mbrojtjen nga rrëketë në përputhje me nenin 141, paragrafi (4) të këtij ligji;
- 10) mbikëqyrje mbi ndërmarrjen e masave të duhura për zhvillimin dhe për mirëmbajtjen e sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë të pijshëm në sasi të mjaftueshme dhe sipas kërkesave të të gjithë konsumatorëve legjitimë (neni 185);
- 11) mbikëqyrje dhe kontroll mbi përdorimin e ujërave të pijshëm dhe për banjë dhe të konstatojë nëse ekziston keqpërdorim dhe shfrytëzim pa dedikim i ujërave të pijshëm dhe për banjë në rajonin e vet (neni 189);
- 12) mbikëqyrje dhe kontroll mbi zbatimin e ndalesës për ujitje dhe për t'i dhënë ujë bagëtisë (neni 193) dhe
- 13) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj ose me rregull tjetër.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i autorizuar me aktvendim:

- 1) do ta ndalojë zbatimin e aktiviteteve, do t'i konstatojë mangësitë dhe do të përcaktojë masa për tejkalimin e tyre;
- 2) do ta ndalojë punën e objekteve, të stabilimenteve dhe të instalimeve për shkak të lëshimit të ujërave të zeza ose hedhjes së materieve dhe të substancave, si edhe vajrave të zeza në kanalizimin, pa dallim në atë se janë siguruar kushte për punën e tyre dhe nëse janë siguruar leje, aprovime dhe pëlqime, të përcaktuara me ligj, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh, afat në të cilin duhet të mënjanohen shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 3) do të urdhërojë mënjanim të mangësive që do t'i përcaktojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe do të përcaktojë afat për mënjanimin e tyre;
- 4) do të urdhërojë ndërmarrje të masave për mirëmbajtjen dhe për pastrimin e rrjeteve të kanalizimit ose për pastrimin e gropave septike;
- 5) do të urdhërojë ndërmarrje të masave me qëllim të mbrojtjes nga ndikimi i dëmshëm në dhe nga ujërat, mbrojtjen nga erozioni dhe nga rrëketë;
- 6) do të urdhërojë zbatim të masave për zbatimin e planit operativ për mbrojtjen nga vërshimet;
- 7) do ta ndalojë zbatimin e aktiviteteve dhe do të urdhërojë ndërmarrje të masave për mbrojtjen nga erozioni dhe për mbrojtjen nga rrëketë;
- 8) do të urdhërojë ndërmarrje të masave për zhvillimin dhe për mirëmbajtjen e sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë;
- 9) do të urdhërojë ndalim të shfrytëzimit të papërshtatshëm të ujërave, si edhe do të urdhërojë ndërmarrje të masave me qëllim të kthimit në gjendjen fillestare dhe
- 10) do të urdhërojë ndalesë të ujitjes dhe të dhënies ujë bagëtisë dhe do të përcaktojë masa për kthimin në gjendjen fillestare.

(3) Inspektorin nga paragrafi (1) i këtij neni, e autorizon kryetari i komunave, i komunave në qytetin e Shkupit dhe i qytetit të Shkupit, në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor.

(4) Gjatë mbikëqyrjes inspektuese nga ky ligj, inspektori i autorizuar vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat për inspektor të autorizuar të ambientit jetësor, të përcaktuara në Ligjin për ambientin jetësor.

(5) Me kërkesë të inspektorit të autorizuar për ambientin jetësor, personi i autorizuar i organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, është i obliguar që të marrë pjesë në kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

## **2.4. Procedimi i inspektorit të ekonomisë ujore, i inspektorit shtetëror të ambientit jetësor dhe i inspektorit të autorizuar të ambientit jetësor**

## Neni 234

### **Procedimi i inspektorit të ekonomisë së ujërave, i inspektorit shtetëror për ambientin jetësor dhe i inspektorit të autorizuar për ambientin jetësor**

(1) Përveç dispozitave të këtij ligji, gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i ekonomisë së ujërave, inspektori shtetëror i ambientit jetësor ose inspektori i autorizuar i ambientit jetësor (në tekstin e mëtejshëm: inspektori), në mënyrë përkatëse i zbatojnë dispozitat e Ligjit për ambientin jetësor dhe Ligji për mbikëqyrje inspektuese.

(2) Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori konstaton se personat juridikë dhe fizikë nuk u përmbahen ligjeve dhe rregullave të tjera, rregullave teknike, standardeve dhe akteve të tjera të përgjithshme, me procesverbal i konstaton parregullsitë e përcaktuara dhe në aktvendimin e përcakton afatin në të cilin të njëjtat duhet të mënjanohen.

(3) Në qoftë se subjektet nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk veprojnë në përputhje me aktvendimin e inspektorit dhe nuk i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar të përcaktuara me aktvendimin, inspektori parashton kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para organit ose gjyqit kompetent, gjegjësisht procedurë penale para organit ose gjyqit kompetent, si edhe fillon procedurë për heqjen e lejeve dhe autorizimeve të fituara, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin për ambientin jetësor.

(4) Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori konstaton se subjektet nga paragrafi (2) i këtij neni nuk u përmbahen ligjeve dhe rregullave të tjera, rregullave teknike, standardeve dhe akteve të tjera të përgjithshme edhe përsëri përcaktimit të afatit në të cilin parregullsitë duhet të mënjanohen, inspektori ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, gjegjësisht të procedurës penale para gjyqit kompetent, respektivisht para organit.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, inspektori procedon sipas llojit të kundërvajtjes së përcaktuar në dispozitat e kundërvajtjes të këtij ligji dhe të Ligjit për ambientin jetësor.

(6) Në rastet kur do të konstatohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe për shëndetin e njerëzve, inspektori jep urdhër me gojë për mënjanimin urgjent dhe të pashtyeshëm të mangësive të përcaktuara të cilat në mënyrë procesverbale do t'i konstatojë në bashkëpunim me Inspektoratin Sanitar-Shëndetësor Shtetëror, si edhe i lajmëron edhe inspektorët tjerë kompetent ose organet tjera shtetërore për parregullsitë e përcaktuara dhe do të kërkojë intervenimin e tyre.

(7) Nëse parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (6) i këtij neni, paraqesin rrezik për ujërat, për jetën dhe shëndetin e njerëzve, inspektori menjëherë jep urdhër me gojë me të cilin e ndalon punën në instalimin, në objektin, në stabilimentin, në aparat, si edhe përdorimin e mjeteve dhe të pajisjes për bërjen e veprimtarisë.

(8) Në rastet nga paragrafi (7) i këtij neni, inspektori merr aktvendim me shkrim në afat prej 48 orësh nga dhënia e urdhrimit me gojë.

(9) Në qoftë se me aktvendimin e lëshuar nga inspektori kompetent, përcaktohet masë me qëllim që të parandalohet shkaktimi i dëmit mbi ambientin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve, ndërsa personi juridikë ose fizikë i cili është ngarkuar me aktvendimin, nuk i ka zbatuar masat në afatin e përcaktuar në aktvendimin, inspektori kompetent është i obliguar të parashtrojë propozim pranë ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për çështjet nga sfera e ambientit jetësor, me qëllim që të miratohet aktvendim për zbatimin e atyre masave nga ana e personit tjetër juridikë ose fizikë ose nga organi kompetent, a në llogari të personit juridikë ose fizikë i cili ka qenë i ngarkuar me aktvendimin për zbatimin e masave të përcaktuara në të njëjtin.

## **2.5. Inspektorët sanitarë-shëndetësorë dhe inspektorët shtetërorë për ushqim**

### **Neni 235**

#### **Fushëveprimi i inspektorëve sanitarë-shëndetësorë dhe i inspektorëve shtetërorë për ushqim**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nga fushëveprimi i tij, inspektori sanitar-shëndetësor bën:

- 1) kontroll dhe inspektim nëse është bërë shënimi i zonave të mbrojtura të ujit të dedikuar për konsumim nga ana e njeriut dhe i regjimin në zonat e mbrojtura të ujit të dedikuar për konsumimin nga njeriu (neni 98 dhe neni 100);
- 2) kontroll dhe inspektim nëse është bërë shënimi i zonave për banjë dhe nëse respektohet regjimi në ujërat për banjë (neni 101);
- 3) kontroll të kualitetit të ujërave për banjë dhe për rekreim;
- 4) mbikëqyrje sanitare-higjienike mbi aparatet dhe mbi stabilimentet për pastrimin e ujërave të zeza dhe
- 5) mbikëqyrje sanitare-higjienike mbi zonat e mbrojtura më të gjëra.

(2) Inspektori shtetëror i ushqimit, bën kontroll mbi sigurinë dhe mbi cilësinë e ujit për konsumim nga njeriu, si edhe mbikëqyrje të sistemeve publike për furnizim me ujë për pirje, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e zonës sanitare mbrojtëse më të ngushtë dhe të rreptë, në përputhje me rregullat për sigurinë e ushqimit.

(3) Me kërkesë të inspektorit nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) i këtij neni, personi i autorizuar i organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme, është i obliguar që të marrë pjesë në kryerjen e punëve nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2) i këtij neni.

### **Neni 236**

#### **Procedimi i inspektorëve sanitarë-shëndetësorë dhe i inspektorëve shtetërorë për ushqim**

(1) Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor, përveç dispozitave të këtij ligji, mbikëqyrjen inspektuese e bën edhe në përputhje me Ligjin për inspektim sanitar dhe shëndetësor dhe me këtë ligj.

(2) Drejtoria e ushqimit, përmes inspektorit shtetëror për ushqim, përveç dispozitave të këtij ligji, mbikëqyrjen inspektuese e bën edhe në përputhje me Ligjin për sigurinë e ushqimit.

(3) Krahas dispozitave të këtij ligji, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektorët nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni në mënyrë adekuate i zbatojnë edhe dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

## **2.6. Inspektori shtetëror i bujqësisë**

### **Neni 237**

#### **Fushëveprimi i inspektorit shtetëror të bujqësisë**

(1) Gjatë mbikëqyrjes inspektuese nga fushëveprimi i tij, inspektori shtetëror i bujqësisë ka të drejtë:

- të bëjë kontroll dhe të përcaktojë nëse zbatohen rekomandimet për praktikë të mirë bujqësore në zonat sensibile në nitrate (neni 102, paragrafi (1)),
- të bëjë kontroll dhe të përcaktojë nëse zbatohen masat e përcaktuara në planin operativ për mbrojtjen e ujërave nga ndotja, e shkaktuar nga nitratat nga burimet bujqësore (neni 102, paragrafi (3)) dhe

- të bëjë kontroll dhe të përcaktojë nëse përdoren plehra artificialë, mjete për mbrojtjen e bimëve dhe të prodhimeve biocide, në kundërshtim me nenin 105, paragrafi (2) i këtij ligji.

(2) Inspektorati shtetëror i bujqësisë, përveç dispozitave të këtij ligji, mbikëqyrjen inspektuese e bën edhe në përputhje me Ligjin për inspektimin bujqësor dhe Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

## **2.7. Autorizimi gjatë bërjes së mbikëqyrjes inspektuese**

### **Neni 238**

#### **Aktvendimet dhe urdhrat dhe masat tjera**

Inspektori kompetent nga nenet 230, 232, 233, 235 dhe 237 të këtij ligji (në tekstin e mëtejshëm: inspektori kompetent), është i pavarur në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, merr aktvendime dhe ndërmerr masa të tjera në suazat e të drejtave, të obligimeve dhe të autorizimeve të përcaktuara me këtë ligj.

### **Neni 239**

#### **Procesverbali**

Për mbikëqyrjen e bërë inspektuese dhe për masat e propozuara, inspektori përgjegjës përpilon procesverbal në të cilin veçanërisht futen konstatimet për gjendjen dhe masat e propozuara, si edhe merr aktvendimet me të cilat ngarkohen personat juridikë dhe fizikë që të ndërmarrin masa, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin për ambientin jetësor.

### **Neni 240**

#### **Procedura**

(1) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror për mjedis jetësor nga neni 232 i këtij ligji dhe inspektorit të ekonomisë së ujërave nga neni 234 i këtij ligji, mund të parashtrahet në afat prej tetë ditëve nga pranimi i aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(2) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar për mjedis jetësor të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit nga neni 233 i këtij ligji, mund të parashtrahet në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(3) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorëve shtetërorë sanitare shëndetësore mund të parashtrahet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorëve shtetërorë të ushqimit, mund të parashtrahet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(5) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorëve shtetëror të bujqësisë, mund të parashtrahet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të



aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(6) Ankesa nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

## **Neni 241**

### **Obligimet e personave juridikë dhe fizikë gjatë bërjes së mbikëqyrjes**

Me qëllim që të zbatohet mbikëqyrja inspektuese, personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar që t'i mundësojnë inspektorit kompetent të drejtë në qasje dhe inspektim në lokalet dhe në dokumentacionin e personit juridikë dhe fizikë, t'ua dorëzojnë të dhënat e kërkuara, sqarimet dhe lajmërimet, të bëjnë matje dhe të marrin ekzemplarë dhe të grumbullojnë prova në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin për ambientin jetësor.

## **Neni 242**

### **Përgjegjësia e personave zyrtarë**

(1) Personat zyrtarë, në organin e administratës shtetërore, kompetentë për zbatimin e këtij ligji të përcaktuar në nenin 224 të këtij ligji, si edhe personat zyrtarë në organet e komunës, të qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit, janë të obliguar, si persona përgjegjës, me kohë dhe në mënyrë efikase t'i ndërmarrin të gjitha masat dhe procedurat e domosdoshme për zbatimin e këtij ligji.

(2) Në qoftë se gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë ligj, konstatohen kundërvajtje nga ana e personit juridikë ose fizikë, të bëra me veprim dhe/ose mosbërjen dhe/ose lëshimin e mbikëqyrjes së detyrueshme mbi personin tjetër i cili ka qenë i autorizuar të veprojë në emër të personit juridikë, si edhe paraqitja e të dhënave dhe të dokumenteve të pasaktë dhe të rrejshëm, personat zyrtarë janë të obliguar të ngritin iniciativë ose kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të Ligjit për ambientin jetësor.

(3) Personat juridikë dhe fizikë për të cilët janë paraparë të drejta dhe obligime të përcaktuara me këtë ligj, në qoftë se konstatojnë kundërvajtje ose tejkalim të autorizimeve nga ana e personave zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni, të bëra me veprime dhe/ose mosbërje, janë të obliguar që për këtë ta lajmërojnë ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për zbatimin e këtij ligji në përputhje me nenin 224 të këtij ligji, respektivisht kryetarin e komunës, e qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit.

(4) Në rast të përcaktimit të cenimeve të kompetencave të personave zyrtarë nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për zbatimin e këtij ligji në përputhje me nenin 224 të këtij ligji, respektivisht kryetari i komunës, i qytetit të Shkupit dhe i komunave në qytetin e Shkupit, është i obliguar që të ngrejë procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së personit zyrtarë, në përputhje me këtë ose me ligj tjetër.

(5) Në qoftë se për shkak të gabimit të personit zyrtar në zbatimin e këtij ligji, personi juridikë ose fizikë ka pësuar dëm, dëmin do ta kompensojë personi zyrtar në përputhje me ligjin.

## **Neni 242-a**

### **Procedura për edukim**

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror për mjedis jetësor përkatësisht inspektori i ekonomisë së ujërave, konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 244 paragrafi (1) pikat 2, 20, 26 dhe 36 dhe 246 paragrafi (1) pikat 1, 4, 6 dhe 11 të këtij ligji, është i detyruar që të përpilojë procesverbal në të cilën do të vërtetojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe dorëzim të njëkohshëm të ftesës për zbatimin e edukimit të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Edukimin e organizon dhe zbaton inspektori shtetëror për mjedis jetësor përkatësisht inspektori i ekonomisë së ujërave, në afat jo më shumë se tetë ditë nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të konstatuara të njëjta ose të njëllota për një ose më tepër subjekte.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është zbatuar.

(6) Nëse personi ose subjekti për të cilin zbatohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtën e kryen, do të konsiderohet se është edukuar lidhur me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor përkatësisht inspektori i ekonomisë së ujërave i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese vërteton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin ndërpritet procedura e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor përkatësisht inspektori i ekonomisë së ujërave i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese vërteton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashton kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para Komisionit për Kundërvajtje.

(9) Inspektori shtetëror për mjedis jetësor përkatësisht inspektori i ekonomisë së ujërave i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese mban evidencë unike, për edukimin e realizuar në mënyrë të përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 242-b**

### **Veprim pas fletëparaqitjes nga personi fizik ose juridik**

(1) Inspektorët kompetentë janë të detyruar që në afat prej shtatë ditësh të veprojnë ndaj iniciativave ose fletëparaqitjeve, për ngritjen e procedurës inspektuese.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektorët kompetentë janë të detyruar që ta njoftojnë parashtruesin e iniciativës ose fletëparaqitjes për ngritjen e procedurës inspektuese në afat prej tetë ditësh nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

## **XIII. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE**

### **Neni 243**

## Sanksionet për kundërvajtje për personat juridikë

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për bërjen e kundërvajtjes personit juridik nëse:

- 1) lundron në kundërshtim me dispozitat e nenit 19 të këtij ligji;
- 2) derdhjet në ujërat, në tokën buzë bregut dhe në vendbanimet ujore bëhet pa leje, në kundërshtim me nenin 78 të këtij ligji;
- 3) derdhin ujëra të zeza ose derdhin ose hedhin materie dhe substanca në recipientët, pa leje paraprakisht të siguruar për derdhjen në ujërat (neni 79);
- 4) në rast të emisionit që do të mund të hynte në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në ujërat sipërfaqësore, në ujërat nëntokësore ose në sistemin e kanalizimit, personi juridik përgjegjës për punën e stabilimentit, nuk e informon menjëherë organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor, si edhe nuk i ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara për pengimin dhe për zvogëlimin e pasojave negative për ambientin jetësor (neni 108, paragrafi (4));
- 5) ujërat urbane të zeza të pastruara, përdoren përsëri pa lejen paraprakisht të siguruar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 117);
- 6) lymë që fitohet nga pastrimi i ujërave urbane të zeza, përsëri shfrytëzohet pa leje paraprakisht të siguruar;
- 7) për nevojat e furnizimit publik me ujë ose për nevoja komerciale, personat juridikë ose fizikë nxjerrin ose marrin ujë të dedikuar për konsumimin nga njeriu, nuk e përcjellin cilësinë dhe sasinë e ujërave të marrë ose të nxjerrë, nuk i ruajnë të dhënat për matjet dhe analizat e bëra dhe të dhënat, nuk i dërgojnë pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor, si edhe pranë organit kompetent për sigurinë e ushqimit dhe organet kompetent për mbrojtjen shëndetësore (neni 148, paragrafi (4));
- 8) personi juridik i cili administron me sistemin e furnizimit me ujë, nuk instalon dhe nuk i mirëmban në gjendje të rregullt instrumentet për matjen dhe për analizën e cilësisë së ujit të lëndës së parë në gjendjen e tij burimore; ujin e pastruar pas dezinfektimit dhe ujin në vendet e furnizimit prej ku shfrytëzohet për konsumim nga njeriu (neni 148, paragrafi (8));
- 9) në përputhje me rregullat për mbrojtjen e natyrës, janë kompetent për menaxhimin me rajonet e mbrojtura, nuk bëjnë monitorim të ujërave në ato rajone dhe nuk i dërgojnë rezultatet pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (nenin 155, paragrafi (1)).
- 10) të dhënat për përcaktimin e shkallës së ndotjes së ujërave të zeza industriale, të ujërave atmosferikë dhe urbanë, të ujërave nga deponitë, si edhe ndikimin e tyre të dëmshëm mbi kualitetin e ujërave në recipientin dhe për shkak të përcaktimit të burimeve të tjera të ndotjes së ujërave në rajonin e derdhjes, si edhe të dhëna të tjera të duhura, nuk i dërgojnë pranë organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor, në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në Ligjin për ambientin jetësor (neni 161).
- 11) bën matje dhe nuk i dërgon të dhënat pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me këtë ligj (neni 165, paragrafi (3)) dhe
- 12) menaxhojnë me sistemet e ekonomisë ujore dhe hidromeliorative, dhe të dhënat nga evidenca nuk i dërgojnë pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor dhe pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e bujqësisë, në përputhje me nenin 174, paragrafi (4) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 700 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në personin juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i

kumtohet personit zyrtarë në personin juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit fizikë, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë në denarë, do të kumtohet për personin fizikë nëse:

- 1) nuk u mundësojnë inspektorëve përgjegjës, të drejtë në inspektim;
- 2) nuk i siguron të gjitha informatat e duhura, të domosdoshme për zbatimin e mbikëqyrjes në afatin e përcaktuar;
- 3) jep deklaratë të rrejshme dhe të dhëna të pasakta dhe
- 4) nuk legjitimohet në vendin e mbikëqyrjes inspektuese, dhe nuk i jep të dhënat e tij personale me kërkesë të inspektorëve kompetent.

(6) Organi kompetent për kumtimin e kundërvajtjeve nga paragrafët (1) dhe (5) të këtij neni, është Komisioni i Kundërvajtjes i formuar në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor.

(7) Në qoftë se, me veprimtaritë nga paragrafi (1), pikat prej 2 deri më 12 të këtij neni, shkaktohet dëm më i madh për jetën dhe shëndetin e njerëzve, përcaktohet sanksion në përpjesëtim me lartësinë e dëmit të shkaktuar, por më së shumti deri në shumën e trefishtë të shumës së përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni.

(8) Në qoftë se ekziston rrezik që personi juridik nga paragrafi (1), pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të këtij neni, përsëri të bëjë kundërvajtje të rrezikshme për jetën dhe për shëndetin e njerëzve, mund t'i kumtohet sanksion ndalesë e përkohshme e kryerjes së veprimtarisë së caktuar, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh.

(9) Kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni, është bërë me qëllim që bërsi për vete ose për person tjetër të përfitojë dobi pronësore ose, kundërvajtja është bërë nga grupi i organizuar i personave i përbërë prej më së pakti tre personave, Komisioni i Kundërvajtjeve mund të kumtojë gjobë në lartësi prej 15.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(10) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1), pika 1 dhe paragrafi (5) i këtij neni, inspektori kompetent, sanksionin për kundërvajtjen mund ta kumtojë aty për aty me dorëzimin e ftesës për pagimin e gjobës, të cilën bërësi është i obliguar ta paguajë brenda tetë ditëve.

(11) Në qoftë se, gjoba nga paragrafi (10) i këtij neni nuk paguhet në afatin e përcaktuar, inspektori kompetent është i obliguar të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes para Komisionit të Kundërvajtjes.

## Neni 244

### Sanksionet për kundërvajtje për personat juridikë

(1) Gjobë në shumë prej 6.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) nuk e lajmëron organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor, për fillimin e nxjerrjes ose të kullimit të ujërave (neni 18, paragrafi (2));
- 2) hap puse në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji;
- 3) derdh ujëra të zeza ose derdh ose hedh materie dhe substanca në recipientët, si edhe vajra të zeza në kanalizim ose në sistemin e kullimit të ujit, në trupa ujorë sipërfaqësore ose nëntokësore, si edhe në tokat buzë bregore dhe në vendbanimet ujore, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në lejen për derdhjet në ujërat, respektivisht lejen e integruar ekologjike në përputhje me ligjin (neni 79);
- 4) bën aktivitete në kundërshtim me nenin 104 të këtij ligji;
- 5) ndërtoni i stabilimenteve dhe i objekteve ose çfarëdo punë dhe aktivitete që përfshijnë përpunimin, procedimin, magazinimin, mënjanimin

ose transportimin e materieve dhe substancave të rrezikshme dhe hedhurinën e ngurtë ose të lëngshme, bëhet në kundërshtim me nenin 105 të këtij ligji;

6) përdor plehra artificialë, mjete për mbrojtjen e bimëve dhe prodhime biocide, në distancë deri më 10 m<sup>3</sup> nga bregu i ujërave sipërfaqësorë (neni 105);

7) objektet dhe stabilimentet nga neni 108, paragrafi (1) të këtij ligji, ndërtohen ose fillojnë me punë pa e siguruar lejen e integruar ekologjike, pa mendimet ose pëlqimet të cilat nevojiten në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor (neni 108);

8) derdh efluent nga hedhura e lëngshme industriale dhe bujqësore, dhe ujëra të zeza urbane në kanalizimin ose në sistemin e kullimit të ujit, në trupa ujorë sipërfaqësorë ose nëntokësorë, si edhe në toka buzë bregore dhe në vendbanime ujore, në kundërshtim me nenin 110 të këtij ligji;

9) personi juridikë dhe fizikë, ekonomitë e ujërave si edhe persona të tjerë të cilët nuk i përmbushin masat e parapara me planet operative për mbrojtjen nga vërshimet, në përputhje me nenin 126 të këtij ligji;

10) personi juridikë i cili udhëheq me digat dhe me akumulimet dhe me pendët mbrojtëse, nuk i shfrytëzon dhe nuk i mirëmban në mënyrën e cila e siguron pranimin e valëve vërshues, si edhe sigurimin e mbrojtjes së tyre në përputhje me nenin 129 të këtij ligji;

11) nuk e monitoron gjendjen me nivelin dhe me sasinë e ujërave të akumuluar në akumulimet, si edhe të sasisë së ujërave që hyjnë dhe që derdhen nga to, dhe për këtë nuk e lajmërojnë organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (nenin 130);

12) në mbrojtjen dhe në mirëmbajtjen e shtretërve lumorë natyrorë dhe të rregulluar, dhe të brigjeve të rrjedhave ujore, të liqeve dhe të akumulimeve, vepron në kundërshtim me nenin 131 të këtij ligji;

13) nuk i ndërmerren masat për rregullimin e rrëkeve, në përputhje me nenin 141 të këtij ligji;

14) derdh ujëra të zeza ndërsa nuk instalon instrumente për matjen e sasive të derdhura të ujërave, dhe analizimin e kualitetit të tyre dhe nuk i mirëmban instrumentet në gjendje të rregullt, nuk mban shënime për matjet e bëra dhe këto të dhëna, nuk i dorëzon pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 150, paragrafi (1));

15) derdh ujëra të zeza nga neni 108 i këtij ligji, nuk instalon instrumente për matjen e sasive të derdhura të ujërave dhe analizimin e kualitetit të tyre, dhe nuk i mirëmban instrumentet në gjendje të rregullt, nuk mban shënime për matjet e bëra dhe këto të dhëna nuk i dorëzon pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 150, paragrafi (2));

16) është pronar ose shfrytëzues i sistemeve ujore ose i sistemeve hidromeliorative për ujitje, nuk i mat sasinë e marra ose të nxjerra të ujërave dhe nuk e përcjell kualitetin e tyre në vendet e nxjerrjes ose të marrjes, si edhe të dhënat për sasinë dhe për cilësinë e ujit nuk i dorëzon pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 151, paragrafi (1));

17) është pronar ose shfrytëzues i sistemeve hidromeliorative për kullimin e tokës në vendet e derdhjes së ujit nga kullimi në recipientin, nuk e mat sasinë e ujit të derdhur dhe nuk e përcjell cilësinë e tij, si edhe të dhënat për sasinë dhe për cilësinë e ujit nuk i dorëzon pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 152, paragrafi (1));

18) nuk e mat sasinë e ujit që shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike në vendet e marrjes, si edhe të dhënat për sasinë e matura nuk i dorëzon pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 153, paragrafi (1));

19) nxjerr ose merr më shumë se 10 m<sup>3</sup> ujë, për dedikime të tjera të ndryshme nga ato të cekura në nenet 148, 151, 152, 153 të këtij ligji,

20) nuk e mat sasinë e ujit të nxjerrë ose të marrë dhe kualitetin e tij dhe të dhënat nga këto matje nuk i dorëzon pranë organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (neni 154, paragrafi (1));

21) në rast të keqësimit ose të rrezikut për keqësimin e ujit ose të trupit ujqorë të cilin e mbikëqyr, nuk e informon menjëherë organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor, për shkak të ndërmarrjes së masave të domosdoshme dhe nuk i ndërmerr masat përkatëse (neni 158);

22) merr ujë nga trupi ujqorë, për shkak të sigurimit të ujit për furnizimin publik me ujë, për industrinë, për ujitjen ose për cilado dedikime të tjera, nuk instalon dhe nuk i mirëmban në gjendje të rregullt instrumentet matëse në vendin e marrjes, nuk i mat sasinë dhe cilësinë e ujit të marrë dhe nuk i ruan të dhënat (neni 165, paragrafi (1));

23) derdh ujë të shfrytëzuar ose ujëra të zeza në trupin ujqorë ose në ekosistemet ujqore, dhe nuk instalon dhe nuk i mirëmban në gjendje të rregullt instrumentet matëse në vendin e derdhjes, nuk i mat sasinë dhe cilësinë e ujit, dhe nuk i ruan të dhënat për këto parametra (neni 165, paragrafi (2));

24) menaxhon me objektet dhe stabilimentet e ekonomisë ujqore dhe nuk e informon organin kompetent, në rast të rrezikut për objektet e ekonomisë ujqore dhe për stabilimentet, dhe nuk i ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet e domosdoshme për zvogëlimin ose për mënjanimin e rrezikut. (neni 166, paragrafi (3));

25) menaxhojnë me objektet dhe me stabilimentet e ekonomisë ujqore, dhe nuk vendosin dhe mbajnë evidencë për ato objekte dhe stabilimente (neni 171, paragrafi (1));

26) të cilët menaxhojnë me sistemet hidromeliorative (ekonomitë ujqore dhe bashkësitë ujqore), nuk vendosin dhe nuk e mbajnë evidencën e sipërfaqeve të përfshira me sistemet hidromeliorative, në përputhje me dokumentacionin investues-teknik sipas së cilit është ndërtuar sistemi (neni 171, paragrafi (2));

27) merr ujë dhe nuk i mënjanon të gjithë ujërat e shfrytëzuar, të cilët rrjedhin nga marrja e ujërave në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 172);

28) ndërton objekte të reja ose e bën rekonstruktimin ose ndërtimin shtesë të objekteve ekzistuese, të cilat gjenden në ose përskaaj ujërave sipërfaqësorë, objekte të cilat kalojnë përmes ose nën ujërat nëntokësorë ose po objekte të cilët janë vendosur në afërsinë e ujërave sipërfaqësorë ose tokave buzë bregut, ose rekonstruktimin ose ndërtimin shtesë të objekteve ekzistuese të ekonomisë ujqore, pa pëlqimin e ekonomisë ujqore (neni 174);

29) fillon me punë instalimi për të cilin në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor, është paraparë që detyrimisht të sigurohet leje e integruar ekologjike, (neni 177, paragrafi (1));

30) fillon me ndërtimin para pranimit të aktvendimit, për studimin për vlerësimin e ndikimit mbi ambientin jetësor, nën kushte, në mënyrën dhe në procedurën e përcaktuar me Ligjin për ambientin jetësor (neni 177);

31) gjatë ndërtimit, rekonstruktimit ose ndërtimit shtesë të objekteve dhe të stabilimenteve, nuk u përmbahet kushteve që përmbahen në pëlqimin e ekonomisë së ujërave (neni 180);

32) nuk i ndërmerr masat e përcaktuara nën mbikëqyrjen dhe nën udhëzimet e organit kompetent, në rastet kur shmangia nga vlerat dhe nga standardet për kualitet, ka të bëjë me sistemin vendor për furnizimin me ujë ose me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tij;

33) shfrytëzon ose përdor ujë për ujitjen dhe për pirjen e kafshëve, në kundërshtim me ndalesën nga neni 193 i këtij ligji.

34) eksploatimi dhe oskultimi i çdo dige, i objekteve shoqëruese i akumulimit me rëndësi të veçantë, nuk është në përputhje me dokumentacionin teknik respektivisht nuk vepron në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin teknik, dhe me kushtet e përcaktuara në lejen (neni 198, paragrafi (1)) dhe

35) menaxhojnë me digat dhe me akumulimet, nuk bëjnë mbikëqyrje teknike dhe nuk përpilojnë raporte vjetore të veçanta (neni 198, paragrafi (2)).

(2) Gjorbë në shumë prej 800 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 700 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit zyrtarë në personin juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit fizikë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Organi kompetent për kumtimin e kundërvajtjeve nga paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni, është Komisioni i Kundërvajtjes i formuar në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor.

(6) Në qoftë se, për shkak të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni shkaktohet dëm më i madh mbi jetën dhe shëndetin e njerëzve, kumtohet sanksioni në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar, por më së shumti deri në shumën e pesëfishtë të shumës së përcaktuar në paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni.

(7) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik nga paragrafi (1) i këtij neni, i kumtohet sanksion plotësues ndalesë për kryerjen e veprimtarisë së personit juridikë, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh, me përjashtim të personave juridikë të cilët kryejnë veprimtari me interes publik.

(8) Në qoftë se ekziston rrezik që personi juridik nga paragrafi (1), pikat 1, 3, 4, 5, 6, 8, 13, 14, 19 dhe 22 të këtij neni, përsëri të bëjë kundërvajtje të rrezikshme për jetën dhe për shëndetin e njerëzve, mund t'i kumtohet sanksion ndalesë e përkohshme e kryerjes së veprimtarisë së caktuar, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh.

(9) Kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni, është bërë me qëllim të vetëm që bërsi për vete ose për person tjerët të përfitojë dobi pronësore, ose kundërvajtja është bërë nga grupi i organizuar i personave i përbërë prej më së pakti tre personave, Komisioni i Kundërvajtjeve mund të kumtojë gjobë në lartësi prej 22.000 euro në kundërvlerë në denarë.

## Neni 245

### Sanksionet kundërvajtëse për personat juridikë

(1) Gjobë në shumë prej 8.000 euro deri në 20.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) bën ndryshime të regjimit të ujërave, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 12, paragrafi (2));
- 2) ujin e shfrytëzon në kundërshtim me nenin 14 të këtij ligji;
- 3) përcakton prioritet në shfrytëzimin e ujërave, në kundërshtim me prioritetet e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji;
- 4) arkëton kompensim për shfrytëzimin e përgjithshëm të ujërave, në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji;
- 5) është pronar i tokës ose bartësi i të drejte tjetër reale, nxjerr dhe shfrytëzon ujë nëntokësorë, në kundërshtim me nenin 17, paragrafi (2) i këtij ligji;
- 6) bën nxjerrje të përkohshme të ujit, për shkak të kullimit të tokës në kundërshtim me nenin 18, paragrafi (1) të këtij ligji;
- 7) e shfrytëzon ujin në kundërshtim me kufizimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji;
- 8) vepron në kundërshtim me obligimet dhe me kufizimet nga neni 22 i këtij ligji;
- 9) realizon të drejtë ujore në kundërshtim me mënyrën dhe me dedikimin e përcaktuar në lejen ose në koncesionin (neni 25);
- 10) realizon të drejtë ujore me trashëgimi, në kundërshtim me nenin 27 të këtij neni;
- 11) ndërmerr aktivitete të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë mbi regjimin e ujërave dhe /ose morfologjinë e trupit ujqorë, pa lejen nga organi përgjegjës (neni 28);
- 12) ia rrezikon të drejtën bartësit të lejes, për realizimin e papenguar të së drejtës nga leja;

- 13) vepron në kundërshtim me aktvendimin për menaxhimin e përkohshëm të dhunshëm (neni 44);
- 14) ndërmerr aktivitete të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë mbi regjimin e ujërave dhe /ose morfologjinë e trupit uJORë, pas pushimit të vlefshmërisë së lejes (neni 47);
- 15) ndërmerr aktivitete të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë mbi regjimin e ujërave dhe /ose morfologjinë e trupit uJORë, edhe përskaj kufizimit të së drejtës uJore (neni 49);
- 16) ndërmerr aktivitete të cilat do ta rrezikonin gjendjen kualitative dhe kuantitative të trupit uJORë, të dedikuar për konsumim nga njeriu në zonat e mbrojtura (neni 100, paragrafi (2));
- 17) personi juridikë i cili menaxhon me sistemin për furnizim me ujë, nuk e rrethon dhe nuk i ndërmerr masat tjera të nevojshme për mbrojtjen dhe për sigurimin e tokës në zonën më të ngushtë të mbrojtur, në përputhje me nenin 100 të këtij ligji;
- 18) bën ndërtimin e objekteve dhe bërja e veprimeve dhe aktiviteteve të tjera, në kundërshtim me nenin 100, paragrafi (5) i këtij ligji;
- 19) Objektet dhe stabilimentet të cilat në procesin e prodhimit, të përpunimit, të mbushjes dhe të magazinimit, shfrytëzojnë ose përdorin materie të rrezikshme dhe, i ndërton, i vendos, i punon dhe i mirëmban në mënyrë me të cilën bëhet ndotje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ujërave (neni 108);
- 20) bën derdhjen e drejtpërdrejtë të materieve dhe substancave me prioritet dhe të materieve dhe substancave ndotëse, në ujërat nëntokësorë edhe përskaj ndalesës nga neni 111 të këtij ligji;
- 21) bën magazinimin ose mënjanimin e ndonjë materies ose substancës me prioritet, ose bërja e aktivitetit tjetër me të cilin shkaktohet derdhja e tërthortë e materieve dhe e substancave me prioritet ose e materieve dhe e substancave ndotëse në ujërat nëntokësorë, pa sigurimin paraprak të lejes nga neni 79 i këtij ligji, si edhe në kundërshtim me nenin 111 të këtij ligji;
- 22) derdh ujëra të zeza industriale në kundërshtim me mënyrën dhe me kushtet e dhëna në lejen nga neni 115 i këtij ligji, respektivisht në lejen e integruar ekologjike nga Ligji për ambientin jetësor;
- 23) në rast të rrezikut nga rrënimi i digave, nga depërtimi i pendëve mbrojtëse, si edhe nga derdhja ose nga vërshimi i sasive më të mëdha të ujit nga akumulimet që mund të shkaktojnë vërshime, ekonomia e ujërave dhe persona të tjerë juridikë nga neni 129 i këtij ligji, nuk e sigurojnë lajmërimin dhe alarmimin e popullatës së rajonit të rrezikuar nga (neni 130, paragrafi (2));
- 24) me sjelljen e vet, me përpunimin jo të rregullt të sipërfaqeve ose me veprim tjetër, krijojnë erozion me çka u shkaktojnë dëme edhe objekteve të tjera dhe nuk i ndërmarrin masat mbrojtëse për pengimin e erozionit, si edhe masat për mënjanimin e pasojave të dëmshme (neni 138);
- 25) nxjerr rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati dhe brigjet e trupave uJore sipërfaqësore pa leje nga neni 142 i këtij ligji;
- 26) gjatë nxjerrjes së rërës, zhavorrit dhe gurit, nuk u përmbahet kushteve në lejen nga neni 142 i këtij ligji;
- 27) vepron në kundërshtim me nenin 142-b të këtij ligji;
- 28) për nevojat personale ose për nevojat e ekonomisë së vet familjare, nxjerr ose merr më shumë se 10 m<sup>3</sup> ujë në ditë, të dedikuar për konsumim nga njeriu (neni 148, paragrafi (2));
- 29) vepron në kundërshtim me nenin 167 të këtij ligji;
- 30) menaxhon me objektet e ekonomisë së ujërave dhe e kufizon ose e ndalon shfrytëzimin e ujërave, në kundërshtim me prioritetet e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji (neni 169, paragrafi (1)).
- 31) menaxhon me objektet e ekonomisë së ujërave dhe nuk i lajmëron shfrytëzuesit e shërbimit të ekonomisë së ujërave, për kufizimin dhe për furnizimin e përkohshëm me ujë dhe pranimin e ujit si dhe shkaqet për këtë (neni 169, paragrafi (3));
- 32) si dhënës i shërbimit të ekonomisë së ujërave, e përjashton nga rrjeti i shërbimeve konsumatorin, në kundërshtim me shkaqet e cekura në nenin 170 të këtij ligji;
- 33) si pronar ose bartës i të drejtave tjera reale mbi truallin fqinjë të tokës nën ujë dhe të tokës buzë bregut, në pronësi të Republikës së



Maqedonisë, e cila shfrytëzohet ose merret për nevojat e objekteve të ekonomisë së ujërave, nuk mundëson qasje deri te objektet e ekonomisë ujore dhe shfrytëzimin e tokës për të gjitha aktivitetet për nevojat e ndërtimit, të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes së objekteve të ekonomisë ujore (neni 173, paragrafi (1));

34) Ujërat për: furnizimin e popullatës me ujë, për institucionet shëndetësore dhe për personat juridikë nga sfera e veterinarisë, për nevojat e mbrojtjes, për industrinë për prodhimin dhe për përpunimin e produkteve ushqimore dhe për dhënien ujë begatisë, për të cilat nevojitet ujë me cilësi për pirje, i shfrytëzon për dedikime të tjera dhe në mënyrë të kundërt nga dispozitat e këtij ligji (neni 181, paragrafi (1));

35) bën furnizimin me ujë të dedikuar për konsumim nga njeriu, i cili nuk i përmbush standardet dhe vlerat për kualitet, ose mund të paraqesë rrezik për shëndetin e njeriut (neni 183);

36) nuk i ndërmer masat e duhura me qëllim të sigurimit të ujit për pirje në sasi të mjaftueshme, në përputhje me ligjin (neni 183);

37) nuk e shfrytëzon dhe nuk e mirëmban sistemin vendor për furnizim me ujë, në mënyrë e cila nuk do të sjell deri në zvogëlimin e cilësisë së ujit për pirje dhe do të mundësohet ujë në sasi të mjaftueshme (neni 185);

38) bën furnizimin me ujë të dedikuar për konsumim nga njeriu, me ç'rast nuk e bën dezinfektimin e ujit në përputhje me nenin 186 të këtij ligji;

39) në rast të shmangies nga vlerat dhe nga standardet për cilësi, të përcaktuara në përputhje me nenin 183 të këtij ligji, personi juridikë i cili bën furnizimin publik me ujë, nuk i ndërmer masat e duhura për sigurimin e rregullsisë dhe sigurisë shëndetësore të ujit, si edhe nuk i informon organet kompetente për mbrojtjen shëndetësore në pajtim me nenin 187 të këtij ligji;

40) bën furnizimin publik me ujë, konsumatorëve të caktuar përkohësisht ua kufizon shfrytëzimin, pa lajmërimin paraprak të konsumatorëve dhe të kryetarit të komunës, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, për kufizimin dhe për kohëzgjatjen e pritur, për zëvendësimin e furnizimit me ujë dhe masat që do t'i ndërmarrë (neni 188);

41) bën furnizimin publik me ujë, nuk vendos dhe nuk e informon popullatën e interesuar për furnizimin e përshtatshëm plotësues me ujë, në rastin kur me kufizimin janë prekur nevojat e popullatës për ujë të dedikuar për konsumim nga njeriu (neni 188);

42) qëllimisht ose nga pakujdesia, e shkakton dëmtimin ose mosfunksionimin e sistemit, për çka nevojitet riparimi ose me këtë shkaktohet ndotja ose shfrytëzimi i joqëllimshëm i ujit në përputhje me nenin 189;

44) digat dhe objektet shoqëruese nuk projektohen, nuk ndërtohen, nuk eksploatohen dhe menaxhohen në mënyrën e përcaktuar në dokumentacionin teknik, në përputhje me këtë ligj (neni 195, paragrafi (1));

44) nuk i përmbush masat e sanimit ose masat për kthimin në gjendjen e mëparshme, të domosdoshme për arritjen e qëllimeve të ambientit jetësor, të përcaktuara në përputhje me nenin 90 të këtij ligji;

45) menaxhon me digat në kundërshtim me nenin 199 të këtij ligji;

46) menaxhon me digat që nuk janë përcaktuar si diga me rëndësi të veçanta, nuk vendos dhe nuk organizon mbikëqyrje minimale teknike të digave me objektet shoqëruese dhe me akumulimet (neni 200).

47) hapja e puseve ose e shpimeve për shkak të nxjerrjes së ujit nga trupi uJOR nëntokësor, bëhet pa pëlqimin paraprakisht të siguruar nga organi i administratës shtetërore, përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e ambientit jetësor (nenin 201);

48) hapësi i pusit nuk vepron në përputhje me nenin 202 të këtij ligji, dhe nuk dërgon raport dhe

49) nuk e paguan kompensimin e përcaktuar në përputhje me këtë ligj.

(2) Gjorbë në shumë prej 1.400 deri në 2.500 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit përgjegjës në personin juridik, për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjorbë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i

kumtohet personit zyrtarë në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Organi kompetent për kumtimin e sanksioneve të kundërvajtjeve nga paragrafët (1), (2) (3) dhe (4) të këtij neni, është gjyqi kompetent.

(6) Në qoftë se për shkak të kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, shkaktohet dëm më i madh mbi jetën dhe mbi shëndetin e njerëzve, kumtohet sanksioni në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar, por më së shumti deri në shumën e shtatëfishtë të shumës së përcaktuar në paragrafët (1) të këtij neni.

(7) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridikë nga paragrafi (1), pikat 19, 20, 21 dhe 23 të këtij neni, i kumtohet sanksioni plotësues ndalimi i kryerjes së veprimtarisë së personit juridikë.

(8) Kur kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni është bërë me qëllim të vetëm që bërsi për vete ose për person tjerët të përfitojë dobi pronësore, gjyqi kompetent mund të kumtojë gjobë në lartësi prej 25.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(9) Në qoftë se konstatohet se kundërvajtja nga paragrafi (1) i këtij neni, është bërë nga grupi i organizuar i personave i përbërë prej së paku tre personave, gjyqi kompetent mund të kumtojë gjobë në lartësi prej 30.000 euro në kundërvlerë në denarë.

## Neni 246

### Sanksionet për kundërvajtje për personat fizikë

(1) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i kumtohet personit fizik për kundërvajtjen e bërë nëse:

1) për nevojat personale ose për nevojat e ekonomisë së vetë familjare, nxjerr ose shfrytëzon më shumë se 10 m<sup>3</sup> ujë nëntokësorë në ditë, nga trupat ujorë nëntokësorë dhe me këtë shkakton pasoja negative për atë ose për trupin ujqor fqinj (neni 17, paragrafi (2));

2) derdh vajra të zezë në kanalizimin ose në sistemin e kullimit, në trupa ujorë sipërfaqësorë ose nëntokësorë, si edhe në toka buzë bregore dhe në vendbanime ujore, në kundërshtim me nenin 79 të këtij ligji;

3) shfrytëzon objekte lundruese dhe instalime që vihen në lëvizje me motorë, në kundërshtim me ndalesat e përcaktuara në nenin 19 dhe 22 të këtij ligji;

4) vepron në kundërshtim me nenin 29, paragrafi (2) dhe paragrafi (3) i këtij ligji;

5) lundrojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 19 i këtij ligji;

6) hap puse në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji;

7) Personat juridikë ose fizikë përdorin plehra artificialë, mjete për mbrojtjen e bimëve dhe prodhime biocide në distancë deri më 10 m<sup>3</sup> nga bregu i ujërave sipërfaqësorë, në kundërshtim me nenin 105 të këtij ligji;

8) shfrytëzon ose përdor ujë për ujitjen dhe për pirjen e kafshëve. në kundërshtim me ndalesën nga neni 193 i këtij ligji;

9) si pronar ose bartës i të drejtave të tjera reale mbi truallin fqinjë të tokës nën ujë dhe të tokës buzë bregut në pronësi të Republikës së Maqedonisë, e cila shfrytëzohet ose merret për nevojat e objekteve të ekonomisë së ujërave, nuk mundëson qasje deri te objektet e ekonomisë së ujërave dhe shfrytëzimin e tokës për të gjitha aktivitetet për nevojat e ndërtimit, të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes së objekteve të ekonomisë së ujërave në përputhje me nenin 173, paragrafi (1) të këtij ligji;

10) qëllimisht ose nga pakujdesia, e shkakton dëmtimin ose mosfunksionimin e sistemit, për çka nevojitet riparimi ose me këtë shkaktohet ndotja ose shfrytëzimi i joqëllimshëm i ujit në përputhje me nenin 189 të këtij ligji dhe

11) ka hapur pus pa dërgimin e lajmërimit në përputhje me nenin 210 të

këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 600 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit fizik për kundërvajtje të kryer, nëse:

1) nxjerr rërë, çakëll dhe gurë me vlerë të vogël në vëllim deri 2 m<sup>3</sup> nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujorë sipërfaqësorë pa leje (neni 142).

(3) Për kundërvajtjet nga ky nen, inspektorët e ambientit jetësor, inspektorët e autorizuar për ambientin jetësor, inspektori i ekonomisë së ujërave, gjobën nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni mund ta kumtojnë aty për aty me dorëzimin e ftesës për pagimin e gjobës, të cilën bërësi është i obliguar ta paguajë brenda tetë (8) ditëve.

(4) Nëse bërësi i kundërvajtjeve nga ky nen, e pranon veprën me të cilën ngarkohet ose nëse personi zyrtar i autorizuar nga paragrafi (3) i këtij neni, kundërvajtjen e konstaton personalisht ose e përcakton me përdorimin e mjeteve dhe aparateve teknike përkatëse, personi zyrtar do të lëshojë urdhëresë pagese menjëherë.

(5) Konsiderohet se bërësi i kundërvajtjes, me nënshkrimin e pranimit të urdhëresës së pagesës, pajtohet ta paguajë gjobën.

(6) Bërësi, është i obliguar që ta paguajë gjobën e përcaktuar sipas këtij neni, brenda tetë ditëve prej pranimit të urdhëresës së pagesës, në llogarinë e shënuar në urdhëresën e pagesës. Bërësi i cili do ta paguajë gjobën brenda atij afati, do ta paguajë vetëm gjysmën e gjobës së kumtuar. Mësimi për atë të drejtë është pjesë e mësimi juridik në urdhëresën e pagesës.

(7) Në procedurën e cila do të përfundojë me lëshimin e urdhëresës, nuk paguhen shpenzimet e procedurës në qoftë se gjoba është paguar nga bërësi.

(8) Në qoftë se gjoba nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni, nuk paguhet në afatin e përcaktuar, personat zyrtarë nga paragrafi (3) i këtij neni, janë të obliguar që të parashtrajnë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes para Komisionit të Kundërvajtjes.

(9) Organi kompetent për udhëheqjen e procedurës së kundërvajtjes dhe për kumtimin e kundërvajtjeve nga ky nen, është Komisioni i Kundërvajtjes i formuar në përputhje me Ligjin për ambientin Jetësor.

## **Neni 247**

### **Sanksionet e kundërvajtjes për personat zyrtarë**

Sanksionet e kundërvajtjes për personat zyrtarë, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, kumtohen në përputhje me Ligjin për ambientin jetësor.

## **Neni 248**

### **Procedura për barazimin dhe për ndërmjetësimin**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 243 të këtij ligji, inspektori kompetent nga neni 238 i këtij ligji, është i obliguar që bërësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim, para se të parashtrajë kërkesë për procedurën e kundërvajtjes.

(2) Për kundërvajtjet nga neni 244 i këtij ligji, inspektori kompetent nga neni 238 i këtij ligji, mundet bërësit të kundërvajtjes t'i ofrojë ndërmjetësim dhe arritje të pajtimit me të cilin bërësi i kundërvajtjes duhet ta paguajë gjobën, detyrimet tjera ose t'i mënjanojë pasojat nga kundërvajtja.

(3) Në rastet në të cilët është arritur pajtimi për barazimin, gjoba e bërësit

mund të zvogëlohet më së shumti për një gjysmë nga gjoba maksimale e përcaktuar për kundërvajtjen.

(4) Procedurat për barazimin dhe për ndërmjetësimin, udhëhiqen në përputhje me dispozitat e Ligjit për ambientin jetësor.

## **Neni 249**

### **Udhëheqja e procedurës së kundërvajtjes**

Procedura para komisionit të kundërvajtjes, udhëhiqet në përputhje me dispozitat e Ligjit për ambientin jetësor.

## **XIV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

## **Neni 250**

### **Strategjia Nacionale për ujërat**

Strategjia Nacionale për ujërat do të miratohet më së voni brenda një viti nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

## **Neni 251**

### **Baza e ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë**

(1) Baza e ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë, do të miratohet më së voni brenda katër viteve nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

(2) Deri në hyrjen e Bazës së ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë në fuqi, do të zbatohet Baza ekzistuese e ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë, studimet dhe dokumentacioni tjetër që ka të bëjë me zhvillimin integral të derdhjes së lumit Vardar, që janë miratuar nga organet kompetente, si edhe kadastra e burimeve natyrore, kadastra e puseve dhe e pompave dhe elaborati për ujërat nëntokësorë dhe bazat e ekonomisë së ujërave të miratuara nga komunat dhe nga qyteti i Shkupit.

## **Neni 252**

### **Planet për menaxhimin me derdhjet e lumenjve**

Planet për menaxhimin me derdhjet e lumenjve, do të miratohen brenda gjashtë viteve nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Deri në miratimin e planeve për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve, do të zbatohet Baza ekzistuese e ekonomisë së ujërave të Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe dokumentet nga neni 251, paragrafi (2) i këtij ligji.

Për shkak të përpilimit të planeve për menaxhimin e rrjedhave të lumenjve:

- 1) vlerësimi fillestar i rrjedhave të lumenjve nga neni 71 i këtij ligji, do të bëhet më së voni në afat prej tri viteve nga hyrja e këtij ligji në fuqi;
- 2) programi për monitorimin e kualitetit dhe e kuantitetit të trupave ujorë, do të përpilohet më së voni në afat prej katër viteve nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi dhe
- 3) qëllimet e ambientit jetësor dhe të programit të masave për arritjen e qëllimeve të ambientit jetësor nga neni 73 i këtij ligji, do të përpilohen më së voni në afat prej pesë viteve nga hyrja e këtij ligji në fuqi.

## Neni 253

### Rrjedha ndërkombëtare e lumenjve

Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e punëve të jashtme, në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e ambientit jetësor, me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të fillojë me aktivitetet për fillimin e procedurës për vendosjen e territoreve të rrjedhave ndërkombëtare të lumenjve me shtetet fqinje përkatëse.

## Neni 254

### Të drejtat ujore

(1) Personi juridikë ose fizikë i cili në bazë të pëlqimit të ekonomisë së ujërave, ka aprovim për ndërtimin, për rikonstruktimin, për bashkëngjijtjen ose për ndërtimin plotësues të objekteve ekzistuese të ekonomisë së ujërave dhe të objekteve dhe stabilimenteve të tjera të cilat kanë ndikim mbi regjimin e ujërave, objektet dhe stabilimentet ekzistuese dhe të tjera të cilat kanë ndikim mbi regjimin e ujërave, si edhe personat juridikë dhe fizikë të cilët me kryerjen e punëve të tjera të cilat munden përkohësisht, kohë pas kohe ose përhershëm të krijojnë ndryshime në regjimin e ujërave, është i obliguar që brenda afatit prej një viti nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, të parashtojë kërkesë për lëshimin e lejes nga nenin 26, paragrafi (1) respektivisht neni 79, paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Personi juridikë ose fizikë i cili në bazë të lejes së ekonomisë së ujërave ose të pëlqimit të ekonomisë së ujërave, është bartës i së drejtës për përdorimin ose për shfrytëzimin e ujit dhe për shfrytëzimin e objekteve të ndërtuara të ekonomisë së ujërave dhe të objekteve dhe stabilimenteve të tjera, të cilat kanë ndikim mbi regjimin e ujërave, si edhe të drejtë për derdhjen e ujërave të përdorur ose të shfrytëzuar në recipientin, në bazë të Ligjit për ujërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 4/1998, 19/2000, 42/2005 dhe 46/2006), është i obliguar që brenda afatit prej një viti nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, të parashtojë kërkesë për lëshimin e lejes nga nenin 26, paragrafi (1) respektivisht neni 79, paragrafi (1) i këtij ligji.

(3) Investitorët e objekteve të cilat gjenden në ose përkaj ujërave sipërfaqësore, objektet të cilat kalojnë përmes ose nën ujërat nëntokësore ose po objektet të cilat janë vendosur në afërsinë e ujërave sipërfaqësore ose tokave buzë bregore e të cilët mund të ndikojnë mbi regjimin e ujërave, si edhe investitorët e objekteve nga neni 163, paragrafi (1) të këtij ligji me përjashtimin e digave, janë të obliguar që brenda afatit prej një viti nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, të parashtojë kërkesë për lëshimin e pëlqimit të ekonomisë së ujërave nga neni 174 i këtij ligji, për shkak të përcaktimit të kushteve të ekonomisë së ujërave, të cilat doemos duhet të realizohen gjatë ndërtimit.

(4) Në qoftë se personat juridikë dhe fizikë deri në skadimin e afatit nga paragrafi (1), (2), dhe (3) të këtij neni, nuk parashtojë kërkesë për lëshimin e lejes, respektivisht kërkesë për lëshimin e pëlqimit të ekonomisë së ujërave, leja e ekonomisë së ujërave respektivisht pëlqimi i ekonomisë së ujërave i lëshuar në bazë të Ligjit për ujërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 4/1998, 18/2000, 42/2005 dhe 46/2006), pushon të vlejë.

## Neni 255

### Shkarkimi, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza urbane

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në bashkëpunim me Kryetarin e komunave, të komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit do

të sigurojnë:

- 1) ekzistimin e sistemit për grumbullimin e ujërave të zeza në çdo vendbanim me më shumë se 2.000 ekuivalentë banorë, brenda afatit prej 15 vitesh nga hyrja e këtij ligji në fuqi;
- 2) pastrimin përkatës të të gjitha ujërave të zeza, të cilat derdhen nga sistemet për grumbullimin e ujërave të zeza nga vendbanimet me më pak se 2.000 ekuivalentë banorë, brenda afatit prej 15 vitesh nga hyrja e këtij ligji në fuqi;
- 3) trajtim sekondar (biologjik) ose trajtim i përshtatshëm me të i ujërave të zeza nga sistemet për grumbullimin e ujërave të zeza nga vendbanimet me më shumë se 2.000 ekuivalentë banorë, brenda afatit prej 15 vitesh nga hyrja e këtij ligji në fuqi.
- 4) ujerat e ndotura të cilat lëshohen në zona të ndjeshme të lëshimit të ujërave të ndotura urbane, do t'i nënshtrohen në pastrim më rigoroz nga ajo që është përcaktuar në piken 3 të këtij paragrafi, për aglomeracione më të mëdha se 10.000 e.b.

## **Neni 256**

### **Identifikimi i ujërave për banjë**

Identifikimi i parë i ujërave për banjë nga neni 149, paragrafi (2) i këtij ligji, do të bëhet në afat prej tri vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të rregullës nga neni 104, paragrafi (6) i këtij ligji.

## **Neni 257**

### **Raporti për ujin e dedikuar për konsumim nga njeriut**

Raporti i parë për ujin e dedikuar për konsumim nga njeriu, për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë nga neni 190, paragrafi (2) i këtij ligji, do të miratohet në afat prej tri vitesh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

## **Neni 258**

### **Rrjeti shtetëror për monitorim**

Rrjeti shtetëror hidrologjik ekzistues i stacioneve, me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, bëhet rrjeti shtetëror për monitorim në përputhje me nenin 145 të këtij ligji.

## **Neni 259**

### **Rregullat për zbatim nga ky ligj**

(1) Rregullat më të përafërta për zbatim nga ky ligj, do të nxirren në afat prej tri vitesh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

(2) Deri në hyrjen e rregullave nga paragrafi (1) i këtij neni në fuqi, do të zbatohen rregullat ekzistuese.

## **Neni 260**

### **Këshilli Nacional për ujërat**

Këshilli Nacional për ujërat, do të themelohet brenda afatit prej tre muajsh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

## **Neni 261**

### **Këshilli për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve**

Këshillat për menaxhimin me rrjedhat e lumenjve, do të themelohen

brenda një viti nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

## **Neni 262**

### **Procedurat administrative**

Procedurat administrative të filluara para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundohen sipas Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 4/1998, 19/2000, 42/2005 dhe 46/2006).

## **Neni 263**

(1) Më 1 janar 2010, Fondi për ujërat i themeluar me Ligjin për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 4/1998, 19/2000, 42/2006 dhe 46/2006) pushon të ekzistojë. Organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e ambientit jetësor i ndërmerr mjetet, pajisjet, të punësuarit, si edhe të drejtat dhe obligimet e Fondit për ujërat.

(2) Me 1 janar 2010, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen punëve në lëmin e ambientit jetësor, i ndërmerr arkivin që ka të bëjë me lejet dhe me planet për menaxhimin dhe për shfrytëzimin e ujërave, mjetet, pajisjen dhe të punësuarit nga Drejtoria e Ekonomisë së Ujërave, të cilët kanë punuar në sistemin e lëshimit të lejeve, të përpilimin e planeve dhe inspektorët e ekonomisë së ujërave, do të sistemohen në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e ambientit jetësor.

(3) Organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e ambientit jetësor, në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e bujqësisë, brenda afatit tre mujor nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi, janë të obliguar që të miratojnë plan për transferimin gradual të punëve nga paragrafi (2) i këtij neni prej organit të administratës shtetërore, kompetent për punët në lëmin e bujqësisë në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në lëmin e ambientit jetësor.

(4) Drejtoria e ekonomisë së ujërave, prej 1 janar 2010 vazhdon të punojë si organ në përbërjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, kompetent për çështjet që kanë të bëjnë me bashkësitë ujore dhe ekonomitë e ujërave.

## **Neni 264**

### **Pushimi i rregullave të tjera**

(1) Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 4/1998, 19/2000, 42/2005 dhe 46/2006).

(2) Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, pushon të vlejë neni 3, paragrafi (2), pika 7 e Ligjit për lëndët e para minerale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 24/2007).

## **Neni 265**

### **Hyrja në fuqi dhe zbatimi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet prej 1 janar të vitit 2011, ndërsa dispozitat nga Kreu III dhe Kreu XI i këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen në afat prej 30 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2009):

**Neni 5**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen dispozitat e nenit 132 alineja 1 dhe 2 të Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 4/98, 19/2000, 42/2005 dhe 46/2006).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/20011):

**Neni 14**

Dispozitat më të përafërta nga nenet 2, 4, 7 dhe 11 të këtij ligji do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/20011):

**Neni 15**

Dispozitat e neneve 1, 2 paragrafi (1), 4 paragrafi (1) dhe 7 paragrafi (1) të këtij ligji, do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin të Komisionit Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Dispozitat e nenit 10 të këtij ligji do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/2012):

**Neni 7**

Dispozitat e neneve 1, 2, 3, 5 dhe 6 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për koncesione dhe partneritet privat publik.

**Neni 8**

Dispozitat e nenit 4 paragrafi (3) të këtij ligji me të cilat në nenin 58 të Ligjit për ujëra ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 87/2008, 6/2009, 161/2009, 83/10 dhe 51/11), shtohen tre paragrafë të rinj (7), (8) dhe (9), do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2016.

Deri në ditën e fillimit të zbatimit të dispozitave nga paragrafi

(1) i këtij neni, do të veprohet në mënyrë si vijon:

- mjetet e kompensimit të koncesionit për shfrytëzimin e ujit për prodhim të energjisë elektrike, paguhen në llogari të veçantë në kuadër të llogarisë së trezorit. Të hyrat nga këto mjete ndahen në përpjesëtim 75% të hyra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe 25% në buxhetin e komunave dhe komunave në qytetin e Shkupit, varësisht në rajonin e së cilës kryhet veprimtaria koncesionare,

- mjetet nga paragrafi (2) alineja 1 të këtij neni që ndahen ndërmjet komunave të rajonit të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit, ndahen në përpjesëtim 50% të hyra për komunën e rajonit të qytetit të Shkupit dhe 50% për qytetin e Shkupit dhe

- obligacionet e denacionalizimit mund të shfrytëzohen për pagesë të pjesës së kompensimit të koncesionit për shfrytëzimin e resurseve ujore për prodhim të energjisë elektrike që janë të hyra të Buxhetit të Republikës së



Maqedonisë në lartësi 75% nga shuma e përgjithshme, ndërsa 25% të tjera që janë të hyra të buxhetit të komunave dhe komunave në qytetin e Shkupit, paguhen në llogari të veçantë në kuadër të llogarisë së trezorit.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2013):

**Neni 23**

Dispozitat e nenit 20 paragrafi (2) të këtij ligji me të cilat në nenin 215 të Ligjit për ujëra ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 87/2008, 6/2909, 161/2009, 83/10, 51/11 dhe 44/12), shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5) do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2013.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2013):

**Neni 24**

Regullat më të përafërta nga nenet 16 dhe 17 të këtij ligji do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

**Neni 7**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.

